RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"MBI VEPRIMTARINË EKONOMIKO FINANCIARE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT, TIRANË

AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3-9**
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-7
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7-9
II.	**HYRJA**	**9-15**
II.1.	Objekti i auditimit	
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**15-236**
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	15-17
III.2.	**Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit**	17-233
III.2.1	Mbi funksionin e inspektimit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve.	17-115
III.2.2	Mbi funksionin e inspektimit të Drejtorisë së Pronësisë Industriale dhe Intelektuale.	116-125
III.2.3	Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit (për blerjen e pajisjeve dhe instrumentave për testim dhe inspektim në terren dhe marrjen me qera të ambjenteve për zyra, pajisjeve kompjuterike)	126-218
III.2.4	Mbi administrimin e ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.	219-233
III.2.5	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.	233
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**233-247**
V.	**ANEKSE**	**248-249**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (në vijim ISHMT), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar të institucionit, vlerësimin procedurës së planifikimit dhe kryerjes së inspektimit, masat administrative të vendosura nga inspektorët dhe ndjekja e tyre, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 14.06.2021 deri më datë 06.08.2021, grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.01.2019 deri më datë 30.06.2021për vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, të ISHMT, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, në zbatimin e buxhetit të shtetit për disa procedura, administrimin e vlerave monetare e materiale, planifikimin dhe kryerjen e inspektimit për produktet elektrike, instrumenta matës, kimike, të drejtat e autorit, vendosjen e masave administrative dhe arkëtimin e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej5 akt-konstatime. Në përfundim të punës audituese në terren është kryer takimi ballafaques me përfaqësuesit e ISHMT. Mbi aktet e mbajtura dhe Projekt Raportin e grupit të auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur nga grupi i auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim të auditimit rezultoi se në:

-Janë paguar 1,545,771 lekë për pasurinë e llojit ñBanimò me nr.X (kati i dytë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, sipërfaqe 191.6 m^2, me mangësi në dokumentacionin vërtetues për garantimin e gëzimit të qetë të saj, në kushtet kurkjo pasuri ka qenë e bllokuar në favor të palëve të treta.

-Janë paguar 4,303,094 lekë paradhënie për 6 muaj, për rregullime/punime në objekt, në mungesë të miratimit paraprak të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, në mungesë të referimit ligjor specifik siç kërkohet.

-Procedurat e prokurimit është shkaktuar dëm ekonomik i matshëm ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 1,585,026 lekë, si pasojë e mosdorëzimit të mallrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara, sôkualifikimit të padrejtë të OE renditur i pari, etj.

-Gjithashtu në 3 procedura prokurimi, mallrat janë marrë në dorëzim jo sipas specifikimeve të kontraktuara, element të cilët nuk mund të maten specifikisht, por që janë pjesë përbërëse e kostos përfundimtare të produktit.

-Në 4 raste për gjobat e vendosura në vlerën 700,000 lekë, të cilat janë kthyer në vendim të formës së prerë, nga ISHMT nuk janë marrë masa për ekzekutimin dhe arkëtimin e tyre (kërkesë për lëshimin e urdhërit për ekzekutim/përcjelljen pranë përmbaruesit të vendimit të gjykatës), me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit;

-14 raste (për produktet si instrumenta karburanti, lodra, etj), në këtë procedurë, nuk dokumentohet me foto vendosja shenjave dalluese të bllokimit/vendosja e masës ñbllokimò, si dhe administrimi i produkteve të bllokuara në magazina të dedikuara për këtë qëllim;

-18 raste është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar, si dhe në 12 raste është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga ISHMT nuk është autorizuar ri-inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre;

-26 raste nuk dokumentohet mostërmarrja (mospasqyrim në procesverbal, mungesë të vërtetimit të mostërmarrjes, protokoll-matjeve), si dhe nuk pasqyrohet metoda e përdorur për analizimin e tyre, kryesisht në produktet e parapaketuara dhe lodrat;

-13 raste mostërmarrja është bërë në mungesë të kompetencës ligjore për marrjen dhe testimin e tyre.

-54 raste procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të detajuar për veprimet e inspektorëve përgjatë inspektimit, ku theksojmë se në 32 raste nga 54 gjithësej, në dosjen e inspektimit administrohet një dokument ñwordò jozyrtar dhe i pamiratuar, në të cilin pasqyrohen dhënat për produktet e inspektuara, të dhëna të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalin e inspektimit;
-32 raste nuk është zbatuar pjesërisht/plotësisht objekti i inspektimit përcaktuar në autorizimin e tij (moskryerja e inspektimit të instrumentave matës, markimit CE të produkteve, etj), ku theksojmë se në 11 raste (të subjekteve që tregëtojnë detergjentë) nga 32 gjithësej, inspektimi nuk është kryer aspak, por është anulluar në mungesë të arsyetimit ligjor dhe të aktit të titullarit të institucionit për anullimin e tij, duke mos realizuar në këtë mënyrë, qëllimin e inspektimit pranë këtyre subjekteve;
-11 raste inspektimi është i pavlefshëm, nga të cilat në 5 raste ai është kryer jashtë afatit të përcaktuar në autorizimin e inspektimit, 5 raste baza ligjore e përdorur për verifikimin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga subjekti i inspektuar, ka qenë e shfuqizuar, si dhe në 1 rast vendimi përfundimtar i inspektimit është marrë jashtë afatit 30-ditor nga data e mbajtjes së procesverbalit të inspektimit;
-60 raste ndaj subjekteve që kanë qenë në shkelje të ligjit nuk është marrë masë administrative gjobë, si dhe në 22 raste në 66 gjithësej veç masës administrative gjobë nuk është vendosur ndalimi i përdorimit të instrumentit matës të karburantit, matësave të ujit, tregëtimit të produkteve të ndryshme elektrike, korrigjimit të shkeljeve, njoftimit të konsumatorit, etj;
-7 raste masa administrative e marrë me vendim të ndërmjetëm, është hequr në vendimin përfundimtar të inspektimit në mungesë të arsyetimit ligjor. Kjo për produkte të ndryshme si Rezistenca, Bolier, Panel Diellor, Dekoder dixhital, Kamera inteligjente, Bateri për kompjuter PC, Ngrohës të ndryshëm, Hekur rrobash etj;
-12 raste trajtim me dy standarde në marrjen e vendimeve/kryerjen e veprimeve inspektuese në subjekt;

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i proçedurës së marrjes me qera të ambjenteve për zyra, është konstatuar se: -Janë paguar 1,545,771 lekë për pasurinë e llojit ñBanimò me nr.X + 1-2 (kati i dytë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, sipërfaqe 191.6 m^2, me mangësi në dokumentacionin vërtetues për garantimin e gëzimit të qetë të saj, në kushtet kur kjo pasuri ka qenë e bllokuar në favor të palëve të treta. Veprime që bien në kundërshtim me nenet 674, 802, 806, 807 të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil në RSHò, i ndryshuar, si dhe shkronjat ñaò dhe ñbò të pikës 35, si dhe pikën 36 në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. -Janë paguar 4,303,094 lekë paradhënie për 6 muaj, për rregullime/punime në objekt, në mungesë të miratimit paraprak të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, në mungesë të referimit ligjor specifik siç kërkohet. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikat 160 dhe 161 të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar.	Faqe 126-216	E lartë	ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për fillimin e procedurës për arkëtimin nga pronari i objektit, shtetasi A.N, të dëmit ekonomik në vlerën 1,545,771 lekë, shkaktuar në buxhetin e shtetit. Ministria e Financës dhe Ekonomisë (institucioni epror i ISHMT) të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për fillimin e procedurës së ndërprerjes së kontratës ndërmjet ISHMT dhe shtetasit A.N, kthimin në buxhetin e shtetit të shumës së paradhënies përfituar nga pronari i objektit, në vlerën 4,303,094 lekë, si dhe sigurimin e ambjenteve për zyra për ISHMT. **Menjëherë**
2	Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik për vitin 2020 ñblerje instrumenta dhe pajisje për inspektim në terrenò, është konstatuar se, OE ñN.Vò shpk, i shpallur fitues, nuk ka sjellë sipas specifikimeve teknike në DST,	Faqe 126-216	E lartë	ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, duke i kërkuar OE N.V shpk, të dorëzojë mallrat ñMatës i

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	mallrat e kërkuara në vlerën 2,454,000 lekë.			shkallës së ndriçimit, Seri gramarësh 1g-500g, Seri gramarësh 1mg-500mg, Aparat për matjen e volumit të gazit, Kronometër, si dheTestues izolacioni multimetërò në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara, ose në të kundërt arkëtimin e vlerës 2,454,000 lekë pa TVSH, të produkteve të mësipërme. **Menjëherë**
3	Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me vlerë të ulët për vitin 2020 ñblerje pajisje kompjuterikeò, është konstatuar se, OE ñI.N Alò shpk, i shpallur fitues, nuk ka sjellë sipas specifikimeve teknike, mallrat e kërkuara (kompjutera dhe laptop 20 cop gjithësej) në vlerën 712,450 lekë pa TVSH.	Faqe 126-218	E lartë	ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 712,450 lekë, nga OE ñI.N Alò shpk, si pasojë e mosdorëzimit nga ky i fundit të mallrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara, ose në të kundërt të kërkojë dorëzimin e tyre sipas specifikimeve teknike. **Menjëherë**
4	Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me vlerë të ulët, për vitin 2020 ñPajisje për videokonferencë dhe panel akses kontrolliò, si dhe referuar fletë-hyrjes nr.19, datë 16.12.2020 të hyrjes së mallrave në magazinë e ISHMT, është konstatuar se, nga OE ñA.Oò, person fizik, janë shtuar mallra/shërbime në vlerën 426,000 lekë, të cilat nuk kanë qenë objekt prokurimi sipas Urdhërit të Prokurimit nr.230, datë 07.12.2020, të Titullarit të ISHMT.	Faqe 126-218	E lartë	ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 426,000 lekë, nga OE ñA.Oò person fizik. **Menjëherë**
5	Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me vlerë të ulët për vitin 2021 ñblerje pajisje kompjuterikeò, u konstatua se si pasojë e veprimeve të Komisionit të Prokurimit, sôkualifikimit padrejtësisht[1] nga gara AK të OE ñJ.Bò renditur i pari me ofertën ekonomike në vlerën 290,000 lekë pa TVSH, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 391,200 lekë pa TVSH, diferenca ndërmjet ofertës ekonomike të shpallur fituese në vlerën 681,200 lekë pa TVSH, me ofertën ekonomike të OE renditur i pari në vlerën 290,000 lekë pa TVSH.	Faqe 126-218	E lartë	ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 391,200 lekë, nga personat përgjegjës. **Menjëherë**
	Nga auditimi i praktikave të inspektimit, është konstatuar se në **4 raste** për gjobat e vendosura në vlerën 700,000 lekë ndaj subjekteve (L, A.E, A 2000, M.M), të cilat janë kthyer në vendim të formës së prerë, nga ISHMT nuk janë marrë masa për ekzekutimin dhe arkëtimin e tyre (kërkesë për lëshimin e urdhërit për ekzekutim/përcjelljen pranë përmbaruesit të vendimit të gjykatës), me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit, mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 9, shkronjën b të pikës 4 të nenit 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò dhe nenet 511 dhe 515 të Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 ñKodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar.	Faqe 17-115 dhe 116-126	E lartë	ISHMT të marrë masat e nevojshme për të bërë kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në Gjykatën e Shkallës së Parë/përcjelljen pranë përmbaruesit të vendimit të gjykatës, me qëllim vënien në ekzekutim të gjobave të vendosura, si dhe eleminimin e efekteve negative financiare në buxhetin e shtetit. **Menjëherë**
6	Ngaauditimi i praktikave të inspektimit u konstatua se: -Në **60 raste** ndaj subjekteve që kanë qenë në shkelje të	Faqe 17-115	E lartë	ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në

[1]Nenin 40, pika 5 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, ñpër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	ligjit nuk është marrë masë administrative gjobë, si dhe në **22 raste** në 60 gjithësej veç masës administrative gjobë nuk është vendosur ndalimi i përdorimit të instrumentit matës të karburantit, matësave të ujit, tregëtimit të produkteve të ndryshme elektrike, korrigjimit të shkeljeve, njoftimit të konsumatorit, etj; - Në **7 raste** masa administrative e marrë me vendim të ndërmjetëm, është hequr në vendimin përfundimtar të inspektimit në mungesë të arsyetimit ligjor. Kjo për produkte të ndryshme si Rezistenca, Bolier, Panel Diellor, Dekoder dixhital, Kamera inteligjente, Bateri për kompjuter PC, Ngrohës të ndryshëm, Hekur rrobash etj; **-** Në **12 raste** trajtim me dy standarde në marrjen e vendimeve/kryerjen e veprimeve inspektuese në subjekt; **-** Në **1 rast**, ku nuk është kryer kallëzim penal ndaj subjektit tregëtues të karburanteve, i cili nuk ka lejuar kryerjen e inspektimit, si dhe ka dëmtuar vulat e bllokimit të instrumenteve, duke kaluar në regjim manual të përdorimit të tyre dhe ndërprerje të lidhjes së instrumentit me kasën fiskale. Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 50 dhe nenin 64 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar; Nenin 43, 48 dhe 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Nenin 27, 30 dhe 35 të Ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Nenin 182 dhe 235 të Ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 ñKodi Penal i Republikës së Shqipërisëò, ndryshuar; Nenin 13 dhe pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr.44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò.			konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës. **Në vijimësi**
7	Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në të cilat sipas informacionit të pasqyruar në procesverbalet dhe vendimet e inspektimit, është bërë bllokimi i produkteve të rrezikshme/jo konforme për përdorim nga konsumatori, është konstatuar se **në 14 raste** (për produktet si instrumenta karburanti, lodra, etj), në këtë procedurë, nuk dokumentohet me foto vendosja shenjave dalluese të bllokimit/vendosja e masës ñbllokimò, si dhe administrimi i produkteve të bllokuara në magazina të dedikuara për këtë qëllim, mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën a të nenit 41, shkronjën ç të pikës 2 të nenit 43 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 ñPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò dhe pikën 18 të Kreut III të VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñPër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò.	Faqe 17-115	E lartë	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast. Gjithashtu të analizohet dhe vlerësohet mundësia e investimit në blerjen/ndërtimin/marrjes me qira (alternativa ekonomikisht e favorshme) të një magazine/ambienti të posaçëm, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen/shkatërrohen, të ruhen në këto ambjente, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në këto ambjente, tôu tarifohet subjekteve në të cilat është bërë bllokimi, deri në momentin e asgjesimit/shkatërrimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet, nuk do tôi lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit të futet

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
				përsëri në treg. **Menjëherë dhe në vijimësi**
8	Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në **18 raste** është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar, si dhe në **12 raste** është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga ISHMT nuk është autorizuar ri-inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre, veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 4 dhe 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 ñPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò, dhe pikën 16 të Kreut IV të Urdhrit nr.25, datë 10.08.2018 për miratimin e rregullores ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ.	Faqe 17-115	E lartë	ISHMT të marrë masat e nevojshme, për autorizimin e inspektimeve me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohen shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohen afate konkrete për korrigjimin e tyre duke këshilluar subjektet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**
9	Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në të cilat është marrë mostër për analizë laboratorike/testim për parapaketime, lodra, nga vetë ISHMT/operator të kontraktuar prej saj, në **45 raste** janë konstatuar mangësi të ndryshme: **-** Në **26 raste** nuk dokumentohet marrja e mostrës (*mos pasqyrimi në procesverbal, mungesë të vërtetimit të marrjes së mostrës, protokoll-matjeve*), si dhe nuk pasqyrohet metoda e përdorur për analizimin e tyre, kryesisht në produktet e parapaketuara dhe lodrat; **-** Në **6 raste** sasia e mostrës së marrë për analizë laboratorike nuk është e plotë; -Në **13 raste** marrja e mostrës është bërë në mungesë të kompetencës ligjore për marrjen dhe testimin e tyre. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 4 të nenit 38 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011ñPër inspektimin në RSHò; Pikën 4 të nenit 30 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet jo ushqimoreò, ndryshuar; Kreun I dhe tabelën nr.1 dhe nr.1/a në VKM nr.1352, datë 3.10.2008 ñPër miratimin e rregullores për parapaketimetò, e ndryshuar; Kreun XIX të Urdhrit nr.305, datë 30.5.2014 ñPër procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregutò.	Faqe 17-115	E lartë	ISHMT të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të inspektimit me dokumentacionin e munguar, si dhe për kryerjen e matjeve/testimeve të saktësisë së instrumentit matës së karburantit, në çdo rast që e gjykon të nevojshme tôi drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose personit juridik privat të autorizuar prej DPM. Gjithashtu nga ISHMT të merren masat që çdo procedurë e marrjes së mostrës, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjes fizike dhe asaj online, të jenë: Autorizimi i inspektimit, listë-verifikimi, procesverbali standard i inspektimit (*ku të pasqyrohet marrja e mostrës*), vërtetimi i marrjes së mostrës në rastin e lodrave, si dhe të eliminohet nga përdorimi dokumenti ñprotokoll-matjeò, përdorur për produktet e parapaketuara, si një dokument jo zyrtar. **Në vijimësi**

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

Opinion i kundërt[2]

Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT). Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000.

ñ*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, mbi*

[2] *Sipas **Manualit të Auditimit Përputhshmërisë** të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.66, datë 2306.2020, grupi II pika 7.3.3, Opinion të kundërt nëse aspektet e mospërputhjes janë materiale dhe të përhapura.*

zbatimin e buxhetit të shtetit, administrimin e vlerave monetare e materiale, planifikimin dhe kryerjen e inspektimit për produktet, vendosjen e masave administrative, shqyrtimin dhe arkëtimin e tyre, përgjatë periudhës 01.01.2019-30.06.2021, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kundërt".

Baza për opinionin.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë"*, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 ñ*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë"*. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të ñKundërtò. Dhënien e opinionit i ñKundërtò e mbështesim në konkluzionet e mëposhtme të arritura në përfundim të procesit të auditimit për marrjen e masave në zgjidhjen e çështjeve:

-Auditimin e proçedurës së marrjes me qera të ambjenteve për zyra, është konstatuar se janë paguar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 1,545,771 lekë, shpenzime qeraje, për pasurinë e llojit ñBanimò me nr.X (kati i dytë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, sipërfaqe 191.6 m^2, me mangësi në dokumentacionin vërtetues, për garantimin e gëzimit të qetë të saj, në kushtet kur kjo pasuri ka qenë e bllokuar në favor të palëve të treta;

-Janë paguar 4,303,094 lekë paradhënie për 6 muaj, për rregullime/punime në objekt, në mungesë të miratimit paraprak të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, në mungesë të referimit ligjor specifik siç kërkohet;

-Nga auditimi i procedurave të prokurimit, rezultoi se, është shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 1,585,026 lekë, si pasojë e mosdorëzimit të mallrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara, sôkualifikimit të padrejtë të OE të renditur i pari, etj;

-4 raste për gjobat e vendosura në vlerën 700,000 lekë, të cilat janë kthyer në vendim të formës së prerë, nga ISHMT nuk janë marrë masa për ekzekutimin dhe arkëtimin e tyre;

-14 raste (për produktet si instrumenta karburanti, lodra, etj), në këtë procedurë, nuk dokumentohet me foto vendosja shenjave dalluese të bllokimit/vendosja e masës ñbllokimò, si dhe administrimi i produkteve të bllokuara në magazina të dedikuara për këtë qëllim;

-18 raste është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar, si dhe në 12 raste është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga ISHMT nuk është autorizuar ri-inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre;

-26 raste nuk dokumentohet mostërmarrja (mospasqyrim në procesverbal, mungesë të vërtetimit të mostërmarrjes, protokoll-matjeve), si dhe nuk pasqyrohet metoda e përdorur për analizimin e tyre, kryesisht në produktet e parapaketuara dhe lodrat;

-13 raste mostërmarrja është bërë në mungesë të kompetencës ligjore për marrjen dhe testimin e tyre.

-54 raste procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të detajuar për veprimet e inspektorëve përgjatë inspektimit, ku theksojmë se në 32 raste nga 54 gjithësej, në dosjen e inspektimit

administrohet një dokument ñwordò jozyrtar dhe i pamiratuar, në të cilin pasqyrohen dhënat për produktet e inspektuara, të dhëna të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalin e inspektimit;
-16 raste në inspektimet jashtë planit (mbi bazë indicie/ankesë) autorizimi i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm, pra shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien.
-32 raste nuk është zbatuar pjesërisht/plotësisht objekti i inspektimit përcaktuar në autorizimin e tij (moskryerja e inspektimit të instrumentave matës, markimit CE të produkteve, etj), ku theksojmë se në 11 raste (të subjekteve që tregëtojnë detergjentë) nga 32 gjithësej, inspektimi nuk është kryer aspak, por është anulluar në mungesë të arsyetimit ligjor dhe të aktit të titullarit të institucionit për anullimin e tij, duke mos realizuar në këtë mënyrë, qëllimin e inspektimit pranë këtyre subjekteve;
-11 raste inspektimi është i pavlefshëm, nga të cilat në 5 raste ai është kryer jashtë afatit të përcaktuar në autorizimin e inspektimit, 5 raste baza ligjore e përdorur për verifikimin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga subjekti i inspektuar, ka qenë e shfuqizuar, si dhe në 1 rast vendimi përfundimtar i inspektimit është marrë jashtë afatit 30-ditor nga data e mbajtjes së procesverbalit të inspektimit;
-60 raste ndaj subjekteve që kanë qenë në shkelje të ligjit nuk është marrë masë administrative gjobë, si dhe në 22 raste në 66 gjithësej veç masës administrative gjobë nuk është vendosur ndalimi i përdorimit të instrumentit matës të karburantit, matësave të ujit, tregëtimit të produkteve të ndryshme elektrike, korrigjimit të shkeljeve, njoftimit të konsumatorit, etj;
-7 raste masa administrative e marrë me vendim të ndërmjetëm, është hequr në vendimin përfundimtar të inspektimit në mungesë të arsyetimit ligjor. Kjo për produkte të ndryshme si Rezistenca, Bolier, Panel Diellor, Dekoder dixhital, Kamera inteligjente, Bateri për kompjuter PC, Ngrohës të ndryshëm, Hekur rrobash etj;
-12 raste trajtim me dy standarde në marrjen e vendimeve/kryerjen e veprimeve inspektuese në subjekt;

Përgjegjësitë e Drejtuesve të ISHMT:
Drejtimi ISHMT, është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:
Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të ISHMT, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe efecient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikuam me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/Gjetje nga auditimit, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikuam çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruam ato në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.614/1, datë 15.06.2021miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 14.06.2021 deri më datë 06.08.2021, në ISHMT për periudhën nga 01.01.2019 deri 30.06.2021 u krye auditimi ñMbi funksionimin dhe veprimtarinë ekonomiko-financiareò nga

Grupi i Auditimit me përbërje:

1.K.K, Auditues, Përgjegjës Grupi;
2.V.B, Auditues, Anëtar.

II.1. Objektivi i auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer auditimin e përputhshmërisë mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, të ISHMT, ku objektivi i auditimit ishte: ñDhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, në:

-Hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;
-Administrimin e vlerave monetare e materiale;
-Planifikimin dhe kryerjen e inspektimit, vendosjen e masave administrative dhe arkëtimin e tyre;
-Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.

-Fushëveprimi i auditimit:Veprimtaria audituese në auditimin e ISHMT, përfshiu periudhën e audituar nga data 01.01.2019 deri 30.06.2021.Theksojmë se aktiviteti i inspektimit përgjatë vitit 2020, ka qenë i kufizuar referuar këtu Urdhrit të Prefektit të Qarkut Tiranë, për ngritjen e grupeve të përbashkëta të monitorimit të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19; Urdhrit nr.28, datë 21.10.2020 të Inspektorit të Përgjithshëm ñPër bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokolleve të sigurisë në kuadërt të Task-Forcës anti COVID-19ò, me qëllim zbatimin e masave të sigurisë dhe senzibilizimin e qytetarëve për mbajtjen e maskave.

II.2. Qëllimi i auditimit.

Dhënia e opinionit dhe lëshimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime në të ardhmen.

II.3. Identifikimi i çështjes.

ISHMT duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj taksapaguesit, duke patur në fokus kryesor, garantimin e sigurisë së produkteve joushqimore. Auditimi u fokusua në fushat e aktivitetit të ISHMT, sipas vlerësimit dhe kategorizimit të riskut (i lartë, i mesëm dhe i ulët), pasqyruar në tabelën nr.1, Kapitulli ñAneksetò.

II.4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

ISHMT si dhe niveli drejtues i saj (Kryeinspektori dhe niveli i mesëm drejtues) kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

II.5.Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjen që është nën auditim. Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

II.6.Kriteret e vlerësimit.

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

Lloji i dokumentit	Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore
Standarde auditimi dhe kuadri ligjor i KLSH:	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC; Ligji nr.154/2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Rregullore e Brendshme ñMbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-sëò, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.85, datë 30.06.2015 i ndryshuar; Rregullore ñMbi Procedurat e auditimit në KLSHò, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë;
Ligje:	Ligji nr.44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr.7895, datë 27.01.1995 ñKodi Penal i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar; Ligji nr.25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò; Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò; Ligji nr.10279, datë 20.5.2010 ñPër Kundërvajtjet Administrativeò; Ligji nr.10489, datë 15.12.2011, ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, ndryshuar; Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò, ndryshuar Ligji nr.10480, datë 17.11.2011, ñPër sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimoreò, ndryshuar; Ligji nr.68/2012 ñPër informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energjiò, ndryshuar; Ligji nr.9875, datë 14.2.2008 ñPër metrologjinëò, ndryshuar; Ligji nr.35/2016 ñPër të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me toò, ndryshuar; Ligji nr.10216, datë 21.01.2010, ñPër detergjentëtò, ndryshuar.
Vendime të Këshillimit të Ministrave (VKM)	VKM nr.36 datë 20.1.2016,ñPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT-sëò; VKM nr.696, datë 16.8.2013 ñPër përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik ñe-inspektimiò; VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuarò; VKM nr.1351, datë 03.10.2008 ñPër miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluaraò, i ndryshuar; VKM nr.1352, datë 03.10.2008, ñPër miratimin e rregullores per parapaketimetò, i ndryshuar; VKM nr.349, datë 29.04.2020, ñPër miratimin e rregullit teknik ñPër pajisjet

	elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionitò dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuaraò, i ndryshuar; VKM nr.480 datë 03.06.2015 ñPër miratimin e rregullave teknike për aparatet marrëse televizive, që do të vendosen në tregò, i ndryshuar;; VKM nr. 220, datë 28.3.2012 për përcaktimin e standardeve, metodave të testimit dhe kufijtë e lejuar për biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente, i ndryshuar; VKM nr. 262, datë 3.4.2013 për miratimin e rregullit teknik ñpër sigurinë e lodraveò , i ndryshuar;
Akte të tjera nën ligjore:	Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 10.8.2018 ñPër miratimin e rregullores, ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 19.02.2015 ñPër e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeveò; Urdhër nr.305, datë 30.5.2014 ñPër procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregutò; Urdhër nr.52, datë 16.07.2018 ñPër miratimin e rregullores për procedurat e hollësishme të shqyrtimit të ankimit administrative nga komisioni i ankimit pranë ISHMTò; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar; Udhëzim i MZHETS nr.177, datë 26.12.2013 ñPër metodat e klasifikimit të risqeve dhe vlerësimit të riskut seriozò; Rregullore e brendshme;

II.7.Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara, si rrjedhojë edhe Raporti Përfundimtar i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara.

II.8.Metodat e auditimit.

1. Ekzaminimi i dosjeve të inspektimit;
2. Verifikimi i transaksioneve;
3. Rillogaritja/kontroll aritmektik të veprimeve financiare;
4. Kryqëzimi i të dhënave;
5. Kombinim i dy metodave, procedurave thelbësore analitike dhe testimi i praktikave të inspektimit;
6. Vlerësimi i auditimit të brendshëm

II.9.Dokumentimi i auditimit.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve5 gjithsej, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili shërbeu si materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Vlerësimi i materialitetit mbi shpenzimet e institucionit, pasqyruar në tabelën nr.2, Kap. ñAneksetò[3]

- Niveli i materialitetit: 2% * 57,592,102 lekë = 1,376,120 lekë;
- Gabimi i lejuar: 1,376,120 lekë * 10% = 137,612 lekë;
- Saktësia: 1,376,120 lekë ï 137,612 lekë = 1,238,508 lekë;
- Preçizioni i materialitetit ose gabimet e mundshme për gjithë popullatën (vlerën totale të shpenzimeve të institucionit) 1,238,508 lekë * 90% = 1,114,657 lekë;
- Numri i çështjeve për tu shqyrtuar për totalin e popullatës: (68,806,000 lekë * 0.7 faktorin e riskut) : 1,238,508 lekë = 38 çështje;
- Numri i çështjeve për tu shqyrtuar për një nga llogaritë ekonomike që ka risk më të lartë se të tjerat, në gjykimin e grupit të auditimit, mallra dhe shërbime, (9,676,000 lekë * 0.7)/ 1,238,508 lekë = 5 ose 6 çështje.

Gjatë planifikimit dhe ushtrimit të auditimeve të përputhshmërisë, Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat dhe rregulloret përkatëse. Shkeljet apo gabimet, janë materiale (në kuptimin e rëndësisë) nëse ato, të shkëputura ose të mbledhura me gabime të tjera, ndikojnë në konkluzionet kryesore të auditimit.
Përcaktimi i materialitetit sipas **sasisë** përfshin gjykimin mbi nivelin maksimal të pranueshëm të shmangies së përputhshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret, etj.

Materialiteti vlerësohet në nivelin 2%.
Për më tepër, në disa raste shmangiet nga përputhshmëria, mund të mos jenë materiale nga ana sasiore, - për shkak të natyrës së tyre ose për shkak të kontekstit në të cilin ato lindin ï janë materiale nga ana **cilësore** dhe në këtë mënyrë kanë ndikim në zbulimet dhe konkluzionet e auditimit.
Vlerësimi i **risku**t, në auditimet e përputhshmërisë, është një parashikim i arsyeshëm, lidhur me nivelin e mundshëm të shmangieve përsa i takon përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke patur parasysh tre komponentët e riskut të auditimit:
Risku i brendshëm, i shmangies nga përputhshmëria apo gabimeve, vlerësohet të jetë i mesëm për shkak të:
- Kompleksitetit të kuadrit rregullator dhe kohës në të cilën është miratuar kjo bazë ligjore.
- Ndryshimet e shpeshta të strukturës organizative.

Risku i kontrollit është risku që një shmangie materiale (e rëndësishme) mund të ndodhë dhe që nuk parandalohet, zbulohet dhe korrigjohet në kohën e duhur, nga sistemet e kontrollit të brendshëm. Risku i kontrollit vlerësohet i mesëm duke qenë se ekzistojnë procedura të kontrollit me anë të konfirmimeve nga palë të treta gjatë zhvillimit të procedurës.
Risku i moszbulimit është risku që auditimi të mos zbulojë shmangie materiale të ndodhura dhe që nuk janë parandaluar apo zbuluar dhe korrigjuar në kohën e duhur nga sistemi i kontrollit të brendshëm të njësisë, entit, departamentit, agjencisë, organizatës, institucionit, etj. Risku i moszbulimit do të jetë i ulët duke marrë parasysh nivelin e pranuar të riskut dhe riskun e vlerësuar të brendshëm dhe atë të kontrollit.[4]

-Nisur nga sa më sipër, nga vlerësimi i riskut të brendshëm (RB), riskut të kontrollit të brendshëm (RKB) dhe riskut të zbulimit (RZ), ku dy risqet RB dhe RKB, ndikojnë në aktivitetet e

[3]Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, Kapitulli 3.4 ñMaterialitetiò
[4]Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, Kapitulli 4.3.2 - Për të ruajtur nivelin e riskut të auditimit (deri 5 %) të përcaktuar në politikat audituese të KLSH-së, sa më i lartë të vlerësohet nga audituesit niveli i riskut të brendshëm dhe/ose të kontrollit, aq më i ulët duhet të jetë risku i mos zbulimit.

institucionit, kemi bërë kategorizimin e riskut të aktiviteteve dhe përzgjedhjen e kampionit të auditimit, të cilat gjykojmë të auditojmë, pasqyruar në tabelën nr.1, Kap. ñAneksetò.

Kampionimi (Përzgjedhja e kampionëve të veçantë dhe testimi i tyre):[5]
Për përzgjedhjen e kampionit, të cilin audituam sipas fushave, kryesisht të inspektimeve, pasi për shpenzimet sipas llogarive ekonomike, e kemi përcaktuar nëpërmjet vlerësimit të materialitetit, jemi mbështetur në disa kritere, shtresëzim dhe nënshtresëzim, nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga subjekti që do të auditohet, përgjatë fazës së planifikimit.
Konkretisht, për funksionin e inspektimit nga DMP, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut në nivel të lartë, kriteret për përzgjedhjen e kampionit janë si më poshtë vijon:
1. Kemi përzgjedhur subjektet të cilat i gjykojmë me risk të lart dhe të mesëm, për nga produktet që tregëtojnë ose përdorin kryesisht inspektimet e produkteve të instrumentave matës, produkteve me përmbajtje lëndë kimike (lodra, detergjentë), produktet elektrike dhe inspektimet për të drejtat e autorit.
2. Kemi përzgjedhur muajt, të cilët kanë numrin më të lartë të inspektimeve, me qëllim që kampioni të jetë sa më gjithëpërfshirës;
3. Brenda këtyre muajve kemi përzgjedhur inspektimet në të cilat janë vendosur masa administrative, gjoba, bllokim produkti, sekuestrim, asgjesim;
4. Gjithashtu përgjatë gjithë vitit, kemi përzgjedhur praktika inspektimi të cilat janë autorizuar, bazuar në indicie, ankesa, dhe inspektimet alert, pra ato me urgjencë, si dhe inspektime në të cilat është vendosur vetëm masa administrative ñParalajmërimò dhe zbatim detyrash brenda afatit të caktuar nga inspektorët.

Struktura e kontrollit të brendshëm të njësisë që auditohet.
Siç e kemi theksuar edhe më sipër, riskun e kontrollit të brendshëm e kemi vlerësuar të mesëm, për arsye se ekzistojnë disa proçedura të kontrollit të brendshëm, por dobësia vihet re në zbatimin e tyre.
-Konkretisht struktura e ISHMT, është e mirë-organizuar, por ka pasur një numër të theksuar vëndesh vakante, si dhe më kryesorja është se, për 3 muaj (Qershor-Shtator) të vitit 2019, ky institucion nuk ka patur Kryeinspektor.
-Gjithashtu nga vlerësimi paraprak i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se në mënyrë të përsëritur nuk janë marrë masa, për rastet e mosrealizimit të planit të miratuar të inspektimeve, si dhe mosmarrjen e miratimit paraprak nga Inspektori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, për rastet e ndryshimit të planeve mujore të inspektimit.
-Mungesa e një strategjie afat-mesme (3 vjeçare), me qëllim përcaktimin e objektivave, dhe masave për realizimin e tyre.
-Kryerja e disa funksioneve, ose marrja e disa kopetencave, të cilat nuk kanë mbështetje ligjore.
-Mangësi në procedurat e kontabilitetit të plotë, të vërtetë, të saktë dhe në kohën e duhur për të gjitha operacionet.

- Sa më sipër, vlerësojmë se, pavarsisht faktit se ISHMT, është një strukturë varësie nga MFE, buxheti i alokuar, nuk është i lartë, ky institucion konsiderohet me risk të lartë, përsa i përket natyrës së aktivitetit që kryen, ndjeshmërisë së lartë që ka, ndërgjegjësimin e biznesit, në garantimin e sigurisë së produkteve joushqimore.

[5] Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, Kapitulli 5.7 - Përzgjedhja e disa artikujve të veçantë bëhet në rastet kur audituesi zgjedh brenda popullatës vetëm artikuj me karakteristika të veçanta. Këto përgjithësisht i korrespondojnë artikujve me risk të lartë ose me vlerë të lartë brenda popullatës së përzgjedhur.

III.PËRSHKRIMI AUDITIMIT

III.1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

1. ISHMT-ja ka për mision garantimin e sigurisë së produkteve joushqimore për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/në përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi. ISHMT-ja është, gjithashtu, përgjegjëse për të monitoruar respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale, objekt inspektimi.

2. ISHMT, është krijuar dhe funksionon nëpërmjet VKM nr.36, datë 20.01.2016 ñPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregutò, i ndryshuar. Ky institucion është në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë. ISHMT është e organizuar si Drejtori e Përgjithshme dhe e shtrinë juridiksionin e vet në të gjithë territorin e vendit.

Struktura e ISHMT është miratuar me Urdhrin nr.107, datë 31.07.2018, në fuqi deri më datë 31.07.2020 dhe është ndryshuar me Urdhrin nr.73, datë 01.06.2020 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

Ky institucion, deri në ndryshimin e strukturës është organizuar në tre nivele, Drejtoria e Përgjithshme, 3 Drejtori dhe 1 Sektor.

Niveli i Drejtorisë së Përgjithshme Përfaqësohet nga Kryeinspektori (1 punonjës), i cili drejton:
1.Drejtorinë Teknike (1 Drejtor + 4 Inspektor);
2.Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Produkteve (1 Drejtor), e cila ndahet në 4 sektor, ai i produkteve mekanike, produkteve elektrike, metrologjik dhe sektori i qelqit, këpucëve, detergjentëve dhe sigurisë së produkteve (4 Përgjegjës sektori dhe 31 Inspektor);
3.Drejtorinë e Pronësisë Industriale dhe Inteëlektuale (1 Drejtor), e cila ndahet në sektorin e pronësisë industriale dhe sektorin e të drejtës së autorit (2 Përgjegjës sektori dhe 15 Inspektor);
4.Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (1 Përgjegjës sektori dhe 8 Specialist).
Pra gjithësej janë 69 punonjës.

Me Urdhrin nr.73, datë 01.06.2020, u bënë ndryshimet si vijon:
-U shtua numri i stafit në Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve, nga 36 punonjës u bë 42;
-U shtua numri i stafit të Drejtorisë Teknike, nga 5 punonjës u bë 7;
-Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse kaloi në nivel Drejtorie, dhe ndahet në Sektorin Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektorin e Financës (1 Drejtor, 2 Përgjegjës sektori dhe 9 Specialist).
Pra gjithësej me ndryshimin e datës 01.06.2020, janë 80 punonjës.

ISHMT ka si funksion:

a) Inspektimin metrologjik (instrumentat matës, parapaketimet);
b) Inspektimin e produkteve elektrike;
c) Inspektimin e detergjenteve, lodrave, tekstilit, etj;
d) Inspektimin e produkteve mekanike (ashensor, pajisje të mbrojtjes personale, makineri të ndryshme);
e) Inspektimin për respektimin e detyrimeve ligjore të mbrojtjes së pronësisë industrial;
f) Inspektimin për respektimin e detyrimeve ligjore të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të autorit.

- Sipas rastit ISHMT, kryen edhe mostëmarrje për analiza laboratorike, kryesisht të lodrave, ku mostrat dërgohen jashtë vendit, pasi në Shqipëri nuk ka laborator të tillë.
- Procedura e inspektimit iniciohet me lëshimin e autorizimit nga Kryeinspektori, në të cilin përcaktohet subjekti, kohëzgjatja, çfarë do të inspektohet, si dhe grupi i inspektorëve.

-Nga grupi i inspektorëve, gjatë inspektimit në terren, pranë subjektit, plotësohet listë-verifikimi, procesverbali i inspektimit, në të cilin pasqyrohen veprimet, shkeljet, lihet detyrë për dorëzim

dokumentacioni, marrje mostrash, si dhe vendimi përfundimtar i inspektimit i cili merret nga grupi i inspektimit.
-Çdo sektor i inspektimit ka planin vjetor të inspektimit (me përjashtim të sektorit të pronësisë industriale, pasi referuar Ligjit nr.9947, datë 07.07.2008 ñPër pronësinë industrialò, i ndryshuar, ky sektor kryen inspektime vetëm mbi bazë ankese) dhe më pas bëhet konsolidimi i tij, si dhe i dërgohet Inspektoratit Qendror të Republikës së Shqipërisë për mendim. Pas dhënies së mendimit nga Inspektorati Qendror, plani vjetor i inspektimit miratohet nga Ministri i Financës dhe Ekonomisë, në rolin e institucionit epror të ISHMT.

▪ Inspektorët e ISHMT, në rastin e konstatimit të shkeljeve ligjore nga subjektet, përgjigjes pozitive (jashtë standardit) nga analiza laboratorike, kanë të drejtë të bllokojnë mallin, sekuestrojnë, dhe të marrin masat për asgjesimin e tij, me shpenzimet e subjektit, duke qenë të pranishëm gjatë procesit të asgjesimit të produktit, dhe dokumentimit të këtij procesi.
▪ ISHMT gjeneron të ardhura nga gjobat, **të cilat kalojnë automatikisht në buxhetin e shtetit**.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

III.2.1.Auditimmbi funksionin e inspektimit të drejtorisë së mbikëqyrjes së produkteve.
Në vija të përgjithshme rezultoi se:
-ISHMT nuk ka një manual/metodikë të posaçëm/e për përllogaritjen e riskut, planifikimin e inspektimit dhe kryerjen e tij mbi bazë risku[6].
-Nga ISHMT nuk është respektuar detyrimi ligjor i përcaktuar në pikën 2, të nenit 10 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, ku është detyrim kur në rastet kur ligji i posaçëm vendos kufij minimalë dhe maksimalë për vlerën e dënimit me gjobë, për hartimin dhe miratimin e metodikës për përcaktimin e vlerës së gjobës.

Respektimi i përcaktimeve ligjore në kryerjen e inspektimeve, dokumentimin e procedurës së inspektimit, vendosjen e masave administrative, bllokimin dhe administrimin e produkteve të bllokuara, arkëtimin e gjobave, trajtuar si më poshtë vijon:

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2018-002577-1 datë 17/01/2019. Subjekti-E. Grupi i inspektimit:G.N, A.H,A.H. Inspektimi ISHMT-DQ-2018-002578-1 datë 21/01/2019. Subjekti-G. Grupi i inspektimit:G.N, A.H,A.H. Inspektimi ISHMT-DQ-2018-002581-1 datë 11/1/2019. Subjekti-K. Grupi i inspektimit: L.L, A.H,A.H. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000102-1 datë 5/2/2019. Subjekti-E.A 2008. Grupi i inspektimit: G.N,A.H,E.S. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000173-1 datë 13/3/2019. Subjekti-S.Eshpk. Grupi i inspektimit: A.H,L.L,E.D. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000174-1 datë 15/3/2019. Subjekti-S.R. Grupi i inspektimit: A.H,L.L,E.D. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000356-1 datë 19/4/2019. Subjekti-A.S. Grupi i inspektimit: A.H,E.S,E.D. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000374-1 datë 17/4/2019. Subjekti-G. Grupi i

[6] Pika 1.3 në kapitullin 1 në urdhërin nr.13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSHò; Neni 3 në Urdhërin nr.6, datë 19.02.2015 ñPër miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskutò;

	inspektimit: A.H,E.S,E.D,Dh.C. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-001749-1 datë 16/10/2019. Subjekti-T. Grupi i inspektimit: A.H,E.S,A.H. -Procesverbalet e inspektimit nuk japin informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, emrin, llojin, numrin serial, si dhe sa prej tyre u përzgjodhën për inspektim. Përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi duhet të kryhet nëpërmjet dokumenteve standard të miratuara; -Në rastet inspektimit të subjekteve E, G, K, EA, SE, sipas informacionit të pasqyruar në listë-verifikim/procesverbal, subjektet kanë qenë në shkelje të kërkesave ligjore (mungesë të deklaratave të konformitetit dhe fiksimit të markimit CE), dhe nga inspektorët është marrë vendim i ndërmjetëm për ndalimin e përkohshëm të tregëtimit të produkteve duke përcaktuar afatin konkret, por në procesverbalin e inspektimit nuk është plotësuar pika 4 dhe 5 për dorëzimin e dokumentacionit të munguar brenda afatit të caktuar, kjo në rastin e inspektimit të subjektit G, pasi në rastet e tjera është plotësuar. Gjithashtu në kushtet e mësipërme, përcaktohet detyrimi që subjekti të ruajë një kopje të dokumentacionit teknik dhe deklaratës së konformitetit, pra në momentin e inspektimit subjekti duhet ti ketë këto dokumente dhe nëse nuk i ka, ndaj tij vendoset masë administrative gjobë, ndalim i përkohshëm i tregëtimit të produkteve përkatëse (me vendim të ndërmjetëm, veprim të cilin inspektorët e kanë kryer) dhe korrigjim të shkeljes brenda afatit të caktuar; -Në rastin e subjektit E, në vendimin përfundimtar të inspektimit, është hequr masa për ndalimin e tregëtimit të produkteve pa markimin CE, nga masa e marrë në vendimin e ndërmjetëm, dhe kjo në mungesë të arsyetimit dhe dokumentacionit të rregullt dhe ligjor. -Ndryshe është vepruar në rastin e subjekteve G dhe K, ku për produktet pa markim CE, të cilat me vendim të ndërmjetëm ishin ndaluar për tregëtim, po i njëjti qëndrim është mbajtur edhe në vendimin përfundimtar të inspektimit. -Në rastin e inspektimit të subektit G, në të cilin me vendim të ndërmjetëm është bërë ndalimi përkohësisht i produkteve dhe i sasisë së tyre: 1-Rezistence 3000W cop-100; 2-Bolier LDV 60L cop-10; 3-Panel Diellor LDV 120L cop-2; 4-Panel Diellor LDV 250L cop-1. **Ndërkohë** në vendimin përfundimtar nuk pasqyrohet sasia e produkteve të ndaluara për tregëtim, por jepet vetëm modeli i tyre, çka nuk e bënë të plotë masën administrative të dhënë nga inspektorët. -**Theksojmë se ky subjekt** është prodhues i paneleve diellore, bolierëve, dhe në këto kushte ai ka detyrimin që të hartoj dokumentacionin teknik dhe kryen procedurat e vlerësimit të konformitetit, të zbatueshme ndaj këtij produkti. Kur nga këto procedura tregohet/demonstrohet përputhshmëria e produktit me kërkesat e zbatueshme, prodhuesi harton deklaratën EC të konformitetit dhe vendos/fikson markimin e konformitetit. 3. Prodhuesi mban dokumentacionin teknik dhe deklaratën EC të konformitetit pas vendosjes së produktit në treg, sipas përcaktimit në rregullat teknike përkatëse; -Në rastin e inspektimit të subektit EA, sipas listë-verifikimit pasqyrohet informacioni se: 1.Produkti I-IT-IV600W, është pa markimin CE të fiksuar; 2.Produkti I-IV400W, është pa markimin CE të fiksuar;

	3.Zgjatues Cable S ï Power C14, është pa markimin CE të fiksuar; **Ndërkohë** me vendim të ndërmjetëm dhe atë përfundimtar ndalohen për tregëtim vetëm zgjatues Cable S ï Power C14, pra jo edhe dy produktet e tjera, duke vepruar me dy standarde; -E njëjta situatë është edhe në rastin e inspektimit të subjektit SE, për produktin C-S-K-AH25WH; -Në rastin e inspektimit të subektit G, në të cilin me vendim të ndërmjetëm është bërë ndalimi përkohësisht i produkteve: 1-Dekoder D,Marka: M, Modeli: 276327801 **Sasia: 1094 cop**; **Ndërkohë** në vendimin përfundimtar nuk pasqyrohet asnjë masë administrative, si dhe as ndalimi i përhershëm i produkteve të mësipërme, të cilat nuk kanë patur të fiksuar markimin CE. -**Theksojmë** se ky subjekt është importues i produkteve të mësipërme, dhe në këto kushte ai ka detyrimin që përpara vendosjes së produktit në treg, të siguroj se: a) prodhuesi i ka kryer procedurat e duhura të vlerësimit të konformitetit dhe ka përgatitur dokumentacionin teknik; b) produkti mban markimin e konformitetit të kërkuar ose markime të tjera dhe shoqërohet nga dokumentacioni i kërkuar; -Markimi CE në produktin dekoder, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në nenin 9 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; -Deklaratat e konformitetit të sjella nga subjektet e mësipërme nuk janë sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2 të nenit 8 Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar, dhe në këto kushte nuk duhet të administrohen në dosjen fizike të inspektimit, si provë sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit; Në këto kushte në vendimin përfundimtar ndaj subjekteve të mësipërme, duhet të ishte vendosur ndalimi i përhershëm i tregëtimit të produkteve, si dhe për më tepër, që edhe pas vendosjes së detyrimit për plotësimin e dokumentacionit brenda afatit të caktuar, detyrim i cili nuk është zbatuar, në kushtet kur dokumentacioni i sjellë nga subjektet është i pasaktë; -Në inspektimet e mësipërme, listë-verifikimi nuk është plotësuar siç duhet, për më tepër për ato përcaktime ligjore që lidhen drejtëpërdrejtë me produktin, konkretisht rrjeshti 4-7. **Theksojmë** se në rastin e subjektit K nuk është plotësuar i gjithë listë-verifikimi; -Në vendimin përfundimtar të inspektimit pranë subjektit K, SE, SR, lidhur me ndalimin e përhershëm të tregëtimit të produkteve, **nuk pasqyrohet sasia e tyre,** e cila është ndaluar për tregëtim, çka nuk e bënë të plotë masën administrative të dhënë nga inspektorët; -Në rastet e mësipërme, ku është ndaluar në mënyrë të përhershme tregëtimi i produkteve, inspektorët në vendimin përfundimtar, duhet të kishin vendosur një ose disa masa të tjera, si: a) lajmërimin e konsumatorëve ose të përdoruesve të fundit, duke përdorur mjetet e përshtatshme të komunikimit publik për rrezikun që paraqet produkti/instalimi; b) urdhërimin për ndalimin e menjëhershëm të tregtimit, në qoftë se produkti është tashmë në treg, ose kthimin mbrapsht të tij; c) urdhërimin e bërjes jofunksional të produktit/instalimit në shërbim ose shkatërrimin e tij; **Por që asnjë** prej këtyre masave shoqëruese nuk është dhënë, çka e bënë të pa plotë masën administrative në vendimin përfundimtar. **Theksojmë** se në mënyrën e vepruar nga Inspektorët në inspektimet e mësipërme,

	nuk garantohet nëse subjekti mund të tregëtojë më pas nga produktet e ndaluara, ose mund të vendosë markim CE të falsifikuar. -Në të gjitha rastet e mësipërme, vendimi përfundimtar nuk është marrë në datën e mbarimit të vendimit të ndërmjetëm, ose ai është marrë rreth **5-15 ditë me vonesë** (në rastin e subjekteve SE, EA, E, SR, G, etj), **ç'ka do të thotë se**, nga data e mbarimit të afatit të vendimit të ndërmjetëm deri në marrjen e vendimit përfundimtar, mbi subjektet nuk rëndon asnjë detyrim për ndalimin e tregëtimit të produkteve; -Në inspektimin e subjektit AS, vendimi përfundimtar i inspektimit është marrë **jashtëafatit 30 ditor** nga data e mbajtjes së procesverbalit. Konkretisht procesverbali është mbajtur më datë 19.04.2019 dhe vendimi përfundimtar është mbajtur më datë 31.05.2019 (12 ditë vonesë); -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës nuk administrohet në praktikën online të inspektimit; -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës fizike, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e markimit CE të produkteve të inspektuar në subjektet e mësipërme; -Nuk është respektuar afati për korrigjimin e shkeljeve brenda datës **03.05.2019**, në rastin e subjektit G dhe në këto kushte në vendimin përfundimtar, në rastet kur subjekti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar, ndaj tij duhet të vendoset masë administrative gjobë, por që nuk është vepruar kështu. **-Theskojmë** se në rastin e subjektit G, në mbarimin e afatit të vendimit të ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente, subjekti ka bërë kërkesë për shtyrje afati për dorëzimin e dokumentacionit nga data 31.10.2019 deri më datë 07.11.2019, ku theksojmë se përsëri nuk e ka respektuar afatin e kërkuar vetë prej tij, dhe nga inspektorët nuk është vendosur asnjë masë administrative. -Kërkesa e subjektit nuk duhet të ishte pranuar pasi, ka kaluar afati 5 ditor për ankesën që duhet të bënte subjekti ndaj vendimit të masës urgjente;
Kriteri	Pika 1 e nenit 39, shkronja ñaò neni 41, pika 6 e nenit 43, pika 1 e nenit 44, pika 3 pika 4 e nenit 45, pika 1 e nenit 46, pika 4 e nenit 48, neni 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 2 e nenit 8, neni 9, neni 11, 12, 13, pika 7 e nenit 30, neni 35 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 4 e nenit 8 në Ligjin nr.68/2012 ñPër informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energjiò; Pika 6.2 dhe 6.4 në VKM nr.1061, datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik ñPy r pajisjet elektrike ty projektuara py r py rdorim brenda disa kufijve të tensionitò dhe py rcaktimin e listy s së standardeve të harmonizuaraò; Pikës 4 në Kreun II dhe shtojca 2 në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve;

	Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000456-1 datë 17.04.2019. Subjekti-L.A. Grupi i inspektimit:I.B, A.M. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin e tyre, si dhe sa u inspektuan, si dhe sa prej tyre ishin pa markimin CE, përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi duhet tëkryhet nëpërmjet dokumenteve standard të miratuar; -Ndaj subjektit veç mungesa e markimit CE, është cituar edhe mungesa e barkodit të produktit, informacion i cili nuk është pasqyruar edhe në inspektimet e subjekteve: RK, P, C 2018, EG, çõka tregon trajtim me dy standarde të subjekteve të inspektuara; -Ndaj subjektit, megjithëse ai ka qenë në shkelje të ligjit, nuk është marrë masë administrative gjobë, ndryshe nga si është vepruar në rastin e inspektimit të subjektit A-17, çõka tregon trajtim me dy standarde të subjekteve të inspektuara; -Në vendimin përfundimtar nuk është përcaktuar afati konkret se kur duhet bërë shkatërrimi i produkteve; -Nuk dokumentohet me foto bllokimi i produkteve, vendosja e shenjave dalluese dhe marrja e tyre në administrim. Për më tepër që nëse i referohemi përcaktimit të bërë në

	pikën 2 dhe 3 të nenit 3 në Ligjin nr.10480, datë 17.11.2011 ñPër sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimoreò, ndryshuar, këto produkte janë të rrezikshme, dhe në kushte të tilla në zbatim të nenit 14 të ligjit të mësipërm, inspektori ka kompetencë edhe sekuestrimin e produkteve që nuk janë të sigurta. ▪ Për verifikimin e respektimit të detyrimit të lënë në këtë inspektim, pra të ndalimit të tregëtimit të produkteve, nuk është kryer një inspektim i ri. Për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit të mësipërm, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar; Pika 4 në Kreun II, në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Neni 13 në Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò; Pika 3 e nenit 45, pika 4 dhe 5 e nenit 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 2 dhe 3 e nenit 3, neni 14 në Ligjin nr.10480, datë 17.11.2011 ñPër sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimoreò, ndryshuar, këto produkte janë të rrezikshme.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative,

	tëmarrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2018-000097-1 datë 26.02.2019. Subjekti-P. Grupi i inspektimit:I.Xh, O.B, A.M. Inspektimi ISHMT-DQ-2018-000074-1 datë 25.02.2019. Subjekti-RK. Grupi i inspektimit:I.Xh, O.B, A.M. Inspektimi ISHMT-DQ-2018-001542-1 datë 30.01.2019. Subjekti-V 2018 shpk. Grupi i inspektimit: I.Xh, I.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2018-002515-1 datë 23.01.2019. Subjekti-EG. Grupi i inspektimit: I.Xh, I.B. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin e tyre, si dhe sa u inspektuan, përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi duhet tëkryhet nëpërmjet dokumenteve standard të miratuar; -Në dosjen fizike nuk administrohet listë-verifikimi i mbajtur në inspektim, si dhe ai që është në portalin online e-inspektimi nuk është plotësuar nga inspektorët; -Nuk administrohet asnjë dokument bashkëlidhur praktikës (deklarata konformiteti, udhëzim përdorimi, etj), lidhur me produktet e inspektuara; -Sipas fotove që janë në praktikën e inspektimit, rezulton se në asnjë prej tyre paralajmërimet nuk janë në gjuhën shqipe; -Markimi CE nuk është sipas formatit të përcaktuar në shkronjën ñbò të pikës 3.7 të VKM nr.262, datë 03.04.2013 ñPër miratimin e rregullit teknik për sigurinë e lodraveò. Theksojmë se në informacionin e pasqyruar në dokumentin word, që administrohet në dosjen fizike të inspektimit, rezulton se asnjë prej produkteve të inspektuara nuk ka barkod (përjashtuar inspektimin në subjektin EG), kusht ky që vendoset në deklaratën e konformitetit EC të produktit, e cila shërben më pas për vendosjen/fiksimin e markimit CE në produkt. -Në këto kushte ndaj subjekteve duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë si dhe korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të caktuar, por që nuk është vepruar në këtë mënyrë.
Kriteri	Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar; Pika 4 në Kreun II, në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 7 në Kreun X në VKM nr.696, datë 16.8.2013 për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik ñe-inspektimiò. Pika 3.2 e Urdhërit të Inspektorit të Përgjithshëm nr.13, datë 23.04.2015; Shkronja ñcò pika 3.2, shkronja ñbò e pikës 3.7 në VKM nr.262, datë 03.04.2013 ñPër miratimin e rregullit teknik për sigurinë e lodraveò;

	Pika 4 e nenit 12 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2018-002587-1 datë 9/1/2019. Subjekti-T+. Grupi i inspektimit: L.L,A.H,A.H. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000080-1 datë 4/2/2019. Subjekti-E. Grupi i inspektimit: L.L,E.D,G.N. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000186-1 datë 5/3/2019. Subjekti-S Co. Grupi i inspektimit: G.N,A.H,E.S. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000347-1 datë 8/4/2019. Subjekti-G Shops. Grupi i inspektimit:L.L, G.N,A.H. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000579-1 datë 28/5/2019. Subjekti-I. Grupi i inspektimit: A.H,L.L, Dh.C. Inspektimi 1206/1 datë 5/6/2019. Subjekti-A.E. Grupi i inspektimit:G.N,E.S. -Procesverbalet e inspektimit nuk japin informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, emrin, llojin, numrin serial, si dhe sa prej tyre u përzgjodhën për inspektim. Përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi duhet tëkryhet nëpërmjet dokumenteve standard të miratuar;

	-Në rastet e mësipërme, sipas informacionit të pasqyruar në listë-verifikim, subjektet kanë qenë në shkelje të kërkesave ligjore (mungesë të deklaratave të konformitetit), ndërkohë nga inspektorët është lënë si detyrim që brenda afatit të caktuar të dorëzojnë këto dokumente pranë ISHMT. Theksojmë se në kushtet e mësipërme, përcaktohet detyrimi që subjekti të ruajë një kopje të dokumentacionit teknik dhe deklaratës së konformitetit, pra në momentin e inspektimit subjekti duhet ti ketë këto dokumente dhe nëse nuk i ka, ndaj tij vendoset masë administrative gjobë, ndalim i përkohshëm i tregëtimit të produkteve përkatëse (me vendim të ndërmjetëm) dhe korrigjim të shkeljes brenda afatit të caktuar. -Deklaratat e konformitetit të sjella nga subjektet e mësipërme nuk janë sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2 të nenit 8 Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar, dhe në këto kushte nuk duhet të administrohen në dosjen fizike të inspektimit, si provë sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit; -Në këto kushte në vendimin përfundimtar ndaj subjekteve të mësipërme, duhet të ishte vendosur ndalimi i përhershëm i tregëtimit të produkteve, për të cilat deklarata e konformitetit nuk është sipas kërkesave ligjore, për më tepër që edhe pas vendosjes së detyrimit për plotësimin e dokumentacionit brenda afatit të caktuar, detyrim i cili nuk është zbatuar, në kushtet kur dokumentacioni i sjellë nga subjektet është i pasaktë; -Në inspektimet e mësipërme listë-verifikimi nuk është plotësuar siç duhet, për më tepër për ato përcaktime ligjore që lidhen drejtëpërdrejtë me produktin, rrjeshti 4-7 në listë-verifikimin për subjektet T+, E, A.E, si dhe rrjeshti 1, 2, dhe 4 ï 7 për subjektin I(në të cilin nuk është bërë inspektimi i markimit CE të produkteve); -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës nuk administrohet në praktikën online të inspektimit; -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës fizike, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e markimit CE të produkteve të inspektuar në subjektet e mësipërme; -Nuk është respektuar afati për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar (për më tepër nr i protokollit të dokumentacionit në rastin e subjekteve Idhe Eështë i korrigjuar), për të cilën mban përgjegjësi A.S, specialiste protokolli e ISHMT në këtë periudhë. Dokumentacioni është sjellë më datë 20.06.2019 dhe nga specialistja e protokollit është bërë korrigjimi 17.06.2019, ose data 28.02.2019 është bërë 27.02.2019, për të respektuar afatin nga subjekti për dorëzimin e dokumentacionit, si dhe shmangien e penalizimit të tij) dhe në këto kushte në vendimin përfundimtar, në rastet kur subjekti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar, ndaj tij duhet të vendoset masë administrative gjobë, por që nuk është vepruar kështu.
Kriteri	Pika 1 e nenit 39, shkronja ñaò neni 41, pika 6 e nenit 43, pika 1 e nenit 44, pika 3 pika 4 e nenit 45, pika 1 e nenit 46, pika 4 e nenit 48, neni 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 2 e nenit 8, neni 9, neni 11, 12, 13, pika 7 e nenit 30, neni 35 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 4 e nenit 8 në Ligjin nr.68/2012 ñPër informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energjiò; Pika 6.2 dhe 6.4 në VKM nr.1061, datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik ñPy r pajisjet elektrike ty projektuara py r pyrdorim brenda disa kufijve të tensionitò

	dhe py rcaktimin e listy s së standardeve të harmonizuaraò; Pikës 4 në Kreun II dhe shtojca 2 në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000740-1 datë 21.05.2021. Subjekti-A. Grupi i inspektimit: J.O,G.N,L.L. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000738-1 datë 21.05.2021. Subjekti-JG. Grupi i inspektimit: A.H,E.S. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-001112-1 datë 04.06.2021. Subjekti-AR. Grupi i inspektimit: J.O,G.N,L.L. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-001131-1 datë 04.06.2021. Subjekti-AL. Grupi i inspektimit: G.N,E.S. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-001116-1 datë 21.06.2021. Subjekti-CC. Grupi i inspektimit:L.L,A.H. -Baza ligjore (VKM nr.1061, datë 23.12.2015 ñPër miratimin e rregullit teknik ñPy r

	pajisjet elektrike ty projektuara py r py rdorim brenda disa kufijve të tensionitò dhe py rcaktimin e listy s së standardeve të harmonizuaraò) e përdorur në listë-verifikimin e inspektimit, me qëllim verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektuar, **është shfuqizuar më datë 05.05.2021,** me VKM nr.349, datë 29.4.2020 ñPër miratimin e rregullit teknik ñpër pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionitò dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuaraò. Për këtë mbajnë përgjegjësi z.L.S Kryeinspektor i ISHMT, z.J.Ll, Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve dhe z.L.L, Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Produkteve Elektrike.
Kriteri	Pika 6 në VKM nr.349, datë 29.4.2020; Shkronja ñaò e pikës 2 të nenit 4 dhe pikën 3 të nenit 45 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 2 e nenit 99 të Ligjit nr.44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Inspektime të pavlefshme dhe që nuk përmbushin qëllimin e ligjit, sigurinë e produkteve joushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e përditësimit të bazës ligjore dhe e zbatimit të kuadrit rregullator.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat për ndryshimin e bazës ligjore (në dokumentet standarde të inspektimit) të përdorur në inspektimin e produkteve elektrike, bazë ligjore e cila është shfuqizuar me VKM nr.349, datë 29.4.2020 ñPër miratimin e rregullit teknik ñpër pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionitò dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuaraò.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002125-1 datë 12.11.2019. Subjekti-RS. Grupi i inspektimit:F.C,O.B. -Subjekti nuk ka respektuar detyrimin e lënë nga inspektorët për paraqitje të dokumentacionit të kërkuar brenda datës 21.11.2019 (në dosje nuk administrohet dokumentacioni), dhe në këto kushte ndaj tij duhet të ishte marrë masë administrative gjobë, por që nuk ka ndodhur kështu; -Dokumentacioni që administrohet në dosjen e inspektimit fizike, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Subjekti ka qenë në shkelje të ligjit (mungesë deklarata konformiteti, mungesë të instruksioneve të përdorimit, paralajmërimit në gjuhën shqipe) dhe ndaj tij duhet të ishte marrë masë administrative gjobë, por që nuk ka ndodhur kështu; -Sipas informacionit të pasqyruar në procesverbal, rezulton se nga Sistemi RAPEX, ishin raportuar disa produkte, lodra, të rrezikshme (SB, BS, SWB), për të cilat inspektorët morrën mostër për analizë laboratorike, si dhe me vendim të ndërmjetëm bënë ndalimin e tregëtimit të tyre, deri në daljen e vendimit përfundimtar të inspektimit; -Pas marrjes së përgjigjeve të analizave laboratorike, të cilat nuk rezultuan brenda parametrave të kërkuar, nga inspektorët në vendimin përfundimtar të inspektimit është vendosur bllokimi, shkatërrimi i produkteve, lajmërimi i konsumatorëve, kthimin e produkteve dhe rimbursimin e çmimit, identifikimin e operatorëve ekonomik, të cilët i ka furnizuar me produktet e mësipërme, për realizimin e të cilave nuk është vendosur asnjë afat konkret;

	-Nuk dokumentohet me foto bllokimi i produkteve, vendosja e shenjave dalluese dhe marrja e tyre në administrim; -Në zbatim të pikës 2 të nenit 4, pikës 4 të nenit 13 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar, ndaj subjektit (i cili ka tregëtuar produkte me parametra jashtë standardit) duhet të ishte marrë masë administrative gjobë, por që nuk ka ndodhur kështu; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e markimit CE të produkteve të inspektuar; -Në dosjen e inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion në përputhje me kërkesat e bëra në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò, hyrë në fuqi më datë 25.11.2019 (rreth 15 ditë përpara se të merrej vendimi përfundimtar), për vërtetimin e kryerjes së shkatërrimit të produkteve, detyrë ligjore të cilën e ka ISHMT dhe që përballohet me shpenzimet e subjektit. ▪ Për verifikimin e respektimit të detyrimeve të lëna në këtë inspektim, pra lajmërimi i konsumatorëve, kthimin e produkteve dhe rimbursimin e çmimit, identifikimin e operatorëve ekonomik, të cilët i ka furnizuar me produktet e mësipërme, nuk është kryer një inspektim i ri.Për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit të mësipërm, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Pika 1 e nenit 39, shkronja ñaò neni 41, pika 4 dhe 5 e nenit 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 2 e nenit 13 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 18 Kreu III në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Pika 2 e nenit 4, pika 4 e nenit 13 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të zbatimit të detyrimit të lënë nga inspektorët; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që çdo proçedurë asgjesimi/shkatërrimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe procesverbali i asgjesimit i mbajtur nga Inspektorët e mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i transferimit të mbetjeve, fletë-dalja e produkteve nga magazina e subjektit privat, kontrata e shërbimit të shkatërrimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast.

	Gjithashtu të analizohet dhe vlerësohet mundësia e investimit në blerjen/ndërtimin/marrjes me qira (alternativa ekonomikisht e favorshme) të një magazine/ambienti të posaçëm, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen/shkatërrohen, të ruhen në këto ambjente, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në këto ambjente, tôu tarifohet subjekteve në të cilat është bërë bllokimi, deri në momentin e asgjesimit/shkatërrimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet, nuk do tõi lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit të futet përsëri në treg. ISHMT të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.
Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002133-1 datë 23.11.2019. Subjekti-TM. Grupi i inspektimit:F.C,E.S,L.L. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002325-1 datë 18.11.2019. Subjekti-T. Grupi i inspektimit:I.Xh,I.B. -Subjekti është gjetur në shkelje të ligjit (nuk administronte deklaratat e konformitetit) dhe në këto kushte ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë por që nuk ka ndodhur kështu; -Deklaratat e konformitetit të sjella nga subjektet e mësipërme nuk janë sipas përcaktimeve ligjore, dhe në këto kushte nuk duhet të administrohen në dosjen fizike të inspektimit, si provë sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit; -Dokumentacioni që administrohet në dosjen e inspektimit fizike, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e markimit CE të produkteve të inspektuar; -Sasia e mostrave të marra për analizë laboratorike, pasqyruar në procesverbalin e inspektimit të subjektit T, nuk është në përputhje me sasinë e përcaktuar në pikën 88 të Kreut XIX të Urdhërit nr.305, datë 30.5.2014; -Në dosjen e inspektimeve nuk administrohet asnjë dokumentacion në përputhje me kërkesat e bëra në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò, hyrë në fuqi më datë 25.11.2019 (rreth 15 ditë përpara se të merrej vendimi përfundimtar), për vërtetimin e kryerjes së shkatërrimit të produkteve, detyrë ligjore të cilën e ka ISHMT dhe që përballohet me shpenzimet e subjektit; -Nuk dokumentohet me foto bllokimi i produkteve, vendosja e shenjave dalluese dhe marrja e tyre në administrim.
Kriteri	Pika 2 e nenit 13 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 1 e nenit 39 Shkronja ñaò neni 41në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò;

	Pika 2 e nenit 8 Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 88 e Kreut XIX të Urdhërit nr.305, datë 30.5.2014 ñPër procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregutò; VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që çdo proçedurë asgjesimi/shkatërrimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe procesverbali i asgjesimit i mbajtur nga Inspektorët e mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i transferimit të mbetjeve, fletë-dalja e produkteve nga magazina e subjektit privat, kontrata e shërbimit të shkatërrimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast. Gjithashtu të analizohet dhe vlerësohet mundësia e investimit në blerjen/ndërtimin/marrjes me qira (alternativa ekonomikisht e favorshme) të një magazine/ambienti të posaçëm, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen/shkatërrohen, të ruhen në këto ambjente, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në këto ambjente, tâu tarifohet subjekteve në të cilat është bërë bllokimi, deri në momentin e asgjesimit/shkatërrimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet, nuk do tâi lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit të futet përsëri në treg.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi Nr.ISHMT-DQ-2019-002319-1 datë 14.11.2019. Subjekti-A-06.Grupi i Inspektimit:I.Xh,O.B. -Subjekti është gjetur në shkelje të ligjit (nuk administronte deklaratat e konformitetit) dhe në këto kushte ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë por që nuk ka ndodhur kështu; -Deklaratat e konformitetit të sjella nga subjekti i mësipërm nuk janë sipas përcaktimeve ligjore, dhe në këto kushte nuk duhet të administrohen në dosjen fizike të inspektimit, si provë sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e markimit CE të produkteve të inspektuar; -Sasia e mostrave të marra për analizë laboratorike nuk është në përputhje me sasinë

	e përcaktuar në pikën 88 të Kreut XIX të Urdhërit nr.305, datë 30.5.2014; -Në dosjen e inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion në përputhje me kërkesat e bëra në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò, hyrë në fuqi më datë 25.11.2019 (rreth 15 ditë përpara se të merrej vendimi përfundimtar), për vërtetimin e kryerjes së shkatërrimit të produkteve, detyrë ligjore të cilën e ka ISHMT dhe që përballohet me shpenzimet e subjektit; -Në vendimin përfundimtar nuk është përcaktuar afati konkret se kur duhet bërë shkatërrimi i produkteve; -Nuk dokumentohet me foto bllokimi i produkteve, vendosja e shenjave dalluese dhe marrja e tyre në administrim. ▪ Për verifikimin e respektimit të detyrimeve të lëna në këtë inspektim, pra lajmërimi i konsumatorëve, kthimin e produkteve dhe rimbursimin e çmimit, identifikimin e operatorëve ekonomik, të cilët i ka furnizuar me produktet e mësipërme, nuk është kryer një inspektim i ri. Për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit të mësipërm, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Pika 2 e nenit 8, pika 2 e nenit 13 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 88 e Kreut XIX të Urdhërit nr.305, datë 30.5.2014 ñPër procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregutò; Shkronja ñaò neni 41, pika 4 e nenit 48, pika 5 e nenit 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë; Pika 18 Kreu III në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që çdo proçedurë asgjesimi/shkatërrimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe procesverbali i asgjesimit i mbajtur nga Inspektorët e mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i transferimit të mbetjeve, fletë-dalja e produkteve nga magazina e subjektit privat, kontrata e shërbimit të shkatërrimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast. Gjithashtu të analizohet dhe vlerësohet mundësia e investimit në blerjen/ndërtimin/marrjes me qira (alternativa ekonomikisht e favorshme) të një

	magazine/ambienti të posaçëm, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen/shkatërrohen, të ruhen në këto ambjente, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në këto ambjente, tâu tarifohet subjekteve në të cilat është bërë bllokimi, deri në momentin e asgjesimit/shkatërrimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet, nuk do tâ lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit të futet përsëri në treg. ISHMT të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-000428-1 datë 01.02.2021. Subjekti-L. Grupi i inspektimit:R.H, E.D. -Autorizimi për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, nuk përmban informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi). -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës nuk administrohet në praktikën online të inspektimit; -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës fizike, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e verifikimit, vulat e vendosura të instrumenteve matës të inspektuar; -Sipas informacionit të pasqyruar në Listë-verifikimin e inspektimit, rezulton se: ñSubjekti ka të instaluar 4 (kater) aparate matëse të karburantit, të tipit Dem Spyrides S Zol3D - S2005, me numra serie: <u>1)- 0705D305819.1, për të cilin:</u> Në datë 29/04/2020, me deshirë të subjektit, nga kompania N.I shpk, në aparatin me numër serie 0705D305819.1 është bërë bllokimi i pistoletës së benzinës, me vulën numër 00005995. Grupi inspektimit të ISHMT-së **konstatoi se vula e bllokimit** te instrumentit **matës është e dëmtuar, dhe subjekti ka bërë çmontimin fizik të pistoletës furnizuese nga aparati mates.** Dëmtimi i kesaj vule është konstatuar nga punonjësit e kompanisë N.I shpk, në datë 19/10/2020. (Bashkëngjitur është Proces-verbali për moskryerjen e inspektimt, i mbajtur nga punonjësit e kompanisë N.I shpk). **Dëmtimi i vulës së bllokimit të këtij instrumenti matës ka krijuar mundesinë e përdorimit të ketij instrumenti matës të paverifikuar dhe i palidhur me kasën fiskale.** <u>2)- 0705D305818.1,</u>

	Aparatet matëse të karburantit me numra serie 0705D305818.1 dhe 0705D305818.3 nuk kanë të instaluar pistoleta furnizuese. <u>3)- 0705D305818.2, për të cilin:</u> Kompania N.I shpk ka bërë zëvendësimin e vulave të DPM-së dhe janë vendosur vulat e vetë kompanisë, me numrat: 00002222 (Tarues), 00002223 (Dhënësin e impulseve), 00002225 (Regjim). **Nga ana e subjektit nuk është bërë i mundur përfundimi i procedurës së verifikimit periodik të instrumentit matës.** Ky instrument matës u bllokua nga grupi i inspektimit me vulën e ISHMT-së me numër ALBANIA 0007744, por që nuk dokumentohet me foto bllokimi i instrumentit. <u>4)- 0705D305818.3.</u> Aparatet matese te karburantit me numra serie 0705D305818.1 dhe 0705D305818.3 nuk kane te instaluar pistoleta furnizueseò. Në përfundim të inspektimit, ndaj subjektit, në vendimin përfundimtar, është vendosur masë administrative gjobë në vlerën 200,000 lekë, si dhe brenda datës 03.03.2021 aparatet 0705D305818.1, 0705D305818.3 dhe 0705D305819.1, nuk duhet të qëndrojnë në vendin e përdorimit. -Sa më sipër, inspektorët nuk pasqyrojnë informacionin se sa pistoleta kanë të instaluara aparatet matës 0705D305819.1 dhe 0705D305818.2; **-Për instrumentin që i është dëmtuar vula nuk kanë bërë bllokimin e tij me vulë të ISHMT, siç kanë vepruar në rastin e instrumentit nr.<u>0705D305818.2</u>;** -Nuk është lënë detyrimi që edhe për aparatin matës 0705D305818.2, të mos qëndrojë në vendin e përdorimit, si në rastin e 3 aparateve të tjera; -Për shkeljet e kryera më sipër nga subjekti, inspektorët i janë referuar pikës 2.1, shkronjës ç të nenit 54 të Ligjit nr.126/2020 ñPër metrologjinëò: 2.1 Për subjekte të biznesit të vogël 20 000 (njëzet mijë) lekë, për subjekte të biznesit të madh 100 000 (njëqind mijë) lekë, për stacione të tregtimit të karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse 200 000 (dyqind mijë) lekë, për shoqëritë që kryejnë veprimtari kërkimi e prodhimi, për rafineritë, impiantet e përpunimit të naftësjellësit, për instalimet dhe terminalet bregdetare dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë 700 000 (shtatëqind mijë) lekë: ç) moskryerja e verifikimit të instrumenteve matëse, sipas përcaktimeve të shkronjës ñcò të nenit 20, mosmirëmbajtja e rregullt e instrumenteve matëse në kundërshtim me shkronjën ñbò të nenit 20 dhe të pikës 2 të nenit 25 të këtij ligji; **Ndërkohë** që në këtë rast jemi përball shkeljeve: -pengimi dhe/ose ndalimi i kryerjes së verifikimeve të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, sikundër parashikohet në pikën 4 të nenit 22 të këtij ligji; -dëmtimi, heqja dhe/ose shkatërrimi i shenjës së verifikimit dhe vulave të sigurisë në instrumente. -**Në këto kushte** ndaj subjektit, në zbatim të pikës 2.3/2 në nenin 54 të Ligjit nr.126/2020 ñPër metrologjinëò, duhet të ishte marrë masë administrative gjobë 1,500,000 lekë: **2.3** Për subjektet e biznesit të vogël 30,000 (tridhjetë mijë) lekë, për subjektet e biznesit të madh 300,000 (treqind mijë) lekë, **për stacionet e tregtimit të karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë**, për shoqëritë që kryejnë veprimtari kërkimi e prodhimi, për rafineritë, impiantet e

	përpunimit të naftësjellësit, për instalimet dhe terminalet bregdetare dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë 5,000,000 (pesë milionë) lekë; -Gjithashtu sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e inspektimit, mbështetur në pikën 2 të nenit 54 të Ligjit nr.126/2020 ñPër metrologjinëò, ku përcaktohet se shkeljet e këtij ligji kur nuk përbëjnë vepër penale (përbëjnë kundërvajtje administrative), por që në këtë rast sipas nenit 182 dhe 235 (kundërshtimi i punonjësve të N.I për zbatimin e detyrës, e cila me kontratën koncesionare nr.1395 REP dhe 1091 KOL, datë 21.08.2019, ka fituar të drejtën dhe detyrimin për kryerjen e një shërbimi publik, pra të shërbimit të kontrollit ligjor periodik të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm), të Ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 ñKodi Penal i Republikës së Shqipërisëò, ndryshuar, kemi të bëjmë me një vepër penale, dhe në këto kushte ndaj subjektit duhet të ishte bërë kallëzim penal, por që nuk ka ndodhur kështu; -Ndaj gjobës në vlerën 200,000 lekë, subjekti ka bërë ankesë pranë ISHMT, e cila me vendimin 24.05.2021 e ka lënë në fuqi gjobën; -Më datë 21.07.2021 me shkresën nr.,prot.1630, ISHMT i është drejtuar GJSHP Tiranë, për konfirmim nëse subjekti ka bërë kërkesë padi pranë saj, ndaj gjobës së vendosur. -Më datë 27.07.2021 GJSHP Tiranë ka kthyer përgjigje, ku subjekti nuk ka bërë kërkesë-padi; -Nga ISHMT ende nuk është bërë kërkesa për lëshim urdhëri ekzekutimi për gjobën, në GJSHP Tiranë.Për mosbërjen e kërkesës për lëshim e urdhërit të ekzekutimit të gjobës, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Pika 2.3/2 dhe pika 2 në nenin 54 të Ligjit nr.126/2020 ñPër metrologjinëò; Neni 182 dhe 235 në Ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 ñKodi Penal i Republikës së Shqipërisëò, ndryshuar; Neni 9, shkronja b në pikën 4 të nenit 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò; Neni 511 i Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 ñKodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar; Pika 1 e nenit 39 Shkronja ñaò neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Kreu III dhe Shtojca 2 në Urdhërin e Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.8.2018 Për miratimin e rregullores, ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Kapitulli III, pika 3.3, pika 3.2 dhe kapitulli VI, pika 6.1 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative gjobë në vlerën e përcaktuar nga ligji, si dhe mungesa e bllokimit të instrumentit matës; Mungesa e ndjekjes së procedurës ligjore për arkëtimin e gjobës së vendosur, me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 200,000 lekë; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për të bërë kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në Gjykatën e Shkallës së Parë, me qëllim vënien në ekzekutim

	tëgjobave të vendosura, si dhe eleminimin e efekteve negative financiare në buxhetin e shtetit. ISHMTtë marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuara mbi bazë ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000912-1 datë 05.06.2019. Subjekti-E 94. Grupi i inspektimit:R.H, S.B, E.D. -Sipas informacionit të pasqyruar në listë-verifikimin e inspektimit, rezulton se, subjekti nuk disponon deklaratat EC të konformitetit për produktet: 1. Matësa uji 1" dhe 2. Matesa uji 1/2", të prodhuar nga kompania "NJI Co. Ltd, me adrese RV, XT, City, Kinë; -Në procesverbalin e inspektimit Kreu II, pika 5, subjektit i është lënë detyrimi për paraqitje të dokumentacionit të munguar: Deklaratat e konformitetit dhe dokumentacioni teknik për produktet: 1. Matësa uji 1" dhe 2. Matësa uji 1/2", brenda datës 21.06.2019, ndërkohë në dosjen fizike të inspektimit dhe atë online, nuk administrohet dokumentacioni i sjellë nga subjekti. Në këto kushte në vendimin përfundimtar, në rastet kur subjekti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar, ndaj tij duhet të vendoset masë administrative gjobë, por që nuk është vepruar kështu. -Nuk dokumentohen me foto shenjat e verifikimit markimi CE dhe ai suplementar, të instrumentave matës; -Në kushtet e mësipërme, në momentin e konstatimit të shkeljeve, inspektorët duhet të kishin marrë masë urgjente për bllokimin dhe ndalimin e tregëtimit të instrumentave të mësipërm, deri në dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar nga subjekti, por që nuk ka ndodhur; -Në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar të inspektimit, si dhe në kushtet kur subjekti nuk ka sjellë dokumentacionin e kërkuar, inspektorët veç masës administrative gjobë për pengim të vazhdimit të inspektimit, duhet të kishin vënë në gjobë mbështetur në pikën 2 të nenit 35 të Ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar, dhe ndalimin e përhershëm të tregëtimit të instrumentave të mësipërm. ▪ Për verifikimin e respektimit të detyrimeve të lëna në këtë inspektim, pra plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar nga inspektorët, nuk është kryer një inspektim i ri. Për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit të mësipërm, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Shkronja ñaò neni 41, Pika 1 dhe 2 e nenit 43, Pika 5 e nenit 48, Neni 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3 e nenit 27, pika 1 e nenit 30 dhe pikën 2 të nenit 35 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e garantimit të zbatimit të detyrimit të lënë nga inspektorët;

	Mungesa e garantimit të plotë të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi 1543/1 datë 19/6/2019. Subjekti-S-K. Grupi i inspektimit:A.H, L.L. Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002348-1 datë 20/11/2019. Subjekti-F-2014.Grupi i inspektimit:A.H, A.H. -Autorizimet për kryerjen e inspektimeve jashtë planit të miratuar, nuk përmbajnë informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi). -Procesverbalet e inspektimit nuk japin informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, emrin, llojin, numrin serial, si dhe sa prej tyre u përzgjodhën për inspektim. Përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara, që nuk ka as nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektitSK), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi duhet tëkryhet vetëm nëpërmjet dokumenteve standard të miratuar; -Në 2 rastet (SK dhe F 2014), sipas informacionit të pasqyruar në listë-verifikim, subjektet kanë qenë në shkelje të kërkesave ligjore (mungesë të deklaratave të konformitetit), ndërkohë nga inspektorët është lënë si detyrim që brenda afatit të caktuar të dorëzojnë këto dokumente pranë ISHMT. Në kushtet e mësipërme, përcaktohet detyrimi që subjekti të ruajë një kopje të dokumentacionit teknik dhe deklaratës së konformitetit, pra në momentin e inspektimit subjekti duhet ti ketë këto dokumente dhe nëse nuk i ka, ndaj tij vendoset masë administrative gjobë, ndalim i përkohshëm i tregëtimit të produkteve përkatëse (me vendim të ndërmjetëm) dhe korrigjim të shkeljes brenda afatit të caktuar. -Deklaratat e konformitetit të sjella nga subjektet e mësipërme (SK dhe F 2014) nuk janë sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2 të nenit 8 Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar, dhe në këto kushte nuk duhet të administrohen në dosjen fizike të inspektimit, si provë sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit. Në këto kushte në vendimin përfundimtar ndaj subjekteve të mësipërme, duhet të ishte vendosur ndalimi i përhershëm i tregëtimit të produkteve, për më tepër, që edhe pas vendosjes së detyrimit për plotësimin e dokumentacionit brenda afatit të caktuar, detyrim i cili nuk është zbatuar, pasi

	dokumentacioni i sjellë nga subjektet është i pasaktë; -Në të dy inspektimet e mësipërme (SK dhe F 2014) listë-verifikimi nuk është plotësuar siç duhet, për më tepër për ato përcaktime ligjore që lidhen drejtëpërdrejtë me produktin, konkretisht rrjeshti 6 dhe 7 në listë-verifikimin për subjektin S, rrjeshti 5-7 në listë-verifikimin për subjektin F; -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës nuk administrohet në praktikën online të inspektimit; -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës fizike, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e markimit CE të produkteve të inspektuar në subjektet (SK dhe F 2014); -Nuk është respektuar afati për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar nga subjekti F 2014 (për më tepër nr., dhe data e protokollit të dokumentacionit është korrigjuar, për të cilën mban përgjegjësi A.S, specialiste protokolli e ISHMT në këtë periudhë), dhe në këto kushte në vendimin përfundimtar, në rastet kur subjekti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar, ndaj tij duhet të vendoset masë administrative gjobë, por që nuk është vepruar kështu.
Kriteri	Pika 1 e nenit 39, shkronja ñaò neni 41, pika 3 e nenit 45, pika 4 e nenit 48, neni 54 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 2 e nenit 8, nenet 11, 12, 13, neni 35 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 4 e nenit 8 të Ligjit nr.68/2012 ñPër informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energjiò; Pikat 6.2 dhe 6.4 të VKM nr.1061, datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik ñPy r pajisjet elektrike ty projektuara py r py rdorim brenda disa kufijve të tensionitò dhe py rcaktimin e listy s së standardeve të harmonizuaraò; Pika 4 në Kreun II dhe shtojca 2 në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Neni 55 në Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar;
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar,

	foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMTtë marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuara mbi bazë ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000412-1 datë 23.04.2019. Subjekti-OT. Grupi i inspektimit:E.L, N.Z. -Sipas informacionit të pasqyruar në listë-verifikimin, mbi verifikimin e instrumentave matës, rezulton se verifikimi i fundit i tyre nga DPM është bërë më datë 20.04.2017, ndërkohë që inspektimi pranë subjektit është kryer më datë 23.04.2018 (**pra kanë kaluar 12 muaj**), dhe në këto kushte, afati i vlefshmërisë së verifikimit të instrumentave **ka mbaruar**. Ndaj këtij subjekti duhet të ishte marrë masë administrative gjobë, bllokim instrumenti dhe përcaktim të afatit për korrigjimin e shkeljeve; -Në procesverbalin e inspektimit Kreu II, pika 2 ñDokumente të marraò nuk është plotësuar nga inspektorët, ndërkohë në listë-verifikimin ata janë shprehur se subjekti ka bërë verifikimin e instrumenteve matëse (faturat tatimore). Për më tepër këto dokumente nuk administrohen në praktikën e inspektimit (on-line), të cilat shërbejnë si provë, sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar;
Kriteri	Neni 50 pika 2 dhe 2.3 e tij dhe neni 64 i Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, ndryshuar; Pika 2 e nenit 43 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit; Mungesa e marrjes së masës administrative.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve

	tëfundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.
Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001132-1 datë 04.06.2020. Subjekti-C ï shpk. Grupi i inspektimit:R.H, N.Z. -Autorizimi për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, nuk përmban informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi). -Ka mbaruar afati i vlefshmërisë së verifikimit të instrumentave matës (pistoleta karburanti 6 cop) të aparatit matës Dresser Wayne 587 6-3 me nr., serie 3185-10481, konkretisht verifikimi i tyre është bërë më datë 08.10.2019 dhe përfundon më datë 08.04.2020, ndërkohë inspektimi është kryer më datë 04.06.2020 (pra afati ka kaluar rreth 2 muaj). Në këto kushte nga inspektorët (veç masës së dhënë ndaj subjektit për kryerjen e verifikimit të rradhës dhe dorëzimin e dokumentacionit përkatës pranë ISHMT, brenda datës 19.06.2020) duhet të ishte marrë masë administrative që është tejkaluar afati i vlefshmërisë së shërbimit të verifikimit, ndalimin e përdorimit të instrumentave, deri në gjenerimin e verifikimit të rradhës. -Sipas procesverbalit të inspektimit, ndaj subjektit është lënë detyrimi për paraqitje të dokumentacionit të verifikimit nga kompania koncesionare N.I, pranë ISHMT, brenda datës 19.06.2020. -Në kushtet e mësipërme nga inspektorët nuk duhet të ishte marrë vendimi përfundimtar po në datën kur subjektit i është lënë detyrimi për dorëzimin e dokumentacionit, por duhet të ishte pritur deri në plotësimin e afatit të vendosur; -Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës rezulton se subjekti nuk e ka respektuar detyrimin e lënë nga inspektorët dhe në këto kushte në vendimin përfundimtar, në rastet kur subjekti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar, ndaj tij duhet të vendoset masë administrative gjobë, por që nuk është vepruar kështu. -Inspektorët shprehen se kanë bërë matje për 2 pistoleta, ndërkohë sipas Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, matjet zyrtare ose testimet e jashtëzakonshme janë veprime të ekspertizës metrologjike, të cilat kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar nga kjo drejtori. Në këtë rast sipas përcaktimeve të bëra në ligjin e mësipërm, si dhe në kushtet e një inspektimi jo të planifikuar dhe kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, Inspektorët duhet të kishin kërkuar nga subjekti kryerjen e matjeve nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar nga DPM, që nuk ka qenë i përfshirë në verifikimet e instrumentit matës në fjalë, të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim dhe të hartojë një raport testimi. Këto veprime janë në tejkalim të kompetencës ligjore.
Kriteri	Pjesa II, neni 34, pika 25 e nenit 3, shkronja ñbò e pikës 2.1 dhe pika 2.3 e nenit 50 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, ndryshuar; Pika 2 e nenit 43, pika 4 e nenit 45, neni 54 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Kreu III i Urdhrit të Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.8.2018 Për miratimin e rregullores, ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Aneksi 2.1, tabela 1, klasa ñsisteme te matjes se sasive te lengjeve pervec ujitò, të

	cilat duhet të verifikohen çdo 6 muaj në Urdhrin nr.195, datë 9.03.2009 ñPër verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluaraò.
Ndikimi/Efekti	Mosmarrja e masës administrative ndaj subjektit; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të inspektimit me dokumentacionin e munguar, si dhe moskryerjen e matjeve/testimeve të saktësisë së instrumentit matës së karburantit, por në çdo rast që e gjykon të nevojshme tôi drejtohet DPM ose personit juridik privat të autorizuar prej DPM, për kryerjen e tyre. ISHMTtë marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuara mbi bazë ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002351-1 datë 25/11/2019. Subjekti-N. Grupi i inspektimit:A.H,A.H. -Sipas listë-verifikimit, rezulton se inspektimi është kryer më datë 27.11.2019, ndërkohë afati për kryerjen e tij është përcaktuar brenda datës 25.11.2019, duke e bërë një inspektim të pavlefshëm; -Në këto kushte nuk shqyrtohet vazhdimësia e veprimeve të mëtejshme të kryera nga inspektorët.
Kriteri	Pika 4 e nenit 29 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò.
Ndikimi/Efekti	Inspektim i pavlefshëm që nuk prodhon asnjë pasojë juridiko-financiare ndaj subjektit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-001708-1 datë 10/10/2019. Subjekti-AD. Grupi i inspektimit:G.N,E.S, A.H. -Sipas listë-verifikimit, rezulton se inspektimi është kryer më datë 11.10.2019, ndërkohë afati për kryerjen e tij është përcaktuar brenda datës 10.10.2019, duke e bërë një inspektim të pavlefshëm; -Në këto kushte nuk shqyrtohet vazhdimësia e veprimeve të mëtejshme të kryera nga inspektorët.
Kriteri	Pika 4 e nenit 29 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inpsektimin në RSHò.

Ndikimi/Efekti	Inspektim i pavlefshëm që nuk prodhon asnjë pasojë juridiko-financiare ndaj subjektit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-002752-1 datë 12/9/2020. Subjekti-M. Grupi i Inspektimit:A.H,L.L -Sipas listë-verifikimit, rezulton se inspektimi është kryer më datë 11.12.2020, ndërkohë afati për kryerjen e tij është përcaktuar brenda datës 10.12.2020, duke e bërë një inspektim të pavlefshëm. -Në këto kushte nuk shqyrtohet vazhdimësia e veprimeve të mëtejshme të kryera nga inspektorët.
Kriteri	Pika 4 e nenit 29 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inpsektimin në RSHò;
Ndikimi/Efekti	Inspektim i pavlefshëm që nuk prodhon asnjë pasojë juridiko-financiare ndaj subjektit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2018-000088-1 datë 05.02.2019. Subjekti-AH. Grupi i inspektimit: I.Xh, I.B. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin e tyre. -Nuk dokumentohen me foto produktet e inspektuara dhe markimi CE i tyre; -Nuk administrohet asnjë dokument bashkëlidhur praktikës (deklarata konformiteti, udhëzim përdorimi, etj), lidhur me produktet e inspektuara; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij; -Sipas informacionit të pasqyruar në listë-verifikim e inspektimit, rezulton se subjekti nuk respekton detyrimet ligjore për paralajmërimet dhe instruksionet e sigurisë për produktet e tregëtuara, të cilat duhet të jenë në gjuhën shqipe, dhe në këto kushte ndaj subjektit duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë si dhe korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të caktuar, por që nuk është vepruar në këtë mënyrë.
Kriteri	Shkronja ñaò neni 41, pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Shkronja ñcò pika 3.2 në VKM nr.262, datë 03.04.2013 ñPër miratimin e rregullit teknik për sigurinë e lodraveò; Pika 4 e nenit 12 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative;

	Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.
Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002303-1 datë 13.11.2019. Subjekti-SB. Grupi i inspektimit:F.C,O.B. -Subjekti është gjetur në shkelje të ligjit (nuk administronte deklaratat e konformitetit, paralajmërimet dhe përdorimi nuk është në gjuhën shqipe, nuk ka numër tipi të produktit) dhe në këto kushte ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë por që nuk ka ndodhur kështu; -Subjekti nuk ka respektuar detyrimin e lënë nga inspektorët për paraqitje të dokumentacionit të kërkuar brenda datës 25.11.2019 (në dosje nuk administrohet dokumentacioni), dhe në këto kushte ndaj tij duhet të ishte marrë masë administrative gjobë, por që nuk ka ndodhur kështu; -Deklaratat e konformitetit të sjella nga subjekti i mësipërm nuk janë sipas përcaktimeve ligjore, dhe në këto kushte nuk duhet të administrohen në dosjen fizike të inspektimit, si provë sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e markimit CE të produkteve të inspektuar; -Në dosjen e inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion në përputhje me kërkesat e bëra në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò, hyrë në fuqi më datë 25.11.2019 (rreth 15 ditë përpara se të merrej vendimi përfundimtar), për vërtetimin e kryerjes së shkatërrimit të produkteve, detyrë ligjore të cilën e ka ISHMT dhe që përballohet me shpenzimet e subjektit; -Në vendimin përfundimtar nuk është përcaktuar afati konkret se kur duhet bërë shkatërrimi i produkteve; -Nuk dokumentohet me foto bllokimi i produkteve, vendosja e shenjave dalluese dhe marrja e tyre në administrim. ▪ Për verifikimin e respektimit të detyrimeve të lëna në këtë inspektim, pra lajmërimi i konsumatorëve, kthimin e produkteve dhe rimbursimin e çmimit, identifikimin e operatorëve ekonomik, të cilët i ka furnizuar me produktet e mësipërme, nuk është kryer një inspektim i ri. Për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit të mësipërm, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Pika 2 e nenit 8, pika 2 e nenit 13 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Shkronja ñaò neni 41, pika 4 e nenit 48, neni 54 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në

	Republikën e Shqipërisë; Pika 18 Kreu III në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të zbatimit të detyrimit të lënë nga inspektorët; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që çdo proçedurë asgjesimi/shkatërrimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe procesverbali i asgjesimit i mbajtur nga Inspektorët e mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i transferimit të mbetjeve, fletë-dalja e produkteve nga magazina e subjektit privat, kontrata e shërbimit të shkatërrimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast. Gjithashtu të analizohet dhe vlerësohet mundësia e investimit në blerjen/ndërtimin/marrjes me qira (alternativa ekonomikisht e favorshme) të një magazine/ambienti të posaçëm, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen/shkatërrohen, të ruhen në këto ambjente, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në këto ambjente, tôu tarifohet subjekteve në të cilat është bërë bllokimi, deri në momentin e asgjesimit/shkatërrimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet, nuk do tõ lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit të futet përsëri në treg. ISHMT të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002301-1 datë 13.11.2019. Subjekti-D. Grupi i inspektimit:I.XhI.B. -Subjekti është gjetur në shkelje të ligjit (nuk administronte deklaratat e

	konformitetit) dhe në këto kushte ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë por që nuk ka ndodhur kështu; -Deklaratat e konformitetit të sjella nga subjekti i mësipërm nuk janë sipas përcaktimeve ligjore, dhe në këto kushte nuk duhet të administrohen në dosjen fizike të inspektimit, si provë sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit; -Nga subjekti nuk është respektuar afati 27.11.2019 për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar nga inspektorët, konkretisht ai është sjellë 13.12.2019 dhe në këto kushte ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë, por që nuk është vepruar kështu; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e markimit CE të produkteve të inspektuar; -Sasia e mostrave të marra për analizë laboratorike nuk është në përputhje me sasinë e përcaktuar në pikën 88 të Kreut XIX të Urdhërit nr.305, datë 30.5.2014; -Në dosjen e inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion në përputhje me kërkesat e bëra në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò, hyrë në fuqi më datë 25.11.2019 (rreth 15 ditë përpara se të merrej vendimi përfundimtar), për vërtetimin e kryerjes së shkatërrimit të produkteve, detyrë ligjore të cilën e ka ISHMT dhe që përballohet me shpenzimet e subjektit; -Në vendimin përfundimtar nuk është përcaktuar afati konkret se kur duhet bërë shkatërrimi i produkteve; -Nuk dokumentohet me foto bllokimi i produkteve, vendosja e shenjave dalluese dhe marrja e tyre në administrim. ▪ Për verifikimin e respektimit të detyrimeve të lëna në këtë inspektim, pra lajmërimi i konsumatorëve, kthimin e produkteve dhe rimbursimin e çmimit, identifikimin e operatorëve ekonomik, të cilët i ka furnizuar me produktet e mësipërme, nuk është kryer një inspektim i ri. Për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit të mësipërm, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Pika 2 e nenit 8, pika 2 e nenit 13 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Shkronja ñaò neni 41, pika 4 e nenit 48, neni 54 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë; Pika 18 Kreu III në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò; Pika 88 e Kreut XIX të Urdhërit nr.305, datë 30.5.2014 ñPër procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregutò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të zbatimit të detyrimit të lënë nga inspektorët; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë

Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që çdo proçedurë asgjesimi/shkatërrimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe procesverbali i asgjesimit i mbajtur nga Inspektorët e mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i transferimit të mbetjeve, fletë-dalja e produkteve nga magazina e subjektit privat, kontrata e shërbimit të shkatërrimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast. Gjithashtu të analizohet dhe vlerësohet mundësia e investimit në blerjen/ndërtimin/marrjes me qira (alternativa ekonomikisht e favorshme) të një magazine/ambienti të posaçëm, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen/shkatërrohen, të ruhen në këto ambjente, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në këto ambjente, tôu tarifohet subjekteve në të cilat është bërë bllokimi, deri në momentin e asgjesimit/shkatërrimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet, nuk do tõi lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit të futet përsëri në treg. ISHMT të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi Nr.ISHMT-DQ-2019-002302-1 datë 14.11.2019. Subjekti-FH.Grupi i Inspektimit:F.C,A.H. -Subjekti është gjetur në shkelje të ligjit (nuk administronte deklaratat e konformitetit, paralajmërimet dhe përdorimi nuk është në gjuhën shqipe, nuk ka numër tipi të produktit) dhe në këto kushte ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë por që nuk ka ndodhur kështu; -Në vendimin e ndërmjetëm nuk specifikohet se për cilat produkte merret masa urgjente, pra nuk ka emër produkti dhe sasi, çõka e bënë të parealizueshme si masë administrative; -Deklaratat e konformitetit të sjella nga subjekti i mësipërm nuk janë sipas përcaktimeve ligjore, dhe në këto kushte nuk duhet të administrohen në dosjen fizike të inspektimit, si provë sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e markimit CE të produkteve të inspektuar;

	-Në dosjen e inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion në përputhje me kërkesat e bëra në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò, hyrë në fuqi më datë 25.11.2019 (rreth 15 ditë përpara se të merrej vendimi përfundimtar), për vërtetimin e kryerjes së shkatërrimit të produkteve, detyrë ligjore të cilën e ka ISHMT dhe që përballohet me shpenzimet e subjektit. -Në vendimin përfundimtar nuk është përcaktuar afati konkret se kur duhet bërë shkatërrimi i produkteve; -Nuk dokumentohet me foto bllokimi i produkteve, vendosja e shenjave dalluese dhe marrja e tyre në administrim. ▪ Për verifikimin e respektimit të detyrimeve të lëna në këtë inspektim, pra lajmërimi i konsumatorëve, kthimin e produkteve dhe rimbursimin e çmimit, identifikimin e operatorëve ekonomik, të cilët i ka furnizuar me produktet e mësipërme, nuk është kryer një inspektim i ri. Për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit të mësipërm, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Pika 2 e nenit 8, pika 2 e nenit 13, pika 1 e nenit 30 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Shkronja ñaò neni 41, pika 4 e nenit 48, pika 5 e nenit 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Pika 18 Kreu III në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që çdo proçedurë asgjesimi/shkatërrimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe procesverbali i asgjesimit i mbajtur nga Inspektorët e mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i transferimit të mbetjeve, fletë-dalja e produkteve nga magazina e subjektit privat, kontrata e shërbimit të shkatërrimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast. Gjithashtu të analizohet dhe vlerësohet mundësia e investimit në blerjen/ndërtimin/marrjes me qira (alternativa ekonomikisht e favorshme) të një magazine/ambienti të posaçëm, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen/shkatërrohen, të ruhen në këto ambjente, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në këto ambjente, tâu tarifohet

	subjekteve në të cilat është bërë bllokimi, deri në momentin e asgjesimit/shkatërrimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet, nuk do tõ lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit të futet përsëri në treg. ISHMT të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi e planifikuara pranë subjekteve E, IAshpk, AM, BB, Iï Italia, Eshpk, EM,Fshpk, ELl, TD, ES, janë anulluar në mungesë të arsyetimit, duke mos realizuar qëllimin e inspektimit pranë këtyre subjekteve. Për më tepër që inspektimi është një procedurë administrative e cila fillon me nxjerrjen e aktit administrativ ñautorizimi për inspektimò dhe në këto kushte kur anullohet zbatimi i tij, duhet të nxirret një akt tjetër i ri për anullimin e tij, veprim/dokument i cili nuk administrohet në dosjen e inspektimit.
Kriteri	Shkronja ñaò pika 2 e nenit 4 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Neni 11 në Ligjin nr.10216, datë 21.01.2010 ñPër detergjentëtò; Shkronja ñdhò e pikës 4 në Kreun II të VKM nr.36, datë 20.01.2016 ñPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMTò, ndryshuar; Pika 3 neni 113 në Ligjin nr.44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative në RSHò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e realizimit të qëllimit të inspektimit; Mungesa e garantimit të mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme që të shmangë anullimin e kryerjes së inspektimit, si dhe në rastet kur kjo është e pamundur objektivisht, anullimi i tij të bëhet me akt tjetër të titullarit të institucionit, i cili të jetë i arsyetuar. Gjithashtu në çdo inspektim të garantohet zbatimi i plotë i objektit të inspektimit, si dhe kryerja e tij brenda afatit të përcaktuar në autorizimin e inspektimit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-002739-1 datë 10/12/2020. Subjekti-MK. Grupi i Inspektimit:I.B, I.Z. -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij; -Sipas fotove të produkteve (5 foto), me përjashtim të njërit prej produkteve (lodër IC) asnjë prej tyre nuk ka markimin CE. Gjithashtu subjekti nuk administronte deklaratat e konformitetit, si dhe nga fotot e administruara, rezulton se

	paralajmërimet dhe përdorimi i produktit nuk është në gjuhën shqipe. Pra subjekti është në shkelje të ligjit dhe në këto kushte ndaj tij duhet të merrej masë administrative gjobë, por që nuk ka ndodhur kështu; -Markimi CE në produktin (lodër IC) nuk është sipas formatit të përcaktuar në shkronjën ñbò të pikës 3.7 të VKM nr.262, datë 03.04.2013; -Deklaratat e konformitetit të sjella nga subjekti i mësipërm nuk janë sipas përcaktimeve ligjore, dhe në këto kushte nuk duhet të administrohen në dosjen fizike të inspektimit, si provë sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit; -Në vendimin përfundimtar nuk është përcaktuar afati konkret se kur duhet bërë shkatërrimi i produkteve, si dhe ai nuk është shoqëruar me njërën ose disa prej masave shoqëruese të mëposhtme: a) lajmërimin e konsumatorëve ose të përdoruesve të fundit, duke përdorur mjetet e përshtatshme të komunikimit publik për rrezikun që paraqet produkti/instalimi; b) urdhërimin për ndalimin e menjëhershëm të tregtimit, në qoftë se produkti është tashmë në treg, ose kthimin mbrapsht të tij; c)urdhërimin e bërjes jofunksional të produktit/instalimit në shërbim ose shkatërrimin e tij; -Në dosjen e inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion në përputhje me kërkesat e bëra në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò, hyrë në fuqi më datë 25.11.2019 (rreth 15 ditë përpara se të merrej vendimi përfundimtar), për vërtetimin e kryerjes së shkatërrimit të produkteve, detyrë ligjore të cilën e ka ISHMT dhe që përballohet me shpenzimet e subjektit. -Nuk dokumentohet me foto bllokimi i produkteve, vendosja e shenjave dalluese dhe marrja e tyre në administrim.
Kriteri	Shkronja ñbò e pikës 3.7 të VKM nr.262, datë 03.04.2013 ñPër miratimin e rregullit teknik për sigurinë e lodraveò; Pika 2 e nenit 8, pika 2 e nenit 13, pika 7 e nenit 30 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 3.2 e Urdhërit të Inspektorit të Përgjithshëm nr.13, datë 23.04.2015; Pika 4 e nenit 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 18 Kreu III në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që çdo proçedurë asgjesimi/shkatërrimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe procesverbali i asgjesimit i mbajtur nga Inspektorët e mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i transferimit të mbetjeve, fletë-dalja e produkteve nga magazina e subjektit privat, kontrata e shërbimit të shkatërrimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill.

	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast. Gjithashtu të analizohet dhe vlerësohet mundësia e investimit në blerjen/ndërtimin/marrjes me qira (alternativa ekonomikisht e favorshme) të një magazine/ambienti të posaçëm, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen/shkatërrohen, të ruhen në këto ambjente, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në këto ambjente, tâu tarifohet subjekteve në të cilat është bërë bllokimi, deri në momentin e asgjesimit/shkatërrimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet, nuk do tâ lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit të futet përsëri në treg. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001521-1 datë 24.07.2020. Subjekti-LM Oil 2015. Grupi i inspektimit:R.H, E.D. -Autorizimi për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, nuk përmban informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi). Për mosnxjerrjen e autorizimit sipas formatit të kërkuar mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT. -Ka mbaruar afati i vlefshmërisë së verifikimit të instrumentave matës (pistoleta karburanti Gaz 1 cop) të aparatit matës Nuovo Pignone me nr., serie 017228, konkretisht verifikimi i tyre është bërë më datë 06.11.2019 dhe përfundon më datë 06.05.2020, ndërkohë inspektimi është kryer më datë 24.07.2020 (pra afati ka kaluar rreth 2 e ½ muaj). Në këto kushte nga inspektorët (veç masës së dhënë ndaj subjektit për kryerjen e verifikimit të rradhës dhe dorëzimin e dokumentacionit përkatës pranë ISHMT, brenda datës 07.08.2020) duhet të ishte marrë masë administrative që është tejkaluar afati i vlefshmërisë së shërbimit të verifikimit, ndalimin e përdorimit të instrumentave, deri në gjenerimin e verifikimit të rradhës. -Sipas procesverbalit të inspektimit, ndaj subjektit është lënë detyrimi për paraqitje të dokumentacionit të verifikimit nga kompania koncesionare N.I, pranë ISHMT, brenda datës 07.08.2020. -Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës, administrohen dy raport inspektimi me nr.8618/2020 TI038 dhe nr.8623/2020 TI038, të cilat nuk dallohen qartë se çfarë informacioni përmbajnë. Theksojmë se këto dy dokumente nuk kanë as numrin e protokollit të ISHMT, për të verifikuar respektimin e afatit 07.08.2020, për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar nga subjekti. -Dokumentacioni bashkëlidhur dosjes fizike të inspektimit, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar;
Kriteri	Pika 1 e nenit 39, pika 2 e nenit 43, pika 4 e nenit 45, neni 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pjesa II, neni 34, pika 25 e nenit 3, shkronja ñbò e pikës 2.1 dhe pika 2.3 e nenit 50 të

	Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, ndryshuar; Kreu III i Urdhrit të Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.8.2018 Për miratimin e rregullores, ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Aneksi 2.1, tabela 1, klasa ñsisteme te matjes se sasive te lengjeve pervec ujitò, të cilat duhet të verifikohen çdo 6 muaj në Urdhrin nr.195, datë 9.03.2009 ñPër verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluaraò.
Ndikimi/Efekti	Mosmarrja e masës administrative ndaj subjektit; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMTtë marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuara mbi bazë ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.
Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001520-1 datë 05.08.2020. Subjekti-JP. Grupi i inspektimit:R.H, E.D. -Autorizimi për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, nuk përmban informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi). Për mosnxjerrjen e autorizimit sipas formatit të kërkuar mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT. -Ka mbaruar afati i vlefshmërisë së verifikimit të 2 instrumentave matës (pistoleta karburanti 2 cop) të aparatit matës Mepsa Vision L me nr., serie 12599, konkretisht verifikimi i tyre është bërë më datë 16.12.2019 dhe përfundon më datë 16.06.2020, ndërkohë inspektimi është kryer më datë 03.08.2020 (pra afati ka kaluar rreth 3 muaj). Në këto kushte nga inspektorët (veç masës së dhënë ndaj subjektit për kryerjen e verifikimit të rradhës dhe dorëzimin e dokumentacionit përkatës pranë ISHMT, brenda datës 31.08.2020) duhet të ishte marrë masë administrative që është tejkaluar afati i vlefshmërisë së shërbimit të verifikimit, ndalimin e përdorimit të instrumentave, deri në kryerjen e verifikimit të rradhës. Për më tepër që veç faturës tatimore të shërbimit të verifikimit nga DPM, subjekti nuk ka dokumentacionin tjetër, si protokoll matje, akt-konstatimin, librezën e instrumentit, certifikatën e lëshuar nga DPM për verifikimin e kryer më datë 16.12.2019. -Sipas procesverbalit të inspektimit, ndaj subjektit është lënë detyrimi për paraqitje të dokumentacionit të verifikimit nga kompania koncesionare N.I, pranë ISHMT, brenda datës 31.08.2020. -Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës (administrohen 8 raport inspektimi me nr.8601, 8591, 8598, 8595, 8599, 8594, 8597, 8596/2020 TI038), dallohen qartë vetëm raport inspektimet:

	nr.8598 dhe 8591/2020 TI038. Nga verifikimi i dy raport-testimeve të mësipërme, rezulton se ato mbajnë datën 03.09.2020, pra jo sipas detyrimit të lënë nga grupi i inspektimit, që subjekti të dorëzojë brenda datës 31.08.2020 raport testimet. Në këto kushte në vendimin përfundimtar, në rastet kur subjekti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar, ndaj tij duhet të vendoset masë administrative gjobë, por që nuk është vepruar kështu. -Raport-testimet e tjera nuk dallohen qartë se çfarë informacioni përmbajnë. Theksojmë se të gjitha dokumentet bashkëlidhur dosjes së inspektimit, nuk kanë as numrin e protokollit të ISHMT. -Dokumentacioni bashkëlidhur dosjes fizike të inspektimit, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Dokumentacioni bashkëlidhur nuk administrohet në praktikën online të inspektimit;
Kriteri	Shkronja ñbò e pikës 2.1 dhe pika 2.3 e nenit 50 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, ndryshuar; Pika 1 dhe 2 e nenit 39, pika 2 e nenit 43, neni 54 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Neni 14, pika 2 e nenit 44 të Ligjit nr. 44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò; Kreu III i Urdhrit të Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.8.2018 Për miratimin e rregullores, ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Aneksi 2.1, tabela 1, klasa ñsisteme te matjes se sasive te lengjeve pervec ujitò, të cilat duhet të verifikohen çdo 6 muaj në Urdhrin nr.195, datë 9.03.2009 ñPër verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluaraò.
Ndikimi/Efekti	Mosmarrja e masës administrative ndaj subjektit; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMTtë marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuara mbi bazë ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000274-1 dhe ISHMT-DQ-2019-000272-1 datë 12.03.2019. Subjekti-DO. Grupi i inspektimit:R.H, E.Sh. -Autorizimi për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, nuk përmban informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi). -Sipas listë-verifikimit pasqyrohet informacioni se subjekti për 12 pistoleta karburanti ka bërë verifikimin nga DPM (faturat tatimore), ndërkohë këto fatura nuk

	administrohen në portalin e-inspektimi, si dhe faturat tatimore që administrohet në dosjen fizike, janë pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Inspektorët shprehen se kanë bërë matje për 4 pistoleta, ndërkohë sipas Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, matjet zyrtare ose testimet e jashtëzakonshme janë veprime të ekspertizës metrologjike, të cilat kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar nga kjo drejtori. Në këtë rast sipas përcaktimeve të bëra në ligjin e mësipërm, si dhe në kushtet e një inspektimi jo të planifikuar dhe kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, Inspektorët duhet të kishin kërkuar nga subjekti kryerjen e matjeve nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar nga DPM, që nuk ka qenë i përfshirë në verifikimet e instrumentit matës në fjalë, të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim dhe të hartojë një raport testimi, por që nuk ka ndodhur kështu. Ky veprim është në tejkalim të kompetencës ligjore; -Sipas protokoll-matjeve të kryera në inspektimin me nr.ISHMT-DQ-2019-000272-1, rezulton se janë **2 instrumente të pa rregullta**, ndërkohë inspektorët në listë-verifikimin dhe procesverbalin e inspektimit, janë shprehur se rezultoi **vetëm 1 instrument**, i cili u bllokua. Në këto kushte duhet të ishte bllokuar edhe instrumenti tjetër me vulën në mizaturë nr. 0007043 (B) Benzinë, për të ndjekur të njëjtin standard veprimi; -Në procesverbalin e inspektimit Kreu II, pika 2 ñDokumente të marraò nuk është plotësuar nga inspektorët, ndërkohë në listë-verifikimin ata janë shprehur se, dokumentacioni që vërteton se instrumentet matëse janë objekt të markimit CE/dokumentacioni që vërteton miratimin e tipit të tyre, është i rregullt, dhe në këto kushte, ky dokumentacion (deklaratë konformiteti), duhet të administrohet në dosje, të cilat shërbejnë si provë, sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar. Theksojmë se dokumentacioni justifikues dhe vërtetues nuk administrohet në dosje; -Sipas informacionit që pasqyrohet në listë-verifikimin, rezulton se subjekti nuk ka dokumentacionin e plotë të verifikimit metrologjik të instrumentave matës dhe në këto kushte, ndaj subjektit duhet të ishte marrë masë administrative gjobë; -Sipas informacionit që pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit nr.ISHMT-DQ-2019-000272-2, Kreu IV, ñVendimi përfundimtarò, subjektit i është lënë detyrimi për riparimin e instrumentit të bllokuar dhe riverifikimin e tij, por pa përcaktuar një afat për kryerjen e këtyre veprimeve; -Nuk dokumentohet me foto bllokimi i instrumentit matës; -Sipas informacionit që pasqyrohet në procesverbalet e 2 inspektimeve, subjektit i është lënë detyrimi për paraqitje pranë ISHMT brenda datës 22.03.2019, për dorëzimin e dokumentacionit të lëshuar nga metrologu i DPM-së: 1-Protokoll matjet për instrumentet e verifikuara dhe 2-Akt konstatimet; -Sipas dokumentacionit bashkëlidhur dosjes fizike, subjekti nuk e ka respektuar afatin e vendosur nga inspektorët më datë 22.03.2019, për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar (inspektimi me nr.ISHMT-DQ-2019-000274-1) por dokumentacioni i sjellë nga subjekti mban datën 26.03.2019 me nr.,prot., 458/1. Në këto kushte në vendimin përfundimtar, në rastet kur subjekti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar, ndaj tij duhet të vendoset masë administrative gjobë, por që nuk është vepruar kështu. -Nuk dokumentohen me foto shenjat e verifikimit të instrumentave matës; ▪ Për verifikimin e respektimit të detyrimeve të lëna në këtë inspektim, pra riparimi i

	instrumentave, nuk është kryer një inspektim i ri. Për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit të mësipërm, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Pjesa II, neni 34, pika 25 e nenit 3, neni 50 pika 2 dhe 2.1, 2.3 e tij dhe neni 64 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, ndryshuar; Pika 1 e nenit 39, shkronja ñaò dhe ñeò neni 41, pika 2 e nenit 43, pika 5 e nenit 48, neni 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Kreu III dhe shtojca 2 në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit; Mungesa e garantimit të zbatimit detyrimit të lënë nga inspektorët; Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar; Mungesa e marrjes së masës administrative.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast. ISHMT të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. ISHMT të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të inspektimit me dokumentacionin e munguar, si dhe moskryerjen e matjeve/testimeve të saktësisë së instrumentit matës së karburantit, por në çdo rast që e gjykon të nevojshme tëi drejtohet DPM ose personit juridik privat të autorizuar prej DPM, për kryerjen e tyre. ISHMTtë marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuara mbi bazë ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-000335-1 datë 26.01.2021. Subjekti-B-L. Grupi i inspektimit:E.M, N.Z, R.B. -Autorizimi për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, nuk përmban informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi). -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës nuk administrohet në praktikën online të inspektimit;

	-Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës fizike, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e verifikimit, vulat e vendosura të instrumenteve matës të inspektuar; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar i gjithë, dhe kjo nuk shoqërohet me arsyetim/koment nga grupi i inspektorëve. Theksojmë se objekti i inspektimit ka si bazë ligjore: Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Ligjin nr.126/2020 ñPër metrologjinëò; Ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò, ndryshuar, dhe në këto kushte duhet të ishin inspektuar minimalisht edhe dokumentacioni metrologjik (certifikata të verifikimit), a janë instrumentet me markim CE dhe metrologjik suplementar, dhe nëse jo, a është i miratuar tipi i tyre; -Sipas dokumentacionit bashkëlidhur dosjes së inspektimit (testimet e N.I), rezulton se, për 6 pistoleta karburanti është bërë mbyllja me dëshirë e tyre nga subjekti, për të cilat nuk është bërë matje e treguesve. Në këto kushte grupi i inspektorëve, për këto dy instrumenta, në vendimin përfundimtar, duhet që të kishte lënë si masë administrative, marrjen e masave nga subjekti që këto dy pistoleta të largohen nga vendi i përdorimit/ose të bëjë verifikimin e tyre dhe ti vendosi në përdorim, por që nuk është vepruar kështu.
Kriteri	Shtojca 2 në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Pika 1 e nenit 39, shkronja ñaò neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 2 e nenit 19 të Ligjit nr.126/2020 ñPër metrologjinëò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMTtë marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuara mbi bazë ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	1.Inspektimi datë ISHMT-DQ-2019-000284-1 datë 13.03.2019. Subjekti-SG. Grupi i inspektimit:R.H, E.Sh. -Autorizimi për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, nuk përmban informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi). -Sipas listë-verifikimit pasqyrohet informacioni se subjekti për 12 pistoleta karburanti ka bërë verifikimin nga DPM (fatura tatimore), ndërkohë këto fatura nuk administrohen në portalin e-inspektimi, si dhe faturat tatimore që administrohet në

	dosjen fizike, janë pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Inspektorët shprehen se kanë bërë matje për 6 pistoleta, ndërkohë sipas Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, matjet zyrtare ose testimet e jashtëzakonshme janë veprime të ekspertizës metrologjike, të cilat kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar nga kjo drejtori. Në këtë rast sipas përcaktimeve të bëra në ligjin e mësipërm, si dhe në kushtet e një inspektimi jo të planifikuar dhe kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, Inspektorët duhet të kishin kërkuar nga subjekti kryerjen e matjeve nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar nga DPM, që nuk ka qenë i përfshirë në verifikimet e instrumentit matës në fjalë, të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim dhe të hartojë një raport testimi, por që nuk ka ndodhur kështu. Ky veprim është në tejkalim të kompetencës ligjore; -Sipas protokoll-matjeve të kryera inspektimin me nr.ISHMT-DQ-2019-000272-1, rezulton se janë 4 instrumente të pa rregullta, të cilat janë bllokuar me vulat e ISHMT, por që nuk dokumentohet me foto bllokimi i instrumentave. -Në procesverbalin e inspektimit Kreu II, pika 2 ñDokumente të marraò nuk është plotësuar nga inspektorët, ndërkohë në listë-verifikimin ata janë shprehur se, dokumentacioni që vërteton se instrumentet matëse janë objekt të markimit CE/dokumentacioni që vërteton miratimin e tipit të tyre, është i rregullt, dhe në këto kushte, ky dokumentacion (deklaratë konformiteti), duhet të administrohet në dosje, të cilat shërbejnë si provë, sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar. Theksojmë se ky dokumentacion nuk administrohet në dosjen e inspektimit; -Sipas informacionit që pasqyrohet në listë-verifikimin, rezulton se subjekti nuk ka dokumentacionin e plotë të verifikimit metrologjik të instrumentave matës dhe në këto kushte, ndaj subjektit duhet të ishte marrë masë administrative gjobë; -Sipas informacionit që pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit nr.ISHMT-DQ-2019-000272-2, Kreu IV, ñVendimi përfundimtarò, subjektit i është lënë detyrimi për riparimin e instrumentit të bllokuar dhe riverifikimin e tij, por pa përcaktuar një afat për kryerjen e këtyre veprimeve; -Sipas informacionit që pasqyrohet në procesverbalet e 2 inspektimeve, subjektit i është lënë detyrimi për paraqitje pranë ISHMT brenda datës 25.03.2019, për dorëzimin e dokumentacionit të lëshuar nga metrologu i DPM-së: 1-Protokoll matjet për instrumentet e verifikuara dhe 2-Akt konstatimet; -Sipas dokumentacionit bashkëlidhur dosjes fizike, subjekti nuk e ka respektuar afatin 25.03.2019 të vendosur nga inspektorët për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar. Në këto kushte në vendimin përfundimtar, në rastet kur subjekti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar, ndaj tij duhet të vendoset masë administrative gjobë, por që nuk është vepruar kështu. -Nuk dokumentohen me foto shenjat e verifikimit të instrumentave matës; ▪ Për verifikimin e respektimit të detyrimeve të lëna në këtë inspektim, pra riparimi i instrumentave, nuk është kryer një inspektim i ri. Për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit të mësipërm, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Pjesa II, neni 34, pika 25 e nenit 3, neni 50 pika 2 dhe pika 2.1 e tij, dhe neni 64 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, ndryshuar; Pika 1 e nenit 39, shkronja ñaò dhe ñeò neni 41, pika 5 e nenit 48, neni 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò;

	Kreu III dhe shtojca 2 në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit; Mungesa e garantimit të zbatimit detyrimit të lënë nga inspektorët; Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masës administrative.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast. ISHMT të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. ISHMT të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të inspektimit me dokumentacionin e munguar, si dhe moskryerjen e matjeve/testimeve të saktësisë së instrumentit matës së karburantit, por në çdo rast që e gjykon të nevojshme tôi drejtohet DPM ose personit juridik privat të autorizuar prej DPM, për kryerjen e tyre. ISHMTtë marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuara mbi bazë ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002283-1 datë 04.11.2019. Subjekti-B. Grupi i inspektimit:R.H, E.D. -Inspektimi nuk është kryer plotësisht në përputhje me objektin e përcaktuar në autorizimin e inspektimit, konkretisht nuk janë inspektuar çështjet të cilat lidhen me markimin CE të instrumentave, deklaratat e konformitetit të instrumentave, fiksimin e shenjave të markimit CE, sipas detyrimeve të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, ndryshuar dhe VKM

	nr. 770, datë 02.11.2016; -Nuk administrohen protokoll-matjet dhe akt konstatimet e DPM për 2 instrumentet matës dhe për këtë shkelje ndaj subjektit duhet të ishte marrë masë administrative gjobë, por që nuk është vepruar në këtë mënyrë, si dhe për instrumentin e gazit data e mbajtjes së akt konstatimit (04.11.2019) nuk përputhet me datën e protokoll-matjes së bërë nga DPM për këtë instrument (01.11.2019), dhe ky fakt duhet ishte pasqyruar nga inspektorët. -Nuk dokumentohen me foto shenjat e verifikimit të instrumentave matës të inspektuar në subjekt; -Faturat tatimore e DPM për 2 instrumenta (karburant), si dhe fatura tatimore, protokoll-matja dhe akt konstatimi për instrumentin e gazit, që administrohet në dosjen e inspektimit fizike, janë pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Inspektorët shprehen se kanë bërë matje për 2 pistoleta, ndërkohë sipas Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, matjet zyrtare ose testimet e jashtëzakonshme janë veprime të ekspertizës metrologjike, të cilat kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar nga kjo drejtori. Në këtë rast sipas përcaktimeve të bëra në ligjin e mësipërm, si dhe në kushtet e një inspektimi jo të planifikuar dhe kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, Inspektorët duhet të kishin kërkuar nga subjekti kryerjen e matjeve nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar nga DPM, që nuk ka qenë i përfshirë në verifikimet e instrumentit matës në fjalë, të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim dhe të hartojë një raport testimi; Veç sa më sipër, edhe në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, ndryshuar, përcaktohet se testimi laboratorik kryhet në laborator të akredituar, ndërkohë që ISHMT nuk është e akredituar. Këto veprime janë në tejkalim të kompetencës ligjore.
Kriteri	Ligji nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, ndryshuar dhe VKM nr. 770, datë 02.11.2016; Pjesa II, neni 34, pika 25 e nenit 3, neni 64 në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, ndryshuar; Pika 1 e nenit 39, shkronja ñaò neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masës administrative; Mungesa e garantimit të plotë të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të inspektimit me dokumentacionin e munguar, si dhe moskryerjen e matjeve/testimeve të saktësisë së instrumentit matës së karburantit, por në çdo rast që e gjykon të nevojshme tôi drejtohet DPM ose personit juridik privat të autorizuar prej DPM, për kryerjen e tyre. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në

	konsideratëhistorikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-002295-1 datë 10/11/2020. Subjekti-PC. Grupi i inspektimit:I.Xh,I.B. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin, numrin serial të tyre, përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi duhet tëkryhet nëpërmjet dokumenteve standard të miratuar; -Nuk administrohet asnjë dokument vërtetues bashkëlidhur praktikës, lidhur me produktet e inspektuara; -Sipas informacionit të pasqyruar në listë-verifikimin dhe procesverbalin e inspektimit, rezulton se 6 produkte nuk kishin etiketimin në gjuhën shqipe, dhe në këto kushte, ndaj subjektit duhet të ishte marrë masë administrative gjobë si dhe vendosjen e afatit konkret për korrigjimin e shkeljeve, por që nuk është vepruar në këtë mënyrë; -Nuk administrohet informacioni për testet për biodegradimin përfundimtar;
Kriteri	Pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; VKM Nr.669, datë 28.09.2011 pika 5; Pika 1 e nenit 9, shkronja ñdò e pikës 1 të nenit 13 në Ligjin nr.10216, datë 21.01.2010 ñPër detergjentëtò; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar; Pika 4 në Kreun II, në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-002612-1 datë 23/11/2020. Subjekti-KSH. Grupi i Inspektimit:A.M, I.B. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin, numrin serial të tyre, përkundrazi në

	dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi duhet tëkryhet nëpërmjet dokumenteve standard të miratuar; -Nuk administrohet asnjë dokument vërtetues bashkëlidhur praktikës, lidhur me produktet e inspektuara; -Sipas informacionit të pasqyruar në listë-verifikimin dhe procesverbalin e inspektimit, rezulton se 6 produkte nuk kishin etiketimin në gjuhën shqipe, dhe në këto kushte, ndaj subjektit duhet të ishte marrë masë administrative gjobë si dhe vendosjen e afatit konkret për korrigjimin e shkeljeve, por që nuk është vepruar në këtë mënyrë; -Nuk administrohet informacioni për testet për biodegradimin përfundimtar;
Kriteri	Pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; VKM nr.669, datë 28.09.2011 pika 5; Pika 1 e nenit 9, shkronja ñdò e pikës 1 të nenit 13 në Ligjin nr.10216, datë 21.01.2010 ñPër detergjentëtò; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar; Pika 4 në Kreun II, në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.
Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002609 datë 03.01.2020. Subjekti-NP.Grupi i Inspektimit:A.H,A.H. -Nga inspektorët nuk është realizuar objekti i inspektimit përcaktuar në autorizimin e tij, konkretisht nuk është inspektuar vendosja e markimit CE, etiketimi, paketimi, instruksionet e përdorimit të produkteve; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij; -Inspektorët në rrjeshtin 10 të listë-verifikimit, janë shprehur se produkti është i pasigurt, nga testimet e kryera nga ISHMT, por që nuk pasqyrohet informacioni se cili produkt është i pasigurt, po kështu edhe në procesverbalin e inspektimit nuk pasqyrohet informacioni përkatës; -Në vendimin përfundimtar, subjektit i është lënë detyrimi i kthimit të produkteve tek importuesi dhe dorëzimi i dokumentacionit vërtetues pranë ISHMT, por pa përcaktuar një afat konkret për realizimin e këtyre detyrave; -Theksojmë se kjo masë administrative e marrë në këtë subjekt, nuk është marrë në asnjë rast tjetër të ngjashëm, përkundrazi në çdo rast të tillë është lënë detyrimi i

	bllokimit dhe shkatërrimit të produktit, çka tregon veprim me dy standarde nga inspektorët. ▪ Për verifikimin e respektimit të detyrimeve të lëna në këtë inspektim, pra kthimin e produkteve tek importuesi, nuk është kryer një inspektim i ri. Për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit të mësipërm, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Pika 2 të nenit 8 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 2 e nenit 13, pika 1 e nenit 30 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar Shkronja ñaò neni 41, pika 4 dhe 5 e nenit 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Pika 18 Kreu III në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñpër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò. Neni 13 në Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò; Autorizimi i inspektimit.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2021-000004-1 datë 12/1/2021. Subjekti-KG. Grupi i Inspektimit:A.M, O.B. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin e tyre; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij;

	-Nga verifikim fotove, rezulton se paralajmërimet nuk janë në gjuhën shqipe. Pra subjekti është në shkelje të ligjit dhe në këto kushte ndaj tij duhet të merrej masë administrative gjobë, por që nuk ka ndodhur kështu;
Kriteri	Pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 e Urdhërit të Inspektorit të Përgjithshëm nr.13, datë 23.04.2015; Shkronja ñcò, pika 3.2 e VKM nr. 262, datë 3.4.2013 ñpër miratimin e rregullit teknik ñpër sigurinë e lodraveò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-002753-1 datë 12/7/2020. Subjekti-SDE. Grupi i Inspektimit:A.H,J.O. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin e tyre. Përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi duhet tëkryhet nëpërmjet dokumenteve standard; -Sipas listë-verifikimit të plotësuar gjatë inspektimit, rezulton se subjekti ka qenë në shkelje të ligjit, (nuk administronte deklaratat e konformitetit, produktet janë pa numër serial), ndërkohë në procesverbalin e inspektimit, Kreu IV, inspektorët janë shprehur se produktet e inspektuara ishin me deklaratë konformiteti dhe markim CE, pra nuk përputhen të dhënat e listëverfikimit me ato të procesverbalit; -Deklaratat e konformitetit që administrohen në dosjen fizike të inspektimit, nuk janë sipas përcaktimeve ligjore, dhe në këto kushte nuk duhet të administrohen në dosjen fizike të inspektimit, si provë sipas Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit. Për këtë ndaj subjektit duhet të ishte marrë masë administrative ñgjobëò. -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e markimit CE të produkteve të inspektuar; -Theksojmë se në këtë inspektim është vepruar ndryshe nga inspektimet e tjera, pra kur subjekti nuk ka patur deklaratat e konformitetit, ndaj tij është lënë detyrimi për paraqitjen e tyre brenda një afati të caktuar, ndërkohë në këtë rast nuk është lënë asnjë detyrim i tillë, çka tregon veprim me dy standarde nga inspektorët.
Kriteri	Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar; Pika 4 në Kreun II, në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò;

	Pika 2 e nenit 8, pika 2 e nenit 13 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Pika 5 e VKM nr.1061, datë 23.12.2015; Neni 13 në Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò; Shkronja ñaò neni 41, pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-000854-1 datë 15.05.2020. Subjekti-LOD. Grupi i inspektimit:R.H, E.D. -Autorizimi për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, nuk përmban informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi); -Subjekti ka dy aparate matëse H33-33 me nr.,serie 46 -1077113 dhe 46 ï 1077112

	të cilat kanë gjithësej 12 pistoleta karburanti; -Këto pistoleta, më datë 08.04.2020, i janë nënshtruar shërbimit të riparimit nga personi juridik i autorizuar për kryerjen e këtij shërbimi, Miscom shpk; -Vlefshmëria e shërbimit të riparimit është 30 ditë nga kryerja e tij, pra afati i shërbimit të riparimit të instrumentave ka mbaruar më datë 08.05.2020, dhe në këto kushte pas këtij afati nuk duhet të përdoret më deri në verifikimin e rradhës; -Inspektimi është kryer më datë 15.05.2020, pra pas 7 ditësh nga data e mbarimit të vlefshmërisë së shërbimit të riparimit dhe subjekti nga data 08.05.2020 ï 15.05.2020, sipas dokumentacionit bashkëlidhur, subjekti nuk ka kryer verifikimin e rradhës. Në këto kushte nga inspektorët (veç masës së dhënë ndaj subjektit për kryerjen e verifikimit/testimit të rradhës dhe dorëzimin e dokumentacionit përkatës pranë ISHMT, brenda datës 26.05.2020) duhet të ishte marrë masë administrative që është tejkaluar afati i vlefshmërisë së shërbimit të riparimit, ndalimin e përdorimit të instrumentave, deri në gjenerimin e testimeve të rradhës nga kompania koncesionare N.I.
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-001979-1 datë 11.11.2019. Subjekti-LC. Grupi i inspektimit:S.B, M.L, N.Z. -Sipas autorizimit të inspektimit, objekti i inspektimit ka qenë Deklarata e Konformitetit, Markimi CE dhe ai suplementar metrologjik, ndërkohë nga inspektorët nuk është plotësuar listë-verifikimi dhe në procesverbal janë shprehur se subjekti në momentin e inspektimit nuk dispononte matësa uji. Pra në asnjë rast në autorizimin e inspektimit nuk është përcaktuar se do të inspektohen vetëm matësat e ujit dhe që të veprohej nga inspektorët në këtë mënyrë. -Sipas verifikimit të grupit të auditimit në ekstraktin e regjistrimit të aktivitetit të subjektit në QKB, rezulton se ai ka në aktivitetin e tij: Import-eksport, tregtim me shumice dhe pakice i mallrave dhe pajisjeve te ndryshme industriale, bujqesore, blegtorale, elektrike, hidraulike, frigoriferike, ashensor, elektroshtepiake/industriale, kancelari dhe artikujve shkollor, blegtorale, ushqimore, pajisjeve kondicionimit dhe ventilimit, kompjutera dhe pajisje kompjuterike, printimi, fotokopjimi si dhe pjese kembimi per to, si dhe te ofroj te gjitha sherbimet/riparime qe kryhen me pajisjet e siperpermendura. Import, eksport dhe tregtim, me shumice dhe pakice te makineri, mjete, automjete, kamiona, makineri industriale, bujqesore, blektorale, si dhe çdo lloj mjeti dhe pajisje te motorrizuar dhe pjese te kembimit per keto makineri, autoservis mjetesh te markave e tonazheve te ndryshme. Për këto produkte inspektorët nuk janë shprehur nëse ka gjëndje apo jo. -Inspektorët nuk janë shprehur as për inspektimin e dokumentacionit të matësave të ujit, të cilat sipas informacionit të pasqyruar nga grupi i inspektorëve janë shitur, pra të deklaratës së konformitetit të matësave të ujit, ku sipas përcaktimit të bërë pikën 7 të VKM nr.770, datë. 02.11.2016 Për miratimin e rregullit teknik ñpër instrumentet matëseò, për disa ndryshime në vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të këshillit të ministrave, ñpër miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluaraò, dhe pyrcaktimin e listys së standardeve të harmonizuaraò, ka detyrimin që për 10 vite të mbaj një kopje të deklaratës së konformitetit dhe siguron ISHMT, që sipas kërkesës së saj, dokumentacioni teknik i vihet në dispozicion. Theksojmë se këtë detyrim inspektorët nuk e kanë inspektuar. -Pra nuk është realizuar objekti i inspektimit, sipas përcaktimit të bërë në autorizimin e tij.
Kriteri	Pika 1 e nenit 6, pika 1 e nenit 37, pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Nenin 50 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, ndryshuar; Shkronja ñaò e pikës 1 në nenin 29 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Autorizimi nr.ISHMT-DQ-2019-0019979-1, datë 11.11.2019.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon

	transparencën e veprimeve të inspektorëve;
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.
Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-001980-1 datë 12.11.2019. Subjekti-G.Grupi i inspektimit:S.B, M.L, N.Z. -Sipas autorizimit të inspektimit, objekti i inspektimit ka qenë Deklarata e Konformitetit, Markimi CE dhe ai suplementar metrologjik, ndërkohë nga inspektorët nuk është plotësuar listë-verifikimi dhe në procesverbal janë shprehur se subjekti në momentin e inspektimit nuk dispononte instrumenta matës (pra ndryshe nga inspektimi i mësipërm, këtu janë shprehur për të gjitha llojet e instrumentave). -Sipas informacionit të pasqyruar në procesverbalin e inspektimit, rezulton se subjekti nuk disponon instrumente matëse, pasi i ka shitur dhe për këtë i ka dorëzuar inspektorëve 4 fatura shitje, të cilat nuk janë sipas formatit të miratuar në nenin 66 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.6, datë 30.01.2015 ñPër TVSH në RSHò, ndryshuar me (ndryshuar me udhëzimin nr. 6/1, datë 17.3.2015, nr. 6/2, datë 19.3.2015, nr. 6/8, datë 5.6.2015, nr. 6/4, datë 4.9.2015, nr. 6/5, datë 5.10.2015, nr. 15, datë 18.5.2017, nr. 16, datë 5.7.2017, nr. 22, datë 11.12.2017, nr. 5, datë 22.2.2019) në fuqi për periudhën kur është kryer inspektimi. Në këto kushte, nuk duhet të kishin pranuar si dokumentacion justifikues faturat e dorëzuara nga subjekti. -Inspektorët nuk janë shprehur as për inspektimin e dokumentacionit të instrumenteve të shitura nga subjekti (peshore), pra të deklaratës së konformitetit, ku sipas përcaktimit të bërë pikën 7 të VKM nr.770, datë. 02.11.2016 Për miratimin e rregullit teknik ñpër instrumentet matëseò, për disa ndryshime në vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të këshillit të ministrave, ñpër miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluaraò, dhe pÿrcaktimin e listÿs së standardeve të harmonizuaraò, ka detyrimin që për 10 vite të mbaj një kopje të deklaratës së konformitetit dhe siguron ISHMT që sipas kërkesës së saj, dokumentacioni teknik i vihet në dispozicion. Theksojmë se këtë detyrim inspektorët nuk e kanë inspektuar. -Pra nuk është realizuar objekti i inspektimit, sipas përcaktimit të bërë në autorizimin e tij.
Kriteri	Pika 1 e nenit 6, pika 1 e nenit 37, pika 2 të nenit 39, pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Autorizimi ISHMT-DQ-2019-001980-1, datë 12.11.2019; Shkronja ñaò e pikës 1 në nenin 29 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Neni 50 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	
Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-000219-1 datë 30.01.2020. Subjekti-CO. Grupi i inspektimit:R.H, E.L, E.D. -Sipas listë-verifikimit pasqyrohet informacioni se subjekti për 8 pistoleta karburanti ka bërë verifikimin nga DPM (fatura tatimore) dhe 1 pistoletë gazi, ndërkohë në dosje administrohet dokumentacioni metrologjik vetëm për 8 pistoletat, si dhe jo për instrumentin e gazit. Gjithashtu ky dokumentacion nuk administrohet në portalin e-inspektimi, si dhe ai që administrohet në dosjen fizike të inspektimit, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Inspektorët shprehen se kanë bërë matje për 2 pistoleta, ndërkohë sipas Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, matjet zyrtare ose testimet e jashtëzakonshme janë veprime të ekspertizës metrologjike, të cilat kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar nga kjo drejtori. Në këtë rast sipas përcaktimeve të bëra në ligjin e mësipërm, si dhe në kushtet e një inspektimi jo të planifikuar dhe kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, Inspektorët duhet të kishin kërkuar nga subjekti kryerjen e matjeve nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar nga DPM, që nuk ka qenë i përfshirë në verifikimet e instrumentit matës në fjalë, të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim dhe të hartojë një raport testimi. Ky veprim është në tejkalim të kompetencave ligjore; -Nuk është kryer inspektim për markimin CE, fiksimin e tij, deklaratë konformiteti, në përputhje me objektin e inspektimit dhe bazën ligjore të pasqyruar; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e verifikimit të instrumentave matës;
Kriteri	Pika 1 e nenit 39, shkronja ñaò neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pjesa II, neni 34, pika 25 e nenit 3 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Shtojca 2 në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të inspektimit me dokumentacionin e munguar, si dhe moskryerjen e matjeve/testimeve të saktësisë së instrumentit matës së karburantit, por në çdo rast që e gjykon të nevojshme tô drejtohet DPM ose personit juridik privat të autorizuar prej DPM, për kryerjen e tyre.

	ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-000333-1 datë 26.01.2021. Subjekti-K. Grupi i inspektimit:E.M, N.Z, R.B. -Autorizimi për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, nuk përmban informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi). -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës nuk administrohet në praktikën online të inspektimit; -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës fizike, është pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e verifikimit, vulat e vendosura të instrumenteve matës të inspektuar; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar i gjithë, dhe kjo nuk shoqërohet me arsyetim/koment nga grupi i inspektorëve. Theksojmë se objekti i inspektimit ka si bazë ligjore: Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Ligjin nr.126/2020 ñPër metrologjinëò; Ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò, ndryshuar, dhe në këto kushte duhet të ishin inspektuar minimalisht edhe dokumentacioni metrologjik (certifikata të verifikimit), a janë instrumentet me markim CE dhe metrologjik suplementar, dhe nëse jo, a është i miratuar tipi i tyre; -Sipas dokumentacionit bashkëlidhur dosjes së inspektimit (testimet e N.I), rezulton se për dy pistoleta karburanti është bërë mbyllja me dëshirë e tyre nga subjekti, për të cilat nuk është bërë matje e treguesve. Në këto kushte grupi i inspektorëve, për këto dy instrumenta, në vendimin përfundimtar, duhet që të kishte lënë si masë administrative, marrjen e masave nga subjekti që këto dy pistoleta të largohen nga vendi i përdorimit/ose të bëjë verifikimin e tyre dhe ti vendosi në përdorim.
Kriteri	Kreu III dhe Shtojca 2 në Urdhrin të Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.8.2018 Për miratimin e rregullores, ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Pika 1 e nenit 39,shkronja ñaò neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 2 e nenit 19 të Ligjit nr.126/2020 ñPër metrologjinëò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve;
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	ISHMTtë marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuara mbi bazë ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim

	jashtë programi, ankesën/indicien.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000911-1 datë 05.06.2019. Subjekti-A.E. Grupi i inspektimit:R.H, S.B, E.D. -Inspektorët veç masës administrative gjobë në vlerën 200,000 (të cilën e kanë vendosur), duhet të kishin vendosur ñndalimin përkohësisht të tregëtimit të këtij produktiò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, nëse kjo është e mundur, kryerjen e testimeve për të marrë rezultatet dhe vlerësimin nëse instrumenti përputhet me kërkesat e VKM nr.770, datë 02.11.2016, dhe në rast se rezulton e kundërta, marrjen e masës së ñndalimit të tregëtimit në mënyrë të përhershme të këtij produktiò dhe jo masën ñndalimi i hedhjes në tregò, pasi ky produkt është vendosur tashmë në treg. Pra nuk është rasti ku produkti nuk është zhdoganuar ende dhe të vendoset masa administrative ndalimi i vendosjes në treg të tij. -Ndaj gjobës së vendosur, nga subjekti është bërë ankesë, më datë 02.07.2019, e cila është shqyrtuar dhe dalë me vendim të Komisionit të Ankimit pranë ISHMT, më datë 02.10.2019, duke e lënë në fuqi gjobën. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se subjekti nuk ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, duke e kthyer në vendim të formës së prerë, si dhe deri në datën e konstatimit, gjoba e vendosur ndaj subjektit nuk është arkëtuar. Për mosbërjen e kërkesës për lëshim e urdhërit të ekzekutimit të gjobës, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT.
Kriteri	Shkronja ñcò e pikës 4 në nenin 29, pika 1 e nenit 30 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Neni 9, shkronjën b të pikës 4 të nenit 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò; Neni 511 i Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 ñKodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit; Mungesa e vendosjes së masës administrative; Mungesa e ndjekjes së procedurës ligjore për arkëtimin e gjobës së vendosur, me efekt negativ në buxhetin e shtetit në vlerën 200,000 lekë.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për të bërë kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në Gjykatën e Shkallës së Parë, me qëllim vënien në ekzekutim të gjobave të vendosura, si dhe eleminimin e efekteve negative financiare në buxhetin e shtetit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000253-1 datë 09.04.2019. Subjekti-AC Company. Grupi i inspektimit:I.Xh, I.B, A.M. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin, numrin serial të tyre, sa prej tyre u përzgjodhën për inspektim. Përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument

	në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi kryhet nëpërmjet dokumenteve standard të miratuar; -Nuk dokumentohen me foto produktet e inspektuara, ndryshe nga si është vepruar në inspektimin e GCB; -Nuk administrohet informacioni për testet për biodegradimin përfundimtar; -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij;
Kriteri	Shkronja ñaò neni 41Pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Pika 1 e nenit 9 në Ligjin nr.10216, datë 21.01.2010 ñPër detergjentëtò; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar; Pika 4 në Kreun II, në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve;
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-000459-1 datë 18.04.2019. Subjekti-EA.Grupi i inspektimit:I.Xh,A.M. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin, numrin serial të tyre, sa prej tyre u përzgjodhën për inspektim, përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi duhet tëkryhet nëpërmjet dokumenteve standard të miratuar; -Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur praktikës nuk administrohet në praktikën online të inspektimit;

	-Nuk dokumentohen me foto produktet e inspektuara, ndryshe nga si është vepruar në inspektimin e GCB; -Nuk administrohet informacioni për testet për biodegradimin përfundimtar; -Sipas dokumentacionit bashkëlidhur (fletët e të dhënave të sigurisë), nuk janë në gjuhën shqipe. -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij;
Kriteri	Shkronja ñaò neni 41, pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Pika 6 e nenit 8, pika 1 e nenit 9 në Ligjin nr.10216, datë 21.01.2010 ñPër detergjentëtò; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar; Pika 4 në Kreun II dheshtojca 2 në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve;
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës.
Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002128-1 datë13.11.2019. Subjekti-A-17. Grupi i Inspektimit:F.C,O.B. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin e tyre, si dhe sa u inspektuan, si dhe sa prej tyre ishin pa markimin CE, përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi duhet tëkryhet nëpërmjet dokumenteve

	standard të miratuar; -Masa administrative gjobë 200,000 lekë si dhe ndalimi i tregëtimit të produkteve nuk është shoqëruar me njërën ose disa prej masave shoqëruese të mëposhtme: a) lajmërimin e konsumatorëve ose të përdoruesve të fundit, duke përdorur mjetet e përshtatshme të komunikimit publik për rrezikun që paraqet produkti/instalimi; b) urdhërimin për ndalimin e menjëhershëm të tregtimit, në qoftë se produkti është tashmë në treg, ose kthimin mbrapsht të tij; c)urdhërimin e bërjes jofunksional të produktit/instalimit në shërbim ose shkatërrimin e tij; -Theksojmë se ndryshe është vepruar në rastin e inspektimit të subjektit LA, ku në vendimin përfundimtar të inspektimit është lënë detyrimi për bllokim dhe shkatërrim të produktit, çka tregon veprim me dy standarde të inspektorëve. -Gjoba është paguar nga subjekti në Janar të vitit 2020, sipas akt-rakordimit të degës së thesarit Tiranë me ISHMT.
Kriteri	Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar; Pika 4 në Kreun II, në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 7 e nenit 30 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Neni 13 në Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të sigurisë së produkteve joushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

	ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-002013-1 datë17/9/2020. Subjekti-AF. Grupi i Inspektimit:F.C,A.M. -Autorizimi për kryerjen e inspektimit jashtë planit të miratuar, nuk përmbajnë informacionin e nevojshëm (shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë program, informacionin, kur ka ardhur indicia). -Nuk dokumentohet me dokumentacion bashkëlidhur praktikës (kopje të faturave të blerjeve të deteregjentëve të subjektit AF), nëse subjekti nuk ka tregëtuar detergjent me emrin A të blerë nga RH, produkt për të cilin është bërë edhe ankesa; -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin, numrin serial të tyre, përkundrazi në dosjen fizike administrohet një dokument në word (ku pasqyrohen produkte të inspektuara), i cili nuk është dokument zyrtar, ndërkohë inspektimi kryhet nëpërmjet dokumenteve standard të miratuar;
Kriteri	Pika 4 në Kreun II, Kreu III të Urdhrit të Inspektoratit Qendror nr. 25, datë 10.8.2018 Për miratimin e rregullores, ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve;
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMTtë marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuara mbi bazë ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm shkaqet, burimin e informacionit për të cilin ka iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-**

	2021
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-000523-1 datë6/2/2020. Subjekti-C Albania. Grupi i Inspektimit:F.C,O.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-000538-1 datë 18/02/2020. Subjekti-S Albania. Grupi i Inspektimit:F.Ç,I.B Inspektimi ISHMT-DQ-2020-000547-1 datë 13/02/2020. Subjekti-I. Grupi i Inspektimit:I.Xh,O.B. -Procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të hollësishëm, pra sa produkte kishte subjekti në ambjentin e tregëtimit, llojin, numrin serial të tyre, sa prej tyre u përzgjodhën për inspektim. -Nuk dokumentohen me foto produktet e inspektuara, ndryshe nga si është vepruar në inspektimin e GCB; -Nuk administrohet informacioni për testet për biodegradimin përfundimtar; -Nuk administrohet asnjë dokument bashkëlidhur praktikës, lidhur me produktet e inspektuara; -Në rastin e subjektit I, listë-verifikimi i inspektimit nuk është plotësuar në çdo përcaktim ligjor të tij;
Kriteri	Shkronja ñaò neni 41, pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Pika 1 e nenit 9 në Ligjin nr.10216, datë 21.01.2010 ñPër detergjentëtò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve;
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E Mesme
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme për eleminimin e përdorimit në procedurën e inspektimit të dokumentit (cituar më sipër) jozyrtar dhe të pamiratuar, por informacioni që pasqyrohet në këtë dokument, të bëhet pjesë e procesverbalit të inspektimit, si dhe ky i fundit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin

	e kuadrit ligjor përkatës.
Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001396-1 datë16/7/2020. Subjekti-NMP. Grupi i inspektimit:A.M,I.Xh. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001370-1datë 17/7/2020. Subjekti-M. Grupi i inspektimit:A.M,I.Xh. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001386-1 datë 6/7/2020. Subjekti-FDN. Grupi i inspektimit:A.M,I.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001392-1 datë 6/7/2020. Subjekti-GM. Grupi i inspektimit:I.Xh,O.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001380-1 datë 6/7/2020. Subjekti-F. Grupi i inspektimit:I.Xh,O.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001400-1 datë 7/7/2020. Subjekti-GP. Grupi i inspektimit:A.M,I.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001368-1 datë 9/7/2020. Subjekti-AH. Grupi i inspektimit:I.Xh,O.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001397-1 datë 9/7/2020. Subjekti-MM. Grupi i inspektimit:I.Xh,O.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001389-1 datë 9/7/2020. Subjekti-JX. Grupi i inspektimit:A.M,I.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001391-1 datë 9/7/2020. Subjekti-SJ. Grupi i inspektimit:A.M,I.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001360-1 datë 10/7/2020. Subjekti-LM. Grupi i inspektimit:A.M,I.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001382-1 datë 13/7/2020. Subjekti-AD. Grupi i inspektimit:O.B,I.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001381-1 datë 20/7/2020. Subjekti-EP. Grupi i inspektimit:A.M,I.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001365-1 datë 20/7/2020. Subjekti-CP. Grupi i inspektimit:I.B,I.Xh. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001395-1 datë 20/7/2020. Subjekti-OF. Grupi i inspektimit:I.B,I.Xh. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001354-1 datë 20/7/2020. Subjekti-PO sh.p.k.. Grupi i inspektimit:I.B,I.Xh. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001376-1 datë28/7/2020. Subjekti-AP. Grupi i inspektimit:A.M,I.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001393-1 datë 30/7/2020. Subjekti-DKF. Grupi i inspektimit:A.M,I.B. Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001394-1 datë29/7/2020. Subjekti-EH. Grupi i inspektimit:A.M,I.B. -Inspektorët shprehen se (përjashtuar inspektimet në dy subjekte NMP dhe M), subjektet nuk tregëtojnë maska artizanale, por vetëm maska kirurgjikale, ndërkohë në procesverbalet e inspektimit pranë subjekteve të mësipërme nuk jepet informacion i hollësishëm, si dhe nuk administrohet dokumentacion bashkëlidhur, pra të merren minimalisht furnizimet e muajit të fundit të subjektit me maska, për të vërtetuar, se ky subjekt nuk tregëton maska artizanale; -Për më tepër asnjë produkt i inspektuar (maskë artizanale apo kirurgjikale) nuk dokumentohet me foto;

Kriteri	Shkronja ñaò neni 41, pika 3 e nenit 45 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E ulët
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme që procesverbali i inspektimit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, barkodi i tyre, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto të markimeve CE dhe të shenjave të verifikimit për instrumentet matës, parapaketimet, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2021-000293-1 datë 02.09.2020. Subjekti-HL. Grupi i inspektimit:M.L, A.A, A.D. -Në procesverbalin e inspektimit Kreu II, pika 1 ñTabela e marrjes së mostraveò nga inspektorët është plotësuar me ñJoò, ndërkohë që në listëverifikimin ata shprehen ñNë subjekt u krye kontrolli sasior me metodën e marrjes së mostrave për produkte të paketuaraò; -Listë-verifikimi për produktet e paketuara nuk është plotësuar siç duhet, konkretisht nuk është plotësuar rrjeshti 2, nëse subjekti disponon sistem kontrolli të sasisë, në rastin kur ka produkte me shenjë konformiteti; -Nuk dokumentohen me foto shenjat dhe mbishkrimet e paketimeve dhe shisheve enëmatëse;
Kriteri	Neni 37/3, neni 50 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar dhe autorizimin e inspektimit Pika 4, neni 38, shkronja ñaò neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mospasqyrimi i plotë i situatës në subjektin e inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mosgarantimi i plotë i sigurisë së produkteve joushqimore. Mungesa e marrjes së masës administrative.
Shkaku	Mungesa e zbatimit plotësisht të kuadrit rregullator
Rëndësia	E ulët
Rekomandime	ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative,

	tëmarrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001100-1 datë 01.06.2021. Subjekti-S. Grupi i inspektimit:M.L, A.D, A.A. -Në procesverbalin e inspektimit Kreu II, pika 1 ñTabela e marrjes së mostraveò nga inspektorët është plotësuar me ñJoò, ndërkohë që në listëverifikimin ata shprehen ñNë subjekt u krye kontrolli sasior me metodën e marrjes së mostrave për produkte të paketuaraò; -Nuk dokumentohen me foto produktet e paketuara të inspektuar; -Listë-verifikimi për produktet e paketuara nuk është plotësuar siç duhet, konkretisht nuk është plotësuar rrjeshti 2, nëse subjekti disponon sistem kontrolli të sasisë, në rastin kur ka produkte me shenjë konformiteti, por që subjekti në këtë rast ka produkte me shenjë konformiteti;
Kriteri	Pika 4, neni 38, shkronja ñaò neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pika 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Neni 37 dhe neni 48 të Ligjit nr.126/2020, datë ñPër metrologjinëò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve;
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E ulët
Rekomandime	ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001901-1 datë 02.09.2020. Subjekti-P. Grupi i inspektimit:M.L, A.D. -Në procesverbalin e inspektimit nuk pasqyrohet metoda e përdorur për marrjen dhe testimin e mostrave. -Inspektorët kanë marrë mostër vetëm për produktet e parapaketuara detergjent dhe vaj olim, ndërkohë sipas verifikimit të grupit të auditimit në ekstraktin e regjistrimit në QKB, subjekti prodhon disa produkte si materiale inerte, importon produkte ushqimore, industriale, për të cilat inspektorët nuk kanë marrë asnjë mostër për inspektimin e sasisë në paketim; -Listë-verifikimi për instrumentat matës nuk është plotësuar siç duhet, konkretisht nuk është plotësuar kërkesa nëse instrumenti matës ligjërisht i kontrolluar, në përdorim, siguron saktësinë e matjeve dhe performancën teknike të kërkuar, dhe nëse plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike; -Në procesverbalin e inspektimit Kreu II, pika 1 ñTabela e marrjes së mostraveò nga inspektorët është plotësuar me ñJoò, ndërkohë që në listëverifikimin ata shprehen

	ñNë subjekt u krye kontrolli sasior me metodën e marrjes së mostrave për produkte të paketuaraò; -Në procesverbalin e inspektimit Kreu II, pika 2 ñDokumente të marraò nuk është plotësuar nga inspektorët; -Nuk dokumentohen me foto shenjat dhe mbishkrimet e paketimeve dhe shisheve enëmatëse, si dhe shenjat e verifikimit të instrumentave matës.
Kriteri	Neni 50/d në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar; Shtojca 1, kollona 7 në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñpër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò Pika 4, neni 38, shkronja ñaò neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Kapitulli III, pika 3.3, 3.2 dhe kapitulli VI, pika 6.1 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mospasqyrimi i plotë i situatës në subjektin e inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve;
Shkaku	Mungesa e zbatimit plotësisht të kuadrit rregullator
Rëndësia	E ulët
Rekomandime	

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2019-002252-1 datë 11.11.2019. Subjekti-AB. Grupi i inspektimit:E.Sh, E.L, A.R. -Në listë-verifikimin e inspektimit, inspektorët shprehen se subjekti është importues i produkteve të parapaketuara dhe kanë marrë mostër për produktin tottis në 3 lloje, ndërkohë sipas verifikimit të grupit të auditimit në ekstraktin e regjistrimit të subjektit në QKB, rezulton se ky subjekt importues edhe i produkteve industriale, dhe inspektorët nuk kanë marrë asnjë mostër për inspektim nga këto produkte; -Sipas listë-verifikimit pasqyrohet informacioni se subjekti nuk zbaton sistemin e tij të kontrollit të sasisë neto të paketimeve, detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 37/3 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar; -Në procesverbalin e inspektimit Kreu II, pika 1 ñTabela e marrjes së mostraveò nga inspektorët është plotësuar me ñJoò, ndërkohë që në listëverifikimin ata shprehen ñNë subjekt u krye kontrolli sasior me metodën e marrjes së mostrave për produkte të paketuaraò; -Në procesverbalin e inspektimit nuk pasqyrohet metoda e përdorur për marrjen dhe testimin e mostrave; -Nuk dokumentohen me foto shenjat e verifikimit të parapaketimeve të inspektuar në subjekt.
Kriteri	Shkronja ñfò pika 2.1 dhe pika 2.4.1 në VKM nr.1352, datë 3.10.2008 ñpër miratimin e rregullores për parapaketimetò, e ndryshuar; Pika 4, neni 38, shkronja ñaò neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Kapitulli III, pika 3.3, 3.2 dhe kapitulli VI, pika 6.1 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò
Ndikimi/Efekti	Mospasqyrimi i plotë i situatës në subjektin e inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve;

	Mosgarantimi i plotë i sigurisë së produkteve joushqimore.
Shkaku	Mungesa e zbatimit plotësisht të kuadrit rregullator
Rëndësia	E ulët
Rekomandime	Me qëllim forcimin e qëllimit të Ligjit nr.126/2020 ñPer metrologjinëò për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet, ISHMT në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, të vlerësojnë mundësinë e ndryshimit ligjor të pikës 1 të nenit 38 në Ligjin nr.126/2020 ñPër metrologjinëò, ku të bëhet e detyrueshme që prodhuesit e parapaketimeve të bëjnë kërkesë për miratimin e sistemit të kontrollit sasior.

Titulli i Gjetjes	**Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve 2019-2020-2021**
Situata	Inspektimi ISHMT-DQ-2020-001920-1 datë 03.09.2020. Subjekti-A. Grupi i inspektimit:M.L, A.D. -Inspektorët kanë marrë mostër vetëm për produktet e parapaketuara pesticide dhe plehëra kimike, ndërkohë sipas verifikimit të grupit të auditimit në ekstraktin e registrimit në QKB, subjekti importon edhe produkte të parapaketuara industriale, ushqimore, blegtorale, për të cilat inspektorët nuk kanë marrë asnjë mostër për inspektimin e sasisë në paketim; -Nuk është kryer inspektimi i instrumentave matës që ka në përdorim subjekti; -Në procesverbalin e inspektimit nuk pasqyrohet metoda e përdorur për marrjen dhe testimin e mostrave. -Në procesverbalin e inspektimit Kreu II, pika 1 ñTabela e marrjes së mostraveò nga inspektorët është plotësuar me ñJoò, ndërkohë që në listëverifikimin ata shprehen ñNë subjekt u krye kontrolli sasior me metodën e marrjes së mostrave për produkte të paketuaraò; -Nuk dokumentohen me foto shenjat dhe mbishkrimet të paketimeve dhe shisheve enëmatëse;
Kriteri	Autorizimi i inspektimit; Neni 50/d në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar; Pika 4, neni 38, shkronja ñaò neni 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Kapitulli III, pika 3.3, 3.2 dhe kapitulli VI, pika 6.1 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
Ndikimi/Efekti	Mospasqyrimi i plotë i situatës në subjektin e inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mosgarantimi i plotë i sigurisë së produkteve joushqimore.
Shkaku	Mungesa e zbatimit plotësisht të kuadrit rregullator
Rëndësia	E ulët
Rekomandime	

Observacion: Me shkresën nr.614/9, datë 27.09.2021 dhe shkresën nr.614/10, datë 15.10.2021 nga ISHMTështë bërë observacion për konstatimet e grupit të auditimit për praktikat e inspektimit më sipër, ku në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë vijon:
-Konstatimi i grupit të auditimit për llojin e aktivitetit që ushtron subjekti dhe kryerjen e inspektimit edhe për produkte të tjera veç atyre që janë pasqyruar në dokumentet e inspektimit, nuk qëndron, pasi subjektet në ekstraktet e tyre regjistrojnë disa lloje aktivitetesh, por që në realitet nuk i ushtrojnë ato.

-Moszbatimi i nenit 37/3 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, nuk është detyrues dhe nuk mund të ngarkohet subjekti me masë administrative;
-Mospasqyrimin e metodës së mostërmarrjes;
-Mospasqyrimin në procesverbalin e inspektimit, tabela e mostëmarrjes, për mostrat e marra në subjekt, me pretendimin se grupi i inspektimit nuk merrë mostra në subjekt për ekzaminime apo analiza të hollësishme, por vetëm për testimin e tyre;
-Mospasqyrimi në procesverbal, rubrika përkatëse, në rastet kur në subjekt është marrë dokumentacion, ku grupi auditimit i referohet shtojca 1, kollona 7 në urdhërin nr.25, datë 10.08.2018, sipas kësaj pike procesverbali duhet te plotesohet në të gjitha rubrikat...ò, në rastin konkret të gjitha rubrikat janë të plotësuara, ashtu dhe rubrika ku shënohet qëështë marrë një kopje e faturës tatimore të verifikimit të instrumentit matës lëshuar nga DPM dhe është shënuar në procesverbal edhe nr. serial i kësaj fature. Në këtë shtojcë nuk cilësohet qëështë e detyrueshme të skanohet fatura e tvsh e marrë fotokopje nga subjekti dhe të ngarkohet në sistem. Kjo faturë eshtë marrë fizikisht dhe është bashkëngjitur dosjes së dorëzuar në protokollin e ISHMT. Gjithashtu listat e verifikimit janë të plotësuara në të gjitha rubrikat edhe në atë ku pyetet nëse subjekti ka bërë apo jo verifikim të instrumenit matës dhe nëse ky verifikim është brenda afatit apo jo.
-Për rastet kur subjekti nuk ruan dokumentacionin e kontrollit, rregjistrimet periodike dhe rezultatet e vetëkontrolleve, në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, nuk parashikohet masë administrative;
-Konstatimi për nënshkrimin e dokumentacionit të marrë në subjekt në përfundim të inspektimit. Këtu grupi i auditimit i referohet pikës 1 të nenit 39, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò ku thuhet, gjatë inspektimit, inspektori ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit. Kërkesa bëhet me gojë dhe pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Çdo kopje dokumenti, i marrë, nënshkruhet nga përfaqësuesi i subjektit të inspektuarò. Grupi inspektimit të ISHMT mban disa dokumente në subjekt me anë të inspektimit online. Procesverbal, listë verifikime, vendim përfundimtar, protokollmatje, tabelë të pasqyrës së tregut, foto. Ndër dokumentet që merren si kopje nga subjektet janë dhe faturat tatimore të lëshuara nga organe si Drejtoria e Përgjithëshme e Metrologjisë apo subjekte private që kryejne këto verifikime dhe që operojnë në RSH. Këto fatura janë të firmosura nga subjekti që në momentin që ju lëshohet një kopje pas kryerjes së pagesës tarifës së verifikimit nga ana e metrologëve. Për cdo dokument tjetër që inspektoret e ISHMT marrin në subjekt që nuk ka firmën e përfaqësuesit të subjektit që mund të jenë deklarata konformiteti mbi produktin apo foto të ndryshme nga subjekti firmosen nga përfaqësuesi. Cdo e dhënë e faturës si nr. Serial, data dhe lloji i instrumentit matës pasqyrohët edhe në listëverifikim dhe procesverbal.
-Mbi dokumentimin me foto të shenjave të verifikimit të produkteve të inspektuar në subjekt.Këtu grupi auditimit i referohet shkronjës a, të nenit 41 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò ku thuhet ñinspektori ka të drejtë të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseveò si dhe pikës 3.2 të urdhërit të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015, ku thuhet ñInspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta: a) të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjedisve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit;
Sic parashikohet ne nenin 41 ashtu edhe ne urdherin nr 13, date 23.04.2015, fotografimi filmimi apo rregjistrimi gjatë inspektimit është një e drejtë e inspektorit dhe jo një detyrim i tij. Fotografime të ambienteve të punës, pajisjeve të punës apo produkteve dhe makinerive janë kryer

nga inspektorët në shumë procese inspektuese dhe kjo është e verifikueshme lehtësisht në shumë dosje e praktika.

-Mbi konstatimin për matjet e kryera në karburantet. Sipas nenit 3, pika 24 Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 citohet se: ñInspektimi metrologjik është kontrolli që ushtrohet në lidhje me vendosjen në treg dhe përdorimin e instrumenteve matëse që kryhet me qëllim për të provuar që ato janë zbatuar/përdorur në mënyrë korrekte, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret që i përkasin. Ai përfshin dhe kontrollin e korrektësisë së sasisë të treguar si dhe përmbajtjes në parapaketime tashmë të vendosura në tregò.

Siç edhe përmendet nga ana e GA, Ligji siç ka gërmë ka edhe frymë, në asnjë rast në Ligjin për metrologjinë nuk ndalohet të kryhen testime nga ana e inspektimit metrologjik për instrumentat matëse ligjërisht të kontrolluara në fushën hidrokarbure por jo vetëm. Referimi nga ana e GA për sa i përket Ekspertizës Metrologjike e cilësuar në ligj me termin ñmatje zyrtareò, referenca i takon rasteve kur nga ana e gjykatës apo institucioneve kërkuese kryhet një veprim i tillë, i cili padyshim kryhet nëpërmjet pagesës.

Nëse i referohemi procedurës për të cilën GA pretendon se ISHMT nuk mund të kryejë testimin e instrumentave matës të shpërndarjes së naftës sqarojmë se :

Në zbatim të Ligjit për metrologjinë dhe atij të inspektimit ISHMT kryen inspektim fizik, vizual dhe laboratorik të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar në fushën hidrokarbure.

Inspektorët e ISHMT kanë kryer të njëjtin proces testimi edhe gjatë kohës që ata kanë qenë si strukturë pranë DPM;

Testimi i instrumentave matës gjatë inspektimeve të planifikuara dhe atyre me bazë risku është me të njëjtin standard dhe procedurë që e kryen edhe DPM. Laboratorët e lëvizshëm të DPM dhe ISHMT kalibrohen dhe certifikohen nga ana e DPM;

Procedura e testimit të një instrument i cili ka kaluar një vlerësim konformiteti nga metrologu i DPM nuk mund të kryhet sërish nga i njëjti institucion, por nga ana e inspektimit metrologjik, ose e një trupë tjetër që në këtë rast mungon në vend, për të krijuar pavarësi të procesit.

Në të gjitha rastet kur ISHMT ka kryer testime/matje të cilat kanë rezultuar me instrumenta matës me një gabim maksimal të lejuar jashtë kufijve të lejuar, nga ana e DPM nuk ka pasur asnjë kontestim gjatë procesit të kthimit në konformitet dhe verifikimit jashtë radhe të instrumentit pas konstatimit të ISHMT, çka konfirmon standardin e matjeve.

Në të gjitha rastet, pa asnjë përjashtim, rezultatet e matjeve të ISHMT për istrumentat me një gabim më të madh të lejuar se kufiri maksimal janë konfirmuar gjatë procesit të kolaudimit të instrumentit por edhe të riverifikimit nga metrologu i DPM.

Neni 20, pika 3 e Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 citohet se: ñPersonat juridikë dhe fizikë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, duhet të përdorin instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara, në mënyrë që të sigurojnë saktësinë e kërkuar të matjeve. Ata janë përgjegjës për performancën teknike të instrumenteve matëse dhe për saktësinë e rezultateve të matjeveò, gjë që përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë, në përputhje me nenin 64, pika 3/b.

GA i referohet nenit 34 ku në pikën 2 thuhet ñPersonat fizikë apo juridikë kanë të drejtë të kërkojnë që Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim dhe të hartojë një raport testimi, kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluarò. Inspektorët e ISHMT kryejnë kontrolle dhe testime të instrumenteve matëse në lidhje me performancën teknike dhe sasinë e rezultateve të matjeve, gjë e cila nuk ka të bëjë me procedurat e verifikimit dhe ekspertizën metrologjike të kryera nga DPM apo persona të tjerë të autorizuar.Sqarojmë se nuk ka patur persona të autorizuar nga DPM apo të akredituar për kryerjen e matjeve në fushën e instrumentave ligjërisht të kontrolluar në fushën hidrokarbure. DPM nuk mund të thërritej për të kryer matje apo testime për instumente që vetë kjo drejtori ka kontrolluar, pasi do të ishim në kushtet e konfliktit të interesit dhe në shkelje të të gjitha parimeve të infrastrukturës së cilësisë dhe mbikëqyrjes së tregut.

-Mbi konstatimin e grupit të auditimit, për mosvendosjen e gjobës, në rastin kur subjekti nuk ka respektuar afatin për dorëzimin e dokumentacionit.
-Faturat tatimore të shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës që ka subjekti.
Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së: Lidhur me observacionet e bëra për inspektimet e mësipërme, qëndrimi jonë sipas çështjeve të konstatuara në çdo inspektim pasqyrohet si vijon:
Si dokumentohet realiteti që subjekti i ushtron apo jo aktivitetet e tjera? Vetëm nëpërmjet pohimit tuaj? Në rast se nga ana juaj si inspektor nuk shoqërohet ky pohim me dokumentacion vërtetues (minimalisht shitjet/furnizimet e subjektit për muajin e fundit), atëherë lind dyshimi i arsyeshëm mbi gjithëpërfshirjen e inspektimit të produkteve sipas llojit të aktivitetit që kryen subjekti. Grupi i auditimit nuk është shprehur se nuk është kryer inspektimi, por që ndodhur në kushte të tilla kur subjekti ka të regjistruar disa lloje aktivitetesh, si dhe kur objekti i inspektimit nuk është specifik (pra kontrolli i parapaketimeve), dhe detyrimin ligjor që ka ISHMT për inspektimin e produkteve të parapaketuara, atëherë edhe llojet e tjera të aktivitetit që ka subjekti të regjistruara kanë produkte të parapaketuara. Sqarojmë se KLSH auditon vetëm mbi bazën e dokumentacionit dhe jo të pohimeve të bëra nga punonjësit e institucionit të audituar.
Për sa më sipër nuk merret në konsideratë observacioni i bërë për këtë konstatim. Ky qëndrim vlenë edhe për observacionet e tjera me të njëjtën përmbajtje.
-Për pamundësinë e marrjes së masës administrative, në rastet kur nuk ruhet dokumentacioni i kontrollit, rregjistrimet periodike dhe rezultatet e vetëkontrolleve, referojuni përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjën ñeò të pikës 1, pikat 2, 2.1, 2.2, 2.3 të nenit 50 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar:
<u>Neni 50</u>
Detyrat e inspektorit metrolog
1. Gjatë inspektimit metrologjik, një inspektor verifikon:
e) mënyrën se si mbahen dhe përdoren regjistrimet dhe dokumentet e përshkruara ï Në këtë rast sipas informacionit që pasqyrohet prej jush, subjekti nuk i ka, dhe në vijim të këtij neni përcaktohet që:
2. Në rastet kur inspektori <u>vëren shkelje të këtij ligji dhe të rregulloreve të miratuara</u> merr masat urgjente, sipas nevojave të rastit, vendos dënimin kryesor dhe mund të vendosë një ose disa nga dënimet plotësuese.
2.1. Dënime kryesore janë:
a) urdhërimi i korrigjimit të parregullsive dhe të mangësive të vërejtura brenda një periudhe kohe të specifikuar ï Ju nuk e keni bërë këtë;
b) dënim me gjobë, <u>i cili vendoset për të gjitha shkeljet e konstatuara</u>, në përputhje me nenin 64 të këtij ligji ï Ju nuk e keni bërë këtë;
2.2. Dënime plotësuese janë:
a) pezullimi i përdorimit të instrumenteve matëse dhe pezullimi i hedhjes në treg të parapaketimeve dhe shisheve enëmatëse, që nuk përputhen me kërkesat e përshkruara;
b) pezullimi i kryerjes së veprimtarive, që janë në kundërshtim me ligjin apo me rregullat e zbatuara;
c) plumbosja;
ç) vendimi për ndalimin e hedhjes në treg apo heqjes nga tregu të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.
2.3. Masa urgjente janë masat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin ï Ju nuk keni marrë asnjë nga masat e mësipërme.
-Për të vazhduar në përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën ñfò të pikës 2.1 (ku importuesi trajtohet njëlloj si prodhuesi i parapaketimeve, pa përjashtuar asnjë element, siç shpreheni ju ñvetëm me konformitetin e produktit që hidhet në treg...ò), shkronjës ñdò të pikës 2.4.4, shkronjat ñbò dhe ñcò të pikës 2.4.8, shkronjën ñbò të pikës 2.4.9 dhe pikën 2.4.11 të VKM nr.1352, datë 03.10.2008 ñPër miratimin e rregullores për parapaketimetò:

2.1/f) ñProdhues i parapaketimeve (paketues)ò është një sipërmarrës i regjistruar në organet përkatëse, i cili mat porcione të një produkti, i fut këto porcione në një paketim (ambalazh) individual dhe hedh parapaketimin për herë të parë në treg; për qëllime të kësaj rregulloreje, një sipërmarës që fut parapaketime në hapësirën doganore të Shqipërisë, këtej e tutje i quajtur ñ importuesò do të trajtohet si prodhues ï Në këtë përcaktim të VKM, nuk pasqyrohet në asnjë moment se importuesi trajtohet si prodhues ñvetëm me konformitetin e produktit që hidhet në treg...ò, referuar shprehjes tuaj. Paragrafi është i qartë, kur thotë për qëllime të kësaj rregullore, pra cilat janë qëllimet e rregullores: Parapaketimet ligjërisht të kontrolluara; Kërkesat e sasive neto të parapaketimeve; Metodat dhe instrumentet matëse që përdoren për përcaktimin e sasisë neto të parapaketimeve; Diapazonet e sasive nominale të përmbajtjeve të parapaketimeve me sasi nominale të njëjtë sasia dhe llojet e produkteve që u përkasin atyre; Kriteret e kontrollit të sasisë neto dhe metodat e kontrollit të parapaketimeve kriteret e pranimit dhe **dokumentacioni;** Rregullat për vendosjen e mbishkrimeve në parapaketime, si dhe forma dhe paraqitja grafike e shenjës së konformitetit. Për të vijuar me përcaktimin e bërë në:

2.4.4/d: ñParapaketimet u nënshtrohen kontrolleve inspektuese në ambientet e prodhuesit ose importuesit konform paragrafit 7.2 të kësaj rregulloreje në rastet kur:

a) gjatë procesit të aprovimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesit, si dhe gjatë monitorimit periodik të tij;

b) kur ekziston një njoftim me shkrim nga struktura përgjegjëse e DPM-së, për regjistrimin e paketuesve dhe importuesve të parapaketimeve;

c) kur gjatë vëzhgimit rezulton shkelje të pikës 7.3.3 të kësaj rregulloreje;

d) kur prodhuesi ose importuesi **nuk mban dokumentacionin** për kontrollin e kryer sipas pikës **7.8** të kësaj rregulloreje **(pika 7.8 -** Prodhuesit e parapaketimeve në sasi nominale të njëjtë ruajnë dokumentacionin e kontrollit, i cili duhet të përmbajë: a) një përshkrim të metodës së kontrollit të përdorur; b) regjistrimet e matjeve dhe të rezultateve të përpunimit dhe kontrollit; c) të dhëna për veprimet korrigjuese të marra kur jokonformiteti i sasisë neto të parapaketimeve me kërkesat e specifikuara është eliminuar; d) regjistrime të tjera që tregojnë vëzhgimin e metodës së kontrollit të përshkruar)ò.

2.4.8/b/c-Inspektimi metrologjik i personave që importojnë parapaketime me **sasi nominale të njëjtë** përfshin:

b) **verifikimin e dokumenteve të kontrollit** që konfirmojnë përputhjen e partisë së importuar me kërkesat e sasive neto;

c) kryerjen e kontrolleve inspektuese në rastet e pikës 2.4.4.

2.4.9/b.Inspektimi metrologjik i personave që importojnë parapaketime me **sasi nominale jo të njëjtë** përfshin: **b) kryerjen e kontrolleve inspektuese në rastet e pikës 2.4.4.**

2.4.11-Për shkelje të konstatuara nga kontrolli, inspektori vepron sipas dispozitave ligjore të **nenit 60** të ligjit ñPër metrologjinëò.

-Sa më sipër përcaktimet ligjore shprehin qartë detyrat tuaja si inspektor në inspektimin e produkteve të parapaketuara, dhe si veprohet në rastet e shkeljeve ligjore nga subjektet e inspektuara.

Për sa më sipër nuk merret në konsideratë observacioni i bërë për këtë konstatim. Ky qëndrim vlen edhe për observacionet e tjera me të njëjtën përmbajtje.

-Për mospasqyrimin në tabelën e procesverbalit të veprimit tuaj, pra testimin e sasisë së produkteve të paraketuara, sqarojmë se:

Referuar pikës 24 të nenit 3 Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, përcaktohet se:

Neni 3 Përkufizime

24. ñInspektimi metrologjikò është kontrolli që ushtrohet në lidhje me vendosjen në treg dhe përdorimin e instrumenteve matëse që kryhet me qëllim për të provuar që ato janë zbatuar/përdorur në mënyrë korrekte, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret që i përkasin. Ai

përfshin dhe kontrollin e korrektësisë së sasisë së treguar dhe përmbajtjes në parapaketime tashmë të vendosura në treg.

Për të vijuar me përcaktimin e bërë në shkronjën **"g" të pikës 2.1** tëVKM nr.1352, datë 03.10.2008 ñPër miratimin e rregullores për parapaketimetò

g) ñMetoda referueseò është një metodë e **kontrollit të parapaketimeve** e përdorur nga trupat (organet) e kontrollit me qëllim **sqarimin e korrektësisë** së procesit të paketimit të produktit;

shkronjën "k" të pikës 2.1:

k) ñMostër e një partie parapaketimiò, këtej e tutje e quajtur ñmostërò **është një numur i caktuar parapaketimesh të marra në një mënyrë të çfarëdoshme** (të rastësishme) nga një parti (dhe zgjidhet në mënyrë të tillë që të jetë sa më përfaqësuese e saj); **dhe përdoret si bazë për vlerësimin e partisë –** Ju në këtë rast keni **marrë mostër për të vlerësuar sasinë**, pra ju **keni testuar** mostrën ï duke vijuar me përcaktimin e bërë në**pikën 4 të nenit 38** të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò:

Neni 38

Marrja e mostrave ï Ju në këtë rast keni marrë mostër;

1. Nëse është e nevojshme për **qëllimin e inspektimit**, inspektorët kanë të drejtë të marrin, pa pagesë, **mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve dhe t'ia nënshtrojnë ato ekzaminimit apo analizave** - Ju në këtë rast nuk keni kryer një ekzaminim[7],

4. Marrja e mostrave **pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit**. Inspektori është i detyruar të njoftojë rezultatet e ekspertizës apo të ekzaminimit brenda 4 ditëve nga data e marrjes së rezultatit të tyre ï Ju nuk e keni pasqyruar në procesverbalin e inspektimit marrjen e mostrës. Në pikën 4 janë dy përcaktime ligjore: 1.Marrja e mostrave **pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit** dhe 2:Njoftimi i rezultatit brenda 4 ditësh. Grupi i auditimit nuk shprehet në asnjë rast për mënyrën e marrjes së mostrës, për afatin e përgjigjes së rezultatit.

Gjithashtu nëse i referohemi përcaktimit të bërë në Kapitullin III, pika 3.3 ñProcesverbali i inspektimitò ï **Seksioni 3.3.1.2** Procedura e inspektimit: ñPër realizimin e qëllimit të inspektimit mund të ketë raste kur nevojitet marrje mostrash të produkteve dhe mjeteve që inspektohen, në procesverbal shfaqen dy opsione ñPoò dhe ñJoò. Nëse inspektori **vendos marrje mostre**, plotëson kutinë ñPoò, dhe në hapësirën e procesverbalit gjenerohen nga sistemi tabelat e marrjes së mostrave, **të cila janë të ndryshme**, **në varësi të inspektortit shtetëror përkatës**, **si dhe tabela për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive**. E njëjta procedurë me ndryshimet përkatëse ndiqet edhe për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive. Marrja e mostrave pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit.

-Sa më sipër ju keni kryer inspektim, keni marrë mostër (sepse kshu e përcakton dhe VKM e mësipërme), ku keni verifikuar peshën e saj, nëse është në përputhje me atë që deklarohet apo jo, dhe ndërkohë nuk e keni pasqyruar në procesverbalin e inspektimi.

Për sa më sipër nuk merret në konsideratë observacioni i bërë për këtë konstatim. Ky qëndrim vlen edhe për observacionet e tjera me të njëjtën përmbajtje.

-Sa i përket plotësimit të rubrikës përkatëse të procesverbalit, pra në rastet kur në subjekt, në përfundim të inspektimit merret dokumentacion, referuar përcaktimit ligjor të bërë nëUrdhërin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 10.8.2018 ñPër miratimin e rregullores, ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò, sqarojmë se, në asnjë rast nuk kemi thënë se nga ju në procesverbal nuk është pasqyruar informacioni që në subjekt keni marrë dokumentacion, por kemi konstatuar se rubrika përkatëse e procesverbalit, ajo ku pasqyrohet se është marrë dokumentacion nga subjekti, nuk është plotësuar,

[7] http://www.fjalori.shkenca.org/-**EKZAMINOJ** *kal., libr*-Vëzhgoj, vërej ose shqyrtoj me vëmendje e hollësisht diçka për ta **kontrolluar**, për të zbuluar veçoritë, tiparet a shenjat dalluese të saj etj.; kontrolloj me kujdes. Ekzaminoj dokumentin.

dhe ky detyrim përcaktohet në shtojcën 1 kollona 7 ñ**Procesverbali i inspektimit plotësohet në të gjitha rubrikat**, gjatë punës në terren nga trupa inspektuese, e cila kryen inspektimin, si dhe mban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit. Trupa inspektuese duhet të pasqyrojë në procesverbal pretendimet e subjektit, objekt inspektimi mbi gjetjet e konstatuara përpara se të përpilojë procesverbalin dhe vendimin përfundimtarò.

-Lidhur me ngarkimin e dokumentacionit të marrë në subjekt, në sistemin e-inspektimi, në asnjë rast nuk kemi thënë se ky dokumentacion duhet të skanohet, por kemi thënë që nuk është hedhur në sistem, detyrim i cili përcaktohet në shtojcën 1 të Urdhërit të mësipërm: Autorizimi, marrja e njoftimit të autorizimit, lista e verifikimit, procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar, vendimi i ndërmjetëm, **dokumentacioni justifikues,** marrja e njoftimit të procesverbalit, shpjegimet apo kontestimet e subjektit mbi gjetjet e konstatuara në procesverbal, marrja e njoftimit të vendimit përfundimtar, përgjigjet e rezultatit të analizave **dhe çdo dokument tjetër i administruar në dosjen e inspektimit** (**prova materiale**, fotografime, filmime), i nënshkruar dhe timbruar, të ngarkohen në portal, në dosjen përkatëse ï Sipas jush si kuptohet ky përcaktim?

Për sa më sipër nuk merret në konsideratë observacioni i bërë për këtë konstatim. Ky qëndrim vlenë edhe për observacionet e tjera me të njëjtën përmbajtje.

-Për nënshkrimin e dokumentacionit të marrë në përfundim të inspektimit, nga përfaqësuesi ligjor i subjektit të inspektuar, në pikën 1 të nenit 39 të Ligjit të inspektimit përcaktohet:

<u>Neni 39 Marrja e kopjeve dhe sekuestrimi i dokumenteve</u>

1. Gjatë inspektimit, inspektori ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë **kopje të dokumenteve** të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit. Kërkesa bëhet me gojë dhe pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. **Çdo kopje dokumenti**, i marrë, **nënshkruhet** nga përfaqësuesi i subjektit të inspektuar ï Pra ju keni marrë dokument në subjekt, i cili është fotokopje (ku përfshihet edhe ajo firma që ju citoni, e cila pasqyron se subjekti ka marrë shërbimin, prandaj firmos faturën tatimore, si blerës i shërbimit të verifikimit. Formati i faturës tatimore dhe plotësimi i saj, është detyrim nëUdhëzimin e Ministrit të Financave nr.6, datë 30.01.2015 ñPër TVSH në RSHò, ndryshuar), pra ajo që referoni ju është tjetër. Në këtë rast nënshkrimi nga përfaqësuesi i subjektit të dokumentacionit të marrë, tregon se ky dokumentacion është marrë gjatë këtij inspektimi në këtë subjekt, ndryshe nuk kuptohet se nga e keni gjetur ju atë dokument. Gjithashtu kjo pikëështë parashikuar që, për çdo rast të kundërshtimeve të subjektit që mund të krijohen nga vendimmarrja e inspektorëve, bazuar në dokumentacionin e administruar (që vërteton respektimin/mosrespektimin e një/disa kërkesave ligjore), të cilat mund të adresohen në gjykatë, atëherë çdo dyshim që mund të ngrihet mbi vërtetësinë dhe autorësinë e dokumentacionit, vërtetohet nëpërmjet nënshkrimit nga përfaqësuesi i subjektit.

Për sa më sipër nuk merret në konsideratë observacioni i bërë për këtë konstatim. Ky qëndrim vlenë edhe për observacionet e tjera me të njëjtën përmbajtje.

-Për pamundësinë e marrjes së masës administrative ndaj subjekteve që nuk kanë të miratuar sistemin e kontrollit të sasisë, siç jemi shprehur në Projekt Raportin e Auditimit, **e kemi marrë në konsideratë,** dhe në konstatimin përkatës kemi hequr fjalët ñnuk është marrë masë administrativeò, si dhe e kemi cituar në qëndrimin tonë se merret në konsideratë për veprimet e inspektorit në subjekt. Fakti që ky konstatim është pasqyruar në inspektimet përkatëse, nuk ju ngarkon me përgjegjësi, por shërben si një fenomen për të mbështetur rekomandimin përkatës për përmirësim ligjor.

-Për rastet e faturave tatimore për verifikimin e instrumentave matës që ju keni sjellë, është marrë në konsideratë dhe është bërë ndryshimi përkatës (përjashtuar inspektimin në subjektin D, për të cilin nuk ka faturë tatimore bashkëlidhur). Theksojmë se në raste të caktuara, grupi i auditimit nuk është shprehur se nuk janë faturat në dosjen e inspektimit, por është shprehur për një parregullsi të evidentuar në plotësimin e rubrikës përkatëse në procesverbalin e inspektimit.

-Për mospasqyrimin e metodës së mostërmarrjes, kemi saktësuar bazën ligjore, Kapitulli III, pika 3.3 dhe kapitulli VI, pika 6.1 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò.
-Lidhur me referimin e shkronjës a të nenit 41 të Ligjit të inspektimit (në rastin e dokumentimit me foto), sqarojmë se neni 41 është pjesë e seksionit 3 të Ligjit, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrat e inspektorit, pra që në krye të herës, përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e inspektorit. Nëse do ti merrnim me rradhë të gjithë nenet e këtij seksioni 37-42, në të gjitha përcaktimet ligjore të bëra, pasqyrohet shprehja inspektori ka të drejtë..., pra për ilustrim neni 37, pika 1: Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, **inspektori ka të drejtë të hyjëdhe të inspektojë** godinat, mjediset, objektet, mjetet e transportit, ku apo nëpërmjet të cilave ushtron veprimtarinë subjekti i inspektimit, si dhe të inspektojë instalimet, pajisjet, makineritë, produktet, sendet, substancat, përbërësit dhe çdo send tjetër të lidhur me veprimtarinë, objekt inspektimi ï Sipas argumentit tuaj edhe kjo nuk është detyrim por e drejtë, atëherë përse kjo e drejtë ushtrohet nga ju?
Neni 38, pika 1 - Nëse është e nevojshme për qëllimin e inspektimit, **inspektorët kanë të drejtë të marrin, pa pagesë, mostra** të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve dhe t'ia nënshtrojnë ato ekzaminimit apo analizave ï Edhe këtu kemi të bëjmë me një të drejtë të inspektorit dhe jo detyrim, atëherë përse ju këtë të drejtë e ushtroni pothuajse në të gjitha rastet (kryesisht në inspektimin e instrumentave matës, parapaketimeve). Sipas argumentit tuaj, atëher rezulton se ju veproni me dy standarde, kur ju doni të drejtën tuaj ligjore e ktheni në detyrim, dhe kur ju nuk doni atëherë këtë të drejtë ju nuk e konsideroni si detyrim.
-Sa më sipër, ligji ju ka garantuar juve të drejtat përball subjektit, pra që në punën tuaj dhe për objektin e saj, mos të hasni pengesa nga subjekti, dhe nëse hasen pengesa të tilla, atëherë në zbatim të këtyre të drejtave që ju garantohen me ligj të merrni masat e nevojshme, por njëkohësisht që në krye të herës, ligji e ka përcaktuar që brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit këto të drejta janë edhe detyrim në punën tuaj.
Për sa më sipër nuk merret në konsideratë observacioni i bërë për këtë konstatim. Ky qëndrim vlenë edhe për observacionet e tjera me të njëjtën përmbajtje.
-Lidhur me argumentin e dhënë nga ju për konstatimin mbi matjet e kryera për instrumentat në karburante, referuar informacionit të pasqyruar prej jush në procesverbal, si dhe të përcaktimeve ligjore, sqarojmë se:
ISHMT është një institucion publik dhe veprimet që kryehen prej tij duhet të bazohen në kuadrin rregullator;
<u>Në pikën24, neni 3</u> - ñInspektimi metrologjikò është kontrolli që ushtrohet në lidhje me vendosjen në treg dhe përdorimin e instrumenteve matëse që kryhet me qëllim për të provuar që ato janë zbatuar/përdorur në mënyrë korrekte, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret që i përkasin. Ai përfshin dhe kontrollin e korrektësisë së sasisë së treguar dhe përmbajtjes në parapaketime tashmë të vendosura në treg. Në këtë pikëështë përcaktuar qartë se për cilat produkte ju mund të kryeni matje, pra për parapaketimet.
<u>Në pikën 25, neni 3</u> - ñMatje zyrtareò **është një matje e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar** (më poshtë ekzekutues i matjes zyrtare), në përputhje me vendimin administrativ për autorizim. Matja zyrtare përdoret si evidencë e besueshme në **procedurat dhe vendimmarrjet e organizmave qeveritarë** apo të gjykatave. Pra për veprimin që keni kryer ju (matje të instrumentave), i jepet e drejta DPM ose personit juridik të autorizuar nga DPM.Pra sipas jush, ligji nuk e ka ndaluar ktë veprim sepse në ligj nuk është shprehur që ISHMT nuk mund të kryej matje të instrumentave, por ajo që konstaton grupi i auditimit, është se ISHMT e ka të ndaluar të kryejë matje, pasi ligji këtë të drejtë dhe detyrë ja ka dhënë DPM ose personit të autorizuar (këtu është fryma e ligjit). Në vijim të këtij paragrafi përcaktohet që matja përdoret si evidencë e besueshme në **procedurat dhe vendimmarrjet e**

organizmave qeveritarë apo të gjykatave, pra ju jeni një organizëm qeveritar, çka do të thotë se ju në një rast të tillë (inspektim me indicie për mosfunksionim korrekt të instrumentit matës) duhet të kërkoni nga DPM që të kryej matje, dhe që këtë mund ta bëjë edhe në prezencën e grupit të inspektimit të ISHMT, nuk është e ndaluar, përkundrazi **neni 31** i Ligjit të inspektimit, ju ka dhënë mundësinë që në veprimet tuaja ju mund të mbështeteni edhe nga institucione publike/subjekte private.

-Sa i përket argumentit tuaj se nuk mund tôi kërkojmë DPM që të kryej verifikimin me pretendimin se do të ishte konflikt interesi, sqarojmë se konflikti i interesit lidhet me personin/personat[8] që kanë të drejtë vendimmarrje mbi një çështje të caktuar, por jo me të gjithë institucionin e DPM[9], çôka do të thotë se DPM nuk ka vetëm një metrolog apo një autolaborator, por ka disa metrolog dhe autolaborator, dhe që mund të autorizohet një metrolog tjetër, nga ai që ka kryer verifikimin e instrumentit, për të shmangur konfliktin e interesit. Për më tepër, që nëse për ju problemi është tek konflikti i interesit, matja mund të kryhet nga metrologu i DPM-së në pranin tuaj.

-Në vijim pasqyrojmë edhe përcaktimin e bërë në**nenin 34**të ligjit të metrologjisë:

1. Veprimtaritë e ekspertizës metrologjike janë: testimi i jashtëzakonshëm i instrumenteve matëse dhe **matjet zyrtare.**

2. Personat fizikë apo **juridikë** kanë të drejtë të kërkojnë që Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar që nuk ka qenë i përfshirë në verifikimet e instrumentit matës në fjalë, të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim dhe të hartojë një raport testimi, **kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar.**

-Nenin 49 "Të drejtat e inspektorit metrolog"

Personat juridikë apo fizikë, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i inspektimit, janë të detyruar të ndihmojnë inspektorin dhe tôi japin atij të dhënat e domosdoshme që lidhen me objektin e inspektimit. Me kërkesë me shkrim të inspektorit, subjekti i inspektimit është i detyruar të japë ose të përgatitë brenda një periudhe të caktuar të dhëna të plota dhe të sakta, informacione dhe regjistrime të nevojshme për kryerjen e inspektimit.

-Nenin 50 "Detyrat e inspektorit metrolog"

1. Gjatë inspektimit metrologjik, një inspektor verifikon:

a) Shfuqizuar;

b) përdorimin e njësive ligjore të matjeve;

c) Shfuqizuar;

ç) **përdorimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara;**

d) konformitetin e parapaketimeve dhe shisheve, enë matëse me masat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij;

dh) Shfuqizuar;

e) mënyrën se si mbahen dhe përdoren regjistrimet dhe dokumentet e përshkruara;

ë) Shfuqizuar.

-Aktualisht ju nuk kryeni më matje, për arsye se këtë shërbim e kryen një subjekt privat ñN.Iò, ndërkohë që më përpara nuk ka qenë ky subjekt, por DPM. Po sot përse nuk kryhen më matje nga ju, sepse nëse i qëndrojmë llogjikës tuaj, ku ligji nuk e jep si të drejtë por as nuk e ndalon, ligji i ri i metrologjisë nuk e ka të shkruajtur që ISHMT nuk duhet të kryej matje.

---

[8] Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, **neni 1** ñqëllimi qëllimi i këtij ligji është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë **të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta".**

[9] Neni 3 Përkufizime - 1. ñKonflikt i interesitò **është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari,** në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Për sa më sipër nuk merret në konsideratë observacioni i bërë për këtë konstatim. Ky qëndrim vlenë edhe për observacionet e tjera me të njëjtën përmbajtje.
-Sa i përket argumentit të dhënë nga ju për konstatimin e grupit të auditimit, se kur subjekti nuk ka respektuar afatin e vendosur nga ju për dorëzimin e dokumentacionit sqarojmë se:
Në shkronjën **"d" të nenit 36** të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò, përcaktohet se:
Neni 36 Detyrimet e subjektit të inspektimit
d) të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për inspektimin, nëse kërkohet nga inspektori dhe brenda afateve të përcaktuara nga ai ï Pra ju keni përcaktuar një afat konkret për dorëzimin e dokumentacionit, me qëllim vazhdimin e procedurës së inspektimit, dhe ky është detyrim për subjektin që ai ta dorëzojë këtë dokumentacion sipas këtij afati, ndërkohë nuk e ka bërë;
Në urdhërin e Inspektorit të Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 ñPër miratimin e dokumenteve standarde të inspektimitò, të ndryshuar - **Formati standard nr.2** ñProcesverbali i inspektimitò, rubrika 6 ñDokumentacioni dhe sendet që duhet të paraqesniò, ku pasqyrohet mbishkrimi ñMosparaqitja **do të konsiderohet pengim** në kryerjen e detyrës së inspektorit shtetëror referuar nenit 54 tëLigjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò, për të vijuar me përcaktimin ligjor të bërë në**nenin 54**:
Kundërvajtjet administrative
ñPrishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve a instalimeve, si dhe çdo shenjë tjetër, të vendosura nga inspektorët, **si dhe pengimi i inspektimit**, nëse nuk përbëjnë vepër penale, **përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë** në vlerën nga 10 000 deri në 100 000 lekë. Të drejtën e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjes e ka çdo inspektor i inspektoratit kompetentò ï Këtë ju nuk e keni kryer.
Për sa më sipër nuk merret në konsideratë observacioni i bërë për këtë konstatim. Ky qëndrim vlenë edhe për observacionet e tjera me të njëjtën përmbajtje.
-Për pretendimet e tjera të bëra nga ju (formatin e deklaratave të konformitetit, mungesën e marrjes së masës administrative gjobë, kur subjekti nuk i ka këto deklarata, shoqërimin e masës së ndalimit të tregëtimit edhe me masat e tjera sipas ligjit), kemi të njëjtin qëndrim me atë të mbajtur në Projekt Raportin e Auditimit.
-Për kërkesën për lëshim urdhëri ekzekutimi të gjobës së vendosur ndaj subjektit ñLò, jemi shprehur se për periudhën objekt auditimi, ky veprim nuk është kryer.
-Për gjobën e vendosur ndaj subjektit A.E nga ju nuk është paraqitur dokumentacion.

III.2.2.Auditimmbi funksionin e inspektimit të drejtorisë së pronësisë industriale dhe intelektuale.

Respektimi i përcaktimeve ligjore në kryerjen e inspektimeve, dokumentimin e procedurës së inspektimit, vendosjen e masave administrative, arkëtimin e gjobave, trajtuar si më poshtë vijon:

Titulli i Gjetjes	Procedurat e inspektimit nga Drejtoria e Pronësisë Industriale dhe Intelektuale 2019-2020-2021
Situata	**1.**Në inspektimin e subjektit A 2000, me veprimtari radio, konstatohet se: -Sipas listë-verifikimit pasqyrohet informacioni se subjekti nuk zbaton përdorimin leje/autorizim nga autoriteti i mbajtjes së drejtës/agjencia e adminsitrimit kolektiv. -Në procesverbalin e inspektimit datë 15.07.2020, është lënë detyrë që brenda 15 ditëvë të plotesohet dokumentacioni dhe të dorëzohet pranë ISHMT-së. -Me vendimin përfundimtar në datë 12.08.2020, është marrë masa administrative gjobë në vlerë 100,000 lekë, por nuk është lënë detyrimi ndaj subjektit për korrigjimin e shkeljeve ligjore brenda një afati të caktuar/mos lejimi i përdorimit të programit, për të cilin nuk administron leje përdorimi/autorizim.

	-Theksojme se lista e verifikimit nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e saj. -Ndaj vendimit të inspektorëve, subjekti ka bërë ankesë në ISHMT, dhe Komisioni përkatës me Vendimin nr.1396/5 datë 06.07.2021 pas shqyrtimit të bërë e ka lënë në fuqi gjobën. -Subjekti nuk ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke e kthyer vendimin e komisionit, në vendim të formës së prerë. -Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se nga ISHMT nuk është bërë kërkesë në GJSHP Tiranë, për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të gjobës. Për mosbërjen e kërkesës për lëshim e urdhërit të ekzekutimit të gjobës, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT. **2**- Në inspektimin e subjektit MM, me veprimtariradio,konstatohet se: -Sipas listë-verifikimit pasqyrohet informacioni se subjekti nuk zbaton perdorimin e leje /autorizim nga autoriteti i mbajtjes së drejtës/agjencia e adminsitrimit kolektiv. -Në procesverbalin e inspektimit datë 21.07.2020, është lënë detyrë që brenda 8 ditëve, të plotesohet dokumentacioni dhe të dorëzohet pranë ISHMT-së. -Me vendimin përfundimarë në datë 12.08.2020, është marrë masa administrative gjobë në vlerë 200,000 lekë, por nuk është lënë detyrimi ndaj subjektit për korrigjimin e shkeljeve ligjore brenda një afati të caktuar/mos lejimi i përdorimit të programit, për të cilin nuk administron leje përdorimi/autorizim. -Theksojmë se në këtë rast nga inspektorët është vepruar me dy standarde, pasi për të njëjtën shkelje në dy subjektet (A 2000 dhe MM) gjoba është në vlera të ndryshme. -Lista e verifikimit nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat. -Subjekti ndaj vendimit të inspektimit, ka bërë ankesë pranë ISHMT, dhe nga Komisioni përkatës me vendimin nr.1393/5 datë 28.10.2020, është lënë në fuqi gjoba e vendosur. -Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se nga ISHMT nuk janë marrë masat për përcjelljen e vendimit të gjykatës, pranë përmbaruesit për ekzekutimin e gjobës. Për mosbërjen e kërkesës për lëshim e urdhërit të ekzekutimit të gjobës, mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektor i ISHMT. **3-** Në inspektimin e subjektit M me veprimtarikabllor, konstatohet se: -Sipas listë-verifikimit pasqyrohet informacioni se subjekti nuk zbaton përdorimin e leje /autorizim nga autoriteti i mbajtjes së drejtës/agjencia e adminsitrimit kolektiv. -Në vendimin përfundimtar datë 20.07.2020, është dhënë masa administrative ñParalajmërimò, ndërkohë që ndaj subjektit duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë, duke ndjekur të njëjtën praktikë si në dy inspektimet e subjekteve (A 2000 dhe MM); **4-**Në inspektimin e subjektit P Tirana, me veprimtari përdorim program kompjuterash konstatohet se: -Listë-verfikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në procesverbalin e inspektimit datë 23.12.2020, është konstatuar se subjekti përdor programe kompjuterike pa ñkontratë apo autorizim për përdoruesin e programeve kompjuterikeò, dhe ndaj tij është vendosur masë administrative gjobë në vlerë 100,000 lëkë. -Subjekti ndaj vendimit të inspektimit, ka bërë ankesë pranë ISHMT, dhe nga Komisioni përkatës me Vendimin nr.3205/5 datë 19.03.2021, është lënë në fuqi gjoba e vendosur. -Gjoba është likujduar vullnetarisht nga subjekti, sipas akt-rakordimit me thesarin

	nëmuajin Prill 2021. **5-**Në inspektimin e subjektit ISA, me veprimtari përdorim programe kompjuterash konstatohet se: -Listë-verfikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në procesverbalin e inspektimit datë 28.12.2020, është konstatuar se subjekti përdorë programe kompjuterike pañKontratë apo autorizim për përdoruesin e programeve kompjuterikeò. -Theksojmë se nga inspektorët nuk është vendosur masë administrative gjobë, për subjektin i cili ka qenë në shkelje të kërkesave ligjore, ndryshe nga si kanë vepruar në rastin e inspektimit të subjektit P Tirana, çka tregon veprim me dy standarde; -Subjekti nuk ka respektuar detyrimin e lënë nga inspektorët për korrigjimin e kërkesave ligjore dhe ndaj tij duhet të ishte marrë masë administrative, por që nuk është vepruar në këtë mënyrë. **6-**Në inspektimin e subjektit A, me veprimtaripërdorim kompjuterash konstatohet se: -Listë-verfikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në procesverbalin e inspektimit datë 02.12.2020, është konstatuar se subjekti përdor programe kompjuterike pa ñKontratë apo autorizim për përdoruesin e programeve kompjuterikeò. Në procesverbal është trajtuar se subjekti kishte 9 kompjutera në përdorim nga të cilët 8 kishin program ñwindows 10 proò dhe paket microsoft 2016 dhe 1 kompjuter program ëindoës 7 program microsoft office 2007. Në procesverbal është lënë detyrë për plotësimin e dokumenatcionit për kontrata/autorizme apo fatura blerje te programeve, mbi programet që ka në përdorim, por që nuk është lënë afat konkret për dorëzimin e tyre; -Subjekti ka sjellë faturë tatimore në datë 08.12.2020 me vlerë 42,400 lekë, për pëdorim e 9 kompjuterave por nuk nuk ka sjellë kontratë apo autorizim për përdorimin e programeve, pra jo kontratë përdorimi. Ndodhur në këto kushte fatura tatimore nuk vërteton përdorimin e autorizuar nga subjekti që ka këtë të drejtë, dhe nuk duhet të merrej si provë referuar Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim vlerësimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar. -Sa më sipër ndaj subjektit duhet të ishte vendosur masë administrative, por që nuk është vepruar në këtë mënyrë. **7-**Në inspektimin e subjektit B, me veprimtari përdorim program kompjuterash konstatohet se: -Listë-verfikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në procesverbalin e inspektimit datë 01.09.2020, është konstatuar se subjekti përdorë programe kompjuterike për të cilat nuk ka kontratë/autorizim përdorimi, dhe nga inspektorët nuk është lënë detyrë për dorëzimin e tyre. -Në vendimin prfundimtar të mbajtur në datë 01.09.2020, shprehen se subjekti nuk ka shkelje administrative; -Theksojmë se në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet dokumentacion vërtetues, çka nuk pasqyron me vërtetësi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **8-**Në inspektimin e subjektit A Group, me veprimtari përdorim programe kompjuterike konstatohet se: -Listë-verfikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në procesverbalin e mbajtur në datë 14.09.2020, theksohet se subjekti ka në

	përdorim 50 kompjutera në sitemin Linux pa kontratë/autorizim përdorimi. -Në vendimin përfundimtar nga inspektorët citohet se subjekti nuk ka shkelje. -Nga ana e inspektorëve nuk i është kërkuar subjektit ñKontratë /apo autorizim për përdoruesin e progranmeve kompjuterikeò, apo faturë tatimorë për blerjen e programeve dhe përdorimin e tyre, në këto kushte duhet të ishte vendosur masë administrative ndaj subjektit, por që nuk është vepruar kështu. **9**-Në inspektimin e subjektit I, me veprimtari përdorim program kompjuterash konstatohet se: -Listë-verfikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në dosjen e inspektimit nuk administrohet asnjë dokument vërtetues mbi përdorimin e programeve kompjuterike. **10**- Në inspektimin e subjektit LG EU, me veprimtari përdorim programe kompjuterash konstatohet se: -Listë-verfikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e kryera nga inspektorët; -Në rubrikat me nr. 6, 7, 8, 9, 10, 11 të listë-verifikimit nuk cilësohet nëse subjekti ka leje, autorizim, license, faturë, për blerje dhe përdorimin e programeve kompjuterike; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion vërtetues bashkëlidhur; **11-** Në inspektimin e subjektit HH, konstatohet se: -Listë-verfikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Sipas listë-verifikimit pasqyrohet informacioni se subjekti nuk zbaton përdorimin e leje/autorizim nga autoriteti i mbajtjes së tëdrejtës, agjencia e adminsitrimit kolektiv. -Inspektorët nuk kanë përcaktuar afat konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar; -Në vendimin përfundimtar të inspektimit është dhënë masa administrative paralajmërim, ndërkohë subjekti ka qenë në shkelje të ligjit dhe ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë; **12-**Në inspektimin e subjektit CN Tirana, me veprimtari përdorim kompjuterash konstatohet se: -Sipas listë-verifikimit janë plotësuar rubrika 2 dhe 5 ku pasqyrohet informacioni se subjekti përdorë 15 kompjutera ëindoës bashkëlidhur kontrata, ndërsa rubrikat tjera të listë verifikimit janë të pa plotësuara. -Në procesverbalin e inspektimit, si dhe vendimin përfundimtar datë 16.09.2020, është konstatuar se subjekti nuk ka shkelje, bashkëlidhur ndodhet një kontratë e fotokopjuar, e cila nuk ka objektine saj, nënshkrimin midis palëve, si dhe nuk përcaktohet koha e vlefshmerisë së kontratës, veprime në kundërdshtim me pikën 6 neni 48 të Ligjit nr. 10433 ñPër Inspektimt në Republikën e Shqipërisëò. Në këto kushte dokumentacioni bashkëlidhur nuk duhej të merrej si provë materiale referuar Kodit të Procedurës Administrative. **13-**Në inspektimin e subjektit S4, me veprimtari përdorim programe kompjuterash konstatohet se: -Listë-verfikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në procesverbalin e inspektimit datë 10.02.2020, në pikën 6 ñDokumentacioni që

	duhet të paraqitetò është konstatuar se subjekti nuk ka kontrata/autorizim apo faturë blerje mbi përdorimin e kompjuterave. Në pikën 7 ñGjetjet e konstatuaraò Shkeljeò të nenit 179 Ligjit nr.35/2016 ñPër të drejtat e autorit e drejta tjera të lidhura me toò. Në piken 8, të pv është lënë detyrë që subjekti të sjellë brenda 8 ditesh dokumentacionin plotësues. -Në vendimin përfundimtar datë 24.02.2020 është cituar se subjekti nuk ka sjellë dokumentacion e kërkuar, dhe ndaj tij është vendosur masa administrative ñParalajmërimò, ndërkohë që ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë. **14-** Në inspektimin e subjektit MG 2009, me veprimtarikabllor konstatohet se: -Sipas listë-verifikimit subjekti nuk zotëron ñleje apo/autorizim nga autori ose mbajtësi i të drejtës ose një agjencie të administrimit kolektivò. -Në procesverbalin e inspektimit datë 08.07.2020, në pikën 6 ñDokumentacioni që duhet të paraqitetò është konstatuar se subjekti nuk ka kontrata/autorizim apo faturë blerje mbi përdorimin e kompjuterave. Në pikën 8 të pv është lënë detyrë që subjekti të sjellë brenda 8 ditësh dokumentacion plotësues. -Në vendimin përfundimtar datë 03.08.2020 është cituar se subjekti nuk ka sjellë dokumentacion e kërkuar, dhe ndaj tij është vendosur masa administrative ñParalajmërimò, ndërkohë që ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë. **15**-Në inspektimin e subjektitBS, me veprimtarikabllor konstatohet se: -Sipas listë-verifikimit subjekti nuk zotëron ñkontrat apo /autorizim nga autori ose mbajtësi i të drejtës ose një agjencie të administrimit kolektivò. -Në procesverbalin e inspektimitdatë 17.07.2020, në pikën 6 ñDokumentacioni që duhet të paraqitetò është konstatuar sesubjekti nuk ka leje/autorizim apo faturë blerje mbi përdorimin e kompjuterave. Në pikën 8, të pv sipas shkeljeve të konstatuara është lënë detyrë që subjekti të sjellë brenda 8 ditesh dokumentacion plotësues. -Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk është në përputhje me atë qëështë kërkuar nga inspektorët, pra nuk ka sjellë dokumentacionin e duhur. Kontrata e dorëzuar është fotokopje, pa nënshkrimin e subjektit të inspektuar; -Në vendimin përfundimtar datë 03.08.2020 është vendosur masa administrative ñParalajmërimò, ndërkohë që ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë. **16-**Në inspektimin e subjektit TC Albania, me veprimtarikabllor konstatohet se: -Sipas listë-verifikimit subjekti nuk zotëron kontratë/autorizim nga autori ose mbajtësi i të drejtës ose një agjencie të administrimit kolektivò. -Në procesverbalin e inspektimit datë 13.07.2020, në piken 5, ñDetyrim i subjektit për paraqitje dokumentacioniôô është lënë afati 10 ditor. -Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk është në përputhje me atë qëështë kërkuar nga inspektorët, pra nuk ka sjellë dokumentacionin e duhur. Kontrata e dorëzuar është fotokopje, pa nënshkrimin e subjektit të inspektuar; -Në vendimin përfundimtar datë 20.07.2020 është vendosur masa administrative ñParalajmërimò, ndërkohë që ndaj tij duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë. **17-** Në inspektimin e subjektit A Albania, konstatohet se: -Nuk është plotësuar asnjë rubrikë e listë-verifikimit të inspektimit;

	-Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **18**-Në inspektimin e subjektit A, me veprimtari të ndryshme si reklama, printime etj, konstatohet se: -Nuk është plotësuar asnjë rubrikë e listë-verifikimit të inspektimit; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **19**-Në inspektimin e subjektit AC, me veprimtari ñshërbime telefonikeò konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij, për më tepër në ato rubrika të cilat pasqyrojnë nëse subjekti respekton detyrimet ligjore në administrimin e kontratës/autorizimit të përdorimit të programeve; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **20-**Në inspektimin e subjektit A-19 Albania, me veprimtari ñsherbime telefonikeò, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij, për më tepër në ato rubrika të cilat pasqyrojnë nëse subjekti respekton detyrimet ligjore në administrimin e kontratës/autorizimit të përdorimit të programeve; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **21.**Në inspektimin e subjektit F, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij, për më tepër në ato rubrika të cilat pasqyrojnë nëse subjekti respekton detyrimet ligjore në administrimin e kontratës/autorizimit të përdorimit të programeve; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **22** -Në inspektimin e subjektit ADPS&S, konstatohet se: -Nuk është plotësuar asnjë rubrikë e listë-verifikimit të inspektimit. -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion

	bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **23-** Në inspektimin e subjektit AC, me veprimtari përdorim program kompjuterash konstatohet se: -Nuk është plotësuar asnjë rubrikë e listë-verifikimit të inspektimit. -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **24-**Në inspektimin e subjektit A 3D, konstatohet se: -Nuk është plotësuar asnjë rubrikë e listë-verifikimit të inspektimit. -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **25.**Në inspektimin e subjektit Z, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij, për më tepër në ato rubrika të cilat pasqyrojnë nëse subjekti respekton detyrimet ligjore në administrimin e kontratës/autorizimit të përdorimit të programeve; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **26.**Në inspektimin e subjektit EC, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **27.**Në inspektimin e subjektit AD, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **28.**Në inspektimin e subjektit S-2AB K, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij;

	-Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **29.**Në inspektimin e subjektit B, konstatohet se: -Sipas listë-verifikimit datë 02.06.2021, nga grupi i inspektimit është plotësuar rubrika 2, 5, ku përshkruhet se subjekti ka në përdorim 2 kompjutera, dhe nga inspektorët është lënë 14 ditë kohë për plotësimin dokumentacioni të munguar. -Në procesverbalin e inspektimit datë 02.06.2021 grupi i inspektimit ka konstatuar veprimet e subjektit, të cilat bien në kundërshtim me nenin 179 pika 1 germa f të ligjit 335/2016, dhe kanë përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit 20 ditë; -Dokumentacioni që administrohet në dosjen fizike të inspektimit është fotokopje dhe pa nënshkrimin e subjektit të inspektuar. **30.**Në inspektimin e subjektit E, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **31.**Në inspektimin e subjektit E, konstatohet se: -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **32.**Në inspektimin e subjektit BG, me veprimtari përdorim programe kompjuterash konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **33.**Në inspektimin e subjektit A-AG, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Në dosjen fizike të inspektimit nuk administrohet asnjë dokumentacion bashkëlidhur, që vërteton kryerjen e veprimeve të inspektorëve dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga subjekti; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **34**.Në inspektimin e subjektit K, konstatohet se: -Sipas informacionit të pasqyruar në procesverbal, rezulton se subjekti është gjetur në

	shkelje të kërkesave ligore të përcaktuar në nenin 179, pika 1 germa f, të ligjit 35/2016, ndërkohë në vendimin përfundimtar të inspektimit pasqyrohet informacioni se subjekti nuk ka shkelje, dhe ndaj tij nuk është vendosur masë administrative. Në këto kushte ndaj subjektit duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë, për mosrespektim të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 179 pika 1 germa f, të ligjit 35/2016. **35**.Në inspektimin e subjektit AG, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Dokumentacioni që administrohet në praktikë, kontrata përdorimi, janë fotokopje, pa nr dhe datë, si dhe pa nënshkrimin e subjektit të inspektuar; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **36**.Në inspektimin e subjektit B, konstatohet se: Sipas listë-verifikimit datë 08.06.2021, nga grupi i inspektimit janë plotësuar rubrika 2 dhe rubrika 3, në të cilën përshkruhet se subjekti ka 158 kompjutera me program windows, nga verifikimi rezulton se 7 kompjutera nuk kishin akses përdorimi, dhe subjektit i është lënë detyrë për plotësim dokumentacioni sipas ligjit të inspektimit. Bashkëlidhur (kontrata dhe foto). -Në proces-verbalin datë 08.06.2021, në pikën 6 ñDokumentacioni që duhet të paraqitetò është lënë detyrë për plotësim dokumentacioni brenda një afati 8 ditor. Në vendimin datë 24.06.2021, është dhënë masë administrative ñgjobëò në vlerë 200,000 lekë. Për mos plotësim dokumentacioni brenda afatit të përcaktuar në pv. -Ndërkohë që subjekti ka paqitur kontratë për përdorimin e programeve, faturë tatimore, foto, prokurë të posacme, dhe nga inspektorët nuk janë marrë në konsideratë. Nderkohë që në raste e tjera nga inspektorët janë marrë në konsideratë kontratat fotokopje pa nr datë nënshkrim apo periudhe përdorimi, është vepruar me dy standarte. **37**.Në inspektimin e subjektit E-2001, konstatohet se: -Sipas listë-verifikimit datë 04.02.2021, nga grupi i inspektimit është plotësuar vetëm rubrika 2 në të cilën përshkruhet se subjekti ka 3 kompjutera në përdorim, pra jo në të gjitha rubrikat. Bashkëlidhur (foto). -Në proces-verbalin datë 04.02.2021 grupi i inspektimit në pikën 7 ñGjetje të konstatuaraò ka konstatuar veprime nëkundërshtim me ligjin 35/2016 ñPër të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me toò neni 88, 89, 90, 179 pika 1/f, dhe 179 pika 2, dhe kanë lënë afat 8 ditor për plotësimin e dokumentacioni. -Subjekti nuk ka respektuar afatin e vendosur nga inspektorët për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar, dhe në vendimin përfundimtar është ndaj tij është vendosur masa administrative paralajmërim, ndërkohë që në këto kushte ndaj tij duhet të ishte vendosur gjobë. Theksojmë se në këtë rast nga inspektorët është vepruar me dy standarde, në krahasim me praktikën e ndjekur për të njëjtën situatë në inspektimin e subjektit B. **38.**Në inspektimin e subjektit C, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Dokumentacioni që administrohet në praktikë, kontrata përdorimi, janë fotokopje, pa nr dhe datë, si dhe pa nënshkrimin e subjektit të inspektuar;

	-Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **39.**Në inspektimin e subjektit ICA, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Dokumentacioni që administrohet në praktikë, kontrata përdorimi, janë fotokopje, pa nr dhe datë, si dhe pa nënshkrimin e subjektit të inspektuar; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **40.**Në inspektimin e subjektit HP, konstatohet se: -Listë-verifikimi nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij; -Dokumentacioni që administrohet në praktikë, kontrata përdorimi, janë fotokopje, pa nr dhe datë, si dhe pa nënshkrimin e subjektit të inspektuar; -Procesverbali i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm mbi veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit. **41.**Në inspektimin e subjektit SF, konstatohet se: -Sipas listë-verifikimit datë 02.02.2021, grupi i inspektimit ka plotësuar vetëm rubrikën 2, në të cilën përshkruhet se subjekti ka 1 kompjuter në përdorim, të pa paisur me licence, pra nuk janë plotësuar të gjitha rubrikat e listë-verifikimit; -Në proces-verbalin e inspektimit, subjektit i është lënë detyrimi që brenda 8 ditësh të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar, ndërkohë rezulton se dokumentacioni (kontrata) i dorëzuar është fotokopje, pa nr dhe datë, pa nënshkrimin e subjektit të inspektuar. Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi B.G, E.Sh, Sh.S, R.G, A.M,D.A, H.C, E.K, E.N, E.A, A.K dhe E.S.
Kriteri	Pika 1 e nenit 39, shkronjat ñaò dhe ñeò në nenin 41, neni 43, Pikat 4 dhe 5 të nenit 48dhe neni 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 ñPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò; Kreu III dhe kolona 7 në shtojcën 1, pika 16 e Kreut IV të Urdhrit nr.25, datë 10.08.2018 për miratimin e rregullores ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò; Ligji nr.35/2016 ñPër të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera e të lidhura me toò; Neni 13 dhe neni 43 në Ligjin nr.44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò; Pika 3.2 në Urdhërin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò; Neni 9, shkronjañbò e pikës 4 të nenit 30 në Ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò; Neni 515 në Ligjinnr.8116, datë 29.3.1996 ñKodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e pasqyrimit të plotë të situatës së subjektit të inspektuar, cenon transparencën e veprimeve të inspektorëve; Mungesa e marrjes së masave administrative; Mungesa e garantimit të mbrojtjes së të drejtave të autorit.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator
Rëndësia	E mesme - E lartë

Rekomandime	ISHMT të marri masat e nevojshme, që në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve. ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës. ISHMT të marrë masat e nevojshme që procesverbali i inspektimit të plotësohet me informacion të detajuar lidhur me veprimet e inspektorëve gjatë inspektimit (produktet që gjenden në subjekt, produktet që u inspektuan, administrimin e dokumentacionit vërtetues/justifikues të sigurisë së produkteve me nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, foto, etj). Gjithashtu në çdo rast të inspektimeve, listë-verifikimi të plotësohet në të gjitha rubrikat e tij, si dhe në rastet e inspektimeve, kur një/disa prej rubrikave nuk gjejnë zbatim, të plotësohet rubrika ñkomenteò me arsyetimin përkatës. ISHMT të marrë masat e nevojshme për të bërë kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në Gjykatën e Shkallës së Parë, me qëllim vënien në ekzekutim të gjobave të vendosura, si dhe eleminimin e efekteve negative financiare në buxhetin e shtetit.

Observacion: Me shkresën nr.614/10, datë 15.10.2021 nga ISHMT është bërë observacion për konstatimet e grupit të auditimit për praktikat e inspektimit më sipër, ku në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë vijon:
-Mbi konstatimin e grupit për moskryerjen e kërkesës për lëshim urdhëri ekzekutimi të gjobës ndaj subjektit ñA 2000ò. Në lidhje me pretendimin e Grupit të Auditimit i cili është shprehur se nga ana e ISHMT-së nuk është bërë kërkesë për lëshim udhëri ekzekutimi për subjektin ñA 2000ò shpk, sqarojmë se: Ankimi administrativ mbi masën e vendosur ndaj subjektit ñA 2000ò shpk është shqyrtuar nga Komisioni i Ankimit dhe me Vendimin nr. 1396/5prot., datë 06.07.2021 është vendosur ñLënia në fuqi e vendimit përfundimtar të Inspektimit nr. 1396/2prot., datë 12.08.2020ò dhe rrëzimi i ankimit administrativ. Mbi këtë vendim subjekti ka marrë dijeni në datën 23.07.2021 dhe nga verifikimi i afatit ligjor për ankimin në rrugë gjyqësore, me anë të shkresës nr. 1982/1prot., datë 08.09.2021 nga Gjykata Administrative Gjirokastër, është konstatuar se ky subjekt ka paraqitur kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër kundër Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.
-Mbi konstatimin e grupit për moskryerjen e kërkesës për lëshim urdhëri ekzekutimi të gjobës ndaj subjektit ñMMò.Në lidhje me pretendimin e Grupit të Auditimit i cili është shprehur se nga ana e ISHMT-së nuk është bërë kërkesë për lëshim udhëri ekzekutimi për subjektin ñMMò sha, sqarojmë se: Nga ana e ISHMT-së është bërë kërkesa nr. 1393/6prot., datë 20.01.2021 ñPër lëshimin e Urdhërit të ekzekutimit dhe kamatëvonesën për aktin administrativ nr.1393/2prot., datë 12.08.2020ò dhe është lëshuar Urdhëri i ekzekutimit me anë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Nr.Regj.them 249 (31134-00534-80-2021) datë e vendimit 27.01.2021. Proçedura për vënien në ekzekutim është pezulluar nga ISHMT për shkak të paraqitjes së Kërkesë Padisë nga subjekti ñMMò sha kundër ISHMT.

-Mbi konstatimin e grupit për moskryerjen e kërkesës për lëshim urdhëri ekzekutimi të gjobës ndaj subjektit ñPTò.Në lidhje me pretendimin nga Grupi i Auditimit i cili është shprehur se nga ana e ISHMT-së nuk është bërë kërkesë për lëshim udhëri ekzekutimi për subjektin ñPTò shpk, sqrojmë se: Subjekti ñPTò shpk ka ekzekutuar vullnetarisht shumën e masës administrative të vendosur nga grupi i inspektimit dhe të lënë në fuqi nga Komisioni i Ankimit, në datën 30.04.2021. kjo gje vërtetohet edhe nga pagesat e kryera në degën e thesarit në llogari të ISHMT-së për muajin Prill 2021. (bashkëlidhur gjeni pagesat e kryera gjatë muajit Prill 2021).
-Mbi observacionin e inspektorëve për ekzekutimin e gjobave.

Qëndrimin i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së:

Lidhur me çështjen e mësipërme ñA 2000ò, dokumentacioni i paraqitur nga ju është i pamjaftueshëm, për arsye se:

1.Si fillim duhet të na paraqisnit ankesën e subjektit ndaj vendimit të inspektimit, pasi gjoba është vendosur në 12.08.2020, ndërkohë vendimi nga ju është 1 vit me vonesë, duke tejkaluar afatin ligjor, pra ose subjekti e ka paraqitur ankesën jashtë afatit, por që nga ju nuk duhej të merrej në shqyrtim, ose subjekti e ka dorëzuar ankesën brenda afatit, por nga ju është shqyrtuar në tejkalim të afatit ligjor, ku në të dy rastet ju jeni në shkelje të ligjit;

2.Kopje të librit të dorëzimit të postës së vendimit ndaj subjektit (në rast se ai nuk ka qenë i pranishëm në mbledhjen e komisionit), pasi afati prej 2 javësh nga marrja e vendimit nga komisioni deri në marrjen në dijeni nga subjekti për vendimin e komisionit është i paarsyetuar, dhe kjo mund të jetë për shkak të mosveprimeve nga ana juaj (që nuk e keni përcjellë në kohën e duhur, ose për shkak se posta e ka patur të vështirë të gjejë vendndodhjen e subjektit), si gjithmon në rast se subjekti nuk ka qenë i pranishëm në mbledhjen e komisionit.

-Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë, pasi ju nuk keni vepruar në afat për ekzekutimin e gjobës.

Lidhur me çështjen e mësipërme ñMMò, dokumentacioni i paraqitur nga ju është i pamjaftueshëm, për arsye se:

1.Ju shpreheni se keni bërë kërkesë për lëshim urdhëri ekzekutimi dhe ka dalë vendimi i GJSHP Tiranë, për pranimin e saj dhe lëshimin e urdhërit, ndërkohë nuk na keni paraqitur shkresën e përcjellë ndaj përmbaruesit për ekzekutimin e gjobës, pra procedura nuk quhet e përfunduar;

2.Ju shpreheni se subjekti ka bërë ankesë ndaj ISHMT, mirëpo nuk jepni informacion dhe dokumentacion, se ku e ka bërë këtë ankes subjekti, ndaj kujt ka bërë ankesë, ndaj vendimit të gjykatës;

-**Sa më sipër observacioni juaj merret në konsideratë pjesërisht** (vetëm për paraqitjen e kërkesës për lëshim urdhëri ekzekutimi), por që theksojmë se procedura nuk është ndjekur plotësisht, dhe gjoba ende nuk është vënë në ekzekutim.

-Lidhur me çështjen e mësipërme ñPTò, **observacioni juaj merret në konsideratë.**

-Lidhur me observacionin e inspektorëve për ekzekutimin e gjobave, sqarojmë se nuk janë ngarkuar ata me përgjegjësi.

III.2.3.Auditim mbi zbatimin e buxhetit të shtetit (për blerjen e pajisjeve dhe instrumentave për testim dhe inspektim në terren dhe marrjen me qera të ambjenteve për zyra, pajisjeve kompjuterike).

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion (situacionet progresive me Degën e Thesarit) nga ISHMT, mbi zbatimin e buxhetit për periudhën 01.01.2019-30.06.2021, rezulton se buxheti i alokuar për ISHMT përgjatë kësaj periudhe ka qenë 131,000,000 lekë për vitin 2019, 108,636,140 lekë për vitin 2020 dhe 119,670,000 lekë për vitin 2021.

Buxheti sipas llogarive ekonomike për periudhën 2019 ï 30.06.2021, është realizuar si më poshtë vijon:

Realizimi i buxhetit për vitin 2019

Artikulli	Plan Vjetor	Shpenz Thesari	Nr Punonj	
			Plan	Fakt
600	90,000,000	46,011,303	69	55
601	13,000,000	7,648,010		
600999	0			
602	14,000,000	9,561,137.00		
604	0	0		
602	0	114,983.30		
606	0	0		
231				
231	700,433			
231	6,500,000	0		
231	500,000	94,920		
231	500,000	0		
231	5,500,000	5,160,000		
231	299,567	215,730		
6029999	0	0		
602	0	0		
466	0	0		
	131,000,000	**68,806,083**		

Shpenzimet operative dhe investimet e institucionit 2019

Pershkrimi	Plani vjetor	Realizimi me banke/thesar	Në %
Shpenzime buxhetore total	**131,000,000**	**68,806,000**	**53**
Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	**90,000,000**	**46,011,000**	**51**
Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	**13,000,000**	**7,648,000**	**59**
Mallra dhe sherbime te tjera	**14,000,000**	**9,676,000**	**69**
Shpenzime telefoni, Internet etj.		153,000	
Shërbim Postar		219,000	
Shërbime udhetim e dieta brenda vendit		2,033,000	
Shërbime udhetim e dieta jashte vendit		1,000,000	
Shpenzim te tjera (Kalibrimi dhe Standartizim)		276,000	
Shpenzime për blerje mallrash te ndryshme		346,000	
Blerje Tonera		696,000	
Taksa automjetesh, siguracion dhe blerje goma		280,000	
Karburant		1,749000	
Sherbim te ndryshme (bankare, pastrimi, printimi)		46,000	
Shpenzime te pergjithshme		402,000	
Kancelari		258,000	
Shpenzime mirembatje		309,000	
Larje automjeti		68,000	
Sherbim parkimi		115,000	
Të tjera, shërbim konsulence dhe Taksa Bashkia		15,000	
Shpenzime gjyqi		222,000	
Qira Ambienti		51,000	
Sherbime mallra sekretimi		594,000	
Sherbim per analizat laboratorike		736,000	
Sherbim blerje jeleke		108,000	
Investime	14,000,000	5,471,000	**39**
Transferime ne buxhetet familjare	**0**	**0**	**0**

Realizimi i buxhetit për vitin 2020

Artikulli	Plan Vjetor	Shpenz Thesari	Nr Punonj	
			Plan	Fakt

600	59,800,000	48,492,480	80	72
601	13,000,000	8,024,802		
	0			
602	28,000,000	17,276,978		
604		0		
602		0		
606		0		
231	0			
231	0	0		
231	0	0		
231	956,400	956,400		
231	5,902,800	5,902,800		
231	854,940	854,940		
231		0		
6029999		0		
606	122,000	0		
600+601		0		
602+606				
	108,636,140	**81,508,400**		

Shpenzimet operative dhe investimet e institucionit 2020

Pershkrimi	Plani vjetor	Realizimi me banke/thesar	Në %
Shpenzime buxhetore total	**131,000,000**	**68,806,000**	**75**
Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	59,800,000	48,492,000	**81**
Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	13,000,000	8,025,000	**62**
Mallra dhe sherbime te tjera	28,000,000	17,277,000	**62**
Shpenzime telefoni, Internet etj.		298,000	
Shërbim Postar		127,000	
Shërbime udhetim e dieta brenda vendit		2,732,000	
Shërbime udhetim e dieta jashte vendit		639,000	
Blerje Tonera		743,000	
Taksa automjetesh, siguracion dhe blerje goma		499,000	
Karburant		1,851,000	
Blerje kufje dhe mikrofona		504,000	
Sherbim te ndryshme (bankare, pastrimi, printimi)		634,000	
Kancelari		277,000	
Shpenzime mirembatje		632,000	
Shpenzime mirembajtje aparate		298,000	
Larje automjeti		75,000	
Sherbim parkimi		240,000	
Të tjera, shërbim konsulence dhe Taksa Bashkia		15,000	
Materiale pastrimi		23,000	
Maska dhe dezinfektant		871,000	
Shpenzime gjyqi		69000	
Qira Ambienti		6,750,000	
Investime	7,714	7,714	**100**
Transferime ne buxhetet familjare	**122,000**	**0**	**0**

Realizimi i buxhetit për vitin 6-mujorin e parë 2021

Artikulli	Plan Vjetor	Shpenzime Thesari	Nr Punonj	
			Plan	Fakt
600	74,940,000	33,028,039	80	70
601	14,300,000	5,506,199		

602	20,156,000	8,436,011		
604	0	0		
606	274,000	248,000		
231	4,000,000	0		
231	800,000	681,200		
231	5,200,000	0		
600+601		0		
602+606		0		
230+231		0		
	119,670,000	**47,899,449**		

Burimi: ISHMT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar sa më sipër, grupi i auditimit përzgjodhi ato shpenzime, të cilat kanë patur peshën kryesore në buxhetin e ISHMT, referuar këtu edhe përcaktimit në pikën 3 të programit të auditimit. Konkretisht:
-Për vitin 2019 u përzgjodhën shpenzimet e kryera nga ISHMT për ñPajisje dhe instrumenta për inspektimò;
-Për vitin 2020 u përzgjodhën shpenzimet e kryera nga ISHMT për ñPajisje dhe instrumenta për inspektimò, ñMarrjes me qera të ambjenteve për zyraò, ñBlerje kompjuteraò, ñBlerje pajisje video-konferencëò;
-Për vitin 2021 u përzgjodhën shpenzimet e kryera nga ISHMT për ñPajisje dhe instrumenta për inspektimò dhe ñBlerje kompjuteraò.

Në mënyrë të detajuar, rast pas rasti, si më poshtë vijon:

Tenderi "Pajisje dhe instrumenta për inspektim", viti 2019, kryer nëpërmjet Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Blerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim		
Urdhëri nr.62 prot., datë 07.10.2019 i Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara Lloji i procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozim	Hartuesit e dokumenteve të tenderit: Urdhër nr.92, datë 03.07.2020, z.J.Ll me detyrë Drejtor; z.R.H, me detyrë Inspektor; z.E.L, me detyrë Inspektor	Komisioni i vlerësimit të ofertave:
Fondi limit (pa TVSH) 4,583,333 lekë	Oferta fituese pa TVSH: 4,300,000	Diferenca me fondin limit (pa TVSH):
Data e hapjes së tenderit: 14.10.2019	Burimi i financimit: Buxheti i shtetit	Operatorët Ekonomike: A.E shpk; F.D shpk; K.R shpk. **S'kualifikuar:** A.E shpk K.R shpk. **Kualifikuar: F.D**
Ankimime	Përgjigje e ankesës	Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP
-		
Zbatimi i kontratës së mallrave		
Lidhja e kontratës Nr.1795/3, datë 06.12.2019	Vlera e kontratës me TVSH: 5,160,000 lekë	Likujduar deri në dt:

Fatura: Nr.79995719, datë 16.12.2019 4,300,000 lekë pa TVSH 5,160,000 lekë me TVSH	Afati i kontratës në ditë: 90 ditë	16.12.2019
Akti i marrjes në dorëzim: Nr.1795/4 prot., datë 16.12.2019	Fletë hyrja nr.25, datë 16.12.2019	

Titulli i Gjetjes	**Tenderi "Pajisje dhe instrumenta për inspektim", viti 2019**
Situata	-Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave të furnizuara nuk ka në përbërjen e tij punonjësin me përgjegjësi materiale, pra magazinierin e ISHMT-së. Për këtë mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektori i ISHMT; -Nga grupi i hartimit të specifikimeve teknike, ngritur me urdhërin nr.118, datë 19.09.2019, me relacionin **nr.1974/2 prot**., datë**19.09.2019** janë hartuar specifikimet teknike për produktet (**specifikimet e fundit për këtë procedurë prokurimi**): Aparat Spektometri, Aparat Densimetri dhe Peshore Elektronike. Në vijim **citojmë disa paragrafe** të specifikimeve teknike, **hartuar dhe pasqyruar** në relacionin nr.1974/2 prot., datë 19.09.2019, faqe nr.3, mbishkrimi:
	ñShënim: **Në momentin e dorëzimit të mallit pranë autoritetit kontraktor**, të gjitha pajisjet laboratorike **duhet të jenë të shoqëruara me dokumentacionin e mëposhtëm:** **-Deklaratë Konformiteti nga Prodhuesi;** **-Markim CE;** **-Autorizim Prodhuesi;** -Katalog ku të jenë të përfshira specifikimet teknike; -Garancia për produktin për një periudhë minimale prej 2 vjetësh (afati i garancisë minimalisht 2 vjet sipas Ligjit nr.9902/2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò, i ndryshuar). **Sqarojmë sedokumentacioni i kërkuar shoqëron produktin** dhe është specifik sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin nr.10489/2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar, VKM nr.770/2016 ñPër miratimin e rregullit teknik, për instrumentat matëseò, për disa ndryshime në VKM nr.1351, datë 03.10.2018 ñPër miratimin e rregullores për kërkesat metrologjike për instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuaraò, si dhe VKM nr.77/2013 ñPër miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumentave të peshimit joautomatikò. Specifikimet teknike për pajisjen Aparat Spektometër, janë bazuar në detyrimet e ISHMT për kryerjen e testeve për përmbajtjen e metaleve të rënda dhe të elementëve të tjerë të ndaluar në produktet joushqimore, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.10489/2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar, Ligjit nr.10480/2011 ñPër sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar, VKM nr.262/2013 ñPër sigurinë e lodraveò dhe VKM nr.1058/2015 ñMbi emrat e fibrave tekstile, etiketimi dhe markimi përkatësò.
	Sa më sipër grupi i auditimit pas verifikimit të përmbushjes/jotë specifikimeve teknike nga OE shpallur fitues, konstatoi se: -Nuk administrohet autorizimi i prodhuesit/distributorit të mallrave të prokuruara; -Nuk administrohet deklarata e konformitetit nga prodhuesi i produktit Spektometër, si dhe ajo që është sjellë në observacionet e bëra nga ISHMT, nuk ka elementët ligjor të saj, numri unik i produktit (10030031-00074A), nuk është në gjuhën shqipe, nuk është lëshuar në emër të subjektit të autorizuar për tregëtimin e tyre, në këtë rast OE

	F.D, por edhe të instaluesit, që në këtë rast është ISHMT; -Nuk administrohet fletë-garancia e produkteve, por në dosjen fizike është një deklaratë e subjektit për ofrimin e garancisë 2 vjeçare për produktet, e cila theksojmë se nuk është sipas kërkesave ligjore; -Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit në prani të Drejtorit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve z.J.Ll dhe Magazinieres së ISHMT zj.L.K, të pajisjes Spektometër, si dhe dokumentacionit fizik të administruar në dosjen e prokurimit, rezultoi se pajisja ñSky Ray Instrument-Spektometër në vlerën 2,250,000 lekë pa TVSHò e marrë në dorëzim**(pasqyruar në fotot nr.1-3, Kapitulli Anekse-Aneksi nr.5)**, nuk ka markimin CEdhe nuk ka deklaratën e konformitetit sipas përcaktimeve ligjore, element të cilët ndikojnë në kostot e produktit[10], por që nuk mund të mund të matet specifikisht. -Sa më sipër konstatohet se pajisja Spektometër, është marrë në dorëzim, në kushtet kur ajo nuk është sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga ISHMT, ndërkohë qëprocesverbaline grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, nr.1795/4 prot., datë 16.12.2019, me përbërje J.Ll Kryetar, F.C, R.H dheE.L Anëtar, është pasqyruar informacionit fiktiv se **dokumentacioni shoqërues i produktit dhe vlerësimi fizik** nga grupi i marrjes në dorëzim, **është në përputhje me specifikimet teknike** referuar procesdurës së prokurimit për blerjen e këtyre mallrave dhe **kontratës së lidhur midis ISHMT dhe Subjektit";** -Në këto kushte pajisja Spektometër në vlerën 2,250,000 lekë pa TVSH, e cila nuk është sipas specifikimeve teknike, nuk duhet të ishte marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim të produkteve; -Pajisjet janë marrë në dorëzim nga grupi i ngritur për marrjen në dorëzim me datë 16.12.2019 ndërsa fletë-dalja nga magazina për Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Produkteve që ka bërë kërkesë (me shkresën nr.1794 prot., datë 19.09.2019) për këto pajisje është rreth 1 vit me vonesë, përkatësisht datë 04.12.2020 dhe datë 22.06.2021, dhe për gjithë periudhën objekt auditimi, nuk janë përdorur dhe sõka asnjë të dhënë apo databasë për këtë qëllim, çka tregon se shpenzimet e kryera në këtë rast në vlerën 5,160,000 lekë janë përdorur pa efektivitet dhe eficiencë. Për këtë mbajnë përgjegjësi z.L.S, Titullari i ISHMT dhe z.J.Ll, Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve (kërkues i pajisjeve për inspektime që realizohen nga struktura, të cilën ai drejton).
Kriteri	Pikën 43 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar; Specifikimet teknike të miratuara me shkresën nr.1795/1 prot., datë 19.09.2019, për këtë procedurë, si dhe pikën 10 të nenit 2, pikën 9.1 të nenit 9, pikën 12.4 të nenit 12, pikën 16.1 të nenit 16, të kontratës nr.1795/3, datë 06.12.2019 lidhur ndërmjet ISHMT dhe F.D shpk; Pikën 1, shkronjat ñaò dhe ñbò të pikës 2 dhe pikën 3 në nenin 8, pikat 2, 3 dhe 7 të nenit 9 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, ndryshuar; Pikën 3 të nenit 32 në Ligjin nr.9902, datë 17.04.2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò, i ndryshuar; Procesverbali i grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, nr.1795/4 prot., datë 16.12.2019; Pikat 24 dhe 25 të nenit 3, shkronjën ñçò të nenit 4, shkronjën ñbò të nenit 19, të

[10]Pika 5 e nenit 7 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011, ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, ndryshuar.

	Ligjit nr.9936, datë 26.08.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetorò, i ndryshuar, pikat 1 dhe 5 të nenit 8 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2018 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	-Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, i cili nuk mund të matet, pasi elementët që mungojnë në pajisjen ñSpektometërò në vlerën 2,250,000 lekë pa TVSH, janë pjesë e kostos përfundimtare të produktit; -Përdorim pa efektivitet dhe eficiencë i fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën 5,160,000 lekë;
Shkaku	Marrja në dorëzim e mallit, në kushtet kur ai nuk është në përputhje me specifikimet teknike; Mosrespektim i detyrimeve kontraktore nga OE Shpallur fitues; Mungesa e përdorimit të pajisjeve të prokuruara, rreth 1 vit të pa përdorura (koha e hyrjes në magazinën e institucionit ï tërheqja e tyre nga mgazina për përdorim); Veprime dhe mosveprimeve në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në kontratën midis palëve, si dhe kuadrin rregullator cituar në kriteret audituese.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, duke i kërkuar OE F.D shpk, të dorëzojë aparatin ñSpektometërò në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara, ose në të kundërt arkëtimin e vlerës2,250,000 lekë pa TVSH, të produktit ñSpektometërò. **Menjëherë**

Observacion: Me shkresën nr.614/10, datë 15.10.2021 nga ISHMT është bërë observacion për konstatimet e grupit të auditimit për procedurën e prokurimit më sipër, ku në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë vijon:

1.Për marrjen në dorëzim të mallrave është ngritur komisioni që ka në përbërje të tij 4 anëtarë të cilët janë specialistë të fushës për produktet që do të dorëzoheshin. Në grupin e marrjes në dorëzim duhet të jenë ekspertë të fushës, me qëllim që të kryhet edhe verifikimi i specifikimeve të secilës pajisje. Është parë e arsyeshme që në grupin e ngritur të përfshihen ekspertët të cilët kanë njohuri për pajisjet, për të mos sjellë pengesa në verifikimin e tyre. Dorëzimi i tyre në magazinën e ISHMT është bërë në prani të punonjësit me përgjegjësi materiale M.Z, me pozicion magazinier, i cili ka firmosur për hyrjen e tyre në magazinë.

2.Në lidhje me autorizimin e prodhuesit, referuar shkresës nr. 62/9, datë 05.12.2019 ñAutorizim për lidhje kontrateò, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara me cilësinë e Organit Qendror Blerës i Autorizon ISHMT të vazhdojë procedurën dhe të lidhë kontratën duke i vënë në dispozicion dokumentacionin si vijon:

Urdhër Prokurimi;
Formulari i njoftimit të fituesit të operatorit ekonomik;
Njoftimi i fituesit i publikuar në buletinin e APP;
Formulari i Ofertës Ekonomike;
Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;
Specifikimet teknike;
Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit;
Deklaratë Garancie;
Katalogët me të dhënat teknike ;

Autorizimi i prodhuesit/distributorit të mallrave të prokuruara siç konstatohet edhe më sipër nga dokumentacioni i ardhur nga ABP, **<u>nuk ka qenë pjesë e dosjes së sjellë nga ABP dhe nuk është administruar nga ISHMT</u>**.

Në VKM-në nr.914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, neni 2 ñ*Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit"*, pika 2.1, paragrafi 2, ku përcaktohet:

"Autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e".

Nga sa më sipër dokumenti i Autorizimit të Prodhuesit apo distributorit të autorizuar është dokumentacion që vlerësohet gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave nga KVO dhe administrohet në dosjen e prokurimit pranë ABP. Çdo përgjegjësi mbi vërtetësinë, korrektësinë e këtij dokumenti është e KVO pranë ABP dhe nuk i takon ISHMT, si institucion përfitues, ta administrojë në dosje këtë dokument.

3.Për sa i përket Deklaratave të Konformitetit për Produktet e kësaj praktike, janë administruar bashkë me marrjen e mallrave në dorëzim dhe ndodhen në dosjen bashkë me dokumentat e tjera të administruara. (Bashkëlidhur gjeni kopje të Deklaratave të Konformitetit për objektet e prokurimit).

4.Në referencë, për sa i përket shkresës nr.62/9 prot, datë 05.12.2019 të sjellë nga ABP ñNjoftim për lidhje kontrateò, është bashkëlidhur ñDeklarata e Garancisëò që operatori ka lëshuar mbi garancinë që kanë produktet sipas afatit të përcaktuar. Ky dokument është administruar dhe është vlerësuar nga KVO e ABP si i rregullt dhe në përputhje me kriteret teknike të vendosura në DST. Përgjegjësia mbi vërtetësinë e kësaj deklarate është e operatorit ekonomik, i cili ka deklaruar se ñgarancia për produktet e ofertuara do të jetë 2 vite sipas Ligjit nr.9902/2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò. Duke qenë se ABP ka vlerësuar këtë deklaratë si të saktë dhe nuk ka kërkuar garanci shtesë mbi produktet, përgjegjësia ligjore mbi deklaratën e garancisë bie mbi operatorin ekonomik, dhe ISHMT si institucion nuk ka kompetencë për kontrollin e vërtetësisë së deklaratave të lëshuara nga operatorët ekonomik.

5.Lidhur me konstatimin e GA të KLSH për mungesën e markimit CE të aparatit spektrometër bëjmë me dije se ky konstatim nuk qëndron.Theksojme dhe eshte provuar me dokumentacion mbeshtetës, se aparati eshte ne konfirmitet dhe ne përputhje me standardet e markimit CE.

Lidhur me konstatimin e GA të KLSH për mungesën e markimit CE të aparatit spektrometër bëjmë me dije se: Bazuar në Ligjin 10489/2011 ñ*Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore*ò, i ndryshuar pika 3 ku përcaktohet se ñMarkimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet vetëm në produktet, për të cilat është parashikuar kjo vendosje/fiksim nga rregullat teknike të zbatueshme dhe nuk duhet të vendoset në produkte të tjeraò dhe pika 7 të nenit 9 ku parashikohet se ñMarkimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në produkt ose në pllakën e tij të të dhënave. Kur kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së produktit, markimi vendoset në paketim ose në dokumentet shoqëruese, në qoftë se rregulli teknik përkatës parashikon dokumente të tilla. **Pra, referuar sa më sipër në pikat 3 dhe 7 të sipërcituara, produkti i konstatuar pa CE në trup**, aparat spektrometër **përfshihet në kategorinë e pajisjeve të cilat përdoren nga profesionistë** dhe jo nga konsumatorët, pasi funksioni është testimi i lëndëve të rrezikshme në produktet që përdoren nga konsumatorët fundorë. Edhe në dokumentacionin e prodhuesit citohet se: spektometri mund të përdoret vetëm nga personel i specializuar dhe është i ndaluar të përdoret nga persona të paautorizuarò. Në këto kushte, kjo pajisje klasifikohet në pajisjet që sipas parashikimeve në pikat 3 dhe 7 të nenit 9 të Ligjit 10489/2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregutò, markimi CE nuk është i nevojshëm të vendoset në trupin e pajisjes por vërtetohet nga dokumentacioni shoqërues i saj. Bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues i produktit për të cilin provohet përputhshmëria me ligjin.

6.Për konstatimin lidhur me eficencën dhe efektivitetin, periudha për të cilën referohet GA ka korresponduar me periudhën pandemike ku përveç se ISHMT ka qënë i përqendruar në kontrollet për zbatimin e masave anticovid referuar VKM nr.15 datë 25.04.2020 ñPër krijimin e Task Forcës për garantiin e protokolleve të sigurisë në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga Covid 19ò, stafi ka patur edhe infektime në masë çka ka sjellë mungesa të konsiderueshmë në zbatimin e planeve

të punës. Gjithashtu theksojmë se konstatimi i GA është subjektiv dhe i pasaktë, kur shkruan se janë përdorur pa efektivitet dhe eficiencë shpenzime në vlerën 5,160,000 lekë, kur kjo shumë ka qenë vlera totale e kësaj procedure prokurimi për 5 pajisje gjithsej.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së:

1.Si fillim sqarojmë se dokumentacionin që administrohej në dosjen e procedurës së mësipërme, grupi i auditimit e ka marrë në një kopje të njësuar me origjinalin, nga zyra juaj e protokollit. Në këto kushte çdo dokument shtesë, qëështë sjellë nga ju, dhe që nuk ka qenë në dosjen fizike të prokurimit, nuk merret në konsideratë, pasi janë dokumente të cilat mund të shkarkohen lehtësisht nga interneti, si dhe nuk provojnë/vërtetojnë plotësimin e kërkesës ligjore, autorësinë e dokumentacionit;

2.Lidhur me përbërjen e grupit të marrjes në dorëzim, grupi i auditimit në asnjë rast nuk është shprehur se në këtë grup nuk duhen ekspert të fushës, por është shprehur se veç specialistëve të fushës, pjesë e këtij grupi duhet të jetë edhe personi me përgjegjësi material në institucion/magazinieri, dhe në këtë rast ai/ajo nuk ka qenë pjesë e grupit të marrjes në dorëzim. Ky detyrim është i përcaktuar në pikën 43 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar:

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, **duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.**

-Sa më sipër observacioni juaj për këtë konstatim nuk merret në konsideratë.

3.Lidhur me administrimin e autorizimit të prodhuesit sqarojmë se, referimi ligjor që përdorni ju në argumentin tuaj, lidhet me procedurën e prokurimit, ndërsa konstatimi jonë lidhet me administrimin e dokumentacionit që lidhet me këtë procedurë. Pra nuk kemi gjykuar vlerësimin e ofertës, shpalljen e fituesit, por plotësinë e dokumentacionit, që lidhet drejtëpërdrejtë me plotësimin e specifikimeve teknike. Sa më sipër po pasqyrojmë disa fakte:

3.1.**Me shkresën nr.74 prot**., **datë 11.01.2019** nga Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve është bërë kërkesë për blerjen e pajisjeve të mësipërme;

3.1.1.Kjo procedurë prokurimi ka filluar në muajin Janar të vitit 2019, ku Drejtuesi në detyrë i ISHMT për periudhën zj.E.Xh me urdhërin nr.11, datë 11.01.2019 ka ngritur grupin për hartimin e specifikimeve teknike me përbërje z.J.Ll Kryetar i grupit, z.R.H dhe z.E.L, anëtar të grupit;

3.1.2.Nga ky grup me relacionin nr.75/2 prot., datë 28.02.2019 janë hartuar specifikimet teknike për produktet: Aparat për kontrollin e matësave të ujit, Aparat spektometri, Aparat Densimetri dhe Peshore Elektronike;

3.1.3.Me shkresën nr.75/3 prot., datë 28.02.2019 këto specifikimeve i janë përcjellë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara;

3.1.4.Në vijim të procedurës së mësipërme, nuk administrohet asnjë dokumentacion, se çfarëështë kryer;

3.1.5.Përsëri me Urdhërin nr.75, datë 25.04.2019 nga Drejtuesi i Komanduar i ISHMT zj.V.J, është ngritur grupi për hartimin e specifikimeve teknike me përbërje z.J.Ll, z.R.H dhe z.E.L.

3.1.6.Nga ky grup me relacionin nr.842/1 prot., datë 26.04.2019 janë hartuar specifikimet teknike për produktet: Aparat për kontrollin e matësave të ujit, Aparat spektometri, Aparat Densimetri dhe Peshore Elektronike;

3.1.7.Me shkresën nr.842/2 prot., datë 26.04.2019 nga Drejtuesi i Komanduar i ISHMT zj.V.J, është miratuar procesverbali për testimin e tregut dhe llogaritjen e fondit limit, i mbajtur po nga grupi i ngarkuar me detyrën e përcaktimit të specifikimeve teknike, që sipas Urdhërit nr.75, datë 25.04.2019, ka qenë i ngarkuar vetëm me këtë detyrë dhe jo edhe me llogaritjen e fondit limit, pra në tejkalim të kompetencës;

3.1.8. Me shkresën nr.836 prot., datë 25.04.2019 këto specifikimeve dhe fondi limit i janë përcjellë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara;

3.1.9. Me shkresën nr.836/1 prot., datë 26.04.2019 është miratuar nga Drejtuesi i Komanduar i ISHMT zj.V.J relacioni argumentues për miratimin e praktikës për Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara për prokurimin e produkteve të mësipërme.
3.1.10. Përsëri në vijim të procedurës së mësipërme, nuk administrohet asnjë dokumentacion, se çfarëështë kryer në vijim;
3.1.11. **Me shkresën nr.1974 prot., datë 19.09.2019** nga Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve, përsëri është bërë kërkesë për blerjen e pajisjeve të mësipërme;
3.1.12. Me urdhërin nr.118, datë 19.09.2019 Drejtuesi i ISHMT z.L.S, ka ngritur grupin për hartimin e specifikimeve teknike me përbërje z.J.Ll Kryetar i grupit, z.R.H dhe z.E.L, anëtar të grupit;
3.1.13. Nga ky grup me relacionin **nr.1974/2 prot**., datë**19.09.2019** janë hartuar specifikimet teknike për produktet (**specifikimet e fundit për këtë procedurë prokurimi**): Aparat spektometri, Aparat Densimetri dhe Peshore Elektronike. Në vijim **citojmë disa paragrafe** të specifikimeve teknike, **hartuar dhe pasqyruar nga ju** në relacionin nr.1974/2 prot., datë 19.09.2019, faqe nr.3, mbishkrimi:

ñShënim: **Në momentin e dorëzimit të mallit pranë autoritetit kontraktor**, të gjitha pajisjet laboratorike **duhet të jenë të shoqëruara me dokumentacionin e mëposhtëm:**
-Deklaratë Konformiteti nga Prodhuesi;
-Markim CE;
-Autorizim Prodhuesi;
-Katalog ku të jenë të përfshira specifikimet teknike;
-Garancia për produktin për një periudhë minimale prej 2 vjetësh (afati i garancisë minimalisht 2 vjet sipas Ligjit nr.9902/2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò, i ndryshuar). **Sqarojmë sedokumentacioni i kërkuar shoqëron produktin** dhe është specifik sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin nr.10489/2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar, VKM nr.770/2016 ñPër miratimin e rregullit teknik, për instrumentat matëseò, për disa ndryshime në VKM nr.1351, datë 03.10.2018 ñPër miratimin e rregullores për kërkesat metrologjike për instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuaraò, si dhe VKM nr.77/2013 ñPër miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumentave të peshimit joautomatikò.
Specifikimet teknike për pajisjen Aparat Spektometër, janë bazuar në detyrimet e ISHMT për kryerjen e testeve për përmbajtjen e metaleve të rënda dhe të elementëve të tjerë të ndaluar në produktet joushqimore, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.10489/2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar, Ligjit nr.10480/2011 ñPër sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar, VKM nr.262/2013 ñPër sigurinë e lodraveò dhe VKM nr.1058/2015 ñMbi emrat e fibrave tekstile, etiketimi dhe markimi përkatësò.

3.1.14.Në vijim të kësaj nga Drejtuesi i ISHMT z.L.Sështë nxjerrë urdhëri i prokurimit nr.119, datë 19.09.2019, për blerjen e pajisjeve të mësipërme, ku theksojmë se ky urdhër nuk ka gjetur zbatim;
3.1.15. Me shkresën nr.1795/1 prot., datë 19.09.2019 është miratuar nga Drejtuesi i i ISHMT z.L.S relacioni argumentues për miratimin e praktikës (specifikime teknike dhe fond limit) për Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara për prokurimin e produkteve të mësipërme. Pra njëherë nxirret një urdhër prokurimi nga ISHMT, ndërkohë i kërkohet Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara kryerja e prokurimit;
3.1.16.Me shkresën nr.1795/2 prot., datë 19.09.2019 ISHMT i ka drejtuar kërkesën ABP, kërkesën për kryerjen e prokurimit;
3.1.17. Nga ABP është nxjerrë urdhëri i prokurimit nr.62 prot., datë 07.10.2019 për kryerjen e procedurës së prokurimit.
3.1.18. Pjesëmarrës në garë kanë qenë OE: F.D, A.E, K.R, nga të cilët janë sõkualifikuar A.E dhe K.R, dhe është shpallur fitues F.D;

3.1.19.Me shkresën nr.1974/5 prot., datë 05.12.2019 ABP drejtuar ISHMT ka autorizuar këtë të fundit për lidhjen e kontratës, bashkëlidhur shkresës dokumentacioni: Urdhër prokurimi, Formulari i njoftimit të fituesit, Njoftimi i fituesit, Formulari i ofertës ekonomike, Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, Specifikimet teknike, Sasia dhe grafiku i lëvrimit, deklaratë garancie, **deklaratë origjine** (**që nga ju nuk referohet në osbervacionin e sjellë**), katalogët me të dhëna teknike;
3.1.20. Pas kësaj shkrese, është lidhur kontrata nr.1795/3 prot., datë 06.12.2019, ndërmjet palëve ISHMT dhe F.D;
3.1.21. Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave **nr.1795/4 prot., datë 16.12.2019** nga grupi me përbërje J.Ll Kryetar, F.C, R.H dhe E.L Anëtar, ku pasqyrohet informacioni:

ñSubjekti F.D ka dorëzuar pranë ISHMT listën me mallrat, Aparat Spektometri (1 cop), Densimetër (1 cop) dhe Peshore Elektronike (3 cop).
Gjithashtu paragrafi në vijim, ku ju shpreheni se nga **vlerësimi i produkteve të sjella** nga subjekti F.D, sipas përshkrimeve të dhëna në anekset bashkëlidhur këtij procesverbali, **rezulton se dokumentacioni shoqërues i produktit dhe vlerësimi fizik** nga grupi i marrjes në dorëzim,**është në përputhje me specifikimet teknike** referuar procesdurës së prokurimit për blerjen e këtyre mallrave dhe **kontratës së lidhur midis ISHMT dhe Subjektit";**

3.1.22.Fatura tatimore e lëshuar nga subjekti dhe fletë-hyrja nr.25, datë 16.12.2019 në magazinën e ISHMT;
3.1.23.Shkresa nr.1795/5 prot., datë 16.01.2020, nga ISHMT drejtuar ABP, ku pasqyrohet informacioni se subjekti F.D**ka dorëzuar në përputhje me specifikimet teknike** pranë ISHMT, produktet: Spektometër, Densimetër dhe 3 Peshore;
3.1.24. Dokumentacioni administruar në dosjen e procedurës së prokurimit, lidhur me OE shpallur fitues: Formulari i cmimit, specifikimet teknike, oferta ekonomike, deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, autodeklaratë për respektimin e sasisë dhe grafikun e lëvrimit të produktit, autodeklaratë për garancinë e produkteve, deklarata e origjinës së produktit sipas prodhuesve të tyre, katalogu i të dhënave teknike për mallrat e prokuruara.
-Për të vazhduar edhe me disa përcaktime ligjore të bëra në kontratë, lidhur me specifikimet teknike për mallrat e prokuruara, **që përsëri nga ju nuk janë respektuar**:
Pika 10, neni 2 ï Objekt i kontratës do të thotë që të gjitha mallrat dhe shërbimet e lidhura me to që kontraktuesi (shitësi) **do të sigurojë sipas kushteve të kontratës**;
Pika 9.1, neni 9 ï **Mallrat e furnizuara** sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe **standardeve teknike të parashikuara në specifikimet teknike**. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës ka ndryshime në kodet përkatëse ose në standardet teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor;
Pika 12.4, neni 12 ï AK do të refuzojë çdo mall që nuk e kalon testimin/inspektimin ose **nuk është konform specifikimeve teknike** dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës;
Pika 16.1, neni 16 ï Përpara pranimit, AK ka të drejtë të verifikojë, inspektojë dhe testojë mallrat.
Pika 16.2, neni 16 ï AK pranon ose refuzon mallrat menjëherë pas dorëzimit duke njoftuar me shkrim kontraktuesin.
Pika 32.1, neni 32 ï Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet tõ dorëzojë AK, sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar;
Pika 4.1, neni 4, kushtet e veçanta ï Inspektimet dhe testimet para pranimit të mallrave do të bëhen në ISHMT.
-Sa më sipër, referuar informacionit të pasqyruar nga ju në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe shkresën dërguar ABP (**dokumentacioni shoqërues i produktit dhe vlerësimi fizik, është në përputhje me specifikimet teknike, ku në këto të fundit ndër të tjera përcaktohet që: Nëmomentin e dorëzimit të mallit pranë autoritetit kontraktor, të gjitha pajisjet laboratorike duhet të jenë të shoqëruara me dokumentacionin e mëposhtëm:**
-Deklaratë Konformiteti nga Prodhuesi;

-Markim CE;

-Autorizim Prodhuesi, si dhe observacionit të bërë nga ju për këtë konstatim ku shpreheni se (Autorizimi i prodhuesit/distributorit të mallrave të prokuruara nga dokumentacioni i ardhur nga ABP, **nuk ka qenë pjesë e dosjes së sjellë nga ABP dhe nuk është administruar nga ISHMT),** kushteve të kontratës arrihet në përfundimin se, dorëzimi i dokumentacionit shoqërues nga OE i shpallur fitues, ka qenë detyrim i OE F.D, si dhe verifikimi i respektimit të detyrimeve kontraktore mbi plotësimin e specifikimeve teknike ka qenë detyrim i grupit të marrjes në dorëzim, pra nuk ka aspak lidhje me përgjegjësinë e ABP, i cili ka patur të drejtën për refuzimin e tyre nëse ato nuk kanë qenë sipas specifikimeve teknike.

Gjithashtu arrihet në konkluzionin ju keni pasqyruar një informacion fiktiv në procesverbalin e marrjes në dorëzim, pasi ju vetë në observacion pohoni se autorizimi i prodhuesit nuk është sjellë, ndërkohë në procesverbalin e marrjes në dorëzim pohoni se dokumentacioni shoqërues është dorëzuar sipas specifikimeve teknike.

-Sa më sipër, observacioni juaj për autorizimin e prodhuesit nuk merret merret në konsideratë.

4.Lidhur me deklaratat e konformitetit që ju keni sjellë në observacion, sqarojmë se ato nuk kanë qenë në dosjen fizike të procedurës së prokurimit, si dhe duke marrë në konsideratë dokumentacionin e dorëzuar nga OE shpallur fitues, konkretisht të deklaratës së origjinës së prodhuesit, ku për produktin Spektometër prodhuesi është JSI Co., Ltd, Kinë, deklaratave të konformitetit nga ju të paraqitura në observacion, si dhe formës dhe përmbajtjes së deklaratës së konformitetit, përcaktuar në pikën 1, shkronjat ñaò dhe ñbò të pikës 2, pikën 3 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, ndryshuar, si vijon:

Pika 1 - **Kur legjislacioni përkatës parashikon një deklarim nga prodhuesi se ai ka demonstruar përmbushjen e kërkesave për një produkt**, prodhuesi harton një deklaratë të vetme EC të konformitetit për të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj produktit, përfshirë dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse;

Pika 2 - Deklarata EC e konformitetit hartohet/përkthehet në gjuhën shqipe dhe përmban elementet e mëposhtme:

Shkronja ñaò, pika 2 - numrin e identifikimit unik të produktit;

Shkronja ñbò, pika 2 - emrin dhe adresën e prodhuesit **ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar**;

Pika 3 - Kjo deklaratë konformiteti lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit ose, sipas rastit, instaluesit.

Arrihet në përfundimin se ato nuk janë sipas përcaktimeve ligjore, nuk përmbajnë numrin unik të produktit (10030031-00074A), nuk janë në gjuhën shqipe, nuk janë lëshuar në emër të subjektit të autorizuar për tregëtimin e tyre, në këtë rast OE F.D, por edhe të instaluesit, që në këtë rast është ISHMT.

-Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

5.Lidhur me markimin CE të produktit, referuar Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, ndryshuar:

Pika 2, neni 9 - Markimi CE i konformitetit **fiksohet në produkt** përpara vendosjes së tij në treg. Ai mund të shoqërohet nga një piktogram ose ndonjë tregues për një përdorim ose rrezik të veçantë;

Pika 3, neni 9 - Markimi CE i konformitetit **vendoset/fiksohet vetëm në produktet**, për të cilat është parashikuar kjo vendosje/fiksim nga rregullat teknike të zbatueshme dhe nuk duhet të vendoset në produkte të tjera;

Pika 7, neni 9. Markimi CE i konformitetit **vendoset/fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në produkt ose në pllakën e tij të të dhënave**. Kur kjo nuk është e mundur për **shkak të natyrës së produktit**, markimi **vendoset** në **paketim ose në dokumentet shoqëruese**, në qoftë se rregulli teknik përkatës parashikon dokumente të tilla ï Këtu ju paraqesni

si argument se produkti i konstatuar pa CE në trup, aparat spektrometër përfshihet në kategorinë e pajisjeve të cilat përdoren nga profesionistë dhe jo nga konsumatorët. Në këto kushte referuar përcaktimit ligjor dhe argumentit tuaj, çfarë lidhje ka ndërmjet natyrës së produktit me kategorinë e përdoruesve të tij, që pengon fiksimin e markimit CE në trupin e produktit. Sqarojmë se natyra e produktit, ka të bëjë me materialin përbërës të tij dhe ndjeshmërinë e materialit, që mundëson/jo fiksimin në trup të markimit, dhe jo këtegorinë e përdoruesve. Gjithashtu në vijim të përcaktimit ligjor, pasqyrohet qartë se kur natyra e produktit nuk mundëson fiksimin e markimit, atëherë markimi vendoset në paketim ose në dokumentet shoqëruese. Në asnjë prej dokumenteve që keni sjellë ju nuk është i vendosur markimi CE. Nëse ju jeni të bindur se e keni respektuar ligjin për këtë detyrim, si është e mundur që nuk jeni paraqitur pranë zyrave të institucionit të KLSH, për të treguar produktin, paketimin e tij, siç ka vepruar grupi i auditimit që e ka fotografuar produktin në disa drejtime, për çdo rast të kundërshtimeve nga ana juaj.

-Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

8.Lidhur observacioni e bërë nga ju mbi përdorimin pa eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike sqarojm se:

Në pikën 25 të nenit 3 të Ligjit nr.9936, datë 26.08.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetorò, i ndryshuar, përcaktohet se eficienca është lidhja ndërmjet produkteve të një programi dhe burimeve financiare dhe njerëzore të përdorura ï pra produkti juaj është produkte joushqimore të sigurta dhe mbrojtja e konsumatorit, burimet financiare përbëjnë shpenzimet tuaja për blerjen e pajisjeve të mësipërme, pra deri në momentin që ju këto pajisje nuk i keni përdorur, burimet financiare të shpenzuara për blerjen e tyre, nuk janë eficiente;

Në pikën 24 të nenit 3 të ligjit të mësipërm, përcaktohet se efektiviteti është madhësia, me të cilën një produkt kontribuon në arritjen e objektivave të politikës apo të qëllimeve të politikës buxhetore ï pra produkti juaj, produkte joushqimore të sigurta në treg, dhe ju për të realizuar këtë produkt, ndër të tjera, keni blerë disa pajisje inspektimi, të cilat nuk janë përdorur, çka do të thotë se produkti i ISHMT nuk është realizuar plotësisht deri në tërheqjen e tyre nga magazina për përdorim, dhe në këto kushte ky produkt ndikon negativisht në arritjen e objektivave të institucionit.

Përdorimi pa eficiencë dhe efektivitet lidhet me periudhën nga momenti i marrjes së pajisjeve në dorëzim deri në përdorimin e tyre, dhe kjo nuk do të thotë se këto shpenzime do të përbëjën mungesë eficience dhe efektiviteti vazhdimisht.

Gjithashtu sipas referimit tuaj të VKM nr.15, datë25.04.2020 ñPër krijimin e Task Forcës për garantimin e protokolleve të sigurisë në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga Covid 19ò,duhet të na kishit vendosur në dispozicion se sa inspektor kanë qenë të angazhuar në këtë Task Forcë, pasi jo i gjithë stafi juaj ka qenë pjesë e këtij grupi. Për më tepër ju keni kryer inspektime sipas planit tuaj të miratuar (janë rreth 18 muaj nga marrja në dorëzim e tyre deri në tërheqjen nga magazine), dhe këto pajisje ju nuk i keni përdorur sikur edhe në një inspektim të vetëm. Epidemia nuk mund të përdoret nga ju si argument për mospërdorimin e pajisjeve. Shumë inspektorate gjatë kësaj periudhe, si edhe ju, kanë qenë të angazhuar në garantimin e protokolleve të sigurisë në kuadër të epidemisë, por ndërkohë kanë kryer edhe aktivitetin e tyre, analiza laboratorike dhe inspektime, si Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial, etj.

-Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

<u>Procedura e marrjes me qera të ambjenteve për zyra – viti 2020</u>

<u>A.Përshkrimi i veprimeve të autoritetit kontraktor</u>

- Me shkresën nr.1173 prot., datë 09.06.2020, Kryeinspektori i ISHMT-së i është drejtuar Ministres së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, për kërkesën për pajisjen me zyra të inspektoratit, për arsye se ambjentet që ka në përdorim (5 zyra), janë të pamjaftueshme për numrin e stafit të ISHMT-së (80 punonjës), si dhe jana krijuar vështirësi në zhvillimin normal të aktivitetit; Gjithashtu, në rast se Ministria e ka të pamundur për të pajisur me zyra ISHMT, është kërkuar miratimi për të filluar procedurën e marrjes me qera të ambjenteve nga të tretët.
- Me shkresën nr.10654/1 datë 15.06.2020, Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së është shprehur për miratimin e procedurës së marrjes me qera të ambjenteve për zyra, për arsye se ministria nuk disponon ambjente.

I. Testimii tregut, përcaktimi i kritereve dhe fondit limit

- Me Urdhrin e brendshëm nr.132, datë 28.07.2020 është ngritur grupi i punës ñPër studimin e tregut të qerave në Qytetin e Tiranës dhe analizën financiare për përcaktimin e fondit limit për selinë e institucionit në buxhetin e aprovuar për vitin 2020 dhe planifikuar për 2021, brenda datës 17.08.2020ò, me përbërje:

1. z.J.Ll (Kryetar)- Drejtor i Mbikëqyrjes së Produkteve.
2. zj.E.Xh (Anëtar) ï Përgjegjës i Sektorit të Financës.
3. zj.S.B (Anëtar) - Inspektor i Sektorit të Inspektimit Metrologjik.

- Më datë 03.08.2020, nga Sektori i Financës, është kërkuar aprovimi për publikimin në median e shkruar të njoftimit për marrjen me qera të ambjenteve për zyra;
- Më datë 17.08.2020 grupi i punës për studimin e tregut të qerave dhe përcaktimin e fondit limit, nëpërmjet relacionit nr.1714/2, drejtuar Kryeinspektorit, janë hartuar dhe miratuar nga titullari kërkesat për ambjentin që do të merret me qera, ku në mënyrë të përmbledhur shprehet se: ñReferuar VKM nr.521/2014 ñPër miratimin e rregullores ñpër kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqësò, hapësira individuale e punës për 1 punonjës, duhet të jetë jo më pak se **12 m^3**. Referuar kritereve dhe standardeve për një hapësirë të tillë llogaritet në rreth **4.5 m^2**hapësira për 1 punonjës. Duke marrë në**vlerësim praktikat më të mira** në ndërtim për ndërtesat që përdoren në funksione administrative, përfshirë ambjentet e përbashkëta, shkallët, korridoret, tualetet, **ambientet për ruajtjen e mostrave të marra në inspektim apo produkteve të rrezikshme për shkatërrim, pajisjeve laboratorike dhe kiteve për inspektim,** sipërfaqja e llogaritur për një punonjës duhet të jetë**10-12.5 m^2**.

-Në total sipërfaqja në dispozicion të institucionit për të kryer funksionet e tij, është 800 ï 1000 m^2;

-Kërkohet që godina/ambientet të jenë të pajisur me akses internet dhe mundësi lidhje për çdo post pune, i cili do të jetë i pajisur me kompjuter;

-Ambientet duhet të kenë akses të mjaftueshëm për të krijuar lidhjen me energjinë elektrike për çdo pajisje që ka në përdorim stafi, si dhe të jenë të pajisura me sistem ngrohje dhe ftohje, **për të krijuar kushtet minimale, në zbatim të legjislacionit për sigurinë në punë;**

-Vendndodhja e institucionit duhet të jetë në distancë të afërt me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, me qëllim kursimin e kohës dhe kostove të transportit të stafit në Ministri.

-ISHMT ka në përdorim edhe automjetet të cilat janë në funksion të inspektorëve për kryerjen e inspektimeve, dhe për këtë arsye ambjentet duhet të kenë edhe parkim.

-Për përcaktimin e fondit limit, grupi i punës ka marrë 3 oferta:

1. Agjensia Imobilare RG ï Godinë 2 katëshe në Rrugën Jordan Misja, me sipërfaqe 1000 m^2, çmimi për m^2 = 6.5 euro, vlera e qerasë mujore 6,500 euro;
2. Agjensia Imobilare RG ï Ambient komercial në Rrugën e Barrikadave, me sipërfaqe 1000 m^2, çmimi për m^2 = 10 euro, vlera e qerasë mujore 10,000 euro;
3. Agjensia Imobilare RG ï Ambient komercial në Rrugën Dëshmorët e Kombit, me sipërfaqe 760 m^2, çmimi për m^2 = 16 euro, vlera e qerasë mujore 12,600 euro;

-Sa më sipër (6.5 + 10 + 16)/3 = **10.83 euro/m^2**çmimi mesatar për m2;
- (6,500 euro + 10,000 euro + 12,160 euro) / 3 = **9,553.33 euro** vlera mesatare e qerasë mujore, e përcaktuar **si fondi limit.**

Kriteret e vendosura për shpalljen e fituesit:
Sipërfaqe që do të përdoret për zyra dhe 4 vende parkimi = 800-1000 m^2;

Kriteret	Pikët
Çmimi lekë/m2 Çmimi më i ulët i ofertuar si ofertë e kualifikuar (ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar) merrë 30 pikë. Çmimet më të larta të ofertuara, se çmimi minimal do të llogariten si vijon: 1% mbi çmimin minimal të ofertuar në garë (- 0.5 pikë) Shembull: për çmimin e ofertuar 13 euro/m^2, Pikët = 30% * 0.5 pikë = -15 pikë, pra konkurrenti që oferton çmimin 13 euro/m^2 merrë 15 pikë.	30
Afati i akomodimit jo më vonë se 14 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës, ku ambjenti të jetë i përshtatur në hapësira sipas nevojave të institucionit qeramarrës. Çdo shtesë në ditë mbi afatin 14 ditë = - 1 pikë.	10
Akomodimi për çdo post pune: Porta internet; Priza energjie; Akomodim i plotë me internet dhe energji elektrike = 10 pikë akomodimi i pjesshëm = 5 pikë	10
Sistem ngrohje/ftohje funksional Ofrimi i sistemit të ngrohjes dhe ftohjes = 10 pikë Mungesa e sistemit = 0 pikë	10
Distanca sa më afër qendrës së Tiranës/MFE Distanca < = 500 metër nga MFE = 30 pikë Distanca < = 1 km = 25 pikë Për çdo 1 km larg nga MFE humbet 2 pikë.	30
Sistem i pavarur për furnizim të pandërprerë të energjisë elektrike dhe ujit = 10 pikë Mungesë e sistemit të pavarur = 0 pikë	10

Dokumentacioni që do të paraqesin ofertuesit të ketë në përbërje:

- ✓ Aktin e pronësisë/disponimit të pronës të rinovuar tremujorin e fundit;
- ✓ Të jetë i pajisur me NIPT/NUIS dhe çertefikatë regjistrimi;
- ✓ Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qerasë;
- ✓ Vërtetim nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- ✓ Vërtetim që mos të ketë detyrime të maturuara nga OSHE, UKT, etj;
- ✓ Vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale si dhe nuk ka proçese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
- ✓ Aktin administrativ zyrtar që objekti rezulton i rregullt nga ana inxhinierike dhe ndërtimore dhe/ose aktin e konstatimit që rezulton i banueshëm që rezulton nga instituti i ndërtimit;
- ✓ Planvendosje të objektit dhe planimetri për çdo kat.
- ✓ Afati i paraqitjes së ofertave është data 30.08.2020, **pra ditë e dielë**.

<u>II.Dorëzimi dhe vlerësimi nga komisioni i vlerësimit të ofertave</u>

- Me Urdhrin nr.143, prot., 1921, datë 28.08.2020 është ngritur grupi i punës për vlerësimin e ofertave për marrjen me qera të ambienteve për zyra për ushtrimin e veprimtarisë administrative, me përbërje:

1.zj.F.C, Kryetar
2.z.L.L, Anëtar
3.z.E.S, Anëtar
-Urdhri hyn në fuqi më datë 30.08.2020, **pra ditë të dielë.**

- Ofertat e administruara nga 3 operator:

1. Shtetasi A.N ï oferta me nr. 1921/1 prot., datë 28.08.2020
   - ✓ Metra katror (800 ï 1000);
   - ✓ Çmimi për m^2 = 8.5 euro/1,050 lekë;
   - ✓ Akomodim i menjëhershëm;
   - ✓ Parking për 4 vende;
   - ✓ Sistem i pavarur për furnizim të pandërprerë të energjisë elektrike dhe ujit
   - ✓ Akomodim për çdo post pune;
   - ✓ Sistem ngrohje/ftohje;
   - ✓ Vendndodhje 100 metra larg MFE;
   - ✓ Shlyerja e të gjithë detyrimeve të Taksave dhe Trifave Vendore (OSHE, UKT).

➢ Ofertuesi në dokumentacionin e sjellë prej tij, shprehet që: ñAmbientet e ofruara **do të përshtaten sipas kërkesave dhe kushteve të paracaktuara** nga ana juajò;
➢ Për të garantuar investimet do të ishte e nevojshme **parapagim 6 muaj.**

- Gjithashtu administrohet edhe kërkesa e personit të sipërcituar z.A.N, me nr.1921/5 prot., datë 28.08.2020, ku shprehet se pas njoftimit në gazetën ñDò më datën 25.08.2020, në momentin e dorëzimit të ofertës pranë ISHMT, **më është kërkuar që të paraqësë dokumentacion shtesë**, që nuk **ishte i publikuar në gazetë**, kështu që, **kërkoj të shtyhet afati i dorëzimit të dokumenteve** deri në datën 11.09.2020.

2. Shoqata GK ï oferta me nr. 1921/2 prot., datë 28.08.2020
   - ✓ Metra katror (800-1000)
   - ✓ Çmimi për m^2 = 11.5 euro përfshirë edhe TVSH (10 euro për qera dhe 1.5 euro për shërbimet si energji, ujë, kondicionim, siguri, kamera, pastrim ambjenti)
   - ✓ Vendodhja ï shumë afër MFE dhe Kryeministrisë
   - ✓ Akomodim i menjëhershëm me lidhjen e Kontratës
   - ✓ Akomodim për çdo post pune
   - ✓ Kondicionim ftohje/ngrohje
   - ✓ Gjenerator automik në rast të ndërprerje energjie
   - ✓ Sistem i pavarur dhe furnizim i pandërprerë me energji dhe ujë
   - ✓ Parkingu i pamundur të ofrohet

3. Agjencia Imobilare RGï oferta me nr. 1921/3 prot., datë 28.08.2020
   - ✓ Kati i dytë tek ñKBò, Bulevardi ñDëshmorët e Kombitò
   - ✓ Metra katror (760)
   - ✓ Çmimi për m^2 = 16 euro

4. Agjencia Imobilare RG ï oferta me nr.prot., 1921/4, datë 28.08.2020
   - ✓ Ambient Komercial tek ñRruga e Barikadaveò, 2 kate
   - ✓ Sipërfaqe 1000 m^2 (200 poste pune + kompjuterat dhe dhomë server + 6 tualete)

- ✓ Kondicionim, aspirim, ndriçim
- ✓ Çmimi për m^2 = 10 euro (përfshirë dhe taksat)

▪ Me Urdhrin nr.138, datë 20.08.2020, është ngritur grupi i punës për verifikimin e tirazhit në mediat e shkruara, me përbërje si vijon:
1. z. N.F ï Kryetar,
2. z. M.M ï Anëtar,
3. z. E.K ï Anëtar
-Afati i përfundimit të punës është data 24.08.2020.

▪ Me procesverbalin nr.1882/1 prot., datë 21.08.2020, nga grupi i punës është bërë studimi i tregut, ku janë pasqyruar 3 gazeta:
-GP ï 36,000 lekë për publikimin 3 ditë rradhazi;
-GF ï 16,500 lekë për publikimin 3 ditë rradhazi;
-GD ï 15,000 lekë për publikimin 3 ditë rradhazi.

▪ Me procesverbalin nr.1882/3 prot., datë 21.08.2020 është shpallur fitues Gazeta ñDò, me ofertën më të ulët.
-Bashkëlidhur kontrata si dhe publikimet në gazetë, për datat 24, 25, dhe 26.08.2020, ku janë **publikuar kriteret dhe i gjithë dokumentacioni** i kërkuar për tôu shpallur fitues**, ndryshe nga çfarë është shprehur** shtetasi A.N**, në kërkesën e tij për shtyrje afati, për plotësimin e dokumentacionit.**

▪ Në procesverbalin nr.1714/3 datë 09.09.2020 administruar në dosje, mbajtur nga grupi i punës, që bëri testimin e tregut dhe përcaktimin e fondit limit, pra pasi kanë kaluar **9 ditë** nga data, në të cilën do të bëhej **vlerësimi i ofertave**, pasqyrohet informacioni si vijon:
ñGjatë fazës së vlerësimit u konstatua se, (por që deri më këtë datë**, vlerësim nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka,** por vlerësimi bëhet **nga grupi i punës,** i cili bëri **testimin e tregut dhe përcaktimin e fondit limit,** pra që nuk ka aspak lidhje me vlerësimin e ofertave dhe nuk ka kompetencë për kryerjen e vlerësimit):
-Në seksionin **"dokumentacioni që duhet të paraqesin ofertuesit"**, pika 2, ku thuhet ñtë jetë i pajisur me NIPT/NUIS dhe certifikatë regjistrimiò, është parashikuar që të pranohen vetëm ofertuesit e pajisur me NIPT/NUIS, **duke përjashtuar nga aplikimi personat fizikë/individë**. Në këtë mënyrë **ngushtohet konkurrenca** e pjesëmarrësve në këtë procedurë.

-Sa më sipër, grupi i punës vendosi të bëjë ndryshimet në kriteret fituese ñdokumentet që duhet të paraqesin ofertuesit të ketë në përbërjeò, si vijon:

- ➢ Pika 2 ishte: të jetë i pajisur me NIP/NUIS dhe certifikatë regjistrimi;
- ➢ Bëhet: ofertuesi duhet të jetë person fizik/individ ose të jetë i pajisur me NIPT/NUIS dhe certifikatë regjistrimi.
- ➢ Pika 4 ishte: Vërtetim nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- ➢ Bëhet: Vërtetim nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore, ky dokument do të kërkohet vetëm për ofertuesit e pajisur me NIPT/NUIS.
- ➢ Pika 5 ishte: Vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale si dhe nuk ka proçese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
- ➢ Bëhet: Vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale si dhe nuk ka proçese gjyqësore në lidhje me aktivitetin; Në rastin kur ofertuesi është individ, paraqitet vërtetimi personal që nuk është në ndjekje penale.

- Ndryshimet e kryera do të pasqyrohen në faqen zyrtare të ISHMT-së. Afati i paraqitjes së ofertave shtyhet deri në datën **11.09.2020**, ora 14:00.

- Me nr.1921/6 prot., datë 10.09.2020, janë dorëzuar dokumente nga shtetasi A.N, si vijon:
  - ✓ Vërtetimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shtetasin A.N, që nuk ka proçedim penal ndaj tij dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë që nuk ka proces penal;
  - ✓ Vërtetimi nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ku pasqyrohet informacioni se shtetasi në fjalë, rezulton debitor në vlerën 79,112 lekë (taksa e ndërtesës), si dhe mandat pagesa bankare e datës 31.08.2020, për likujdimin e taksës;
  - ✓ Vërtetim për për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, lëshuar më datë 09.09.2020;
  - ✓ Certifikata e regjistrimit në Drejtorinë e Tatimeve Tiranë dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - ✓ Llogari bankare nga Tirana Bank;
  - ✓ Statuti i shoqërisë tregtare S-2004 shpk, ku shtetasi është ortaku i vetëm i saj;
  - ✓ Libër-pagesat e dritave dhe ujit dhe vërtetimet e lëshuara nga OSHE dhe UKT;
  - ✓ Vërtetimet noteriale për 6 dokumente pronësie (certifikatë për vërtetim pronësie, kartel pasurie, planimetri), konkretisht: Podrumi në katin (-2), Podrumi në katin (-1), Kati i II, III, IV dhe V banim.

- Në procesverbalin nr.1921/7 prot., datë 14.09.2020, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasqyrohet informacioni se, **subjekti i shpallur fitues ka dorëzuar**:
  - ✓ Për vërtetimin e sipërfaqes së pronësisë është kontrolluar certefikata e pronësisë ku pasqyrohet informacioni për 800 m^2 sipërfaqe, pra plotëson kriterin;
  - ✓ Parkim (4 automjete), plotëson kriterin;
  - ✓ Aktin e pronësisë të rinovuar tremujorin e fundit, pra plotëson kriterin;
  - ✓ Të jetë i pajisur me NIPT/NUIS dhe certifikatë regjistrimi, plotëson kriterin;
  - ✓ Vërtetim nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore, plotëson kriterin;
  - ✓ Vërtetim që mos të ketë detyrime të maturuara nga OSHE, UKT, plotëson kriterin;
  - ✓ Vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka proçese gjyqësore në lidhje me aktivitetin, plotëson kriterin;
  - ✓ Aktin administrativ zyrtar që objekti rezulton i rregullt nga ana inxhinierike dhe ndërtimore dhe/ose aktin e konstatimit që rezulton i banueshëm nga Instituti i Ndërtimit, plotëson kriterin;
  - ✓ Planvendosje të objektit për çdo kat, plotëson kriterin.

- Sa më sipër KVO shpallë fitues, **ofertën e shtetasit A.N**, me çmimin 8.5 euro/m^2 (përfshirë edhe taksat) për sipërfaqen 800 m^2.
- Në vijim nga KVO, është përgatitur **raporti përfundimtar** i procesit të vlerësimit të ofertave dhe shpalljes së fituesit, dhe i është përcjellë Titullarit të ISHMT-së, me shkresën nr.1921/8 prot., datë 14.09.2020, duke u miratuar nga ky i fundit.

III.Lidhja e kontratës ndërmjet palëve

- Pas shpalljes së fituesit më datë 14.09.2020, **po në këtë datë** ndërmjet ISHMT-së, përfaqësuar nga Titullari z. L.S dhe z. A.N, **është lidhur kontrata e qerasë** me nr.1921/9 prot., datë 14.09.2020.

Objektet që do të merren me qera janë **4 kate** me sipërfaqe 191.6 m^2/kat dhe **1 kat** nën tokë me sipërfaqe 33.6 m^2, pra gjithësej (4 * 191.6 m^2 + 33.6 m^2) = 800 m^2, si vijon:
-Pasuria e llojit ñPodrumò me nr.X + B2 Zonë Kadastrale (ZK) X, vol X, faqe X, datë 24.09.2014, marrë me qera 33.6 m^2;
-Pasuria e llojit ñBanimò me nr.X + 1-2 (kati i dytë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, marrë me qera 191.6 m^2;
-Pasuria e llojit ñBanimò me nr.X + 1-3 (kati i tretë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 15.10.2014, marrë me qera 191.6 m^2;
-Pasuria e llojit ñBanimò me nr.X + 1-4 (kati i katërt banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 15.10.2014, marrë me qera 191.6 m^2;
-Pasuria e llojit ñBanimò me nr.X + 1-5 (kati i pestë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 24.09.2014, marrë me qera 191.6 m^2.

- Afati i kontratës fillon më datë 14.09.2020 dhe përfundon më datë 13.09.2025 (pra 5 vite).
- Efektet financiare të kontratës fillojnë nga data **01.10.2020** deri më datë **13.09.2025** (pra 59 muaj e 13 ditë).
- Vlera gjithësej e kontratës është **50,146,518 lekë**.
- Llogaritur për muaj - (8.5 euro/ m^2 * 124.08[11], kursi kembimit, që do të jetë fiks deri në përfundim të afatit) = 1,054.6 lekë * 800 m^2 = **843,744 lekë në muaj** (përfshirë edhe tatimin në burim 15%), ose **126,561.6 lekë** tatimi në burim +**717,182.4 lekë qera mujore**.
- Palët kanë rënë dakord që pagesa në total (**3 muaj qera** + **6 muaj paradhënie**) për vitin 2020, është 2,531,232 lekë (3 muaj) dhe 5,062,464 lekë paradhënie.

Gjithësej për vitin 2020 që do të paguhet nga ISHMT është **7,593,696 lekë**.
-Në vijim për vitin 2021, për 12 muaj do të paguhen 10,124,928 lekë;
-Për vitin 2022, për 12 muaj do të paguhen 10,124,928 lekë;
-Për vitin 2023, për 12 muaj do të paguhen 10,124,928 lekë;
-Për vitin 2024, për 12 muaj do të paguhen 10,124,928 lekë;
-Për 2 muaj (01.01.2025 ï 28.02.2025) që do të paguhet nga ISHMT, është vlera 1,687,488 lekë dhe për 13 ditë (01.03.2025-13.03.2025) është vlera 365,622.4 lekë. Pra për vitin **2025** nga ISHMT do të paguhen **2,053,110 lekë**.

1. Gjithashtu në **pikën 6.7 të nenit 6** të kontratës, është parashikuar që qiramarrësi **detyrohet** që tõ **parapaguajë** paradhënie qiradhënësit, në vlerën e **6 muajve** të qerasë, në momentin e lidhjes së kontratës, **për të kryer rregullimet e nevojshme** për tõju përshtatur kërkesave të qiramarrësit.

IV.Marrja në dorëzim e ambjenteve

- Me Urdhrin nr.160, datë 25.09.2020, është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të ambienteve me qera, me përbërje:

1. z. J.Ll ï Kryetar;
2. z. R.G ï Anëtar;
3. z. E.S ï Anëtar;
4. zj. S.B ï Anëtar;
5. z. G.N ï Anëtar.

-Grupi i punës duhet të hartojë procesverbalin për vlerësimin e ambjenteve të marra me qera.

[11] Kursi i këmbimit publikuar në Bankën e Shqipërisë.

2. Në vijim të Urdhrit të mësipërm, nga grupi i punës është mbajtur procesverbali me nr.2290/1 prot., datë 28.09.2020, ku është shprehur se:

Gjatë marrjes në dorëzim të ambienteve, u konstatua se ato janë në përputhje me kriteret dhe specifikimet teknike për kualifikimin përfundimtar dhe vërtetohet përkatësisht:

- ✓ Plotësimi i kriterit të sipërfaqes për zyra, 800 m^2, në 4 katet e sipërme dhe katin nëntokë;
- ✓ Vendparkimi për 4 automjete;
- ✓ Prezenca e sistemit ngrohje/ftohje funksional;
- ✓ Distanca rreth 300 metra nga MFE;
- ✓ Sistem i pavarur për furnizim të pandërprerë të energjisë elektrike dhe ujit;
- ✓ Planvendosje të objektit dhe planimetri për çdo kat.

V.Pagesat e kryera sipas urdhër shpenzimeve:

1. Nr.187, datë 29.10.2020 ï 2,151,547 lekë (paradhënie për 3 muaj);
2. Nr.198, datë 04.11.2020 ï 2,151,547 lekë (paradhënie për 3 muaj);
3. Nr.199, datë 09.11.2020 ï 885,932 lekë [tatim i mbajtur në burim 15% për 7 muaj qera (126,562 * 7), nga të cilat 6 muaj paradhënie dhe 1 për pagesën e qerasë për muajin Tetor 2020];
4. Nr.200, datë 09.11.2020 ï 717,182 lekë (qera për muajin Tetor 2020);
5. Nr.229, datë 03.12.2020 ï 717,182 lekë (qera për muajin Nëntor 2020);
6. Nr.230, datë 03.12.2020 ï 126,562 lekë (tatim i mbajtur në burim 15% për qeranë e muajit Nëntor 2020);
7. Nr.14, datë 08.01.2021 ï 717,182 lekë (qera për muajin Dhjetor 2020);
8. Nr.15, datë 08.01.2021 ï 126,562 lekë (tatim i mbajtur në burim 15% për qeranë e muajit Dhjetor 2020);
9. Nr.40, datë 03.02.2021 - 717,182 lekë (qera për muajin Janar 2021);
10. Nr.41, datë 03.02.2021 ï 126,562 lekë (tatim i mbajtur në burim 15% për qeranë e muajit Janar 2021);
11. Nr.76, datë 04.03.2021 - 717,182 lekë (qera për muajin Shkurt 2021);
12. Nr.78, datë 04.03.2021 ï 126,562 lekë (tatim i mbajtur në burim 15% për qeranë e muajit Shkurt 2021);
13. Nr.101, datë 07.04.2021 - 717,182 lekë (qera për muajin Mars 2021);
14. Nr.102, datë 07.04.2021 - 121,562 lekë (tatim i mbajtur në burim 15% për qeranë e muajit Mars 2021);
15. Nr.130, datë 10.05.2021 - 717,182 lekë (qera për muajin Prill 2021);
16. Nr.129, datë 10.05.2021 - 121,562 lekë (tatim i mbajtur në burim 15% për qeranë e muajit Prill 2021);
17. Nr.156, datë 03.06.2021 - 717,182 lekë (qera për muajin Maj 2021);
18. Nr.157, datë 03.06.2021 - 126,562 lekë (tatim i mbajtur në burim 15% për qeranë e muajit Maj 2021);

➢ Gjithësej, deri më datë 03.06.2021, janë paguar 10,040,550 lekë qera + 1,635,304 tatim 15% = **11,675,854 lekë**.

- Gjithashtu, dokumentet bashkëlidhur gjithë procedurës:
  - ✓ Raporti i akt-ekspertizës, lëshuar më datë 11.09.2014;
  - ✓ Akti i kolaudimit, lëshuar në Shtator të vitit 2014;
  - ✓ Kërkesa e shtetasit A.N me nr.1921/10 prot, datë 18.09.2020, për ndryshimin e numrit të llogarisë ku do të bëhen pagesat e qerasë, sipas dokumentit datë 18.09.2020, bashkëlidhur kërkesës, dokument **i cili është pa vulën e bankës përkatëse**.

Titulli i Gjetjes	Procedura e marrjes me qera të ambienteve për zyra-viti 2020
Situata	**<u>B.Shqyrtimi dhe Vlerësimi i Veprimeve në Procedurën e Mësipërme.</u>** <u>I. Testimi i tregut, përcaktimi i kritereve dhe fondit limit:</u> 1. Nga Titullari i Institucionit, mbështetur në nenin 5, 8, pikën 4 të nenit 9, 16 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, nuk është nxjerrë një urdhër i brendshëm që të përcaktonte gjithë procedurën e marrjes me qera, me qëllim përdorimin efiçient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangien e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë, por nuk ka ndodhur. Për këtë mbanë përgjegjësi z.L.S. 2. Për kryerjen e kësaj procedure nuk ka bazë ligjore, si dhe **referencat ligjore të cituara në Urdhërin** e Kryeinspektorit të ISHMT-së, për fillimin e kësaj procedure, nuk janë të sakta, pasi është referuar neni 7 i Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokuriminò, i ndryshuar, ndërkohë që në këtë nen, procedura e marrjes me qera përjashtohet nga rregullat e prokurimit public. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 të nenit 3, shkronjën ñaò të nenit 11, pikën 2 në nenin 99, të Ligjit nr.44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò; 3. Për hapësirën e llogaritur për 1 punonjës, grupi i punës **nuk i është përmbajtur përcaktimit ligjor të bërë në shkronjën** ñaò të pikës 2, Shtojca, të VKM nr.521, datë 06.08.2014 ñPër miratimin e rregullores ñpër kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqësò, sipas të cilës, përcaktohet hapësira për 1 punonjës = 12 m^3 ose 5.3 m^2 (duke i marrë të barabarta, gjatësinë 2.3 m^2, lartësinë 2.3 m^2 dhe gjerësinë 2.3 m^2), dhe për 80 punonjës që ka ISHMT, hapësira që i nevojitet institucionit për çdo punonjës është 424 m^2 + hapësirat e përbashkëta (korridore, tualete, shkall, 1 magazinë) 200 m^2 = **rreth 600 m^2 – 700 m^2,** ndërkohë është përcaktuar se për 1 punonjës duhet **10-12.5 m^2** sipërfaqe (për ruajtjen e mostrave të marra në inspektim apo produkteve të rrezikshme për shkatërrim, pajisjeve laboratorike dhe kiteve për inspektim, **produkte të cilat nuk mund të mbahen nëpër zyra**, por në ambjente të posaçme, magazinën e institucionit) dhe në total ISHMT-së i duhen **800-1000 m^2,** që në gjykimin e grupit të auditimit, si dhe duke iû referuar përcaktimit të bërë në VKM nr.521, datë 06.08.2014, është sipërfaqe e madhe dhe e pa arsyetuar, çka ndikon direkt në rritjen e shpenzimeve të financimit të marrjes me qera të ambienteve për zyra. 3.1.Theksojmë se në arsyetimin e bërë nga grupi i përcaktimit të specifikimeve, nuk ka asnjë praktikë të mirë të referuar konkretisht, siç është shprehur grupi i punës ñduke marrë në **vlerësim praktikat më të mira** në ndërtim për ndërtesat që përdoren në funksione administrativeé ò 4. Në përcaktimin e kritereve fituese, grupi i punës nuk ka kërkuar asnjë të tillë që lidhet me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, referuar përcaktimeve ligjore të bëra në **VKM nr.564, datë 3.7.2013 "Për miratimin e rregullores "për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës"**, konkretisht për: -Rrugët dhe daljet e emergjencës; -Mjediset e punës, nëse është e nevojshme, përshtaten në mënyrë të tillë që të marrin parasysh nevojat e punëmarrësve me aftësi të kufizuar; -Zbulimi dhe shuarja e zjarrit (pajisen me detektorë dhe sisteme alarmi për zjarret); -Tualete të ndara për meshkujt dhe femrat; -Disponimi i certifikatës së sigurisë nga zjarri dhe projektit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, detyrime ligjore të përcaktuara në nenin 37 të Ligjit nr.152/2015 ñPër

	shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtiminò; **Detyrime që duhet të zbatohen nga institucionet publike sipas VKM-së së mësipërme.** 6. Afati i përcaktuar për dorëzimin e ofertave ditën e dielë, është në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 4, pikat 1 dhe 2 të nenit 53 të Ligjit nr. 44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò, si dhe pikat 1 dhe 2 të Kreut I dhe pikën 1 të Kreut II të nr.511, datë 24.10.2002 ñpër kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetëroreò, të ndryshuar. Sa më sipër mbanë përgjegjësi grupi i ngritur me Urdhërin nr.132, datë 28.07.2020 z.J.Ll (Kryetar), zj.E.Xh (Anëtar), zj.S.B (Anëtar). **II.**Dorëzimi dhe vlerësimi nga komisioni i vlerësimit të ofertave: 1. Afati i përcaktuar në Urdhërin për ngritjen e KVO, i cili hyn në fuqi në ditë të dielë, pra ditë pushimi është në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 1 dhe 2 të Kreut I dhe pikën 1 të Kreut II të nr.511, datë 24.10.2002 ñpër kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetëroreò, të ndryshuar, dhe për këtë mban përgjegjësi Titullari i Institucionit z.L.S.
	2. Deri më datë **30.08.2020** (afat i vendosur për vlerësimin e ofertave të dorëzuara, sipas Urdhërit nr.143, prot., 1921, datë 28.08.2020), nga KVO nuk ka patur asnjë vendimmarrje, pra nuk është respektuar afati për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, për të cilën mbanë përgjegjësi KVO ngritur me Urdhrin nr.143, prot., 1921, datë 28.08.2020 zj.F.C, Kryetar, z.L.L, Anëtar, z.E.S, Anëtar.
	3. Dokumentet e dorëzuara nga shtetasi A.N, sipas njoftimit të publikuar në Gazetën ñDò, më datë 24, 25, dhe 26.08.2020, i cili është paraqitur si person juridik, ortak i vetëm i subjektit tregtar S-2004 shpk, **nuk janë të plota**, konkretisht: ▪ Nuk ka sjellë vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, ku sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve[12], ky subjekt ka detyrime të papaguara në afat, ndaj të cilëve Administrata Tatimore, në zbatim të nenit 91 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", ka vendosur marrjen e masave të sigurimit mbi të gjithë pasuritë për ekzekutimin e detyrimeve dhe se ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të tyre;
	▪ Konstatohet se shtetasi i shpallur fitues, në kohën e dorëzimit të dokumenteve, nuk i ka plotësuar kriteret e vendosura, pasqyruar kjo në ofertën e tij, i cili kërkon 6 muaj paradhënie, për tôi përshtatur ambientet sipas kërkesave të ISHMT, me qëllim që të shpallet fitues, por as ky fakt nuk është pasqyruar nga KVO.
	-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO ngritur me Urdhrin nr.143, prot., 1921, datë 28.08.2020 zj. F.C, Kryetar, z. L.L, Anëtar, z. E.S, Anëtar.
	4. Konstatohet se nga grupi që ka përcaktuar fondin limit, më datë **09.09.2020,**është bërë ndryshimi i kritereve fituese dhe afati procedurial (është përfshirë edhe kriteri, që në këtë procedurë mund të konkurrojë edhe një person fizik), me arsyetimin se nga vlerësimi i ofertave të dorëzuara, (**që kjo është në mungesë të kompetencës ligjore**, pasi ky grup nuk ka pasur të drejtë të bëjë vlerësimin e ofertave), kanë marrë pjesë vetëm subjekte tregtare/përfaqësues të tyre, dhe në këtë mënyrë **ngushtohet konkurrenca** e pjesëmarrësve në këtë procedure, **ndërkohë** që nuk ka patur **asnjë ankesë nga konkurrentët/palë të interesuara për këtë kriter**, si dhe deri në datë 09.09.2020, nuk administrohet asnjë dokument ku të jetë pasqyruar vlerësimi i ofertave të dorëzuara, **për të dalë në përfundimin se duhen ndryshuar kriteret**,

[12] https://www.tatime.gov.al/c/8/129/130/borxhi-tatimor

	për të krijuar konkurrencë të ndershme. Për më tepër që, në një procedurë të tillë, administrative, ky vendim merret nga organi publik, i cili përfaqësohet nga Titullari i Institucionit, mbështetur në përcaktimet e bëra në pikën 2 në nenin 53 në Kreun V të Ligjit nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò.
	-Për këtë mbanë përgjegjësi grupi i ngritur me Urdhërin nr.132, datë 28.07.2020 z.J.Ll (Kryetar), zj.E.Xh (Anëtar), zj.S.B (Anëtar).
	5. Është marrë në konsideratë kërkesa e bërë nga shtetasi A.N (oferta e shpallur fituese), për ndryshimin e afatit dhe dorëzimin e dokumenteve shtesë, nga data 30.08.2020 të bëhet në datë 11.09.2020, me pretendimin nga ky i fundit, se këto dokumente nuk ishin të pasqyruara në njoftimin e bërë në Gazetën ñDò, **por nga verifikimi që bëri grupi i auditimit**, çdo kërkesë për dokumentacion që ishte përcaktuar si kriter fitues, **ishte publikuar edhe në njoftimin në gazetë**, çka do të thotë se kërkesa e personit të mësipërm nuk duhet të ishte marrë në konsideratë, por duhet të ishte sõkualifikuar menjëherë për mosplotësim të dokumentacionit. Për më tepër që kërkesa e shtetasit në fjalë është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën ñaò dhe pikën 2 të nenit 44, pikën 3 të nenit 53, pikën 2 të nenit 58, shkornjën ñaò dhe ñbò të nenit 65, si dhe pikat 1 dhe 3 të nenit 82 në Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò.
	▪ Në këto kushte nga KVO, me përfundimin e afatit të dorëzimit dhe vlerësimit të ofertave, duhet të ishte mbajtur procesverbali i vlerësimit të tyre, dhe nëse asnjë ofert nuk plotësonte kriteret për tu shpallur fituese, **duhej të bëhej anullimi i procedurës**, por që nuk ka ndodhur.
	-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO ngritur me Urdhrin nr.143, prot., 1921, datë 28.08.2020 zj.F.C, Kryetar, z.L.L, Anëtar, z.E.S, Anëtar.
	6. Njëri nga ambjentet e marrë me qera, konkretisht, Pasuria e llojit ñBanimò me nr.X + 1-2 (kati i dytë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, sipërfaqe 191.6 m^2, në kohën e vlerësimit të ofertave, sipas verifikimit të kryer në Kartelën e Pasurisë në seksionin ñEò ka **qenë e bllokuar që në datë 24.09.2019 për shumën 100,000 euro,** në favor të një shtetasi tjetër, dhe ndodhur në këto kushte kjo ofertë duhet të ishte **s'kualifikuar**, **por që ky fakt nuk është përmendur në asnjë rast nga KVO.** Referuar përcaktimit ligjor të bërë në pikën 3 në nenin 802 të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil në RSHò, i ndryshuar: Qiradhënësi duhet: **3. të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë.**
	7. Në dokumentet e sjella nga subjekti i shpallur fitues nuk përcaktohet në asnjë pozicion hapësira e përcaktuar për parkimin e 4 automjeteve, ndërkohë nga KVO është pasqyruar se plotëson kriterin, për më tepër dokumentat e sjella nga subjekti i përkasin kateve të banimit dhe podrumit, pra nuk lidhen aspak me truallin përreth objektit, ku të jetë i përcaktuar ambjenti për parkimin e automjeteve;
	-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO ngritur me Urdhrin nr.143, prot., 1921, datë 28.08.2020 zj. F.C, Kryetar, z. L.L, Anëtar, z. E.S, Anëtar. **III.**Lidhja e kontratës ndërmjet palëve: Mbi lidhjen e kontratës konstatohet se: 1. Ajo nuk është e noterizuar, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 1 të VKM nr.469, datë 03.06.2015 ñPër përcaktimin e vlerës minimale të

	çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimoreò, si dhe paragrafit të dytë në nenin 83 të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civilò, i ndryshuar, ku përcaktohet: ñËshtë i pavlefshëm veprimi juridik, kontrata e lidhur ndërmjet palëve, që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligjiòdhe në kushtet që ndodhej prona, pra referuar **statusit juridik** të saj, **kontrata nuk mund të lidhej përball noterit**, pasi në këtë rast, pasuria me nr.X + 1-2 (kati i dytë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, sipërfaqe 191.6 m^2, ka qenë e bllokuar/barrë hipotekore, **për ligjërimin e** pikës**5.1 të nenit 5 të kontratës**: ñProna është e lirë nga çdo lloj barre dhe hipoteke, detyrimi ose çdo lloj garancie, pengese që i është vënë asajò. Gjithashtu ky veprim bie në kundërshtim me nenin 674, 675, 677 dhe pikën 3 të nenit 802 të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civilò, i ndryshuar. Për këtë mbanë përgjegjësi titullari i institucionit z.L.S. 2. Lidhja e kontratës, konkretisht për marrjen me qera të një prej pasurive, konkretisht të asaj me nr.X + 1-2 (kati i dytë banim) ZK X, vol X, faqe X, sipërfaqe 191.6 m^2, është në kundërshtim me nenin 674 të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civilò, i ndryshuar. Konkretisht në nenin 674 përcaktohet se: ñPalët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës. **Pala që ka ditur, ose që duhej të dinte shkakun e pavlefshmërisë së kontratës dhe nuk i'a ka bërë të ditur atë palës tjetër, detyrohet të shpërblejë dëmin që kjo e fundit ka pësuar**, për shkak se besoi pa fajin e vet në vlefshmërinë e kontratësò. 3. Pika **6.7 e nenit 6** të kontratës, ku në momentin e lidhjes së saj, qiramarrësi ka detyrimin që të parapaguajë 6 muaj paradhënie, për kryerjen e rregullimeve/punimeve të nevojshme, që ambjenti i marrë me qera të plotësojë kërkesat e ISHMT-së, **është e pambështetur ligjërisht,** pasi në këtë rast kemi të bëjmë me një kontratë qeraje dhe jo me një kontrat sipërmarrje (kontrata me të cilën njëra palë (sipërmarrësi) detyrohet, që me mjetet e saj dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një vepër (punë), ose të bëjë një shërbim apo një zbatim të pavarur të punimeve, ndërsa pala tjetër detyrohet ta pranojë atë kundrejt çmimit të caktuar në kontratë). 3.1.Gjithashtu në mungesë të referimit të aktit ligjor/nënligjor për pikën 6.7 të nenit 6 të kontratës, që parashikon paradhënien, parashikimi i bërë për pagesën 6 muaj paradhënie, bie në kundërshtim me pikën 161 të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar: ñNë lidhjen e kontratave për investime (në këtë rast sipas përcaktimit të kontratës janë dhënë fonde për kryerjen e rregullimeve/punimeve) nuk lejohet të parashikohet dhënia e fondeve buxhetore në formën e paradhënies, përveç rasteve kur parashikohet në kontratë me referencë të specifikuar të aktit ligjor/nënligjor (në këtë rast mungon referenca e specifikuar) Në këto raste paradhënia mund të jetë deri në 10%, por jo më shumë se kufiri i garancisë së kontratës. Struktura përgjegjëse për thesarin evindenton vlerën totale të çdo kontrate/urdhër prokurimi, si dhe grafikun e shlyerjes së kontratës, pasi vërtetohet ekzistenca e fondeve buxhetore vjetore të mjaftueshme në SIFQ, për pjesën e vitit korent të kontratës, të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit në strukturën përkatëse buxhetore. Vlera e mbetur e kontratës shumëvjeçare rregjistrohet për vitet pasardhëseò; dhe nenin 660 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 ñKodi Civili në RSHò, i ndryshuar: ñPalët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqiò ï sipas legjislacionit në fuqi Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSHò, i ndryshuar, Ligjit nr.10296. datë

08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, duke ardhur në përcaktimin e bërë pikën 161 të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar, akt nënligjor i dalë në zbatim të akteve ligjore më sipër. Për këtë mbanë përgjegjësi titullari i institucionit z.L.S.

4. Lidhja e kontratës për një afat 5-vjeçar (**pra ndërmarrja e angazhimeve buxhetore për 5 vite**, ndërkohë kur planifikimi për fonde bëhet deri në 3 vitet e ardhshme) nga titullari i ISHMT-së, **është e pa mbështetur ligjërisht**, përkundrazi bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 23 dhe 26 të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, si dhe pikën 156 të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò. Për këtë mbanë përgjegjësi titullari i institucionit z.L.S.

5. Veç sa më sipër, konstatohet se lidhja e kësaj kontrate në kushtet e mësipërme, është në kundërshtim me nenin 1 dhe shkronjën ñçò në nenin 4 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 ñPër mbrojtjen e konkurrencësò, i ndryshuar:

ñQëllimi i këtij ligji është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës dhe përgjegjësitë e tyreò.

ñNdalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që:

ç)në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrenceò;

pasi autoriteti kontraktor me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, duke favorizuar mangësitë e fituesit të kontratës dhe duke i kërkuar/ofruar mundësinë atij për plotësimin e dokumenteve të nevojshme për fitimin e kontratës, praktikë që nuk e ka bërë edhe me ofertuesit e tjerë. Për këtë mbanë përgjegjësi grupi (z.J.Ll Kryetar i grupit, zj.E.Xh dhe zj.S.B anëtar), i cili ka marrë vendimin për shtyrjen e afatit për plotësimin e dokumentacionit nga subjekti i shpallur fitues, dhe KVO (zj.F.C, Kryetare e grupit, z.L.L dhe z.E.S), anëtar, e cila nuk duhet të kishte pranuar ndryshimin e afatit në mungesë të vendimit për miratim nga titullari i institucionit.

<u>IV.Marrja në dorëzim e ambjenteve</u>

1. Nga verifikimi i godinës së marrë me qera nga grupi i auditimit të KLSH-së, në prani të Titullarit të Institucionit dhe Drejtorit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve, si dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar në dosje, **nuk ka gjetur zbatimpika 5.7 e nenit 5 të kontratës**, ku është përcaktuar se ambienti i dhënë me qera duhet të ofrojë kushtet që plotësojnë kërkesat në përputhje me legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë, konkretisht kjo godinë nuk ka:

-Rrugët dhe daljet e emergjencës;

-Detektorët dhe sistem alarmi për zjarret;

-Certifikatën e sigurisë nga zjarri (që nuk administrohet në dosje);

-Projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin (që nuk administrohet në dosje, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 37 të Ligjit nr.152/2015 ñPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtiminò),si dhe përcaktimet e bëra në Shtojcën e VKM nr.521, datë 6.8.2014 ñPër miratimin e rregullores ñpër kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqësò, dhe për këtë nga komisioni i marrjes në dorëzim duhet të ishte pasqyruar në procesverbalin e mbajtur për marrjen në dorëzim të ambjenteve dhe refuzimin e marrjes në dorëzim të ambjenteve, por që nuk ka ndodhur;

	2. Nuk dokumentohet asnjë veprim i kryer nga komisioni i marrjes në dorëzim të ambjenteve, matje të kryera, foto të ambjenteve të marra me qera, foto të hapësirave për parkimin e 4 automjeteve si dhe vendosjen e tabelës identifikuese të parkimit të automjeteve për ISHMT në ambjentin e marrë me qera, me qëllim ruajtjen e gjurmëve të auditimit, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 2, 19, 21, 36, 42, 47 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar. -Për sa më sipër mbanë përgjegjësi grupi i punës, ngritur me Urdhrin nr.160, datë 25.09.2020, për marrjen në dorëzim të ambienteve me qera, me përbërje: z. J.Ll ï Kryetar, z. R.G, z. E.S, zj. S.B dhe z. G.N ï Anëtar. **<u>V.Pagesat e kryera sipas urdhër shpenzimeve:</u>** 1.Pagesat e kryera në vlerën 1,545,771 lekëpa përfshirë tatimin 15%(për pasurinë e llojit ñBanimò me nr.X + 1-2, sipërfaqe 191.6 m^2, kati i dytë banim, ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, shpenzime qeraje për periudhën Tetor 2020-Maj 2021), e cila ka qenë e bllokuar në favor të të tretëve, mbështetur në përcaktimet e bëra në pikën 5.1 të nenit 5 të kontratës, nenet 674, 802, 806, 807 të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil në RSHò, i ndryshuar, si dhe shkronjat ñaò dhe ñbò të pikës 35, si dhe pikën 36 në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, do të konsiderohen dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit.
	-Pika 5.1 e nenit 5 të kontratës <u>ndërmjet palëve ñProna është e lirë nga çdo lloj barre dhe hipoteke, detyrimi ose çdo lloj garancie, pengese që i është vënë asajò.</u> -Neni 674-Palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës. **Pala që ka ditur, ose që duhej të dinte shkakun e pavlefshmërisë së kontratës dhe nuk i'a ka bërë të ditur atë palës tjetër, detyrohet të shpërblejë dëmin që kjo e fundit ka pësuar**, për shkak se besoi pa fajin e vet në vlefshmërinë e kontratës. -Neni 802 Qiradhënësi duhet: 1. tõ dorëzojë qiramarrësit sendin në kohën e caktuar dhe në gjendje që të lejojë përdorimin për të cilën palët janë marrë vesh; 2. të kujdeset për të mbajtur sendin në po këtë gjendje; **3. të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë.** -Neni 806-Në qoftë se në kohën e dorëzimit, sendi i dhënë me qira cenohet nga të meta që ulin në mënyrë të dukshme vlerën e përdorimit të kontraktuar, qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, ose zbritjen e çmimit të qirasë, përveç kur ai ka patur dijeni për të metën ose ajo është lehtësisht e dallueshme. **Qiradhënësi është i detyruar t'i paguajë qiramarrësit dëmet e ardhura nga veset e sendit**, në qoftë se nuk provon se, pa patur faj, nuk ka patur dijeni për këto vese në momentin e dorëzimit. -Neni 807-Marrëveshja, me të cilën përjashtohet ose kufizohet përgjegjësia e qiradhënësit për veset e sendit, nuk ka efekt në qoftë se qiradhënësi **i'a ka fshehur me keqbesim qiramarrësit ato, ose kur veset janë të tilla që të pengojnë gëzimin e sendit.** -Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Pika 35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: a) **Dokumente autorizuese** - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i **bashkëlidhet dokumentit vërtetues**. Të tilla janë

	urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj. b) **Dokumente vërtetuese - vërtetojnë kryerjen në fakt**, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi. 36. Dokumentacioni quhet i rregullt **kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen**, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin **dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative**. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve.
	1. Konstatohet se sipas pikës **6.7 të nenit 6 të kontratës, ndaj shtetasit A.N,** janë paguar 4,303,094 lekë (pa përfshirë tatimin 15%) paradhënie për 6 muaj, për rregullime/punime në objekt, në mungesë të miratimit paraprak të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 160 të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò. ñNdalohet përdorimi i formës së ngurtësimit në llogari të klientit për të gjitha kontratat (investime, shërbime). Përjashtimet nga ky rregull mund të bëhen vetëm për kontrata të rëndësisë së veçantë (për investime dhe shërbime) dhe vetëm me miratim paraprak të Ministrit përgjegjës për Financat. Kushti i kontratës i lidhur në kundërshtim me këtë parashikim, është i pavlefshëm dhe nuk ekzekutohetò. *Sa më sipër shpenzimet 4,303,094 lekë, e kryera nga ISHMT në formën e paradhënies ndaj shtetasit A.N, do të konsiderohen shpenzime me efekt dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit.* -Për sa më sipër mbanë përgjegjësi Titullari i ISHMT, z.L.S.
Kriteri	Nenin 5, 8, pikën 4 të nenit 9, 16 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; -Nenin 4, pikën 3 të nenit 3, shkronjën ñaò të nenit 11, shkronjën ñaò dhe pikën 2 të nenit 44, pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 53, pikën 2 të nenit 58, shkronjën ñaò dhe ñbò të nenit 65, pikat 1 dhe 3 të nenit 82, pikën 2 në nenin 99të Ligjit nr.44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò; Nenin 83, nenet 660, 674, 675, 677, pikën 3 të nenit 802, 806, 807 të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil në RSHò, i ndryshuar; -Nenin 23 dhe 26 të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; -Nenin 1 dhe shkronjën ñçò në nenin 4 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 ñPër mbrojtjen e konkurrencësò, i ndryshuar -Nenin 37 të Ligjit nr.152/2015 ñPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtiminò; -VKM nr.564, datë 3.7.2013 ñPër miratimin e rregullores ñpër kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punësò; -VKM nr.521, datë 6.8.2014 ñPër miratimin e rregullores ñpër kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqësò; -Pikat 1 dhe 2 të Kreut I dhe pikën 1 të Kreut II të nr.511, datë 24.10.2002 ñpër kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetëroreò, të ndryshuar; -Pikën 1 të VKM nr.469, datë 03.06.2015 ñPër përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimoreò;

	Pikat 156, 160 dhe 161 të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar; Pikat 2, 19, 21, shkronjat ñaò dhe ñbò të pikës 35, pikat 36, 42, 47 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar; Relacioni nr.1714/2, datë 17.08.2020, për hartimin e kërkesave dhe fondit limit, i ndryshuar; Procesverbali nr.1921/7 prot., datë 14.09.2020, për vlerësimin e ofertave të dorëzuara; Urdhëri nr.143, prot., 1921, datë 28.08.2020, i Titullarit të ISHMT; Oferta me nr. 1921/1 prot., datë 28.08.2020 dhe kërkesa e shtetasit z.A.N, me nr.1921/5 prot., datë 28.08.2020, shpallur fitues.
Ndikimi/Efekti	-Pagesat e kryera në vlerën 1,545,771 lekë pa përfshirë tatimin 15% (për pasurinë e llojit ñBanimò me nr.X + 1-2, sipërfaqe 191.6 m2, kati i dytë banim, ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, shpenzime qeraje për periudhën Tetor 2020-Maj 2021), do të konsiderohen dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit. -Shpenzimet 4,303,094 lekë, pa përfshirë tatimin 15%, e kryera nga ISHMT në formën e paradhënies ndaj shtetasit A.N, do të konsiderohen shpenzime me efekt dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit.
Shkaku	Moszbatimi i kuadrit ligjor në lidhjen e kontratës, çka në gjykimin dhe vlerësimin e grupit të auditimit bazuar në përcaktimet ligjore e bënë atë të pavlefshme.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për fillimin e procedurës për arkëtimin nga pronari i objektit, shtetasi A.N, të dëmit ekonomik në vlerën 1,545,771 lekë, shkaktuar në buxhetin e shtetit. Ministria e Financës dhe Ekonomisë (institucioni epror i ISHMT) të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për fillimin e procedurës së ndërprerjes së kontratës ndërmjet ISHMT dhe shtetasit A.N, kthimin e shumës së paradhënies përfituar nga pronari i objektit, në vlerën 4,303,094 lekë në buxhetin e shtetit, si dhe sigurimin e ambjenteve për zyra për ISHMT. **Menjëherë**

Observacion: Me shkresën nr.614/10, datë 15.10.2021 nga ISHMT është bërë observacion për konstatimet e grupit të auditimit për procedurën e marrjes me qera të ambjenteve për zyra, ku në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë vijon:

1.Në nenin 5, 8, pikën 4 të nenit 9, 16 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar **nuk ka asnjë përcaktim** ku të thuhet se duhet të ishte nxjerrë një urdhër i brendshëm që të përcaktonte giithë procedurën e marrjes me qera, me qëllim përdorimin efiçient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangien e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë, **siç argumentohet nga ana e GA**. Titullari i ISHMT në zbatim të VKM 36/2016 ñPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT-sëò, në zbatim të pikës 9, në zbatimin e përgjegjësive të parashikuara në pikën 6 të këtij vendimi, Kryeinspektori nxjerr urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për veprimtarinë e strukturave të ISHMT-së. Për sa i përket procedurës së marrjes me qira të ambjenteve të ISHMT-së, Titullari i ISHMT ka nxjerrë:

- Procedura për marrjen me qira të ambjenteve për zyra ka nisur me miratimin e kërkesës së Titullarit të institucionit nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së.
- Shkresa zyrtare iniciuse për procedurën është kërkesa me nr.1173 prot, datë 09.06.2020 drejtuar MFE për pajisjen me zyra për ISHMT.

- Nuk ka asnjë parashikim ligjor i cili ngarkon Titullarin e institucionit për inicimin e kësaj procedure ku duhet të nxjerrë një Urdhër të posaçëm. Në detyrat funksionale të Titullarit të institucionit përfshihet sipas VKM-së nr. 36/2016 ñPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT-sëò, në zbatim të pikës 9, në zbatimin e përgjegjësive të parashikuara në pikën 6 të këtij vendimi, kryeinspektori nxjerr urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për veprimtarinë e strukturave të ISHMT-së në fushën e inspektimit që ai mbulon sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar praktikës së marrjes me qira,Urdhëri iKryeinspektorit me nr.182 datë 28/07/2020 është hartuar për ngritjen e GP për studimin e tregut të qirave në qytetin e Tiranës dhe analizën financiare për përcaktimin e fondit limit, për selinë e institucionit në buxhetin e aprovuar për vitin 2020 dhe planifikuar për 2020-2021. Ky Urdhër nuk është nxjerrë për fillimin e procedurës, pasi fillimi i procedurës është inicuar nga ministria e linjës.

2.Baza ligjore e përmendur në Urdhërin nr.132, datë 27.07.2020 ku përcaktohet veç të tjerave dhe neni 7 i Ligjit 9643 óPër prokurimin publikò, i ndryshuar është përmendur si bazë ligjore sipas së cilës kjo procedurë është përjashtuar nga procedurat e prokurimeve publik të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

3.Për të kryer studimin e tregut sipas kritereve teknike dhe Urdhërit nr 132, datë 28.07.2020, ISHMT është detyruar që të marrë çmimet e qirave të zyrave nga Agjensia Mobiliare si vijon :

-Agiensia Imobilare RG- Godinë 2 katëshe në Rrugën Jordan Misja, me sipërfaqe 1000 m^2, çmimi për m^2= 6.5 euro, vlera e qerasë mujore 6,500 euro;

-Agjensia Imobilare RG - Ambient komercial në Rrugën e Barrikadave, me sipërfaqe 1000 m^2, çmimi për m^2 = 10 euro, vlera e qerasë mujore 10,000 euro;

-Agensia Imobilare RG- Ambient komercial në Rrugën Dëshmorët e Kombit, me sipërfaqe 760 m^2, çmimi për m^2 = 16 euro, vlera e qerasë mujore 12,600 euro;

Ofertat e paraqitura nga Agjensia Imobiliare i përkasin pronave të ndryshme në zona të ndryshme përreth qendrës së Tiranës, ku dhe është kërkuar testimit i tregut sipas Urdhërit. Juridikisht ofertat e paraqitura nuk mund të arsyetohen sikur janë vetëm nga një operator pasi agjensia imobiliare nuk është pronari i pronave, por i përkasin subjekteve fizike dhe juridike të ndryshme. Agjensia imobiliare bën vetëm listimin e pronave, por nuk është ajo përcaktuese për ofertat/qiratë që jepen nga pronarët e këtyre pronave. Për këtë arsye me këto oferta, është plotësuar kërkesa sipas Urdhërit për studimin e tregut ku është nxjerrë edhe një çmim i përafërt për marrjen me qira të zyrave. Pavarësisht sa më sipër në asnjë akt ligjor nuk është parashikuar numri i ofertave apo procedura që duhet të ndiqet për të përcaktuar fondin limit.

Referanca sipas përcaktimeve ligjore të bëra në pikën 2 dhe shkronjat "c" dhe "*d" të pikës 3 të 4.VKM nr.469, datë 3.6.2015 ñPër percaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", nuk ka asnjë bazë ligjore për të përcaktuar çmimin e tregut të shitjes së pronave të paluajtshme apo dhënies me qira të tyre. Siç edhe e përcakton VKM nr.469, datë 3.6.2015 ñPër percaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", çmimi mimnimal fiskal sipas zonave të pasurive të paluajtshme, përdoret vetëm për qëllime fiskale. Në vlerësimin dhe studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit, ISHMT i ka plotësuar kushtet që vendos kjo VKM për të mos patur çmime nën minimalen fiskale.Gjithashtu ju informojme se përcaktimet ligjore të bëra në pikën 2 dhe shkronjat "c" dhe "d" të pikës 3 të VKM nr.469, datë 3.6.2015 ñPër percaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", japin vlerat minimale fiskale për qeramarrjen.Gjithë vlerësimi i cili është kryer nga GA sa më sipër nuk përdor terminologjinë sipas VKM nr.469, datë 3.6.2015 ñPër percaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore",por llogaritjet për çmimet minimale fiskale të pronave dhe qiratë minimale fiskale sipas zonave i referon si ñçmime të shitjes së pronave sipas zonave dhe qira sipas zonaveò, duke dhënë një përcaktim që është në kundërshtim me vet bazën ligjore të cilës i referohet.

5.Referuar VKM nr.521, datë 6.8.2014 "Përmiratimin e rregullores "për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje meekran shfaqës", në pikën 2/a të shtojcës përcaktohet se : hapësira e vendit individual të punës është jo më pak se 12 m^3 dhe projektohet në mënyrë të tillë që të ofrojë lehtësi për ndryshimin e pozicionit dhe kryerjen e lëvizjeve të punëmarrësit. Në kuptim të kësaj baze ligjore kriteri prej 12m^3 për një punonjës është hapësira minimale të cilën duhet të përmbushi një institucion. VKM e sipërcituar nuk lejon që hapësirë më të vogël se 12 m^3 por nuk shprehet dhe nuk jep për një hapësirë maksimale, në kufinjtë e të cilës duhet të parashikohen hapësirat për një punonjës. ISHMT ka zbatuar rigorozisht VKM, duke garantuar hapësirat për çdo punonjës jo më pak se 12 m^3. Gjithashtu Inspektoriati është treguar i kujdeshëm dhe nuk ka marrë hapësira përtëj arsyes në m^3 për punonjës. Dhe kjo është evidente në kërkesat e vendosura dhe organikën e miratuar në kohën e kryerjes së procedurës.
6.Lidhur me pretendimet se nuk ka tualete të ndara për meshkujt dhe femrat, referuar gjëndjes faktike për të 4 katet që ISHMT ka me qira, janë në total 8 tualete nga 2 për secilin kat. Pra është përmbushur konstatimi, i cili nuk qëndron në këtë rast. Kushtet për rrugët dhe daljet e emergjencës, kushtet për punëmarrësit me aftësi të kufizuara, sistemet e zbulimit dhe të shuarjes së zjarrit si edhe certifikatën e sigurisë së zjarrit, janë kritere të cilat plotësohen para kolaudimit të objektit në ndërtim, të cilat verifikohen nga kolauduesi i objektit si dhe nga bashkia. Sipas aktit të ekspertizës së datës 11.09.2014, hartuar nga eksperti Ing ED, thuhet se objekti ka dalje direkte në rrugicë, mbrojtje kundër zjarrit, është theksuar se objekti ndodhet në një nga zonat më të mira pranë qendrës së Tiranës cka nënkupton se rrjetet inxhinjerike janë të sistemuara. Sistemi i alarmit dhe kamerave vëzhguese janë parashikuar për të ardhmen. Kafazi i shkallëve të objektit është në qendër të objektit dhe jo hermetik ndaj zjarreve duke mos luajtur funksionin e shkallëve të shpëtimit, por parashikohet një sistem i saktë ujësjellësi, funksional kundër zjarreve të mundshme. Gjithashtu në konkluzion të aktit të ekspertimit është konkluduar se ndërtesa paraqitet si një kompleks ndërtimor teknik, i cili duke mbikëqyrur cilësinë e punimeve, materialeve ndërtimore dhe pajisjeve të vendosura, arrihet sigurimi i funksionimit teknik të objektit. Gjithashtu, bazuar në kushte teknike dhe ato të projektimit, arrihet të sigurohet qëndrueshmëria e karakteristikave përbërë të cilat identifikojnë karakteristikat e objektit dhe si rrjedhojë sjellin qëndrueshmërinë e tij. Gjithashtu, nga pikëpamja e përputhshmërisë me kërkesat teknike dhe ato të performancës që rrjedhin nga standardet e tregut janë plotësuar, rezistencë mekanike dhe stabilitet, akses i lehtë, përsosmëri dhe disponueshmëri e hapësirave të shërbimeve, mbrojtje e higjenës shëndetit dhe mjedisit, përdorimi i sigurt i ndërtesës, mbrojtje ndaj zhurmave, mbrojtje kundra zjarrit, ruajtje e energjisë dhe parandalimi i humbjeve të nxehtësisë.Duke qenë se, këto kritere plotësohen që në ndërtimin e objektit nuk është parë e arsyeshme dhe e bazuar që të kërkoheshin si kritere për kualifikimin dhe shpalljen fitues, pasi KVO nuk mund të luajë rolin e kolauduesit për përmbushjene kritereve teknike të ndërtesës, të cilat kontrollohen që në fazën e ndërtimit.Referuar konstatimit lidhur me qëllimin dhe funksionin e godinës se ajo duhet të kishte në certifikatën e pronësisë titullin godinë shërbimi dhe jo godinë banimi, GP sqaron se një përkufizim i tillë do të rriste çmimin e qirasë duke kufizuar tregun pasi një pjesë e godinave të cilat janë përshtatur për zyra dhe që kanë në certifikatë tjetër qëllim do të shmangeshin nga oferta. Procedura e marrjes me qira të ambienteve për përdorim për zyra për institucionin nuk është kryer në bazë të një legjislacioni specifik, i cili përcakton rregullat për zhvillimin e procedurave të cilat përjashtohen nga zbatimi i ligjit ñPër Prokurimin Publikò. Për këto arsyje nga ana e grupit janë kërkuar dokumentat të cilat janë parë të domosdoshme për përshtatjen si ambiente për zyra. Nuk është gjendur asnjë bazë ligjore në bazë të të cilës nga ana e ISHMT-së të kërkohej sigurimi i kontratës, me qëllim garantimin dhe mbrotjen e interesave të ISHMT-së, në rast të moszbatimit të kontratës nga qiradhënësi.Sigurimi i kontratës është realizuar me anë të paradhënies e cila është bërë kundrejt palës qeradhënëse, në masën 6 muaj. Bazuar në nenin 601 Kodi Civil ñKapar quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do ti paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj.

Gjithashtu në bazë të nenit 660 të Kodit Civil ñPalët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufinjve të vendosura nga legjislacioni në fuqi.ò Si dhe në bazë të nenit 690 ñKontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palëtò.

7.Në lidhje me kohëzgjatjen e qerasë, në bazë të parimit të lirisë kontraktuale palët mund të parashikojnë kushte të ndryshme në kontratë të cilat zbatohen me dhënien e pëlqimit nga të dyja palët që e nënshkruajnë atë. Kodi civil, dispozitat përkatëse mbi kontatën e qerasë nuk ka asnjë parashikim ligjor për afatin e kontratës. Në nenin 803 të Kodit Civil parashikohet se: ñQeraja nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se tridhjetë vjet, përvecse kur parashikohet ndryshe nga ligji. Në qoftë se ajo është e lidhur për një periudhë më të gjatë ose pa afat, ka fuqi vetëm për afatin e sipërm. Për ndërtesat që përdoren për banim, kontrata e qerasë nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se pesë vjet. Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë më shkresë.Për sa më sipër nga ana e ISHMT-së janë zbatuar të gjitha parashikimet ligjore për kohëzgjatjen e kontratës së qirasë.

8.Në bazë të Ligjit nr 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative në RSHò, Neni 56, pika 4 përcakton se kur dita e fundit e një afati i bie e shtunë ose e diele, ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Për sa më sipër përcaktimi i ditës së Dielë, si dita e fundit për dorëzimin e ofertave nuk sjell asnjë pengesë apo kufizim për dorëzimin e ofertave.

9.Grupi i prokurimit i përbërë nga 2020 znj.F.C, Kryetar, z.L.L, Anëtar, z.E.S, Anëtar, para caktimit në KVO nga titullari i institucionit me anë të urdhërit nr.143 Datë 28.08.2020, kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit në datën 31.08.2020.

Urdhëri nr.143, datë 28.08.2020, përcakton se hyn në fuqi në datën 30.08.2020. Kjo datë nuk nënkupton datën në të cilën KVO duhet të kishte përfunduar detyrimet që lindin nga urdhëri të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të saj, por është data në të cilën hyn në fuqi.

10.Lidhur me dokumentin e Drejtorisë së Taksave pranë Bashkisë Tiranë, ku thuhet se është pa vulë dhe firmë të Drejtorit të saj; është përmendur detyrimi që ka subjekti në vlerën 79 112.0 lekë, bashkëlidhur saj gjendet mandate bankare të lëshuara nga B, Dega Ibrahim Rugova datë 31.08.2020 ku vërtetohet se është bërë pagesa në kodin e thesarit 3535 kodi i të ardhurave 7020200, kodi inst 2101001/taksa ndërtese kësti numër një dhe dy, prona numër 6/67, taksë ndërtese kësti numër një dhe dy 25 dhe taksë ndërtese kësti një dhe dy, prona numër 6/67 plus 1- Kjo pagesë vërteton se detyrimi i përmendur në vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifa Vendore Bashkia Tiranë, duke qenë se është e njëjtë me pagesën e kryer në degën e thesarit Tiranë dhe me përshkrim të detyrimit të paguar, të njëjtë në të dy dokumentat, vërteton që shtetasi A.N me numër ID 50213135l ka shkyer të gjitha detyrimet.

Për sa i përket pretendimit nga GA se shtetasi A.N, nuk ka sjellë vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, sqarojmë se pjesmarrja në procedurën e zhvilluar nga ISHMT nga ana e shtetasit A.N është bërë si individ (Pronar i Godinës së ofruar) dhe jo si subjekt. Për këtë arsye individët nuk mund të pajisen me vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve pasi nuk janë subjekte tatimpaguese, sipas legjislacionit tatimor. Bazuar në kriteret në kriteret e shpallura në njoftimin për marrje godine me qira, është përcaktuar se për individët nuk është e nevojshme paraqitja e vërtetimit nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve. Ky dokument është kërkuar vetëm për ofertuesit e pajisur me NIPT/NUIS.

11.Në lidhje me konstatimin se shtetasi i shpallur fitues, në kohën e dorëzimit të dokumenteve, nuk i ka plotësuar kriteret e vendosura, pasqyruar kjo në ofertën e tij, i cili kërkon 6 muaj paradhënie, ky konstatim nuk qëndron pasi paradhënia prej 6 muajsh nuk ka qenë e vendosur si kriter nga ana e ISHMT-së dhe nuk është vendosur as si kusht nga ofertuesi Shtetasi A.N. Ky kusht është vendosur në kontratën e lidhur mes palëve, si kusht kontraktual me pëlqimin e të dyja palëve me qëllim sigurimin e kontratës dhe veprimtarisë së institucionit.

12.Për sa i përket ndryshimit të kritereve pas ankesës së bërë nga ana e ShtetasiA.N për shtyrje të afatit të paraqitjes së dokumentave për këtë procedurë të marrjes me qira, grupi i ngritur për studimin e tregut dhe përcaktimin e kritereve ngritur me Urdhërin nr. 132, datë 28.07.2020, ka

kryer ndryshimin e kritereve duke hapur mundësinë për ofertues edhe individë dhe persona fizikëme qëllim rritjen e konkurrencës dhe mundësve për të marrë pjesë në këtë garë pasi ishte e kufizuar vetëm për personat me staus juridik. Pavarësisht vendimit që afati për sjelljen e dokumentave nga ana e ofertuesve u shty deri në datën 11.09.2020, ky afat parashikohej edhe në relacionin e hartuar në datën 17.08.2020 nga ana e Grupit të Punës ku për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar për ofertuesit e kualifikuar duhet të kryhej brenda datës 11 Shtator 2020. Për sa i përket kompetencës për ndryshimin e afatit dhe kritereve pas ardhjes së një kërkese nga një ofertues, sqarojmë se edhe në rastet e procedurave të prokurimit publik, psh në rastin e blerjeve të vogla apo procedurave: Kërkesë për propozim, për ndryshimin e kritereve teknike për kkualifikim apo shtyrjen e afatit, është Njësia e Prokurimit sips Ligjit të prokurimit (i referohet GA), e cila sipas rastit vlerëson dhe ndryshon kriteret nëse ato janë kufizuese për ofertuesit dhe në çdo rast ndryshimi i tyre nuk miratohet nga ana e titullarit por është e mjaftueshme që të ketë një miratim nga ana e Njësisë së Prokurimit. Duke iu referuar kësaj praktike të njohur, pasi nuk ka një bazë ligjore për tu ndjekur në rastin e procedurës së marrjes me qira në legjislacionin shqiptar, Grupi i Punës ka miratuar ndryshimit në kriteret e pjesëmarrjes në garë dhe i ka njoftuar ato nëpërmjet faqes zyrtare, duke zgjeruar pjesëmarrjen edhe për personat fizikë, të cilët sipas kërkesave mund të kishin prona për të ofruar me qira. Për sa sa më sipër Kryeinspektori i ISHMT dhe në zbatim të VKM nr 36/2016 ñPër krijimin dhe organizimin e ISHMTò, nuk ka kompetencë vendimarrëse në procedurat e marrjes me qira të ambjenteve për zyra të institucionit. Pas ndryshimit të kritereve nga ana e ISHMT, është hapur gara për të marrë pjesë si ofertues edhe individët të cilët mund të kenë në pronësi godina të cilat përmbushin kriteret e vendosura për ushtrimin e veprimtarisë së ISHMT-së. Pretendimi se individi A.N duhet të ishte skualifikuar menjëherë për mosplotësim të dokumentacionit, sqarojmë se në bazë të kritereve është përcaktuar që plotësimi i dokumentacionit të kërkuar për ofertuesit e kualifikuar duhet që të kryhet brenda datës 11 Shtator 2020. Për këtë arsye sôkualifikimi i menjëhershëm i tij, pa pritur dokumentacionin plotësues do të çonte në një skualifikim të padrejtë të ofertuesit.

Në dokumentacionin e paraqitur nga ana e shtetasit A.N nuk është konstatuar fakti që Pasuria e llojit "Banim" me nr.X + 1-2 (kati i dytë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, sipërfaqe 191.6 m^2, në kohën e vlerësimit të ofertave, ka patur kufizime. Për këtë arsye të Qiradhënësi ka vepruar ne keqbesim ndaj Qiramarrësit. Pavarësisht kësaj, veprimtaria e ISHMT-së si institucion në godinën e marrë me qira nuk është cënuar dhe as është kufizuar në asnjë lloj forme konkrete. Lidhur me konstatimin e GA se subjekti i shpallur fitues duhet të përcaktonte pozicionin e hapësirave të parkimit për 4 automjete, bëjmë me dije se parkimi për 4 automjete është ofertuar nga ana e subjektit fitues.

Në lidhje me këtë pretendim, ISHMT nuk ka qenë në dijeni të kufizimit që ka patur godina e marrë me qira, pasi qiradhënësi ka vepruar ne keqbesim ndaj ISHMT. Kodi civil i RSH, në dispozitat për kontratën e qirasë, neni 803 përcakton se kontrata e qirasë për një kohë më të gjatë se një vit duhet bërë me shkresë. Kjo nënkupton faktin që kushti për formën formale të kontratës në mënyrë shkresore bëhet për efekt provueshmërie dhe jo për efekt vlefshmërie të saj. Fakti që kontrata nuk është e noterizuar, apo e lidhur para noterit nuk vë në dyshim pëlqimin mbi kushtet e kontratës, pasi hartimi dhe vendosja e kushteve është pjesë e lirisë kontraktuale të palëve, një e drejtë që e garanton Kodi Civil i RSH, ku shprehet se: Palët kanë të drejtë të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi. Gjithashtu, bazuar në nenin 690 të Kodit Civil, kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se bazuar në nenit 674 të KC, përcaktohet se palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës duhet të sillen në mirëbesim me njëra tjetrën, sqarojmë se nga ana e ISHMT ka patur mirëbesim për sa i përket hartimit të kushteve të kontratës dhe të gjitha dispozitave të tjera të saj, pasi nuk ka qenë në dijeni të asnjë shkaku që do të sillte pavlefshmërinë e saj apo mosplotësimin e kushteve si ofertues të shtetasit A.N. Bazuar në nenin 674 paragrafi 2, pala që ka ditur ose duhet të dinte shkakun e pavlefshmërisë së kontratës (në këtë rast ofertuesi)

dhe nuk ja ka bërë të ditur atë palës tjetër (ISHMT) **detyrohet që të shpërblejë dëmin që kjo e fundit ka pësuar për shkak se besoi pa fajin e vet në vlefshmërinë e kontratës.**
Qiradhënësi duhet që ti dorëzojë qiramarrësit sendin në kohën e caktuar dhe më gjëndje që të lejojë përdorimin për të cilin janë marrë vesh, sipas nenit 802 të Kodit Civil. Për këtë arsye bazuar edhe në parashikimin e bërë në kontratë, Qiradhënësi për periudhën nga data e lidhjes së kontratës deri në datën 1.10.2020, do të bëjë përshtatjen e ambjentit sipas kritereve të rëna dakord mes palëve. Përcaktimi i afatit 6 muaj paradhënie nuk ka shërbyer për mbulimin e shpenzimeve për përshtatjen e godinës siç analizon Grupi i Auditmit. Parashikimi për paradhënien është bërë në bazë të nenit 601 të Kodit Civil, për vërtetimin e lidhjes së kontratës dhe me qëllim që të sigurojë ekzekutimin e saj.
Parashikimi i kryer në pikën 6.7 të nenit 6 të kontratës është në përputhje me nenin 660 të KC si edhe në përputhje me nenin 601 ku parashikohet se kapar quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do të paguhet në bazë të kontratës me qëllim që të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj. Për sa më sipër, dhënia e paradhënies ose kaparit është kusht i përcaktuar në kodin civil dhe si rrjedhojë kusht i ligjshëm i vendosur në kontratë.
Parashikimi i afatit të lidhjes së kontratës për 5 vite është kryer sipas parashikimeve të KC. Gjithashtu edhe për sigurimin e veprimtarisë së institucionit dhe vazhdimësinë për ushtrimin e aktivitetit në të njëjtën godinë. Referuar edhe çmimeve të tregut si edhe tendencës në rritje të tyre për Tiranën, veçanërisht në zonën ku është vendoshja e godinës, ky parashikim mbron ISHMT nga rritja e çmimeve të qirasë.
Në lidhje me këtë pretendimtë konkluduar nga GAsqarojmë se ISHMT ka administruar si dokumentacion që ka paraqitur shtetasi A.N, vetëm dokumentacionin e dorëzuar gjatë procedurës së dorëzimit të ofertave nga ana e ofertuesit. Për sa i përket kufizimit të regjistruar në datën 01.02.2021 me numër referencë 20406 sqarojmë e ISHMT nuk ka detyrim të kërkojë rifreskim të të dhënave të gjëndjes së pasurisë pasi në kontratën e lidhur mes palëve qiradhënësi duhet të garantojë qiramarrësin që prona e dhënë me qira është e lirë nga çdo pretendim nga palët e treta.
Ligjin Nr. 9121/2003 ñPër mbrojtjen e konkurencësò, neni 1 *“ Qëllimi i ligjit Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe institucionet përgjegjëse përmbrojtjen e konkurrencës dhe përgjegjësitë e tyre”,* referenca mbi të cilën bazohet GAnuk është e saktë pasi në këtë ligj përfshihen vetëm ndërmarrjet/subjektet privatë dhe institucionet për mbrojtjen e konkurrencës siç është Autoriteti i Konkurrencës. Për sa i përket referncës së GA mbi nenin 4 të këtij ligji përfshihen marrëveshjet e ndaluara për caktimin e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve në treg nga subjektet private, ose ndarja e pjesëve të tregut she shkelje të tjera që lidhen me marrëdhëniet midis operatorëve ekonomikë. Në asnjë rast shtyrja e afatit për plotësimin e dokumentacionit nga subjekti i shpallur fitues për kontratën e qirasë nuk parashikohet në Ligjin nr.9121/2003 ñPër mbrojtjen e konkurencësò. AK në asnjë rast për sa i përket lidhjes së kontratës së qirasë nuk ka favorizuar ofertues të caktuar, por me veprimet e kryera është munduar të rrisë konkurrencën me një pjesëmarrje sa më të lartë të ofertuesve në treg.
Në pikën 2, 19, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Përmenaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, nuk parashikohen detyrimet e konstatuara nga GA, sa më sipër për marrjen në dorëzim të ambjenteve të ISHMT. Grupi i Marrjes në dorëzim ka vlerësuar referuar Kontratës së Qirasë dhe kqyrjes së godinës së marrë me qira se ajo ishte në përuthje me kriteret e vendosura në kontratë.
GA: Pagesat e kryera në vlerën 1.545,771 lekë (për pasurinë e llojit "Banim" me nr.X + 1-2 (kati i dytë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, sipërfaqe 191.6 m, e cila ka qenë e bllokuar në favor të të tretëve, *do të konsiderohen dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit;*
ISHMT: Për sa më sipër sqarojmë se pas konstatimit nga ana e GA mbi barrën hipotekore të vendosur mbi pasurinë e llojit "Banim" me nr.X + 1-2 (kati i dytë banim), është vërtetuar edhe

nga ana jonë ky fakt, por nuk mund të konsiderohet dëm ekonomik pasi kjo sipërfaqe është shfrytëzuar nga ana e ISHMT-së pa asnjë kufizim. Është e pa qartë cfarë rrugë ligjore do duhet të ndjeke Inspektoriati, sic rekomanduar në projekt raport, për të rekuperuar një shumë për të cilën është marrë shërbimi. Grupi auditimit duhet të përcaktoj bazën ligjorë mbi të cilën Inspektoriati nuk duhet të kryente pagesën apo do duhet tôja bënim atë një pale tjetër. Rekomandimi nuk adreson gjetjen, sepse na rekomandoni që të mos bëjmë pagesa për një shërbim të marrë. Palë të treta mund të ngrenë pretendimet e tyrë ndaj pronarit dhe përdorimit që ai i ka bërë pronës dhe benefitet e nxjerra prej saj, nëse ky është rasti sipas legjislacionit në fuqi.
Kërkojmë të dimë nga grupi auditimit cila është baza ligjore që ndalon pronarin e pronës për të dhënë me qera pronën me barrë hipotekore dhe cilat kushte të saj janë thyer. Edhe një apartament i blerë nga një pronar më kredi bankare ka mbi të barrë hipotekore. Pronari i apartamentit mund ta japë atë me qera, përsa kohë nuk parashikohet ndryshe. Dhe në asnjë moment Qeramarrësi nuk shkakton dëm ekonomik për qeranë e paguar për shfrytëzimin e hapësira që faktikisht ka ndodhur në bazë të një kontrate të ligjshme. Nësë pala e tretë ka pretendime për përftimet nga kjo pronë nga pronari ajo mund ti drejtohet atij, ose nëse e mbështetur në ligj, të kërkoj që pagesat e qerasë të transferohën në emër të saj. Në asnjë rast kjo nuk ka ndodhur.
Bazuar në sa më lart, shuma e vendosur si dëm ekonomik nga grupi i auditimit në vlerë 1,545,771 lekë nuk është e tillë dhe kërkojmë të rishikohet si e pa mbështetur në fakte dhe legjislacionin në fuqi në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
GA: Konstatohet se janë paguar 4,303,094 lekë paradhënie për 6 muaj qera, pa përfituar shërbimin për këtë periudhë (pra të shfrytëzimit të ambjenteve) dhe në mungesë të miratimit paraprak të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 156 dhe 160 të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò.
ISHMT: Ky konstatim i bërë nga GA, i cili nuk e ka klasifikuar në gjetje rekomandime me të drejtë sepse nuk ka thyerje të përputhshmërisë, është marrë në konsideratë për nga ndikimi pozitiv dhe nga Inspektoriati janë marrë të gjitha masat mbi rregullimin e mardhënies juridike të qirasë mes ISHMT-së dhe qiradhemësit Z. A.N, duke kompensuar paradhënien me pagesën e qirasë mujore deri në muajin Dhjetor 2021. Për këto hapa do të dokumentohen në mbarim të periudhës 6- muaj qera për të cilën është mbajtur nga pagesa e kryer si Paradhënie.
Sqarojme së kontrata e qirasë e lidhur mes Z.A.N si qiradhënës dhe ISHMT-së si qiramarrës është lidhur më afat 5-vjecar për efekt sigurie të vazhdimësisë së veprimtarisë së institucionit në një ambient stabël dhe sigurimin e vazhdimësisë së ushtrimit të aktivitetit të institucionit në këtë ambient. Vlera e kontratës së qirasë nuk është e buxhetuar pranë degës së thesarit për periudhën 5 vjecare.
Sipas udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò Detajimi i fondeve buxhetore **pika 54** ñNëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qëndrore mbështetur në informacionin e marrë nga Nëpunësi i Parë Autorizues, krahasojnë buxhetin e planifikuar me buxhetin e miratuar për njësinë që mbulojnë, dhe organizojnë procesin e detajimit të fondeve për organin qëndror dhe për njësitë evartësisë. Si dhe **pika 55**: ñNëpunësit autorizues të nivelit të dytë, për njësitë e vartësisë direkt nga Titullari e krahasojnë buxhetin e miratuar, të dërguar nga nëpunësi autorizues me buxhetin e planifikuar dhe bëjnë rregullimet përkatëse në rastet kur ka ndryshime f.bëjnë detajimin e buxhetit vjetorsi edhe të tavaneve për dy vitet e tjera buxhetore të miratuara në ligjin e buxhetor vjetor,për të gjitha nivelet e njësisë shpenzuese që drejtojnë (nëse ka nivele të tjera vartësie), sipas klasifikimit buxhetor deri në nivel artikulli dhe e dërgojnë zyrtarishtdhe nëformëelektroniketek nëpunësi autorizuesò.
Në kontratën e lidhur mes palëve nuk ka asnjë kusht penalizues për ISHMT-në si qiramarrëse për zgjatjen e kontratës apo prishjen e saj, pasi në dispozitat e kontratës është favorizuar institucioni, si dhe janë parashikuar si raste për prishjen e kontratës, me lajmërimin 1 muaj para.
Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së:

-Lidhur me argumentin tuaj se në nenet 5, 8, pika 4 të nenit 9 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, nuk pasqyrohet detyrimi që titullari i ISHMT duhet të nxjerrë urdhër të brendshëm për të përcaktuar procedurën e marrjes me qera, sqarojmë se është e pakuptueshme që ju si nëpunës publik të kërkoni që në referencat ligjore të mësipërme, të bëhet një përcaktim shprehimisht siç e kërkoni ju;
ISHMT është një institucion publik, që menaxhon fonde buxhetore, ku për menaxhimin e tyre ka disa akte ligjore dhe nënligjore. Ne i jemi referuar aktit ligjor që prevalon nga fuqia juridike mbi VKM që citoni ju për organizimin dhe funksionimin e ISHMT;
Jemi përball ndërmarrjes së një angazhimi financiar, për të cilin nuk ka një bazë ligjore të posaçme që disiplinon kryerjen e veprimeve hap pas hapi;
Ky angazhim financiar i ndërmarrë nga ju është për herë të parë, pra mungon eksperienca e mëparshme;
Nga buxheti i shtetit u janë akorduar fonde financiare, të cilat do të përdoren për marrjen e një objekti me qira, me qëllim që ju të realizoni punën tuaj në kushte normale, e rrjedhimisht të mos pengoheni në realizimin e objektivave institucional.
Me qëllim që kjo procedurë të jetë e disiplinuar, burimet financiare ti shërbejnë qëllimit dhe të shmanget mundësia për abuzim me këto fonde, ekziston një Ligj, i cili është ai i menaxhimit financiar dhe kontrollit (ligj i detyrueshëm për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, OJF, shoqëri tregtare, etj), i cili ka si qëllim: përdorimin sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.
Që të arrihet qëllimi i mësipërm përgjatë ligjit janë përcaktuar disa detyrime që duhen zbatuar nga Titullarët e Institucioneve, Drejtuesit e Drejtorive, etj..., nga të cilat kemi cituar neni 5, 8, pika 4 e nenit 9 të këtij ligji.
Konkretisht në nenin 5 përcaktohet:

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem **politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh**, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëritë shërbimeve publike. Ky **sistem vendoset,** ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në **zbatim nga i gjithë personeli,** me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet: a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi; b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat; c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota; ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Sa më sipër këto procedura, politika, veprimtari, kontrolle, sipas jush si mund të vihen në zbatim? Ju jeni duke kryer një veprimtari e cila kërkon përdorim të fondeve buxhetore (aktive jomateriale), të cilën nuk e keni kryer më përpara dhe në këto kushte është e nevojshme që Titullari i institucionit të nxjerrë akte të brendshme për zbatimin e tyre.
Neni 8:

1. Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, **përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.**
4. Në rast moscaktimi të nëpunësit autorizues, përgjegjshmëria menaxheriale dhe përgjegjësitë, sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji, i takojnë titullarit të njësisë publike.
5. Drejtuesit e të gjitha niveleve të njësive të varësisë i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, deri tek titullari i njësisë publike, dhe janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe

zbatimin e përgjegjësive të caktuara nga titullari, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.
8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:
a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planveprimeve për arritjen e objektivave;
b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;
c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit;
ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave;
d) propozimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon ndryshe;
dh) rregullimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë funksionale të tij;
e) futjen e procedurave antikorrupsion, bazuar në legjislacionin në fuqi;
ë) sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Si përdoren fondet publike në mënyrë të ligjshme me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet? Llogjikisht dhe ligjërisht duke nxjerrënjëurdhër të brendshëm, ku të përcaktohen qartëhapat e procedurës, lloji i objektit që do të merret me qera, hapësirat, afati i qiramarrjes, mënyrën e përllogaritjes së fondit limit, mënyrën e përcaktimit të kritereve dhe specifikimeve teknike, etj., ku theksojmë përsëri se, nuk ekziston një bazë ligjore që disiplinon këtë procedurë dhe hapat e mësipërme. Pra është e nevojshme nxjerrja e një urdhëri, i cili mbështetet në përcaktimet ligjore të bëra në ligjin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Neni 9:

4. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:
a) propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike **të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë,** të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi;
b) hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuar nga titullari i njësisë publike;
c) monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë që menaxhojnë;
d) planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së njësisë publike;
dh) **mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional për menaxhimin financiar dhe kontrollin;**
ë) përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar;

-Pra janë të qarta detyrimet ligjore që ka titullari i ISHMT, sipas ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, dhe jo vetëm për këtë procedurë, por për gjithë veprimet e institucionit (rregullore e brendshme, menaxhimi i aktiveve materiale dhe jomateriale, komunikimi, raportimi, veprimtaria juaj e përditshme, qoftë edhe inspektimi, pasi për kryerjen e këtij funksioni

shpenzohen fonde buxhetore, përdoren burime njerëzore dhe materiale, etj.,) të cilat kërkojnë menaxhimin në mënyrë të ligjshme, me efektivitet, ekonomicitet dhe eficencë.

Observacioni i bërë për këtë konstatim nuk merret në konsideratë.

-Lidhur me referimin e nenit 7 të Ligjit për prokurimin, sqarojmë se një akt administrativ referon një bazë ligjore[13] që mbështet urdhërimin e kryerjes së një veprimi dhe zbatimin e tij, dhe jo një bazë ligjore që përjashton. Ju jeni duke ushtruar një të drejtë tuajën, nxjerrjen e një urdhëri për marrjen me qera të ambienteve për zyra[14], për të cilin duhet të respektohen elementët e formës dhe përmbajtjes[15].

Observacioni i bërë për këtë konstatim nuk merret në konsideratë.

-Është e vërtetë që në asnjë akt ligjor nuk përcaktohet marrja e ofertave nga 3 operatorë, pasi nuk ka një akt ligjor/nënligjor që të përcaktojë procedurën e qeramarrjes nga institucioni publik-privat, dhe pikërisht është e nevojshme nxjerrja e urdhërit të titullarit që të përcaktojë mënyrën e veprimit në çdo fazë të procedurës. Përdorimi me ekonomicitet i fondeve publike (detyrim ligjor),

Pika 23 në nenin 3, të Ligjit nr.9936, datë 26.08.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetorò, i ndryshuar, përcakton:

ñPërdorim me ekonomiò është përdorimi i një sasie dhe cilësie të dhënë të inputeve në një kohë të dhënë dhe me koston më të ulët.

shkronjën ñçò të nenit 4, të ligjit të mësipërm:

Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë:

ç) përdorimi ekonomik, efiçent dhe efektiv i burimeve publike;

shkronjën ñbò të nenit 19, të ligjit të mësipërm:

Neni 19 Nëpunësi autorizues

Përgjegjësitë për menaxhimin financiar përfshijnë, por nuk kufizohen me:

b) sigurimin e përdorimit me efiçencë, efektivitet dhe ekonomi të burimeve publike që ai menaxhon. Nëpunësi autorizues vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Pra sipas jush si mund të arrihet kosto më e ulët, duke bërë një studim sa më gjithëpërfshirës, duke marrë më tepër oferta.

Argumentoni se juridikisht ofertat e paraqitura nuk mund të arsyetohen sikur janë vetëm nga një operator pasi agjensia imobiliare nuk është pronari i pronave, por i përkasin subjekteve fizike dhe juridike të ndryshme, mirëpo nuk citoni asnjë referencë ligjore për argumentin tuaj.

Observacioni i bërë për këtë konstatim nuk merret në konsideratë.

-Për referimin e pikës 2 dhe shkronjave ñcò dhe ñdò tëVKM nr.469, datë 03.06.2015, po i pasqyrojmë si vijon:

2. Në asnjë rast, vlera e dhënies me qira të ndërtesës, sipas pikës 1, të këtij vendimi, nuk do të jetë më e vogël se vlera minimale e qirasë, e përcaktuar në këtë vendim. Vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, e përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, ñPër miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesaveò, që miratohet çdo vit. Shembujt e zbatimit të këtij vendimi pasqyrohen në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Për dhënien me qira të ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, në qytetin e Tiranës, vlera minimale e qirasë mujore, për 1 m^2 sipërfaqe ndërtimi, përcaktohet, si më poshtë vijon:

c) Për 1m^2 sipërfaqe për zyrë dhe magazinë, vlera minimale e qirasë mujore është e barabartë me vlerën minimale të qirasë mujore për 1m^2 sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës;

d)Për 1m^2 sipërfaqe bodrumi, vlera minimale e qirasë mujore është 70 për qind e vlerës minimale të qirasë mujore për 1m^2 sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës;

---

[13]Shkronja ñaò neni 11 të Ligjit nr.44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò

[14] Pika 3, neni 3 të Ligjit nr.44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò

[15]Pika 2 në nenin 99 të Ligjit nr.44/2015 ñKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisëò

-Sa më sipër ku qëndron referimi i gabuar nga grupi i auditimit dhe përllogaritja e bërë. Theksojmë edhe njëherë argumentin që kemi dhënë edhe në Projekt Raportin e Auditimit, pra nga grupi i auditimit është përmendur që ky akt nënligjor nuk është marrë në referencë nga një institucion publik që menaxhon fonde të buxhetit të shtetit. Ky akt nënligjor përcakton se si llogariten çmimet e qerasë sipas zonave. Mos referimi i këtij akti nënligjor, **nuk cenon mënyrën e përllogaritjes apo vlerën e përcaktuar prej jush**, pasi në të kundërt do kishte të tjera konstatime të grupit të auditimit. Është përmendur **me qëllim të vlerësimit të mundësive** të kursimit të fondit. **Në asnjë rast grupi i auditimit nuk është shprehur se çmimi/m^2 duhet të ishte 711,45 lekë.** Që ju të jeni të qartë marrja e 3 ofertave, referimi i këtij akti nënligjor, është cituar me qëllim vlerësimin e mundësisë së kursimit të fondeve buxhetore nga ana juaj. Pra do të ishte më e drejtë nga ju, nëse do të ishte bërë një përllogaritje e tillë dhe më pas të arrihej në përfundimin se, duke iu referuar kësaj VKM, dhe kërkesave për ambjentin me qera, është e pamundur praktikisht të sigurohet një ambient i tillë me çmimin 711,45 lekë.

-Pra nuk jeni ngarkuar me përgjegjësi për sa më sipër. Sqarojmë se nuk jeni ngarkuar me përgjegjësi se keni përzgjedhur një çmim të tillë për marrjen me qera të godinës për zyra, pasi jemi të vetëdijshëm që këto çmime i përcakton tregu, sipas ekuilibrit kërkesë-ofertë.

-Termi ñminimalò është korrigjuar dhe është bërë ñmesatarò, në fazën e përgatitjes së Projekt Raportit të Auditimit, dhe nuk ka arsye të observohet përsëri.

-Sa i përket arsyetimit tuaj për hapësirën për 1 punonjës, ju mund të kërkoni që 1 punonjës ta ketë hapësirën e zyrës edhe 20 apo 30 m^2, por duke patur në konsideratë që rritja e hapësirës ndikon në rritjen e shpenzimeve dhe përdorimin me ekonomicitet të fondeve publike, vlerësohet realisht hapësira e nevojshme që duhet për një punonjës. Për më tepër, ju në përllogaritjen e hapësirës, **keni cituar praktika të mira**, ndërkohë qënë dosjen e kësaj procedurënuk kishte asnjë praktikë të mirë, **por edhe në osbervacionin e sjellë nga ju nuk kishte një praktikë të mirë të referuar**. Gjithashtu veç praktikave të mira, për përllogaritjen e hapësirës për 1 punonjës, keni pasqyruar se duhet kjo hapësirëpër ruajtjen e mostrave të marra në inspektim apo produkteve të rrezikshme për shkatërrim, pajisjeve laboratorike dhe kiteve për inspektim, **produkte të cilat nuk mund të mbahen nëpër zyra**, por në ambjente të posaçme, magazinën e institucionit. Pra sipas jush, inspektori në zyrën e tij mund të mbajë edhe produkte të rrezikshme.

-Sa më sipër në kushtet kur nga ju nuk është sjellë dokumentacion justifikues mbi praktikat e mira të referuara prej jush, si dhe pabazueshmërinë ligjore që një punonjës në zyrën e tij duhet të ketë hapësirë të nevojshme për ruajtjen e mostrave të marra në inspektim apo produkteve të rrezikshme për shkatërrim, pajisjeve laboratorike dhe kiteve për inspektim,**observacioni i bërë nga ju për këtë konstatim nuk merret në konsideratë.**

-Sa i përket argumentit tuaj të cilin e keni mbështetur në pikën 4 të nenit 56 tëLigjit nr.44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative në RSHò, sqarojmë se referuar përcaktimit të bërë në nenin 53:

Neni 53 Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale

1. Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim ñafatet proceduraleò, **përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.**

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, **organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.**Për të vazhduar me atë që përcaktohet në **parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, neni 4:**

Neni 4 Parimi i ligjshmërisë

1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara **dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë**, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale **nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ**, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.
Sa më sipër afatin për kryerjen e veprimeve e kushtëzon përcaktimi i bërë nëpikat 1 dhe 2 të Kreut I dhe pikën 1 të Kreut II të nr.511, datë 24.10.2002 ñpër kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetëroreò, të ndryshuar, pasi sipas urdhërit, punonjësit e ISHMT duhet të paraqiten në punë ditën e dielë për vlerësimin e ofertave, çka do të thotë se në këtë mënyrë të drejtat e punonjësve tuaj për kryerjen e pushimit, cenohen.
-Pra kuadri ligjor e ka të përcaktuar qartë, afatin për veprimet procedurale, duke u bazuar në parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. Në këto kushte **observacioni i bërë për këtë konstatim nuk merret në konsideratë.**
-Jeni shprehur se për pretendimet se në çdo kat nuk ka tualete të ndara për meshkujt dhe femrat, sqarojmë se nuk pretendojmë, por konstatojmë dhe verifikojmë, ashtu siç është kryer verifikimi i godinës në praninë e titullarit të institucionit dhe drejtorit të drejtorisë së mbikëqyrjes së produkteve, dhe rezultoi se kati i 4-Pasuria e llojit ñBanimò me nr.x + 1-4 (kati i katërt banim) ZK x, vol x, faqe x, datë 15.10.2014, marrë me qera 191.6 m^2, ka vetëm një tualet.
-Rrugët dhe daljet e emergjencës dhe përshtashmëria e mjediseve të punës, nëse është e nevojshme, që të marrin parasysh nevojat e punëmarrësve me aftësi të kufizuar, detektorët dhe sistem alarmi për zjarret, certifikatën e sigurisë nga zjarri, projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, janë element tësigurisë dhe shëndetit në punë dhe që çdo institucion duhet ti sigurojë, në përputhje me kërkesat e bëra nënenin 37 të Ligjit nr.152/2015 ñPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtiminò dhe përcaktimet e bëra në Shtojcën e VKM nr.521, datë 6.8.2014 ñPër miratimin e rregullores ñpër kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqësò, VKM nr.564, datë 3.7.2013 ñPër miratimin e rregullores ñpër kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punësò. Për më tepër këto i keni parashikuar edhe nëpikën 5.7 të nenit 5 të kontratës ñAmbienti i dhënë me qira duhet të ofrojë kushtet që plotësojnë kërkesat në përputhje me legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punëò, pra sipas jush kush është legjislacioni përkatës dhe çfarë kërkon ai.
-Lidhur me argumentin tuaj se kushtet për rrugët dhe daljet e emergjencës, kushtet për punëmarrësit me aftësi të kufizuara, sistemet e zbulimit dhe të shuarjes së zjarrit si edhe certifikatën e sigurisë së zjarrit, janë kritere të cilat plotësohen para kolaudimit të objektit në ndërtim, nuk qëndron për arsye se kjo është një godinë banimi dhe akti i kolaudimit është bërë për një godinë banimi dhe jo godinë social-ekonomike, ku të ofrohen shërbime publike/jopublike, pra nuk mund të shprehet akt i kolaudimit se godina e banimit plotëson kriterin për punëmarrësit me aftësi të kufizuara.
Observacioni i bërë për këtë konstatim nuk merret në konsideratë.
-Lidhur me kohëzgjatjen e kontratës, theksojmë edhe njëherë se ju jeni institucion buxhetor, dhe si i tillë në veprimtarinë tuaj kushtëzoheni nga buxheti që ju akordohet, të cilin siç e kemi referuar edhe ligjërisht në trajtimin e çështjes, parashikohet për një periudhë deri në 3 vite. Pra sipas përcaktimeve ligjore nënenin 23 dhe 26 (shkrimi ñBoldò) të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, thuhet që
Brenda muajit janar, ministri i Financave paraqet, për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, raportin për vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike për:
a) dy vitet përpara vitit buxhetor;
b) vitin buxhetor;
c) tre vitet e ardhshme buxhetore.
Në këtë raport përfshihen:
a) supozimet dhe mënyrat e përdorura për vlerësimin e parashikimin makroekonomik dhe fiskal, përfshirë edhe identifikimin e vlerësimin e riskut për qëndrueshmërinë e stabilitetit makroekonomik të vendit;

b) vlerësimet më të fundit të situatës ekonomike, në bazë të të dhënave zyrtare, si dhe krahasimin me parashikimet e mëparshme;
c) parashikimin për të ardhurat e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të politikave ekzistuese dhe të propozimeve të politikave të reja apo ndryshi-meve të atyre ekzistuese;
ç) parashikimin për shpenzimet e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të politikave ekzistuese dhe propozimeve për politika të reja apo ndryshimeve në politikat ekzistuese;
d) parashikimin për deficitin e qeverisjes së përgjithshme dhe financimin e tij, duke respektuar dhe garantuar disiplinën dhe qëndrueshmërinë fiskale;
dh) informacion të hollësishëm për stokun e borxhit, të brendshëm dhe të jashtëm, për çdo sektor të qeverisjes së përgjithshme.
Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike të miratuara, ministri i Financave **përgatit tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm** dhe i dërgon për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave brenda muajit shkurt.
Neni 26
Programi buxhetor afatmesëm pasqyron shpërndarjet e buxhetit afatmesëm të njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilat përllogariten në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara në udhëzimin përkatës të ministrit të Financave.
Programi buxhetor afatmesëm përmban:
1. Një përmbledhje të treguesve kryesorë makroekonomikë dhe buxhetorë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave, si pjesë e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm.
2. Një raport përmbledhës të politikave ekonomike dhe fiskale për tre vitet e ardhshme.
3. Një raport të detajuar për kërkesat buxhetore, të paraqitura nga njësitë e qeverisjes qendrore, brenda tavaneve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe për kërkesat shtesë.
4. Tërësinë e dokumentacionit të dërguar nga njësitë e qeverisjes qendrore, sipas formateve standarde, i cili duhet, minimalisht, të përmbajë: qëllimet e politikave të programeve, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre respektive.
5. Një raport përmbledhës të konkluzioneve të seancave dëgjimore, ndërmjet njësive të qeverisjes qendrore dhe shoqërisë civile, zhvilluar në kuadër të përgatitjes së kërkesave buxhetore.

Pikën 156 të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò
Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme ose **nëpunësi autorizues i nivelit të dytë** sipas rastit merr përsipër detyrimin për të gjitha llojet e shpenzimeve, nënshkruan kontratën dhe/ose urdhrin e prokurimit për blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla. Pra merrë përsipër shpenzimet, të cilat sipas Ligjit të mësipërm janë të parashikuara deri në vitin 2022. Siç edhe vet ju e keni referuar nenin 660 të Kodit Civil, kuptohet se përmbajtja e **kontratës kushtëzohet nga legjislacioni në fuqi.**
Observacioni i bërë për këtë konstatim nuk merret në konsideratë.
-Sigurimi i kontratës bëhet për favorin e ISHMT dhe jo të qiradhënësit (pra në llogarinë e ISHMT depozitohet një shumë monetare, e cila qëndron aty deri në fund të zbatimit të kontratës. Ju në kontratë keni përcaktuar disa detyrime ndaj pronarit të objektit, pra që ju të siguroheni se të gjitha detyrimet do të përmbushen nga pronari i objektit, duhet ti siguroni ato nëpërmjet një police sigurimi.Shuma monetare që ju keni parapaguar në avanc është në kundërshtim me përcaktimet ligjore të cilat i kemi pasqyruar në trajtimin e çështjes më sipër, dhe ajo shumëështë në favor të pronarit të objektit dhe jo tuajin (Neni 1113, shkronja ñaò, neni 1114, neni 1115 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 ñPër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisëò). Për më tepër që ju në kontratënë **pikën 6.7 të nenit 6** të saj, keni parashikuar që qiramarrësi **detyrohet** që të **parapaguajë** paradhënie qiradhënësit, në vlerën e **6 muajve** të qerasë, në momentin e lidhjes së

kontratës, **për të kryer rregullimet e nevojshme** për tôju përshtatur kërkesave të qiramarrësit, pra për çfarë sigurimi flisni ju.
Observacioni i bërë për këtë konstatim nuk merret në konsideratë.
-Lidhur me deklaratat e konfliktit të interesit, merret në konsideratë argumenti dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
-Sa i përket argumentit tuaj se shtetasi A.N ka bërë ankesë dhe prandaj i kemi ndryshuar kriteret dhe afatin, siç e kemi trajtuar edhe më sipër, ky shtetas nuk ka bërë ankesë, por njëkërkesë, ku nëse i referohemi Kodit të Procedurës së Administrative (ku jeni në një të tillë) për formën, përmbajtjen, afatin e paraqitjes së saj, dhe arsyetimin, parashtrojmë si vijon:
Neni 44 Fillimi i procedurës administrative me kërkesë
2. Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, **legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji** dhe në përfundim:
a) **njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa është pranuar për vazhdimin e procedurës – Ju se keni bërë këtë;**
KREU V
AFATET Seksioni 1
Afatet e veprimeve procedurale për palët, shtyrja dhe rivendosja në afat
Neni 53 Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale
3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, **ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar**, të paraqitur përpara mbarimit të afatit ï Në këtë rast cili është justifikimi i kërkesës së palës, pasi shtetasi në fjalë ka paraqitur kërkesën me pretendimin se më janë kërkuar dokumente shtesë (të cilat nuk janë pasqyruar në kërkesën e tij, se cilat dokumente shtesë i janë kërkuar), dhe se ato nuk ishin të pasqyruara në njoftimin e bërë në Gazetën ñDò, por nga verifikimi që bëri grupi i auditimit, çdo kërkesë për dokumentacion që ishte përcaktuar si kriter fitues deri në datën qëështë paraqitur kërkesa nga shtetasi, ishte publikuar edhe në njoftimin në gazetë, çka do të thotë se kërkesa e personit të mësipërm nuk duhet të ishte marrë në konsideratë, por duhet të ishte refuzuar menjëherë për mosplotësim të dokumentacionit.

Neni 58 Forma dhe përmbajtja e kërkesës
2. Kërkesa duhet të jetë **mjaftueshëm e qartë për të përcaktuar** kërkuesin dhe **qëllimin e saj**, përveçse kur ligji parashikon një përmbajtje të caktuar.

Neni 65 Verifikimi paraprak përpara fillimit të procedurës administrative
Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:
a) nëse të drejtat apo interesat e kërkuara nga palët janë subjekt i ndonjë kufizimi kohor ï **ju nuk e keni bërë këtë;**
b) legjitimimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative ï **ju nuk e keni bërë këtë.**

Neni 82 Barra e provës
1. Në procedurat administrative, **të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën**, **barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë**, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj ï Nga shtetasi që ka bërë kërkesën nuk është pasqyruar asnjë provë që të përligjë kërkesën e tij, pra të specifikonte se një dokument i caktuar që i është kërkuar në momentin e dorëzimit të ofertës nuk ka qenë i publikuar në gazetë.
3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund tôi bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative **dokumente ose fakte të ndryshme**.

Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.
-Lidhur me përdorimin e qetë të objektit pa pasur asnjë lloj shqetësimi, sqarojmë edhe njëherë se ne auditojmë mbi bazë dokumentash, të cilat në këtë rast për një prej pasurive, si dhe referuar nenit përkatës të kontratës, nuk garanton gëzimin e qetë të pasurisë në fjalë. Ju vetë jeni shprehur se pala tjetër është sjellë në keqbesim ndaj jush dhe në këto kushte detyrohet që të shpërblejë dëmin që kjo e fundit ka pësuar për shkak se besoi pa fajin e vet në vlefshmërinë e kontratës. Pra kur edhe vetë shpreheni atëherë përse kërkohet nga ju baza ligjore për kthimin e shumës së paguar për një nga pasuritë e marra me qira. Në vijim ju risjellim në vëmendjen tuaj përcaktimet ligjore të bëra në:
1. Pikën 5.1 të nenit 5 të kontratës, i cili është shprehur se: ñProna është e lirë nga çdo lloj barre dhe hipoteke, detyrimi ose çdo lloj garancie, pengese që i është vënë asajò, ndërkohë ka qenë e kundërta.

2.Neni 674
Palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës. **Pala që ka ditur, ose që duhej të dinte shkakun e pavlefshmërisë së kontratës dhe nuk i'a ka bërë të ditur atë palës tjetër, detyrohet të shpërblejë dëmin që kjo e fundit ka pësuar**, për shkak se besoi pa fajin e vet në vlefshmërinë e kontratës.

3.Neni 675
Në rast se një palë kontraktuese **disponon njohuri profesionale** dhe pala tjetër i ngjall asaj besim të plotë, **e para ka detyrim t'i japë asaj me mirëbesim, informata e udhëzime –** Ju jeni institucion publik që dispononi njohur profesionale, dhe ndërkohë duhet ta kishit informouar pronarin e objektit për mangësitë në dokumentacionin e objektit, por që nuk e keni bërë.

Shkaku i paligjshëm
4.Neni 677
Në një kontratë, shkaku ligjor është i paligjshëm **kur vjen në kundërshtim me ligjin,** rendin publik, **ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme –** Kontrata e lidhur nga ISHMT është në kundërshtim me ligjin,prapikën 1 të VKM nr.469, datë 03.06.2015 ñPër përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimoreò, si dhe keni shmangur zbatimin e një norme, pra detyrimin për noterizimin e kontratës dhe dhënien e fuqisë ligjore të saj.

5.Neni 802 Qiradhënësi duhet:
1. tõi dorëzojë qiramarrësit sendin në kohën e caktuar dhe në gjendje që të lejojë përdorimin për të cilën palët janë marrë vesh;
2. të kujdeset për të mbajtur sendin në po këtë gjendje;
3. të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë.

4.Neni 806-Në qoftë se në kohën e dorëzimit, sendi i dhënë me qira cenohet nga të meta që ulin në mënyrë të dukshme vlerën e përdorimit të kontraktuar, qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, ose zbritjen e çmimit të qirasë, përveç kur ai ka patur dijeni për të metën ose ajo është lehtësisht e dallueshme.
Qiradhënësi është i detyruar t'i paguajë qiramarrësit dëmet e ardhura nga veset e sendit, në qoftë se nuk provon se, pa patur faj, nuk ka patur dijeni për këto vese në momentin e dorëzimit.

6.Neni 807-Marrëveshja, me të cilën përjashtohet ose kufizohet përgjegjësia e qiradhënësit për veset e sendit, nuk ka efekt në qoftë se qiradhënësi **ia ka fshehur me keqbesim qiramarrësit ato, ose kur veset janë të tilla që të pengojnë gëzimin e sendit.**

Në Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil në RSHò
7.Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò
Pika 35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:
a) **Dokumente autorizuese** - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i **bashkëlidhet dokumentit vërtetues**. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit,
etj.
b) **Dokumente vërtetuese - vërtetojnë kryerjen në fakt**, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.
36. Dokumentacioni quhet i rregullt **kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen**, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin **dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative**. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve.
Theksojmë se KLSH auditon dhe shprehet mbi bazën e dokumentacionit, që në këtë rast ka patur mangësitë e konstatuara në çështjen përkatëse. Grupi i auditimit nuk ka ndejtur dy vjet pranë zyrave të ISHMT dhe çdo ditë ka bërë verifikimin nëse ky kat është shfrytëzuar qetësisht dhe plotësisht nga ISHMT. Këtë e garanton dokumentacioni, i cili në këtë rast pasqyron se ky kat është dhënë peng në favor të të tretëve.
-Lidhur me procedurën e marrjes në dorëzim, edhe njëherë parashtrojmë, referuar përcaktimeve ligjore:
-Në pikën 2 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, specifikohet:

Të gjitha njësitë e sektorit publik kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme **për dokumentimin,** mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Sa më sipër si është dokumentuar nga ju vendparkimi për 4 automjete, distanca nga MFE, ambjentin e magazinës në podrumin e objektit, pasi është një pjesë e të gjithë katit të podrumit, si e verifikuat ju që ambienti i magazinës është 33.6 m^2?

Pikën 19**:**

Aktivet duhet të menaxhohen njësoj si çdo pjesë tjetër e punës së njësisë, **që do të thotë se duhet të ekzistojnë sistemet e kontrollit** dhe informimit për të provuar nëse mjetet monetare janë shpenzuar me efiçencë, efektivitet dhe ekonomi.

Cilat janë për ju sistemet e kontrollit të aktiveve?

Pikën 21

Për identifikimin e risqeve të lidhura me aktivet për ndodhitë e mundshme, duhet të përdoret më shumë se **një burim informacioni (dokumenti i sjellë nga fituesi i kontratës)** Risku identifikohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme: a) Shqyrtimi i dokumentacionit c) Survejimet (inspektimet) fizike;

Pikën 36

Dokumentacioni quhet i rregullt kur **përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen**, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, **treguesit sasiorë** dhe ato

të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Pikën 42

Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për **sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre** dhe të **dokumentacionit shoqërues.**

Pikën 47

Në çdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të **dhënat e verifikuara** dhe mospërputhjet me faturën dhe kushtet e kontratës, nuk i merr në dorëzim, por i mban në ruajtje në po ato kushte që mban aktivet e veta, dhe njofton shitësin për t'i tërhequr duke përcaktuar dhe afatin kohor sipas rastit (brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësia publike në marrëdhënie me furnitorin).

-Sa i përket argumentit tuaj se përse nuk e kemi klasifikuar si gjetje dhe më pas dhënien e rekomandimit në fazën e Projekt Raportit, për konstatimin e pagesës së paradhënies 6 muaj, ju lutemi referojuni publikimeve (akte nënligjore, manuale të auditimit) në faqen zyrtare të institucionit të KLSH, www.klsh.org.al, ku do të kuptoni se komunikimi i gjetjeve dhe rekomandimeve është një proces që zgjat deri në përgatitjen e raportit përfundimtar të auditimit. Gjithashtu referuar dokumenteve të punës së audituesit të KLSH (manual i auditimit të përputhshmërisë, rregullore e procedurave të auditimit) do të kuptoni se për gjetje të ndryshme mund të jepen rekomandime të ndryshme me karakter përmirësim ligjor, organizativ, shpërblim dëmi, eliminimin e efekteve negative financiare, disiplinore, etj;
-Sa i përket pyetjes tuaj se si do të zbatohet rekomandimi për arkëtimin e dëmit ekonomik, sqarojmë se grupi i auditimit në formatin e rekomandimit, mbështetet në përcaktimet e bëra në pikën 10 të nenit 29 të Rregullores së Procedurave të Auditimit, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.107, datë 08.08.2017, i ndryshuar me vendimin nr.63, datë 22.06.2020, ku përcaktohet se:Rekomandimet duhet tõju përgjigjen pyetjeve: Çfarë duhet bërë-arkëtimi i dëmit?; Kush duhet ta bëjë-ISHMT? Dhe kur duhet të bëhet-Menjëherë?

Tenderi "Blerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim", viti 2020

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Blerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim		
Urdhër prokurimi nr.92, datë 03.07.2020 Lloji i procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozim	Hartuesit e dokumenteve të tenderit: Urdhër nr.92, datë 03.07.2020, z. E.S me detyrë Inspektor; z. A.H, me detyrë Inspektor; z. E.L, me detyrë Inspektor	Komisioni i vlerësimit të ofertave: Urdhër nr.100 datë 09.07.2020 z. J.Ll, Kryetar z. L.L, Anëtar z. G.N, Anëtar
Fondi limit (pa TVSH) 5,000,000 lekë	Oferta fituese pa TVSH: 4,919,000 lekë	Diferenca me fondin limit (pa TVSH): +81,000 lekë
Data e hapjes së tenderit: 08.07.2020	Burimi i financimit: Buxheti i shtetit	Operatorët Ekonomike: L.B shpk N.V shpk Sõkualifikuar: L.B Kualifikuar: N.V
Ankimime	Përgjigje e ankesës	Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP
Nga subjekti L.G shpk datë 15.07.2020, tërhequr nga ankesa më		

datë 16.07.2020 me shkresën nr.1321/4		
Nga subjekti L.B shpk datë 15.07.2020, tërhequr nga ankesa më datë 16.07.2020 me shkresën nr.1321/5		
Zbatimi i kontratës së mallrave		
Lidhja e kontratës Nr.1321/11, datë 24.08.2020	Vlera e kontratës me TVSH: 5,902,800 lekë	Likujduar deri në dt: 19.10.2020
Fatura: Nr.89214702, datë 11.09.2020 4,919,000 lekë pa TVSH 5,902,800 lekë me TVSH	Afati i kontratës në ditë: 20 ditë	
Akti i marrjes në dorëzim: Nr.1908/1, datë 11.09.2020	Fletë hyrja nr.12, datë 06.10.2020	

Titulli i Gjetjes	**Tenderi "Pajisje dhe instrumenta për inspektim", viti 2020**
Situata	-Personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit me Urdhrin nr.25, datë 10.02.2020 të Titullarit të AK, nuk është pjesë e njësisë së prokurimit, për të cilën mban përgjegjësi z. L.S, Kryeinspektori i AK; -Në komisionin e marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara, nuk ka qenë anëtar, personi me përgjegjësi materiale në ISHMT, pra magazinieri i institucionit. Për këtë mbanë përgjegjësi z.L.S, Kryeinspektori i ISHMT; -Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk administrohen fizikisht ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, theksojmë se ato janë në sistemin elektronik të prokurimit. Për këtë mbanë përgjegjësi njësia e prokurimit, z. E.S, z. A.H, z. E.L. -Nuk administrohet argumentimi i AK për përzgjedhjen e operatorëve ekonomik, të cilëve u ka drejtuar ftesën për ofertë, për të cilën mbanë përgjegjësinjësia e prokurimit, z. E.S, z. A.H, z. E.L. **<u>Vlerësimi i ofertës së shpallur fituese, nga operatori ekonomik "N.V" shpk:</u>** Nga verifikimi i kryer në sistemin e Agjencisë Prokurimit Publik (APP), të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik, i shpallur fitues[16] konstatohet se ky i fundit nuk ka përmbushur kërkesat e kapacitetit teknik dhe specifikimet teknike për mallrat, të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht: -Dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së procedurës ï Procedura është shpallur më datë 06.07.2020, pra dëshmit e kërkuara duhen që nga muaji Korrik i vitit 2017, ndërkohë ato janë sjellë për periudhën nga muaji Janar i vitit 2018 ï Mars 2020, pra për periudhën e mbetur të vitit 2017, nuk ka sjellë dëshmi për furnizime të ngjashme, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 2.3 ï Kapacitete Teknike ñPër të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së procedurësò, e cila është shpallur më datë 06.07.2020 me nr., REF-64283-07-06-2020. Pra sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.3, si dhe referuar datës së publikimit të procedurës 09.07.2020 ï 09.07.2019 (1 vit) ï 09.07.2018 (2 vite) ï 09.07.2017 (3 vite); Dëshmitë e sjella nga OE i shpallur fitues fillojnë nga data 24.01.2018;

[16] https://www.app.gov.al:446/

	Sa më sipër për periudhën e mbetur nuk është plotësuar kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3, Kapacitete Teknike. Gjithashtu grupi i auditimit bëri verifikimin edhe të aktivitetit të Operatorit Ekonomik, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, **ku rezultoi se ky subjekt është licencuar** për furnizimin, instalimin dhe tregëtimin e pajisjeve elektrike më datë **23.02.2018**, pra praktikisht nuk e ka patur të mundur që të sillte dëshmi të ngjashme për një periudhë të mëparshme, me qëllim plotësimin e kriterit teknik të DST, pasi nuk e ka ushtruar si aktivitet; -Garancia e kontratës në masën 10% të vlerës së saj është fotokopje dhe e pa noterizuar, dhe në këto kushte nuk duhej të pranohej nga Njësia e Prokurimit z. E.S, z. A.H, z. E.L; -Dorëzimin e referencave të kalibrimit nga laborator të akredituar me certifikatën ISO 17025 të pajisjeve të kryera gjatë 3 viteve të fundit ï OE N.V ka sjellë dy fatura tatimore të shitjes së disa pajisjeve ndaj një subjekti tjetër privat ñN.Cò shpk, të cilat mbajnë datat 20.05.2019 dhe 28.05.2019, si dhe certifikata kalibrimi të lëshuara në emër tëN.C dhe jo në emër të tij, pra këto certifikata nuk i përkasin OE të shpallur fitues ñN.Vò shpk. Gjithashtu theksojmë se edhe pse ky subjekt ka sjellë këto certifikata që nuk janë të lëshuara në emër të tij, ato janë pa firmën e inxhinierit të kalibrimit dhe asistentit dhe pa vulë (çka K.R dyshime mbi vërtetësinë e tyre), si dhe mbajnë data të cilat nuk korrenspondojnë me datat e faturave tatimore (08.05.2019, 15.05.2019, pra certifikatat e kalibrimit janë lëshuar më përpara se shitja e kryer nga N.V shpk ndaj N.C). Pra subjekti nuk e ka respektuar detyrimin e vendosur nëDST, pika 2, Kreu 2.3 ñKapaciteti Teknikò: ñOperatori ekonomik duhet të paraqesë referenca për kalibrim nga laborator të akredituar me certifikatën ISO17025 të pajisjeve të kryera gjatë viteve të fundit. Gjithashtu bazuar në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008, neni 13, pika 2. Nisur nga rëndësia e veçantë e këtyre pajisjeve pasi ato duhet të jenë precize në vlerat e matura pasi në bazë të rezultateve mund të lind e drejta e vendosjes së masës administrative, njësia ka kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë të paktën 1 referencë/praktikë për kalibrim nga laborator i akredituar me certifikatën ISO17025 të kryer gjatë 3 viteve të fundit për të paktën një pajisjeò. -Sipas përcaktimit të bërë më sipër, OE ka detyrimin që ta plotësojë duke dorëzuar certifikata kalibrimi të pajisjeve të ngjashme me ato që po prokurohen/ose të njëjta me ato që po prokurohen, të cilat duhet të jenë të lëshuara në emër të vetë operatorit që po konkurron në garë. Ndërkohë ai ka sjellë fatura tatimore shitje produktesh (detyrim i cili është i ezauruar në pikën 1 të kapaciteteve teknike, furnizime të mëparshme, si dëshmi pranohen fatura tatimore të shitjes), pra që ky dokument është i panevojshëm për plotësimin e kësaj kërkese. Për respektimin dhe plotësimin e kërkesës së DST, është e nevojshme që OE të dorëzojë referenca të certifikatave të kalibrimit, sepse duhet të dëshmojë që plotëson kërkesat e aftësive teknike, ndërkohë ai ka dorëzuar certifikata kalibrimi që janë të lëshuara në emër të një subjekti tjetër. -Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, në rast se paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit ï OE ka dorëzuar autorizimin e prodhuesit Nucelar Shields për produktin nr.11 (veshje mbrojtëse nga rrezatimi X), ku pasqyrohet informacioni se N.V shpk, është distributori i autorizuar, mirëpo nuk vërtetohet lidhja midis N.V dhe prodhuesit, pra me furnizime të ngjashme të kryera në periudha të mëparshme, siç kërkohet në kriteret teknike të DST. Kjo mangësi konstatohet edhe për produktet e tjera, si: 1. Matës i shkallës së ndriçimit (Aparat Lux Metër); 2. Matës distance me lazer, digjital; 6. Takometër; 8. Instrument për testimin e pajisjeve elektrike; 9. Matës izolacioni multimetër; 10. Testues izolacioni multimetër; 14. Seri Gramarësh (1g - 500g); 15.Seri Gramarësh 1mg ï 500 mg;

	17. Kronometër (numrat në krah të produkteve janë sipas renditjes së tyre në DST); -Sa më sipër OE i shpallur fitues nuk e ka përmbushur pikën 3 të Kreut 2.3 ñKapacitetit teknikò në DST. -Dokumenti i sjellë (si certifikatë kalibrimi) për produktet 14 dhe 15 ñSeri Gramarëshò (1g - 500g) dhe 1 mg ï 500 mg, nuk është certifikatë kalibrimi, por deklaratë konformiteti, si dhe anekset e deklaratës për subjektin (HGG) dhe për çfarë shërbimesh kalibrimi është ai i akredituar, si dhe ajo nuk ka elementët që përmban një certifikatë kalibrimi, pra subjektit përfitues i shërbimit të kalibrimit, në këtë rast N.V shpk, periudhën e vlefshmërisë së certifikatës, rezultatet e matjeve të kryera për pajisjen, numri serial i certifikatës, numri i urdhrit të kalibrimit, vendi ku është kryer kalibrimi, numri unik i produktit qëështë kalibruar, etj. -Sa më sipër, nga OE i shpallur fitues, nuk është përmbushur detyrimi përcaktuar nëDST, shtojca nr.1, datë 17.07.2020, pika 5 për kapacitetin teknik, për artikujt ñmatësò, me numër rendor 12, 13, **14, 15,** 16 dhe 17: ñInstrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, duhet që të mbartin Markimin CE, Markimin metrologjik suplementar M, të shoqëruar me Deklaratën e Konformitetit dhe Dokumentacionin Teknik. **Gjithashtu të jenë të pajisur me certifikatë kalibrimi** nga një laborator kalibrues i akredituar sipas standardit ISO17025, akredituar nga një organ akreditimi, i cili ka firmosur marrëveshjen e EA-MLA, e cila është firmosur dhe nga Shteti Shqiptarò. **Afati kohor i dorëzimit të ofertave dhe hapjes së ofertave shtyhet më datë 27.07.2020".** -Certifikata e kalibrimit për produktin 16 ñAparat për matjen e volumit të gazitò, e lëshuar nga Laboratori D, në Bullgari, nuk është i lëshuar nga një laborator i akredituar për ofrimin e shërbimit të kalibrimit në këtë fushë. Për mbështetjen e këtij konstatimi, grupi i auditimit: -Bëri verifikimin në faqen e Organizatës Europiane të Akreditimit, ku rezultoi se për shtetin e Bullgarisë, nënshkrues i marrëveshjes EA-MLA (siç është kërkuar në DST) është edhe Agjencia ñBASò, e cila ka akredituar laboratorin D[17] në Bullgari, për disa fusha (pasqyruar në tabelën nr.1 në vijim); -Pra sipas informacionit të pasqyruar në tabelën nr.1, në asnjë nga fushat Laboratori D, nuk është i akredituar për kalibrimin e instrumentit/instrumentave për matjen e volumit të gazit, që të ketë njësi matëse Litër/minut dhe të përfshijë intervalin e caktuar prurja maksimale = 50 Litra/minut dhe Prurja minimale 5 Litra/minut. -Për më tepër metoda referuar nga Laboratori D në rrjeshtin 8 të tabelës, bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15, pikën 1, në Ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur është paraqitur certifikata e kalibrimit: Neni 15 Kalibrimi i etaloneve të matjes dhe instrumenteve matëse 1. Kalibrimi kryhet në përputhje me dokumentet dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare për standardizimin, akreditimin dhe metrologjinë, si EURAMET-Organizata Rajonale e Metrologjisë për Europën[18], OIML-Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore[19], ILAC-Organizata Ndërkombëtare për Akreditimin e Trupave të ndryshëm (testues, inspektues, kalibrues).[20] -Certifikata e kalibrimit e sjellë nga OE shpallur fitues, mban datën 26.08.2020, pra rreth 1 muaj me vonesë nga data 27.07.2020, përcaktuar në DST, si dokument për tôu dorëzuar nga OE; -Certifikata e kalibrimit është lëshuar për aplikantin Sk GE Ltd EOOD, Adresa:44 Ul. I str.AP. O 18, F 3, SZ, 6000 Bulgaria, pra jo për N.V/ISHMT, blerës/përdorues të këtij instrumenti;

[17] https://www.nab-bas.bg/en/registers/laboratory-for-calibration-at-denev-d-ltd-18-lk-10625.html
[18] https://www.euramet.org/index.php?eID=tx_securedownloads&p=446&u=0&g=0&t=1666301856&hash=8f3c5684cdfb5596ac61d467c807a1f608a9b584&file=Media/docs/Publications/calguides/I-CAL-GUI-023_Calibration_Guide_No._23_web.pdf
[19] https://oiml.nim.ac.cn/sites/default/files/media/document/2020-07/r117-1-e19.pdf
[20] ILAC_G18_04_2010.pdf-Materiali e specifikon se si duhet tw pwrcaktohen fushat, instrumentat pwr tw cilat wshtw i akredituar laboratori qw ofron shwrbimin e verifikimit.

	-Për produktin 4 ñKalibër, digjitalò, nuk është dorëzuar certifikatë kalibrimi, por dokumenti që administrohet në dosje është katalogu i përdorimit të produktit. Pra nga OE shpallur fitues nuk është përmbushur detyrimi i përcaktuar nëDST, shtojca nr.1, datë 17.07.2020, pika 5 për kapacitetin teknik: ñNë shtojcën 9 të DST-ve, e ndryshuar, lidhur me specifikimet teknike për artikullin ñkalibër digjital, duhet që të ketë Markimin CE, Markimin metrologjik suplementar M, të shoqëruar me Deklaratën e Konformitetit dhe Dokumentacionin Teknik. **Gjithashtu të jenë të pajisur me certifikatë kalibrimi** nga një laborator kalibrues i akredituar sipas standardit ISO17025, akredituar nga një organ akreditimi, i cili ka firmosur marrëveshjen e EA-MLA, e cila është firmosur dhe nga Shteti Shqiptarò. **Afati kohor i dorëzimit të ofertave dhe hapjes së ofertave shtyhet më datë 27.07.2020.** -Gjithashtu certifikata e kalibrimit në paketimin e produktit të mësipërm, nuk është në gjuhën shqipe, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit. Kjo certifikatë nuk përmban standardin ISO:17025, standardi për akreditimin e laboratorëve për lëshimin e certifikatave të kalibrimit, nuk ka elementët që përmban një certifikatë kalibrimi, pra subjektit përfitues i shërbimit të kalibrimit, periudhën e vlefshmërisë së certifikatës, rezultatet e matjeve të kryera për pajisjen, numri serial i certifikatës, numri i urdhrit të kalibrimit, vendi ku është kryer kalibrimi, numri unik i produktit qëështë kalibruar, etj[21]. -Certifikata e kalibrimit me nr.,serial 61047563 e sjellë për produktet 12 dhe 13 ñInstrument matës temperature me një sensor N, me bateriò, është e lëshuar më datë 09.07.2019 për subjektin ñK.Rò shpk, dhe jo për N.V shpk (pra nuk i përket operatorit fitues), si dhe për më tepër data e mbarimit të kalibrimit është 09.07.2020, pra në këtë datë sipas certifikatës së lëshuar duhet që të bëhet rikalibrim i pajisjes, por që nuk administrohet asnjë certifikatë kalibrimi e tillë, megjithëse e ritheksojmë se certifikata e sjëllë nuk është as e subjektit fitues të procedurës. Theksojmë se certifikata e mësipërme është e lëshuar për produktin lloji-Testo 735-2 Speicher, ndërkohë ai që është sjellë sipas specifikimeve teknike dhe të verifikuar në magazinën e ISHMT, është lloji T 720; -Cerifikatat e kalibrimit nuk përmban standardin ISO:17025, standardi për akreditimin e laboratorëve për lëshimin e certifikatave të kalibrimit; -Gjithashtu nga verifikimi i grupit të auditimit në faqen e Organizatës Europiane të Akreditimit, ku rezultoi se për shtetin e Gjermanisë (T kompani me seli në Gjermani), nënshkrues i marrëveshjes EA-MLA (siç është kërkuar në DST), është Trupi Gjerman i Akreditimit, për të vazhduar më tej me verifikimin në faqen zyrtare[22] të këtij të fundit www.dakks.de; rezultoi se Kompania T S&Co. KGaA, nuk ka laborator të akredituar për të lëshuar certifikata kalibrimi. Sa më sipër OE shpallur fitues nuk e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nëDST, shtojca nr.1, datë 17.07.2020, pika 5 për kapacitetin teknik: ñInstrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, duhet që të mbartin Markimin CE, Markimin metrologjik suplementar M, të shoqëruar me Deklaratën e Konformitetit dhe Dokumentacionin Teknik. **Gjithashtu të jenë të pajisur me certifikatë kalibrimi** nga një laborator kalibrues i akredituar sipas standardit ISO17025, akredituar nga një organ akreditimi, i cili ka firmosur marrëveshjen e EA-MLA, e cila është firmosur dhe nga Shteti Shqiptarò. **Afati kohor i dorëzimit të ofertave dhe hapjes së ofertave shtyhet më datë 27.07.2020".** -Theksojmë se nga verifikimi i kryer i dy instrumentave të mësipërm pranë magazinës së ISHMT, të dyja sondat (aksesor i këtij produkti) kanë mbishkrimin: Data e kalibrimit ï 31.08.2020 **(pra rreth 1 muaj më pas)** nga data e përfundimit të dorëzimit të ofertave

[21] https://www.oiml.org/en/tc-sc-pg/committee-drafts/files/tc3-sc5-p4-1cd.pdf, pika 5.10.2, dhe nw vijim neni 15, pika 1 nw Ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, nw fuqi pwr periudhwn kur wshtw paraqitur certifikata e kalibrimit.
[22] https://www.dakks.de/en/search-result.html

27.07.2020, **ndërkohë** që duhet të ishte përpara kësaj date, **me qëllim plotësimin e kërkesave teknike sipas DST(pasqyruar në fotot nr.1-4, Kapitulli Anekse-Aneksi nr.3).**
-Për produktin 17 ñKronometërò, nuk është sjellë certifikatë kalibrimi.
Sa më sipër OE shpallur fitues nuk e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në DST shtojca nr.9, datë 17.07.2020, për produktin 17
Në vijim të konstatimit të mësipërm, grupi i auditimit bëri verifikimin në faqen zyrtare të Agjencisë së Akreditimit në Sllovenihttps://www.slo-akreditacija.si/, e cila është nënshkruese e marrëveshjes EA-MLA, siç është kërkuar në DST, si dhe për të vijuar më tej, në faqen zyrtare të agjencisë së mësipërme, bëri verifikimin për laboratorin që ka lëshuar certifikatën e kalibrimit për produktin kronometër, https://www.slo-akreditacija.si/acreditation/slovenski-institut-za-kakovost-in-meroslovje-3/?lang=en, ku rezultoi se ky laborator, sipas fushave dhe nënfushave të akredituara, për të cilat ofron shërbimin e kalibrimit, për sa i përket kalibrimit të kronometrave/më specifikisht fusha ñkoha relativeò nuk e ofron si shërbim.
▪ **Sa më sipër, si pasojë e mospërmbushjes së kritereve të vendosura në DST, nga KVO nuk duhet të ishte shpallur fitues subjekti "N.V" shpk.**
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO-së z. J.Ll, Kryetar, z.L.L, Anëtar dhe z.G.N, Anëtar.

<u>Mbi marrjen në dorëzim të mallrave të furnizuara:</u>
Në procedurën e mësipërme, nga OE i shpallur fitues, janë dorëzuar mallrat, pasqyruar në tabelën nr.2 më poshtë;
Grupi i auditimit në prani të Magazinierit të ISHMT zj. L.K, si dhe sipas rastit në varësi të natyrës së produktit/specifikës së tyre, më konkretisht, për aparatin Lux metër, veç magazinieres, është bërë në prani edhe të zj.S.B, Përgjegjëse e Sektorit të Inspektimit të Produkteve Mekanike, njëkohësisht anëtare e grupit të marrjes në dorëzim;
Për aparatin testues izolacioni multimetër është veç magazinieresështë bërë në prani edhe të z.L.L Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Produkteve Elektrike, si dhe ky aparat u ndez nga vetë personi i sipërcituar;
Për aparatin e matjes së volumit të gazit, është bërë në prani të z.R.B, Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Metrologjisë.
Nga ky verifikim, u konstatua se:
-Sasia e sjellë është në përputhje me sasinë e kërkuar nga AK;
-6 produkte të furnizuara, nuk janë sipas specifikimeve teknike, konkretisht për 5 prej tyre (Matës i shkallës së ndriçimit-aparat Lux metër), Seri gramarësh 1g-500g, Seri gramarësh 1mg-500mg, Aparat për matjen e volumit të gazit dhe Kronometër) është kërkuar që ato të jenë të markuara me shenjën e konformitetit CE, por faktikisht nuk kanë qenë të markuara me shenjën CE, **si dhe për 1 produkt** ñTestues izolacioni multimetërò, sipas specifikimeve teknike në DST, është kërkuar që të matjen e rezistencës ta bëjë brenda intervalit 200 kq (kilohm) deri 2 Tq (teraohm), ndërkohë faktikisht, kjo pajisje ofronte matje deri në 1 Tq (teraohm), (**pasqyruar në fotot nr.5-10, Aneksi nr.3).**
-Certifikatat e kalibrimit për produktet 14 dhe 15 ñseri gramarëshò, nuk janë në gjuhën shqipe, sipas përcaktimeve të bëra në shtojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe Pika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020, shprehimisht:ñMe përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, çmimi i kontratës përfshin kostot dhe **tarifat**, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhura me dorëzimin e mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualet **dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar** dhe të nevojshme për përdorim të rregullt, mirëmbajtje dhe riparime të mallraveò.
-Certifikata e kalibrimit për produktin 4 ñkalibër digjitalò, nuk është në gjuhën shqipe, sipas përcaktimeve të bëra në shtojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe

	Pika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020. Certifikata e kalibrimit për produktin ñkalibër digjitalò nuk përmban standardin ISO:17025, standardi për akreditimin e laboratorëve për lëshimin e certifikatave të kalibrimit. -Certifikatat e kalibrimit për produktet 12 dhe 13ñInstrument matës temperature me një sensor N, me bateriò, nuk janë në gjuhën shqipe, sipas përcaktimeve të bëra në shtojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe Pika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020. Cerifikatat e kalibrimit për dy produktet e mësipërme nuk përmban standardin ISO:17025, standardi për akreditimin e laboratorëve për lëshimin e certifikatave të kalibrimit; -Certifikatat e kalibrimit për produktin 17 ñKronometërò, nuk janë në gjuhën shqipe, sipas përcaktimeve të bëra në shtojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe Pika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020. -Vlera e produkteve, të cilat nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuaradhe kontraktuara (markimi dhe dokumentacioni i tyre, për certifikatat e kalibrimit, element të cilët ndikojnë në kostot e produktit[23], por që nuk mund të mund të matet specifikisht, kjo edhe për arsye se, çmimet e vlerësimit të konformitetit me qëllim vendosjen e markimit CE, si dhe shërbimit të kalibrimit nuk janë të publikuara në faqet e laboratorëve përkatës), është **2,454,000 lekë;** **Referuar sa më sipër këto produkte nuk duhet të ishin marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim, procesverbali i marrjes në dorëzim të produkteve me nr.1908/1, datë 11.09.2020.** ➢ Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim, J.Ll Kryetar, S.B, F.C, A.H dhe E.L Anëtar. -Gjithashtu në përfundim të trajtimit të procedurës, theksojmë se nga pajisjet e mësipërme, është tërhequr (fletë-dalja nr.19, datë 02.06.2021, pra pas rreth 1 viti nga momenti i blerjes së tyre) nga magazina vetëm 1 mikrometër nga Inspektori E.M për përdorim në inspektim, kurse pajisjet e tjera deri në momentin e verifikimit të kryer nga grupi i auditimit, nuk janë përdorur, megjithëse nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve është kërkuar me shkresën nr.903, datë 12.03.2020 blerja e këtyre pajisjeve, *ç'ka tregon mungesë koordinimi dhe studimi të nevojave të institucionit për të përdorur këto instrumenta, si dhe një shpenzim në vlerën 5,902,800 lekë pa efektivitet dhe eficiencë.* Për këtë mbajnë përgjegjësi z.L.S, Titullari i ISHMT dhe z.J.Ll, Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve (kërkues i pajisjeve për inspektime që realizohen nga struktura, të cilën ai drejton).
Kriteri	Neni 39 pikat 2 dhe 3 të nenit 57 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar; Neni 46, shkronja ñbò e Ligjit nr.9634, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar; Nenin 15, pikat 1 dhe 2, në Ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur është paraqitur certifikata e kalibrimit dhe në vijim rekomandimi i OIML-https://www.oiml.org/en/tc-sc-pg/committee-drafts/files/tc3-sc5-p4-1cd.pdf, pika 5.10.2; Pikën 43 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar; Pikën 1, shkronjat ñaò dhe ñbò të pikës 2 dhe pikën 3 në nenin 8, pikat 2, 3 dhe 7 të nenit 9 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, ndryshuar; Pikat 24 dhe 25 të nenit 3, shkronjën ñçò të nenit 4, shkronjën ñbò të nenit 19, të Ligjit nr.9936, datë 26.08.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetorò, i ndryshuar, Pikat 1 dhe 5 të nenit 8 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2018 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; Dokumentet Standard të Tenderit hartuar me procesverbalinpa *nr.,*i mbajtur më datë 08.07.2020,

[23]Pika 5 e nenit 7 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011, ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, ndryshuar.

	ndryshuar më datë17.07.2020; Kontrata nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020 lidhur ndërmjet ISHMT dhe OE N.V; Procesverbali i grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, nr.1908/1, datë 11.09.2020;
Ndikimi/Efekti	-Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, i cili nuk mund të matet, pasi elementët që mungojnë në pajisjen ñMatës i shkallës së ndriçimit, Seri gramarësh 1g-500g, Seri gramarësh 1mg-500mg, Aparat për matjen e volumit të gazit, Kronometër, si dheTestues izolacioni multimetërò në vlerën 2,454,000lekë pa TVSH, janë pjesë e kostos përfundimtare të produktit; -Përdorim pa efektivitet dhe eficiencë i fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën 5,902,800 lekë;
Shkaku	Marrja në dorëzim e mallit, në kushtet kur ai nuk është në përputhje me specifikimet teknike; Mosrespektim i detyrimeve kontraktore nga OE Shpallur fitues; Mungesa e përdorimit të pajisjeve të prokuruara, rreth 1 vit të pa përdorura (koha e hyrjes në magazinën e institucionit ï tërheqja e tyre nga mgazina për përdorim); Veprime dhe mosveprimeve në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në kontratën midis palëve, si dhe kuadrin rregullator cituar në kriteret audituese.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, duke i kërkuar OE N.V shpk, të dorëzojë mallratñMatës i shkallës së ndriçimit, Seri gramarësh 1g-500g, Seri gramarësh 1mg-500mg, Aparat për matjen e volumit të gazit, Kronometër, si dheTestues izolacioni multimetërònë përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara, ose në të kundërt arkëtimin e vlerës 2,454,000 lekë pa TVSH, të produkteve të mësipërme. **Menjëherë** ISHMT të marrë masat e nevojshme për vendosjen në përdorim të instrumenteve të prokuruara, në mënyrë që ato të shërbejnë për arritjen e objektivave institucional, si dhe shamngien e përdorimit të fondeve buxhetore pa efektivitet dhe eficiencë. **Menjëherë dhe në vijimësi**

Tabela nr.1 Fushat e akredituara të laboratorit D në Bullgari ku mund të ofrojë shërbimin e kalibrimit.

No-Nr	**Measurement instrument-Instrumenti matës**	**Measured quantity,measurement unit-Njësia**	**Range of measurement-Intervali matjes**	**Measurement uncertainty-Pasiguria e matjes**	**Calibration method-Metoda e kalibrimit**	**Instrumenti i kërkuar për kalibrim "Aparat për matjen e volumit të gazit, LPG"**
1	*2*	*3*	*4*	*5*	*6*	*7*
1	Instruments for volume measurements	Volume, m^3			ʃ ʂ ¯ ʂ -01-15	Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, këtu bëhet fjalë për tanket horizontal dhe vertikal, si dhe njësia matëse është metër kub, jo litër për minut, si ajo e kërkuar, në specifikimet teknike
	Horizontal and vertical tanks, stationary and mounted on movable platforms, ëith different geometric shapes		Up (sipër) to 10 m^3	0,15%	Geometric and volumetric method-metodë gjeometrike dhe volumetrike	
			From (nga) 10 m^3	0,1%	ʃ ʂ ɹ ɽ ʉ ISO 7507-1	
			To (në) 50 m^3	0,1%	Tape method-metoda shirit	
			From (nga) 50 m^3		ʃ ʂ ¯ ʂ -01-15	

			To (në) 50 000 m³		Geometric method- metodë gjeometrike	
					ʃ ʂ ɹ ɾ ʉ ISO 7507-1	
					Tape method-metoda shirit	
	Volume instruments: pipettes, automatic pipettes, dosimeters, dispensers, test tubes,burettes, laboratory glassware	Volume, l	From (nga) 0,1 ml	from 0,008 ml	ʃ ʂ ¯ ʃ ʃ -06	Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, këtu bëhet fjalë për pipeta, pipeta automatike, dozator, shpërndarës, tuba, byreta, qelqe laboratorike, si dhe njësia matëse është në intervalin 0.1ml ï 50ml, jo 5 L ï 50 L, si ajo e kërkuar në specifikimet teknike
			To (në) 50 ml	to 0,016 ml	Weight method-Metoda e peshës	
	Flasks, cylinders, pycnometers		From (nga) 50 ml	from 0,016 ml		Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, këtu bëhet fjalë për shishe, cilindra, piknometra[1], dhe intervalin e matjes së kërkuar, për instrumentin në specifikimet teknike
			To (në) 2 000 ml	tts 0,13 ml		-
	Made of metal and non-metal		From (nga) 2 l To (në) 50 l	0,03 %		
			From (nga) 1l To (në) 2500 l	0,04%	ʃ ʂ ¯ ʂ -05-19	Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, si dhe intervalin e matjes së kërkuar për instrumentin në specifikimet teknike
					Volume method-metoda e volumit	
2	Thermometers	Temperature, °C	From (nga) negative (-) 30 °ʉ	from 0,06 °C	ʃ ʂ ¯ ʊ-01	Instrumenta të tjerë nga ai i kërkuar, termometër likuid, dixhital, analog
	liquid, digital, analogue		To (në) 300 °ʉ	to 0,12 °C	Comparative method-metoda krahasuese	
3	Calipers, caliper depth gauges and caliper altimeters	Length, mm	From (nga) 0,5 mm	from 0,030 mm	ʃ ʂ ¯ ɾ -04	Instrumenta të tjerë nga ai i kërkuar, kalibra, matës thellësie
			To (në) 1 000 mm	tts 0,032 mm	Direct method-metoda direkte	

	- Digital;		From (nga) 0,5 mm	from 0,033 mm		
			To (në) 1 000 mm	tts 0,034 mm		
	- Vernier					
4	Micrometers with flat measurement surface, Micrometer depth gauges	Length, mm			ʃ ş ¯ ɾ -05	Instrumenta të tjerë nga ai i kërkuar, kalibra, matës thellësie
					Direct method-metoda direkte	
	- digital		From (nga) 0,5 mm	from 0,0058 mm		
			To (në) 1 000 mm	to 0,0070 mm		
	- mechanical		From (nga) 0,5 mm	from 0,0082 mm		
			To (në) 1 000 mm	to 0,0097 mm		
5	Scale marks measures of length: -tape measures	Length, mm	From (nga) 0 mm	from 0,15 mm	ʃ ş ¯ ɾ -03	E njëjta si më sipër
	-tapes		To (në) 30 000 mm	tts 0,50 mm	Comparative method-metoda krahasuese	
	-Measuring lines;		From (nga) 0 mm	0,15 mm		
			To (në) 3000 mm			
	-tape measures with tensioning weight and sinker		From (nga) 0 mm	0,06 mm	ʃ ş ¯ ɾ -03-01	
			To (në) 310 mm		Comparative method-metoda krahasuese	
			From (nga) 310 mm	from 0,21 mm		
			To (në) 30 000 mm	tts 0,60 mm		
6	Gauge blocks	Length, mm	From (nga) 0,5 mm	from 0,22 µm	ʃ ş ¯ ɾ -06	E njëjta si më sipër
			To (në) 100 mm	tts 0,36 µm	Comparative contact method-Metoda krahasuese e kontaktit	
7	Vacuum and Pressure measuring instruments	Pressure,	From (nga) negative (-) 0,9 bar	from 3.10^{-3} bar	ʃ ş ¯ ʅ -01	E njëjta si më sipër
		p, bar	To (në) 35 bar	tts 6.10^{-3} bar	Comparative method-metoda krahasuese	
8	Flow meters for	Volume, m³,	From (nga)	0,05%	ʃ ş ¯ Razhod-	Matës të rrjedhës për

	water and liquids other than water	volumetric flow rate, m³/h	0,001 m³/h		01	ujë dhe lëngje të ndryshme nga uji, pra jo për instrumentin e kërkuar, si dhe njësia e matjes dhe intervali i matjes i ndryshëm nga ai i kërkuar në specifikimet teknike.
			To (në) 150 m³/h		Comparative method-metoda krahasuese	

Burimi:Faqja zyrtare e Agjencisë ñBASò të akreditimit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.2 Mallrat e furnizuar nga OE N.V

Nr	**Emërtimi i pajisjes**	**Sasia/ copë**	**Total**	**Sasia sipas porosisë**		**Sjellë sipas specifikimev e teknike**		**Marrë në dorëzim nga komisioni**		**Vlera e produkteve të cilat nuk duhet të ishin marrë në dorëzim**
				PO	**JO**	**PO**	**JO**	**PO**	**JO**	104,000
1	Matës i shkallës së ndriçimit (aparat Lux metër)	2	104,000	X			X	X		
2	Matës distance me lazer, digjital	2	196,000	X				X		
3	Mikrometër, digjital	1	210,000	X				X		
4	Kalibër, digjital	2	104,000	X				X		
5	Dinamometër	1	168,000	X				X		
6	Takometër	2	266,000	X				X		
7	Komplet veglash pune	2	410,000	X				X		
8	Instrument për testim e paisjeve elektrike	1	325,000	X				X		
9	Matës izolacioni multimetër	2	410,000	X				X		
10	Testues izolacioni multimetër	1	990,000	X			X	X		990,000
11	Veshje mbrojtëse nga rrezatimi X	1	245,000	X				X		
12	Instrument matës temperature me një sensor N me bateri	1	55,000	X				X		
13	Instrument matës temperature me një sensor N me bateri	1	76,000	X				X		
14	Seri gramarësh 1g-500g	1	60,000	X			X	X		60,000
15	Seri gramarësh 1mg-500mg	1	175,000	X			X	X		175,000
16	Aparat për matjen e volumit të gazit	1	990,000	X			X	X		990,000
17	Kronometër	3	135,000	X			X	X		135,000
	Total pa TVSH		**4,919,000**							**2,454,000**
	TVSH 20%		983,800							
	Total me TVSH		**5,902,800**							

Burimi: ISHMT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Observacion: Me shkresën nr.614/10, datë 15.10.2021 nga ISHMT është bërë observacion për konstatimet e grupit të auditimit për procedurën e prokurimit më sipër, ku në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë vijon:

1.Me urdhërin nr.25, datë 10.02.2020 është caktuar Zj.V.J si Administratore e sistemit të prokurimit publik për vitin 2020ò.

2.Për marrjen në dorëzim të mallrave është ngritur komisioni që ka në përbërje të tij 4 anëtarë të cilët janë specialistë të fushës për produktet që do të dorëzoheshin. Dorëzimi i tyre në magazinën e ISHMT është bërë në prani të punonjësit me përgjegjësi materiale M.Z, me pozicion magazinier, i cili ka firmosur për hyrjen e tyre në magazinë.

3.Administrimin e ftesës për ofertë drejtuar OE, janë në sistemin elektronik të prokurimit.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së:

-Urdhërin nr.25, datë 10.02.2020, e kemi pasqyruar që në fazën e Projekt Raportit të auditimit, konstatimi jonëështë se personi i caktuar si administrator, nuk është pjesë përbërëse e njësisë së prokurimit (baza ligjore është cituar në konstatimin përkatës).

-Për grupin e marrjes në dorëzim, nuk kemi shprehur kundërshtime se në përbërje të tij ka specialist të fushës, madje shumë mirë. Jemi shprehur se pjesë e tij nuk është edhe personi me përgjegjësi materiale (baza ligjore është cituar në konstatimin përkatës).
-Për administrimin e ftesave për ofertë, kemi bërë rregullimin e nevojshëm, si dhe jemi shprehur për administrimin në dosjen e prokurimit të ftesave për ofertë drejtuar 5 OE (baza ligjore është cituar në konstatimin përkatës).
Observacion: Duke vlerësuar konstatimin sa më sipër të GA të KLSH bëjmë me dije se: Referuar VKM nr.914/2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, pika 4, neni 27 kontratat e mallrave thuhet se: për të provuar përvojën e mëparshme autoriteti kontraktor kërkon dëshminë për furnizime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturat tatimore të shitjes ku shënohet datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
Duke analizuar dispozitën e mësipërme pika 4, neni 27 VKM 914/2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, Operatori ekonomik i ka përmbushur përmbushur kërkesat e kapacitetit teknik dhe specifikimet teknike për mallrat, të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht:
1.KontratëN.V Shp me DHP, Nr faturës tatimore 77998318, datë 30.3.2020
2. Kontratë A me N.V Shpk, Nr faturës tatimore 89214651, datë 28.05.2020
3. Kontratë E Sha me N.V Shpk, Nr faturës tatimore 77998282, datë 18.12.2019
4. N Shpk me A, Nr faturës tatimore 77998281, datë 18.12.2019
5. N.V Shpk me GE, Nr faturës 57973909, datë 14.01.2019
6. N.V Shpk me E Shpk, Nr faturës tatimore 57973920, datë 25.02.2019
7. N.V Shpk me M Shpk, Nr faturës tatimore 57973921, datë 25.02.2019
8. N.V Shpk me KI, Nr faturës 77998259, datë 25.10.2019
9. N.V Shpk me TI, Nr faturës 57973896, datë 24.12.2018
10. N.VShpk me GE, Nr faturës 57973839, datë 17.08.2018
11. N.V me Klientë të ndryshëm, Nr faturës 39841473, datë 24.01.2018
12. N.V Shpk me EF, Nr faturës 57973943, datë 25.05.2018
13. N.V Shpk me N.C, Nr faturës 57973925, datë 05.03.2019
14. N.V Shpk me AQ, Nr faturës 57973927, datë 26.03.2019
15. N.V Shpk me N.C, Nr faturës 57973968, datë 20.05.2019
16. N.V Shpk me N.C, Nr faturës 39841468, datë 19.01.2019
17. N.V Shpk me AE, Nr faturës 57973830, datë 18.07.2018
18. N.V Shpk me BP, Nr faturës 57973827, datë 06.07.2018
19. N.V Shpk me BP, Nr faturës 57973811, datë 31.05.2018
20. N.V Shpk me T Shpk, Nr faturës 57973880, datë 09.11.2018
21. N.V Shpk me BP, Nr faturës 39841497, datë10. 04.2018
22. N.V Shpk me BC, Nr faturës 39841495, datë 10.04.2018
23. N.V Shpk me L.G Shpk, Nr faturës 57973821, datë 21.06.2018
24. N.V Shpk me A Shpk, Nr faturës 57973859, datë 03.10.2018
Si konkluzion në këtë paragraf, për sa më sipër deklarojmë se Operatori Ekonomik referuar pika 4, neni 27 VKM nr.914/2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publicò, i ndryshuar, ka paraqitur faturat tatimore me subjekte private të cilat janë në përputhje me kërkesat në DST të tenderit, pra plotësohet kushti që brenda 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së procedurës, subjekti ka paraqitur dëshmi për furnizime të ngjashme.
Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:
Për argumentin e dhënë nga ju më sipër, po citojmë shprehimisht përcaktimin e bërë nga njësia e prokurimit në DST, procesverbali i mbajtur më datë 08.07.2020:
Pika 2.3 ï Kapacitete Teknike

Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së procedurës;
Data e shpalljes së procedurës ï 06.07.2020 me nr., REF-64283-07-06-2020;
Pra sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.3, si dhe referuar datës së publikimit të procedurës 09.07.2020 ï 09.07.2019 (1 vit) ï 09.07.2018 (2 vite) ï 09.07.2017 (3 vite);
Dëshimitë e sjella nga OE i shpallur fitues fillojnë nga data 24.01.2018;
Sa më sipër për periudhën e mbetur nuk është plotësuar kërkesa e përcaktuar nga ju në pikën 2.3, Kapacitete Teknike - dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së procedurës;
-Pra në vlerësimin e përmbushjes së kritereve nga OE, në fazën e vlerësimit të ofertave, e kemi bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ju në DST.
Gjithashtu edhe nëse do tõ referoheshim dokumenteve standarde të tenderit (të detyrueshme për tu zbatuar gjatë procedurave të prokurimit publik) të publikuara në faqen zyrtare të APP, dhe më konkretisht për procedurën kërkesë për propozim për mallra, si dhe ato DST që kanë qenë në fuqi deri në miratimin e DST nga njësia e prokurimit në procedurën e mësipërme, përcaktohet shprehimisht:

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:
2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:
2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:
2.3 Për kapacitetin teknik:
(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Veprim që ju e keni kryer dhe e keni plotësuar me përmbajtjen e cituar edhe më lartë. Pra ju e keni kushtëzuar këtë si kriter, duke shtuar fjalët: të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së procedurës, çka do të thotë se ky kriter duhet të plotësohet ashtu siç ju e keni përcaktuar.
Sa më sipër observacioni për këtë konstatim nuk merret në konsideratë.
-Nëse garancia e kontratës ka qenë origjinale, dhe me pretendimin se i është paraqitur grupit të auditimit (mungesë serioziteti dhe korrektësie nga ana juaj) atëherë përse nuk është paraqitur një kopje e saj e noterizuar. Grupi i auditimit nuk ka asnjë arsye të dali në konstatime të tilla, është tërësisht i pavarur përgjatë auditimit dhe objektiv në çështjet e trajtuara dhe konstatuara.
Observacion: Lidhur me kërkesat në DST për sa i përket eksperiencës që OE duhet të ketë në kalibrime të instrumentave matës në laborator të akredituar në standardin ISO 17025 pajisjeve të kryera gjatë 3 viteve të fundit - OE ka sjellë dy fatura tatimore të shitjes së disa pajisjeve ndaj një subjekti tjetër privat "N.C" shpk, të cilat mbajnë datat 20.05.2019 dhe 28.05.2019. Në këto dy fatura tatimore OE N.V Shpk, provohet shitja nga OE N.V Shpk kundrejt shoqërisë N.C e produkteve për të cilat janë paraqitur certifikatat e kalibrimit sipas stdnardit ISO 17025. N.V Sh.pk nëpërmjet Autorizimit administruar nga ISHMT është distributor i autorizuar i kompanisë ME D.O.O. Nëkto kushte është e provuar lidhja mids M dhe N.V Sh.p.k. Certifikatat e kalibrimit janë lëshuar në emër tëN.C si blerës i produktit për nevoja që mund të ketë kompania për tu akredituar si organ i vlerësimit të konformitetit.
Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:
Në DST, pika 2, Kreu 2.3 Kapaciteti Teknik, keni përcaktuar shprehimisht:
ñOperatori ekonomik duhet të paraqesë referenca për kalibrim nga laborator të akredituar me certifikatën ISO17025 të pajisjeve të kryera gjatë viteve të fundit. Gjithashtu bazuar në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008, neni 13, pika 2. Nisur nga rëndësia e veçantë e këtyre pajisjeve pasi ato duhet të jenë precise në vlerat e matura pasi në bazë të rezultateve mund të lind e drejta e vendosjes së masës administrative, njësia ka kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë të paktën 1 referencë/praktikë për kalibrim nga laborator i akredituar me certifikatën ISO17025 të kryer gjatë 3 viteve të fundit për të paktën një pajisjeò.

-Sipas përcaktimit të bërë më sipër, OE ka detyrimin që ta plotësojë duke dorëzuar certifikata kalibrimi të pajisjeve të ngjashme me ato që po prokurohen/ose të njëjta me ato që po prokurohen, të cilat duhet të jenë të lëshuara në emër të vetë operatorit që po konkurron në garë. Ndërkohë ai ka sjellë fatura tatimore shitje produktesh (detyrim i cili është i ezauruar në pikën 1 të këtij Kreu, shitje ndaj sektorit privat, si dëshmi pranohen fatura tatimore të shitjes), pra që ky dokument është i panevojshëm për plotësimin e kësaj kërkese. Për respektimin dhe plotësimin e kërkesës së DST, është e nevojshme që OE të dorëzojë referenca të certifikatave të kalibrimit, sepse duhet të dëshmojë që plotëson kërkesat e aftësive teknike (neni 46, shkronja ñbò e Ligjit nr.9634, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar), ndërkohë ai ka dorëzuar certifikata kalibrimi që janë të lëshuara në emër të një subjekti tjetër, pra rezulton se ai po dëshmon aftësinë teknike të një subjekti tjetër. Këtu nuk jemi në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, ku secili prej tyre merrë përsipër të plotësojë disa/të gjitha/në mënyrë përpjestimore/ kriteret teknike.
2.Kemi konstatuar një fakt tjetër plotësues, që certifikatat e kalibrimit të sjella nga OE N.V, lëshuar në emër tëN.C, janë të lëshuara disa ditë më përpara se faturat tatimore të shitjes së produktit nga N.V ï N.C (pra sipas jush, subjekti N.V paska aplikuar për kalibrimin e këtyre pajisjeve, që të lëshohen në emër të blerësit N.C, se e paska ditur që do tõ shesë këto pajisje tek ky i fundit), pra nuk kanë asnjë lidhje llogjike/financiare me certifikatat e kalibrimit.
3.Për të ardhur tek argumenti juaj, se certifikatat e kalibrimit janë të lëshuara në emër N.C, si blerës i produktit, me prentendimin se duhet të akreditohet, si keni arritur në këtë përfundim? Nuk keni dhënë informacion. Gjithashtu në asnjë prej certifikatave të kalibrimit të produkteve që ju keni prokuruar nuk është lëshuar në emrin e ISHMT, si blerës i këtyre pajisjeve, për më tepër që edhe ju duhettë akreditoheni si institucion[24].
-Sa më sipër observacioni juaj bie në kundërshtim me vetë kriteret e përcaktuara në DST, dhe nuk merret në konsideratë.

Observacion: Ashtu siç është dhe pohuar nga GA sa më sipër për të gjithë produktet e ofertuara nga OE provohet lidhja midis OE dhe prodhuesit ose OE dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi si edhe midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar. Në asnjë pikë të DST nuk kërkohet që OE të paraqesë kontrata të ngjashme për furnizime të mëparshme nga prodhuesi apo distributor i autorizuar që ka marrë pjesë në këtë procedurë. Për sa i përket DST, eksperienca kërkohet që brenda 3 viteve të fundit nga publikimi i procedurës, OE të paraqesë kontrata të ngjashme me operator ekonomik, por jo detyrimisht vetëm ata prodhues apo distributor të autorizuar që do marrin pjesë në këtë procedurë tënderimi. Një kriter i tillë do të ishte diskriminues dhe në kundërshtim më legjislacionin në fuqi.
Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:
-Për argumentin tuaj në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit mbi plotësimin e kriterit ñOperatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi per mallrat objekt prokurimi, **ne rast se paraqitet kjo e fundit** duhet te **vertetohet lidhja midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit,** sqarojmë se nuk kemi përmendur në asnjë rast **kontrata të ngjashme**, por kemi cituar furnizime të mëparshme nga distributori i autorizuar me prodhuesin e produktit, me qëllim për të përligjur kërkesën e bërë nga ju ñtë vërtetohet lidhja, nëse paraqitet autorizimiò, si dhe për tõju sqaruar më tepër, po ju pasqyrojmë**qëndrimin tuaj në vlerësimin e ofertës së dorëzuar nga subjekti L.B, (s'kualifikuar nga gara)**, për këtë kërkesë të DST, sipas procesverbalit të mbajtur nga KVO pa nr., më datë 29.07.2020, shprehimisht:

ñNuk plotëson pikën 3 të kapacitetit teknik pasi dokumenti i paraqitur si autorizim nga distributori M nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe. Gjithashtu **nuk është paraqitur asnjë dokument që**

[24] Shkronja ñbò në pikën 3 të nenit 19 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e produkteve joushqimoreò, i ndryshuar.

të vërtetojë lidhjen midis distributorit dhe prodhuesve të ndryshëm, mallrat e të cilëve janë paraqitur nga OE, ashtu siç kërkohet në DSTò.

-Pra përgjigjen për argumentin tuaj e keni më sipër. Në këto kushte observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Observacion: Certifikatat e kalibrimit për produktet 14 dhe 15 "Seri Gramarësh" (1g- 500g) dhe l mg - 500 mg, janë të administruara nga ISHMT me numër serial përkatësisht 1050920 të datës dhe objekt kalibrimi janë seri gramarësh (1 mg ï 500 g) në momentin e marrjes në dorëzim të produkteve. Certikata nr serial 1280920 datë dhe objekt janë gramarët (1 mg ï 500 mg) është marrë në momentin e dorëzimit të mallit. Certikata e kalibrimit referuar edhe shtojcës 1 dhe specifikimeve teknike në Shtojcën 9 të DST, **është një dokument që duhet të shoqërojë produktin gjatë dorëzimit të tij.** Për të patur sigurinë që produktet do të jenë të kalibruara OE i janë kërkuar referenca të kalibrimeve të ngjashme. Nga ana e OE janë paraqitur në specifikimet teknike certifikata kalibrimi të produkteve të ngjashme të H. Duke qenë se kalibrimi ka një vlefshmëri kohore të caktuar, atëherë është e përshatshme që afati i kalibrimit të jetë sa më afër datës së dorëzimit të mallit. Certifikatat e kalibrimit janë bashkëlidhur këtij materiali dhe jepen në foto në vijim për gramarët me numër serial përkatësisht 1050920 të datës dhe objekt kalibrimi janë seri gramarësh (1 mg ï 500 g) në momentin e marrjes në dorëzim të produkteve. Certikata nr serial 1280920 datë dhe objekt janë gramarët (1 mg ï 500 mg) është marrë në momentin e dorëzimit të mallit.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:

-Për argumentin (bashkëlidhur edhe certifikata e kalibrimit) tuaj në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit se gjatë fazës sëvlerësimit të ofertave, nga OE N.V për produktet 14 dhe 15 ñSeri gramarëshò, nuk është sjellë certifikatë kalibrimi, sqarojmë se:

-Në DST, shtojca nr.1, datë 17.07.2020, pika 5 për kapacitetin teknik, keni përcaktuar shprehimisht:

1.ñNë shtojcën 9 të DST-ve, në specifikimet teknike për artikujt ñmatësò, me numër rendor 12, 13, **<u>14, 15,</u>** 16 dhe 17, shtohet paragrafi si më poshtë:

Instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, duhet që të mbartin Markimin CE, Markimin metrologjik suplementar M, të shoqëruar me Deklaratën e Konformitetit dhe Dokumentacionin Teknik. **Gjithashtu të jenë të pajisur me certifikatë kalibrimi** nga një laborator kalibrues i akredituar sipas standardit ISO17025, akredituar nga një organ akreditimi, i cili ka firmosur marrëveshjen e EA-MLA, e cila është firmosur dhe nga Shteti Shqiptarò.

Afati kohor i dorëzimit të ofertave dhe hapjes së ofertave shtyhet më datë 27.07.2020.

2.ñNë DST, shtojca nr.8-1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, nëse gjuha e përdorur në procedurëështë gjuha shqipe, atëherë**dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me njëpërkthim të noterizuar në gjuhën shqipe**ò.

3.ñNë DST, pika 9, paragrafi në vijim ï ñDokumentacioni duhet origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. **Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti** ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për sõkualifikimò.

4.ñPika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020, lidhur ndërmjet palëve ISHMT-N.V shpk, ku përcaktohet se: Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, çmimi i kontratës përfshin kostot dhe **tarifat**, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhura me dorëzimin e mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualet **dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar** dhe të nevojshme për përdorim të rregullt, mirëmbajtje dhe riparime të mallrave. Vlera e taksës dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas legjislacionit përkatës, 28 ditë para hapjes së ofertaveò.**Pra sa më sipër gjuha e specifikuar është gjuha shqipe.**

Për të vijuar më tej, në asnjë rast nuk është përcaktuar se certifikata e kalibrimit duhet të shoqërojë produktin gjatë dorëzimit të tij, pra argumenti juaj nuk qëndron;

Certifikatat e kalibrimit të sjella nga ju në observacion, nuk janë në gjuhën shqipe, sipas përcaktimeve të bëra nështojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe Pika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020. Në kushtet e mësipërme ky OE, duhet të ishte sõkualifikuar gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, dhe përveç kësaj, certifikatat e kalibrimit të dorëzuara nga OE gjatë dorëzimit të mallit, nuk janë në gjuhën e specifikuar, kusht për refuzimin e pranimit të tyre.

-Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Observacion: Për laboratorët e akredituar nuk është e detyrueshme që të vendosin logon (ILAC-MRA). Bashkëlidhur gjeni certifikatën e akreditimit të lëshuar për laboratorin D, e cila mund të verifikohet edhe në faqen e laboratorit www.D-d.com. Gjithashtu ky verifikim mund të bëhet edhe ne faqen BAS www.nab-bas.bg. Bashkëlidhur certifikata e akreditimit dhe të dhënat e nxjerra nga faqja e sipërcituar. Sqarojmë se laboratori e ka pas Certifikatën e Akreditimit fillestar që në datën 01.08.2003.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:

-Lidhur me argumentin se për laboratorët nuk është e detyrueshme të vendosin Logon (ILAC-MRA) në certifikatën e lëshuar prej tyre, nuk jemi shprehur se është e detyrueshme, ai është vullnetar, por Organizata Ndërkombëtare e Akreditimit të Laboratorëve, por kjo organizatë vazhdimisht inkurajon laboratorët e akredituar që të përdorin logon e mësipërme, dhe në këtë rast e kemi cituar si një element përbërës, që sipas ISO17011 referohet si simbol i akreditimit[25];

Grupi i auditimit në vijim të argumentit tuaj të bërë më sipër, bëri verifikimin në faqen e Organizatës Europiane të Akreditimit, ku rezultoi se për shtetin e Bullgarisë, nënshkrues i marrëveshjes EA-MLA është edhe Agjencia ñBASò, e cila ka akredituar laboratorin D[26] në Bullgari, për disa fusha, si vijon:

No-Nr	Measurement instrument-Instrumenti matës	Measured quantity,measurement unit-Njësia	Range of measurement-Intervali matjes	Measurement uncertainty-Pasiguria e matjes	Calibration method-Metoda e kalibrimit	Instrumenti i kërkuar për kalibrim "Aparat për matjen e volumit të gazit, LPG"
1	*2*	*3*	*4*	*5*	*6*	*7*
1	Instruments for volume measurements	Volume, m^3			∫ ş ¯ ş -01-15	Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, këtu bëhet fjalë për tanket horizontal dhe vertikal, si dhe njësia matëse është metër kub, jo litër për minut, si ajo e kërkuar, në specifikimet teknike
	Horizontal and vertical tanks, stationary and mounted on movable platforms, ëith different geometric shapes		Up (sipër) to 10 m³	0,15%	Geometric and volumetric method-metodë gjeometrike dhe volumetrike	
			From (nga) 10 m³	0,1%	∫ ş ı ţ н ISO 7507-1	
			To (në) 50 m³	0,1%	Tape method-metoda shirit	
			From (nga) 50 m³		∫ ş ¯ ş -01-15	
			To (në) 50 000 m³		Geometric method-metodë gjeometrike	

[25] publications-and-resources/ilac-rules-series/, ILAC R7:05/2015 Rules for the Use of the ILAC MRA Mark
[26] https://www.nab-bas.bg/en/registers/laboratory-for-calibration-at-denev-d-ltd-18-lk-10625.html

					ʃ ʂ ɹ ɽ ʉ ISO 7507-1	
					Tape method-metoda shirit	
	Volume instruments: pipettes, automatic pipettes, dosimeters, dispensers, test tubes,burettes, laboratory glassëare	Volume, l	From (nga) 0,1 ml	from 0,008 ml	ʃ ʂ ¯ ʃ ʃ -06	Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, këtu bëhet fjalë për pipeta, pipeta automatike, dozator, shpërndarës, tuba, byreta, qelqe laboratorike, si dhe njësia matëse është në intervalin 0.1ml ï 50ml, jo 5 L ï 50 L, si ajo e kërkuar në specifikimet teknike
			To (në) 50 ml	to 0,016 ml	Ëeight method-Metoda e peshës	
	Flasks, cylinders, pycnometers		From (nga) 50 ml	from 0,016 ml		Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, këtu bëhet fjalë për shishe, cilindra, piknometra[1], dhe intervalin e matjes së kërkuar, për instrumentin në specifikimet teknike
			To (në) 2 000 ml	tts 0,13 ml		-
	Made of metal and non-metal		From (nga) 2 l To (në) 50 l	0,03 %		
			From (nga) 1l To (në) 2500 l	0,04%	ʃ ʂ ¯ ʂ -05-19	Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, si dhe intervalin e matjes së kërkuar për instrumentin në specifikimet teknike
					Volume method-metoda e volumit	
2	Thermometers	Temperature, ^{o}C	From (nga) negative (-) 30 ^{o}ʉ	from 0,06 ^{o}C	ʃ ʂ ¯ ʊ-01	Instrumenta të tjerë nga ai i kërkuar, termometër likuid, dixhital, analog
	liquid, digital, analogue		To (në) 300 ^{o}ʉ	to 0,12 ^{o}C	Comparative method-metoda krahasuese	
3	Calipers, caliper depth gauges and caliper altimeters	Length, mm	From (nga) 0,5 mm	from 0,030 mm	ʃ ʂ ¯ ɽ -04	Instrumenta të tjerë nga ai i kërkuar, kalibra, matës thellësie
			To (në) 1 000 mm	tts 0,032 mm	Direct method-	

					metoda direkte	
	- Digital;		From (nga) 0,5 mm	from 0,033 mm		
			To (në) 1 000 mm	tts 0,034 mm		
	- Vernier					
4	Micrometers ëith flat measurement surface, Micrometer depth gauges	Length, mm			ʃ ş ¯ ɾ -05	Instrumenta të tjerë nga ai i kërkuar, kalibra, matës thellësie
					Direct method-metoda direkte	
	- digital		From (nga) 0,5 mm	from 0,0058 mm		
			To (në) 1 000 mm	to 0,0070 mm		
	- mechanical		From (nga) 0,5 mm	from 0,0082 mm		
			To (në) 1 000 mm	to 0,0097 mm		
5	Scale marks measures of length: -tape measures	Length, mm	From (nga) 0 mm	from 0,15 mm	ʃ ş ¯ ɾ -03	E njëjta si më sipër
	-tapes		To (në) 30 000 mm	tts 0,50 mm	Comparative method-metoda krahasuese	
	-Measuring lines;		From (nga) 0 mm	0,15 mm		
			To (në) 3000 mm			
	-tape measures ëith tensioning ëeight and sinker		From (nga) 0 mm	0,06 mm	ʃ ş ¯ ɾ -03-01	
			To (në) 310 mm		Comparative method-metoda krahasuese	
			From (nga) 310 mm	from 0,21 mm		
			To (në) 30 000 mm	tts 0,60 mm		
6	Gauge blocks	Length, mm	From (nga) 0,5 mm	from 0,22 µm	ʃ ş ¯ ɾ -06	E njëjta si më sipër
			To (në) 100 mm	tts 0,36 µm	Comparative contact method-Metoda krahasuese e kontaktit	
7	Vacuum and	Pressure,	From (nga)	from 3.10^{-3}	ʃ ş ¯ ʅ -01	E njëjta si më sipër

	Pressure measuring instruments		negative (-) 0,9 bar	bar		
		p, bar	To (në) 35 bar	tts 6.10^{-3} bar	Comparative method-metoda krahasuese	
8	Floë meters for ëater and liquids other than ëater	Volume, m³, volumetric floë rate, m³/h	From (nga) 0,001 m³/h	0,05%	∫ ş ¯ Razhod-01	Matës të rrjedhës për ujë dhe lëngje të ndryshme nga uji, pra jo për instrumentin e kërkuar, si dhe njësia e matjes dhe intervali i matjes i ndryshëm nga ai i kërkuar në specifikimet teknike.
			To (në) 150 m³/h		Comparative method-metoda krahasuese	

Pra sipas informacionit të pasqyruar në tabelën e mësipërme, në asnjë nga fushat Laboratori D, nuk është i akredituar për kalibrimin e instrumentit/instrumentave për matjen e volumit të gazit, që të ketë njësi matëse Litër/minut dhe të përfshijë intervalin e caktuar prurja maksimale = 50 Litra/minut dhe Prurja minimale 5 Litra/minut.

Për më tepër metoda referuar nga Laboratori D në rrjeshtin 8, bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15, pikën 1, në Ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur është paraqitur certifikata e kalibrimit:

Neni 15 Kalibrimi i etaloneve të matjes dhe instrumenteve matëse

1. Kalibrimi kryhet në përputhje me dokumentet dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare për standardizimin, akreditimin dhe metrologjinë, si EURAMET-Organizata Rajonale e Metrologjisë për Europën[27], OIML-Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore[28], ILAC-Organizata Ndërkombëtare për Akreditimin e Trupave të ndryshëm (testues, inspektues, kalibrues).[29]

-Gjithashtu po ju pasqyrojmë një model (foto ilustruese) të akreditimit të laboratorit për shërbimin e kalibrimit, nënshkrues i marrëveshjes EA-MLA, ku specifikohen qartë fushat e akredituara.

[27] https://www.euramet.org/index.php?eID=tx_securedownloads&p=446&u=0&g=0&t=1666301856&hash=8f3c5684cdfb5596ac61d467c807a1f608a9b584&file=Media/docs/Publications/calguides/I-CAL-GUI-023_Calibration_Guide_No._23_web.pdf

[28] https://oiml.nim.ac.cn/sites/default/files/media/document/2020-07/r117-1-e19.pdf

[29] ILAC_G18_04_2010.pdf-Materiali e specifikon se si duhet të përcaktohen fushat, instrumentat për të cilat është i akredituar laboratori që ofron shërbimin e verifikimit.

Annex to declaration of accreditation (scope of accreditation)
Normative document: EN ISO/IEC 17025:2017
Registration number: **K 127**

of **Bronkhorst High-Tech B.V.**
Bronkhorst Calibration Centre

This annex is valid from: **22-04-2020** to **01-06-2022** Replaces annex dated: **24-04-2019**

Location(s) where activities are performed under accreditation

Head Office

Nijverheidsstraat 1A
7261 AK
Ruurlo
Netherland

Location	Abbreviation/ location code
Nijverheidsstraat 1A 7261 AK Ruurlo Netherland	RU

HCS code	Measured quantity, Instrument, Measure	Range	CMC[1]	Remarks	Location
FG 1 0	FLOW OF GAS				RU
FG 1 1	Gas volume flow rate	0.16 ml/min – 108 ml/min	0.55% - 0.30%	Piston Prover	
		5.4 ml/min – 33 l/min	0.30% - 0.25%	Piston Prover	
		0.11 m^3/h – 409 m^3/h	0.35 % – 0.25 %	Rotary Meter	
FG 1 1	Gas mass flow rate	0.15 ml_n/min – 100 ml_n/min	0.55% - 0.30 %	Piston Prover	
		5.0 ml_n/min – 30 l_n/min	0.30 % – 0.25 %	Piston Prover	

This annex has been approved by the Board of the Dutch Accreditation Council, on its behalf,

J.A.W.M. de Haas

[1] Calibration and Measurement Capability (CMC): Demonstrated measurement uncertainty, with coverage probability of 95%, in a given measurement point or measurement range. Measurement uncertainty, *U*, is calculated according to EA-4/02 "*Evaluation of the Uncertainty of Measurement in Calibration*".

Annex to declaration of accreditation (scope of accreditation)
Normative document: EN ISO/IEC 17025:2017
Registration number: **K 127**

of **Bronkhorst High-Tech B.V.**
Bronkhorst Calibration Centre

This annex is valid from: **22-04-2020** to **01-06-2022** Replaces annex dated: **24-04-2019**

HCS code	Measured quantity, Instrument, Measure	Range	CMC[1]	Remarks	Location
		0.1 m^3_n/h – 380 m^3n/h	0.35 % – 0.25 %	Rotary Meter	
FL 1 0	FLOW OF LIQUIDS				RU
FL 1 1	Liquid mass flow rate	(1 – 2) g/h	0.65%	Balance	
		(2 – 10) g/h	0.35%	Balance	
		(0.01 – 30) kg/h	0.10%	Balance	
PV 0 0	PRESSURE AND VACUUM				RU
PV 1 1	Absolute gas pressure	(2.5 – 3500) kPa	$5.10^{-4}\cdot p$ + 80 Pa	Pressure Calibrator	
		(0.1 – 41.5) MPa	$5.10^{-4}\cdot p$ + 1.4 kPa	Pressure Calibrator	
		(0.1 – 41.5) MPa	$5.10^{-4}\cdot p$ + 1.4 kPa	Pressure Calibrator	
PV 1 2	Over atmospheric gas pressure	(-97.5 – 3400) kPa	$5.10^{-4}\cdot p_e$ + 80 Pa	Pressure Calibrator	
		(0 – 41.4) MPa	$5.10^{-4}\cdot p_e$ + 1.4 kPa	Pressure Calibrator	

Remarks:

The ambient temperature and humidity during calibration is: 21 °C ± 2 °C and 50 %rh± 20 %rh resp.

Calibration gases:
For Piston prover: Compressed dry Air, Ar, N_2, CO_2, H_2 or He; other gases on request
For Rotary meter: Compressed dry Air only

The flow units ml_n/min and l_n/min refer to gases under normal (n) conditions of 273.15 K and 101325 Pa.

Fixed normal densities ρ_n [kg/m³] are used to convert from the flow unit [l_n/min] to the mass flow unit [g/h], using the equation:

$$\Phi_m\left[\frac{g}{h}\right] = \Phi_m\left[\frac{l_n}{min}\right]\cdot\rho_n\left[\frac{kg}{m^3}\right]\cdot 60$$

For example:

Annex to declaration of accreditation (scope of accreditation)
Normative document: EN ISO/IEC 17025:2017
Registration number: **K 127**

of **Bronkhorst High-Tech B.V.**
Bronkhorst Calibration Centre

This annex is valid from: **22-04-2020** to **01-06-2022** Replaces annex dated: **24-04-2019**

Gas	Normal density [kg/m3]	Equivalent [g/h] to 1 [l_n/min]:
Compressed dry air (AiR)	1.293	77.58
Argon (Ar)	1.784	107.0
Nitrogen (N2)	1.250	75.02
Carbon dioxide (CO2)	1.977	118.6
Hydrogen (H2)	0.08991	5.395
Helium (He)	0.1785	10.71

This way, any flow of any gas in [l_n/min] can be converted into mass flow in [g/h].

-Certifikata e kalibrimit e sjellë nga OE shpallur fitues, mban datën 26.08.2020, pra rreth 1 muaj me vonesë nga data 27.07.2020, përcaktuar në DST, si dokument për tôu dorëzuar nga OE;
-Certifikata e kalibrimit është lëshuar për aplikantin Sk GE Ltd EOOD, Adresa:44 Ul. I str.AP. O 18, F 3, SZ, 6000 Bulgaria, pra jo përN.V/ISHMT, blerës/përdorues të këtij instrumenti[30];
Sa më sipër, observacioni juaj merret në konsideratë për përdorimin e logos ILAC-MRA, në certifikatën e kalibrimit.

Observacion: Për produktin 4 "Kalibër, digjital", certifikatë kalibrimi me numër P19-045023. Certifikata e kalibrimit është nga prodhuesi në momentin e dorëzimit të produktit bashkë me dorëzimin e mallit. (bashkëlidhur foto e certifikatës së kalibrimit).
Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:
-Për argumentin (bashkëlidhur edhe foto e certifikatës së kalibrimit) tuaj në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit se gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, nga OE N.V për produktin 4 ñKalibër, digjitalò, nuk është sjellë certifikatë kalibrimi, sqarojmë se:
-Në DST, shtojca nr.1, datë 17.07.2020, pika 5 për kapacitetin teknik, keni përcaktuar shprehimisht:
1.ñNë shtojcën 9 të DST-ve, e ndryshuar, lidhur me specifikimet teknike për artikullin ñkalibër digjital), keni kërkuar:
Duhet që të ketë Markimin CE, Markimin metrologjik suplementar M, të shoqëruar me Deklaratën e Konformitetit dhe Dokumentacionin Teknik. **Gjithashtu të jenë të pajisur me certifikatë kalibrimi** nga një laborator kalibrues i akredituar sipas standardit ISO17025, akredituar nga një organ akreditimi, i cili ka firmosur marrëveshjen e EA-MLA, e cila është firmosur dhe nga Shteti Shqiptarò.
Afati kohor i dorëzimit të ofertave dhe hapjes së ofertave shtyhet më datë 27.07.2020.
2.ñNë DST, shtojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, nëse gjuha e përdorur në procedurëështë gjuha shqipe, atëherë**dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me njëpërkthim të noterizuar në gjuhën shqipe**ò.
3.ñNë DST, pika 9, paragrafi në vijim ï ñDokumentacioni duhet origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. **Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti** ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për sôkualifikimò.
4.ñPika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020, lidhur ndërmjet palëve ISHMT-N.V shpk, ku përcaktohet se: Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, çmimi i kontratës përfshin kostot dhe **tarifat**, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhura me dorëzimin e mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualet **dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar** dhe të nevojshme për përdorim të rregullt, mirëmbajtje dhe riparime të mallrave. Vlera e taksës dhe tarifave duhet

[30]Nenin 15, pikën 2, në Ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur është paraqitur certifikata e kalibrimit.

tëpërcaktohet sipas legjislacionit përkatës, 28 ditë para hapjes së ofertaveò. **Pra sa më sipër gjuha e specifikuar është gjuha shqipe.**
-Për të vijuar më tej, në asnjë rast nuk është përcaktuar se certifikata e kalibrimit duhet të shoqërojë produktin gjatë dorëzimit të tij, pra argumenti juaj nuk qëndron;
-Certifikata e kalibrimit e sjellë nga ju në observacion, nuk janë në gjuhën shqipe, sipas përcaktimeve të bëra nështojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe Pika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020. Në kushtet e mësipërme ky OE, duhet të ishte sõkualifikuar gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, dhe përveç kësaj, certifikatat e kalibrimit të dorëzuara nga OE gjatë dorëzimit të mallit, nuk janë në gjuhën e specifikuar, kusht për refuzimin e pranimit të tyre.
-Certifikata e kalibrimit për produktin ñkalibër digjitalò nuk përmban standardin ISO:17025, standardi për akreditimin e laboratorëve për lëshimin e certifikatave të kalibrimit.
-Certifikata e kalibrimit nuk jep asnjë informacion se për këështë lëshuar, blerësin/përdoruesin[31].
-Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Observacion:Në bazë të Shtojcës Nr 1. Datë 17.07.2020 ñPër modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit, ñKërkesë për propozimò, me objekt: ñBlerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim në terrenò, me fond limit: 5.000.000 lek pa tvsh dhe nr REF-64283-07-06-2020ò, pikA 5 ñ5. Në Shtojcën 9 të DST-ve, në specifikimet teknike për artikujt ñmatësò, me numër rendor **12, 13**, 14, 15, 16 dhe 17 shtohet paragrafi si më poshtë:
ñInstrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, duhet që të mbartin Markimin CE, Markimin Metrologjik Suplementar M, të shoqëruar me Deklaratën e Konformitetit dhe Dokumentacionin Teknik. Gjithashtu të jenë të pajisur me çertifikatë kalibrimi nga një laborator kalibrues i akredituar sipas standartit ISO 17025, akredituar nga një organ akreditimi i cili ka firmosur marrëveshjen e EA-MLA e cila është e firmosur dhe nga shteti Shqiptarò
Referuar ndryshimeve sa më sipër kërkuar nga APP, kërkesat për markimi CE, Markimi Suplementar Metrologjik dhe instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, Deklaratën e Konformitetit dhe Dokumentacionin Teknik është kërkuar për instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar. Sqarojmë se produkti matës temperature me një sensor NTC, me bateri, nuk është instrument matës ligjërisht i kontrolluar në kuptim të Ligjit nr.9875/2008 Për Metrologjinëò, i ndryshuar dhe VKM nr.770/2016 ñPër miratimin e rregullit teknik ñPër instrumentet matëseò, për disa ndryshime në vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, ñPër miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluaraò, dhe pyrcaktimin e listys së standardeve të harmonizuara. Në këto kushte ky instrument matës nuk është i nevojshëm që të ketë markimin suplementar, por është i mjaftueshëm deklarata e konformitetit. (bashkëlidhur foto deklarata e konformitetit)
Certikata e kalibrimit referuar edhe shtojcës 1 dhe specifikimeve teknike në Shtojcën 9 të DST, është një dokument që duhet të shoqërojë produktin gjatë dorëzimit të tij. Për të patur sigurinë që produktet do të jenë të kalibruara OE i janë kërkuar referenca të kalibrimeve të ngjashme.
GA konstaton në mënyrë të gabuar kur vlerëson se certifikatat e kalibrimit të produkteve janë kërkuar gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave. Në DST certifikatat përkatëse të kalibrimit duhet të shoqërojnë mallin gjatë dorëzimit të tij.
Nga ana e OE janë paraqitur në specifikimet teknike certifikata kalibrimi të produkteve të ngjashme nga OE (T 735-2). Duke qenë se kalibrimi ka një vlefshmëri kohore të caktuar, atëherë është e përshatshme që afati i kalibrimit të jetë sa më afër datës së dorëzimit të mallit. Certifikatat e kalibrimit janë bashkëlidhur këtij materiali dhe jepen në foto në vijim për instrumentin matës të

[31] Nenin 15, pikën 2, në Ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur është paraqitur certifikata e kalibrimit

ofertuar T 720 me numër përkatësisht 03523147 dhe 03523069 dhe të administruara nga ISHMT. Të dhënat mbi këtë kalibrim janë të konstatuara dhe nga GA nëpërmjet fotove.
Për sa i përkët konstatimit nga GA se Certifikatat e Kalibrimit nuk janë lëshuar në emër të OE port ë Subjektit K.R Shpk, nëpërmjet dokumentit të noterizuar ñAutorizim Distributoriò (foto bashkëlidhur) jepet e drejta N.V Shpk të negociojë dhe të nënshkruajë kontratë me ISHMT për tenderin me objekt ñBlerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim në terrenò. Gjithashtu në këtë në dokumentin e noterizuar unifikim me origjinalin ñLetër Autorizimi 2020ò, kompania TS& co kga Autorizon subjektin K.R Shpk për të marrë dokumentat e tënderit në fjalë dhe të paraqesë oferta në emër të saj. Në këto kushte provohet qartësisht lidhja midis K.R Shpk si distributor i autorizuar i kompania TS& co kga dhe K.R me Subjektin N.V Sh.p.k. Certifikatat e kalibrimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. (Bashkëlidhur certifikatat).
Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:
-Për argumentin (bashkëlidhur edhe certifikata e kalibrimit) tuaj në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit për produktet 12 dhe 13, sqarojmë se:
-Në DST, shtojca nr.1, datë 17.07.2020, pika 5 për kapacitetin teknik, keni përcaktuar shprehimisht:
1.ñNë shtojcën 9 të DST-ve, në specifikimet teknike për artikujt ñmatësò, me numër rendor **12, 13,** 14, 15, 16 dhe 17, shtohet paragrafi si më poshtë:
Instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, duhet që të mbartin Markimin CE, Markimin metrologjik suplementar M, të shoqëruar me Deklaratën e Konformitetit dhe Dokumentacionin Teknik. **Gjithashtu të jenë të pajisur me certifikatë kalibrimi** nga një laborator kalibrues i akredituar sipas standardit ISO17025, akredituar nga një organ akreditimi, i cili ka firmosur marrëveshjen e EA-MLA, e cila është firmosur dhe nga Shteti Shqiptarò.
Afati kohor i dorëzimit të ofertave dhe hapjes së ofertave shtyhet më datë 27.07.2020.
Ndërkohë në argument shpreheni se produktet 12 dhe 13 nuk janë instrumenta matës dhe nuk janë të nevojshëm të kenëmarkimin suplementar, por është i mjaftueshëm deklarata e konformitetit. Pra juve edhe e përcaktoni si kriter në DST, edhe e rrëzoni nëpërmjet argumentit tuaj.
Gjithashtu grupi i auditimit nuk është shprehur për markimin suplementar dhe deklaratën e konformitetit, por për certifikatën e kalibrimit, ku sipas përcaktimit të bërë në:
2.ñNë DST, shtojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, nëse gjuha e përdorur në procedurëështë gjuha shqipe, atëherë**dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me njëpërkthim të noterizuar në gjuhën shqipe**ò.
3.ñNë DST, pika 9, paragrafi në vijim ï ñDokumentacioni duhet origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. **Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti** ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për sõkualifikimò.
4.ñPika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020, lidhur ndërmjet palëve ISHMT-N.V shpk, ku përcaktohet se: Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, çmimi i kontratës përfshin kostot dhe **tarifat**, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhura me dorëzimin e mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualet **dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar** dhe të nevojshme për përdorim të rregullt, mirëmbajtje dhe riparime të mallrave. Vlera e taksës dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas legjislacionit përkatës, 28 ditë para hapjes së ofertaveò. **Pra sa më sipër gjuha e specifikuar është gjuha shqipe.**
Për të vijuar më tej, në asnjë rast nuk është përcaktuar se certifikata e kalibrimit duhet të shoqërojë produktin gjatë dorëzimit të tij, pra argumenti juaj nuk qëndron;
Certifikatat e kalibrimit të sjella nga ju në observacion për produktin 12 dhe 13, nuk janë në gjuhën shqipe, sipas përcaktimeve të bëra nështojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe Pika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020. Në kushtet e mësipërme ky OE, duhet të ishte sõkualifikuar gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, dhe

përveç kësaj, certifikatat e kalibrimit të dorëzuara nga OE gjatë dorëzimit të mallit, nuk janë në gjuhën e specifikuar, kusht për refuzimin e pranimit të tyre;
Cerifikatat e kalibrimit nuk përmban standardin ISO:17025, standardi për akreditimin e laboratorëve për lëshimin e certifikatave të kalibrimit;
Kompania TS&Co kga nuk ka laborator të akredituar për të lëshuar certifikata kalibrimi, verifikuar në faqen www.dakks.de - Trupi Gjerman i Akreditimit nënshkrues i marrëveshjes EA-MLA[32].
Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Observacion: Certikata e kalibrimit referuar edhe shtojcës 1 dhe specifikimeve teknike në Shtojcën 9 të DST, është një dokument që duhet të shoqërojë produktin gjatë dorëzimit të tij. Për produktet Kronometër ISHMT administron certifikatat e kalibrimit nga SIQ me numër serie përkatësisht SIQ20059, SIQ20060, SIQ20061 të datës 07.09.2020.
Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:
-Për argumentin (bashkëlidhur edhe certifikata e kalibrimit) tuaj në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit për produktin 17, sqarojmë se:
-Në DST, shtojca nr.1, datë 17.07.2020, pika 5 për kapacitetin teknik, keni përcaktuar shprehimisht:
1.ñNë shtojcën 9 të DST-ve, në specifikimet teknike për artikujt ñmatësò, me numër rendor 12, 13, 14, 15, 16 dhe **17,** shtohet paragrafi si më poshtë:
Instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, duhet që të mbartin Markimin CE, Markimin metrologjik suplementar M, të shoqëruar me Deklaratën e Konformitetit dhe Dokumentacionin Teknik. **Gjithashtu të jenë të pajisur me certifikatë kalibrimi** nga një laborator kalibrues i akredituar sipas standardit ISO17025, akredituar nga një organ akreditimi, i cili ka firmosur marrëveshjen e EA-MLA, e cila është firmosur dhe nga Shteti Shqiptarò.
Afati kohor i dorëzimit të ofertave dhe hapjes së ofertave shtyhet më datë 27.07.2020.
2.ñNë DST, shtojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, nëse gjuha e përdorur në procedurëështë gjuha shqipe, atëherë**dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me njëpërkthim të noterizuar në gjuhën shqipe**ò.
3.ñNë DST, pika 9, paragrafi në vijim ï ñDokumentacioni duhet origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. **Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti** ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për sõkualifikimò.
4.ñPika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020, lidhur ndërmjet palëve ISHMT-N.V shpk, ku përcaktohet se: Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, çmimi i kontratës përfshin kostot dhe **tarifat**, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhura me dorëzimin e mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualet **dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar** dhe të nevojshme për përdorim të rregullt, mirëmbajtje dhe riparime të mallrave. Vlera e taksës dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas legjislacionit përkatës, 28 ditë para hapjes së ofertaveò. **Pra sa më sipër gjuha e specifikuar është gjuha shqipe.**
Për të vijuar më tej, në asnjë rast nuk është përcaktuar se certifikata e kalibrimit duhet të shoqërojë produktin gjatë dorëzimit të tij, pra argumenti juaj nuk qëndron;
Certifikatat e kalibrimit të sjella nga ju në observacion për produktin 17, nuk janë në gjuhën shqipe, sipas përcaktimeve të bëra nështojca nr.8 - 1.Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe Pika 18.2, neni 18 i kontratës nr.1321/11 prot., datë 24.08.2020. Në kushtet e mësipërme ky OE, duhet të ishte sõkualifikuar gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, dhe përveç kësaj, certifikatat e kalibrimit të dorëzuara nga OE gjatë dorëzimit të mallit, nuk janë nëgjuhën e specifikuar, kusht për refuzimin e pranimit të tyre;

[32]https://www.dakks.de/en/search-result.html

-Grupi i auditimit bëri verifikimin në faqen zyrtare të Agjencisë së Akreditimit në Sllovenihttps://www.slo-akreditacija.si/, e cila është nënshkruese e marrëveshjes EA-MLA, siç e keni kërkuar edhe ju, si dhe në faqen zyrtare të agjencisë së mësipërme, bëri verifikimin për laboratorin që ka lëshuar certifikatën e kalibrimit për produktin kronometër, https://www.slo-akreditacija.si/acreditation/slovenski-institut-za-kakovost-in-meroslovje-3/?lang=en, ku rezultoi se ky laborator, sipas fushave dhe nënfushave të akredituara, për të cilat ofron shërbimin e kalibrimit, për sa i përket kalibrimit të kronometrave/më specifikisht fusha ñkoha relativeò nuk e ofron si shërbim. Ky laborator e përdor si instrument ñkronometrinò gjatëmetodave të testimit të instrumenteve të kohës dhe frekuencës

Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Observacion:ISHMT - Kërkesat për markimin CE të aparatit Lux metër, bazuar në konstatimin e GA të KLSH për mungesën e markimit CE të aparatit Lux metër, bëjmë me dije se:

Bazuar në Ligjin 10489/2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar pika 3 ku parashikohet se ñMarkimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet vetëm në produktet, për të cilat është parashikuar kjo vendosje/fiksim nga rregullat teknike të zbatueshme dhe nuk duhet të vendoset në produkte të tjeraò, dhe pika 7 të nenit 9 ku parashikohet se ñMarkimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në produkt ose në pllakën e tij të të dhënave. Kur kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së produktit, markimi vendoset në paketim ose në dokumentet shoqëruese, në qoftë se rregulli teknik përkatës parashikon dokumente të tilla.

Nëpërmjet letrës së tij të Konfirmimit, prodhuesi konfirmon që jo të gjithë pajisjet që ai prodhon (që sigurisht janë konform të gjithë direktivave dhe normave të CE kanë të vendosur në trupin e tyre Markimin CE). Përkatësisht për këtë arsye prodhuesi harton dhe lëshon Deklaratën e Konformitetit për të lajmëruar përdoruesin fundor që ky produkt është prodhuar dhe testuar në përputhje me të gjithë normat dhe kërkesat të përmendura në të. Bashkëlidhur do të gjeni Letrën e Konfirmimit të prodhuesit, deklaratën e konformitetit dhe foto të markimit CE (foton më poshtë) të vendosur në paketimin e produktit. Sic evidentohet nga dokumentacioni dhe evidencat pajisja në pëputhje më specifikimet teknike dhe konformitetin dhe si rrjedhojë nuk mund të klasifikohet vlera e saj si dëm ekonomik.

Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH:

Si fillim verifikimin e pajisjeve të marra në dorëzim nga ju dhe më konkretisht, aparatin Lux metër, është bërë në prani të magazinieres së institucionit dhe zj.S.B, Përgjegjëse e Sektorit të Inspektimit të Produkteve Mekanike, njëkohësisht anëtare e grupit të marrjes në dorëzim;

Për aparatin testues izolacioni multimetër është veç magazinierit është bërë në prani edhe të z.L.L Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Produkteve Elektrike, si dhe ky aparat u ndez dhe u vu në funksion nga vetë personi i sipërcituar;

Për aparatin e matjes së volumit të gazit, është bërë në prani të z.R.B, Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Metrologjisë.

Gjatë këtyre verifikimeve, personave të sipërcituar, si specialist të fushës, por edhe anëtar të komisionit të marrjes në dorëzi (zj.S.B), i janë vënë në dukje mangësitë e produkteve në përputhje me specifikimet teknike. Nga këta persona apo edhe Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve, gjatë auditimit pranë ISHMT nuk është sjellë asnjë dokument që të arsyetojë argumentin tuaj në këtë observacion.

-Sa për dokumentacionin që keni sjellë ju (deklarata konformiteti, letër e prodhuesit), janëfotokopje dhe mund të shkarkohen lehtësisht në internet dhe të manipulohet;

-Ky dokumentacion nuk është në gjuhën shqipe edhe as i noterizuar siç i keni kërkuar në termat e DST, për më tepër janë detyrim ligjor, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 8 në Ligjin nr.10489/2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar;

-Keni sjellë një letër, ku pasqyrohet informacioni që kompania M, deklaron se në disa produkte nuk mund të vendoset markimi CE, dhe në këto kushte ajo pasqyrohet në deklaratën e konformitetit. Si është e mundur që përfaqësuesi i autorizuar lëshon një deklaratë në emër të prodhuesit të produktit, ndërkohë që procesin e hartimit të deklaratës së konformitetit dhe fiksimin e markimit CE e bënë vetëm prodhuesi i produktit. Për më tepër që edhe Ligji nr.10489/2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar, neni 2, shkronja ñaò e kanë përcaktuar qartë se cfarë mund të bëjë përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit të produktit. Po kështu edhe letrën e konfirmimit.
-Deklarata e konformitetit për produktin e mësipërm nuk përmban as numrin serial të tij, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në shkronjën ñaò të pikës 2 të nenit 8 në Ligjin nr.10489/2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar.
-Sa i përket markimit CE, në përcaktimet Ligjore të bëra nëLigjin nr.10489/2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar:
-Pika 2, neni 9 - Markimi CE i konformitetit **fiksohet në produkt** përpara vendosjes së tij në treg. Ai mund të shoqërohet nga një piktogram ose ndonjë tregues për një përdorim ose rrezik të veçantë;
-Pika 3, neni 9 - Markimi CE i konformitetit **vendoset/fiksohet vetëm në produktet**, për të cilat është parashikuar kjo vendosje/fiksim nga rregullat teknike të zbatueshme dhe nuk duhet të vendoset në produkte të tjera;
-Pika 7. Markimi CE i konformitetit **vendoset/fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në produkt ose në pllakën e tij të të dhënave**. **Kur kjo nuk është e mundur** për **shkak të natyrës së produktit**, markimi **vendoset** në **paketim ose në dokumentet shoqëruese**, në qoftë se rregulli teknik përkatës parashikon dokumente të tilla. Ilustruar më poshtë për një nga produktet që ju keni marrë në dorëzim:

-Pra në produktin e mësipërm markimi CE është i fiksuar në trupin e produktit dhe numrin e identifikimit të organit notifikues.
-Ky argumentim vlenë edhe për pajisjet e tjera të marra në dorëzim.

-Argumenti juaj që në DST përcaktoni si kriter markimin CE, ndërkohë në observacion shpreheni se nuk është i nevojshëm markimi CE, nuk merret në konsideratë.

Shpenzimet për "Pajisje për videokonferencë dhe panel akses kontrolli".
Nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse me kërkesën nr.2982 prot., datë 03.12.2020 është bërë kërkesë për pajisjen me sistem check-in dhe panel kontrolli hyrje-dalje.
Me urdhërin nr.218, datë 26.11.2020 është ngritur grupi i punës për marrjen e ofertave dhe testimin e tregut për pajisjet e mësipërme, me përbërje si vijon:
-G.N
-A.Sh
-D.A
Me procesverbalin nr.2933/1, datë 04.12.2020 nga grupi me përbërje A.M, M.M dhe A.M, janë marrë 3 oferta nga operatorët I.N.al shpk, E, F shpk, dhe është përcaktuar fondi limit në vlerën 750,000 lekë pa TVSH.
Urdhëri i prokurimit nr.230, datë 07.12.2020, ka dalë për blerjen e pajisjeve të videokonferencës dhe panel akses kontrolli.
Operatorë Ekonomik që kanë konkurruar në procedurën e mësipërme:

1. FE ï 599,000 lekë
2. AK ï 629,000 lekë
3. OT ï 666,667 lekë
4. A.O ï 669,000 lekë
5. R AL ï 689,000 lekë
6. PCS ï 698,500 lekë
7. AD ï 700,000 lekë
8. EH ï 714,000 lekë
9. 2H ï 720,000 lekë
10. FL ï 720,000 lekë
11. ES ï 728,900 lekë
12. ZN ï 730,000 lekë
13. JG ï 733,333 lekë
14. I.N.AL ï 735,000 lekë

Fitues është shpallur subjekti ñA.Oò me ofertën me vlerë 669,000 lekë pa TVSH/802,800 lekë me TVSH.
Fatura tatimore me nr.serial 90098168 datë 16.12.2020, tek përshkrimi i mallit nuk i ka të specifikuara mallrat e furnizuara, por ka mbishkrimin shitje sipas faturës bashkangjitur, e cila nuk ka vlerë ligjore, pasi nuk njihet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
Me procesverbalin nr.3215, datë 16.12.2020 nga Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave, me përbërje A.M, M.M dhe A.M, bashkëlidhur fletë hyrja nr.19, datë 16.12.2020, ku pasqyrohet informacioni:
1.Riparim ekran 50 inch
2.Video Suport;
3.Mikrofon Tavolinash;
4.Kufje, kamera për PC;
5.Riparim dhe aksesor për derën kryesore;
6.Karta check-in;
7.Riparim audio-vidjo;
8.Mikrofona akullore;
9.Mirëmbajtje, konfigurim.
Subjekti është likujduar nga ISHMT më datë 28.12.2020 me Urdhër shpenzimin nr.244.

Titulli i Gjetjes	**Shpenzimet për "Pajisje për videokonferencë dhe panel akses kontrolli"-viti 2020**
Situata	**Në proçedurën e mësipërme konstatohet se:** -Nga Titullari i ISHMT-së nuk është nxjerrë urdhëri për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim të mallrave. Për këtë mbanë përgjegjësi z.L.S. -Është i njëjti grup i cili administrimit të procedurës së prokurimit, ka marrë në dorëzim mallrat, me përbërje M.M, A.M, A.M, si dhe në komisionin e marrjes në dorëzim nuk është personi me përgjegjësi materiale në ISHMT. Për ktë mbanë përgjegjësi Titullari i ISHMT, z.L.S. -Procedura e mësipërme nuk është zhvilluar me mjete elektronike; -Kërkesat e 3 operatorëve të renditur të parët për të cilat janë mbajtur procesverbalet (3 në total) nga grupi i mësipërm, me titull ñPër kalimin tek operatori ekonomik i rradhësò sipas datave 10 dhe 11.12.2020, janë fotokopje, të panoterizuara, pa numër protokolli të ISHMT, pa datë, çka nuk pasqyron me vërtetësi nëse këta operator janë tërhequr nga gara; -Sipas fletë-hyrjes nr.19, datë 16.12.2020 në magazinë e ISHMT, të mallrave të furnizuar, konstatohet se ato nuk përputhen me mallrat e përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit nr.230, datë 07.12.2020, si dhe janë shtuar zëra të cilët nuk janë kërkuar, konkretisht: <table><tr><td>Përcaktuar në Urdhërin e Prokurimit</td><td>Furnizuar sipas emërtimit</td></tr><tr><td>Ekran TV 50 inch LCD ëireless</td><td>Shërbim riparim ekrani në vlerën 70,680 lekë</td></tr><tr><td>Nuk është kërkuar</td><td>Riparim dhe aksesorë për derën kryesore në vlerën 46,200 lekë</td></tr><tr><td>Nuk është kërkuar mirëmbajtje, por vetëm konfigurime, të cilat nuk janë tarifuar, por është përcaktuar që shërbimi (konfigurime) të jetë i përfshirë në vlerën e pajisjeve të porositura</td><td>Mirëmbajtje dhe konfigurime, ku është tarifuar vlera 123,600 lekë</td></tr><tr><td>Nuk është kërkuar</td><td>Riparim audio dhe video në vlerën 58,200 lekë</td></tr><tr><td>Nuk është kërkuar</td><td>Video support në vlerën 198,000 lekë</td></tr><tr><td>Kamera vëzhgimi</td><td>Nuk është sjellë</td></tr><tr><td>Kamera për video-konferencë</td><td>Nuk është sjellë</td></tr></table>-Në këto kushte, nuk duhet të ishin pranuar zërat e mësipërm nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe më pas marrja në dorëzim e tyre. -Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.M.M, zj.A.M, z.A.M;
Kriteri	Pika 11, neni 3 në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar; Shkronja b, pika 3 në nenin 22 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; Neni 101 i Ligjit nr.92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò; Pika 3, neni 57, VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për prokurimin publikò, i ndryshuar; Pikat 42, 43 dhe 47 e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar; Pika 18 në Udhëzimin nr.3, datë 8.01.20181 ñmbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, ndryshuar; Fletë-hyrja nr.19, datë 16.12.2020 në magazinë të mallrave; Fatura tatimore me nr.serial 90098168 datë 16.12.2020.
Ndikimi/Efekti	Janë marrë në dorëzim mallra/shërbime në vlerën 426,000 lekë, të cilat nuk kanë qenë objekt prokurimi sipas Urdhërit të Prokurimit nr.230, datë 07.12.2020, të Titullarit të ISHMT, me efekt dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.
Shkaku	Marrja në dorëzim e mallit të pa kërkuar; Mosrespektim i detyrimeve kontraktore nga OE shpallur fitues, i cili ka shtuar zëra në faturë, të cilat nuk kanë qenë objekt prokurimi;

	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore të bëra në kuadrin rregullator në fushën e prokurimit
Rëndësia	E Lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 426,000 lekë, nga OE ñA.Oò person fizik. **Menjëherë**

Shpenzimet për "Pajisje kompjuterike".
Me urdhërin nr.168, datë 06.10.2020 është ngritur grupi i punës për marrjen e ofertave dhe testimin e tregut për pajisjet e mësipërme, me përbërje si vijon:
-E.L
-G.N
-L.L
Me shkresën nr.2272 prot., datë 23.09.2020 ISHMT i është drejtuar AKSHI-t për miratimin e specifikimeve teknike;
Në dosje administrohet shkresa me nr.2278/1 prot., datë 07.10.2020, e dërguar nga AKSHI për miratimin e specifikimeve teknike;
Me procesverbalin nr.2399/2 prot., datë 07.10.2020 nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operator ekonomik (ST, KQ dhe I.N.al) është përcaktuar fondi limit i procedurës në vlerën 800,000 lekë pa TVSH, si dhe miratimi i relacionit nga titullari i institucionit;
Urdhëri i prokurimit nr.187, datë 27.10.2020 për blerjen e pajisjeve kompjuterike në vlerën 800,000 lekë pa TVSH;
Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr.2572/1 prot., datë 27.10.2020, bashkëlidhur specifikimet teknike, si dhe përcaktohet afati i lëvrimit të mallrave brenda 3 ditëve pune nga momenti i njoftimit të fituesit;
Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje z.M.M, zj.A.M, z.A.M, ku është shpallur fitues OE i renditur i pari me ofertën më të ulët në vlerën 712,450 lekë pa TVSH;
Formulari i njoftimit të ofertës fituese për subjektin I.N.AL, me nr.2572/2 prot., datë 28.10.2020;
Garancia e lëshuar nga OE;
Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave të furnizuara, nr.2572/3 prot., datë 02.11.2020
Fatura tatimore e lëshuar nga OE më datë 06.11.2020 për mallrat e furnizuara;
Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave të furnizuara, nr.2572/4 prot., datë 06.11.2020 për marrjen në dorëzim të mallrave të furnizuara, ku pasqyrohet mbishkrimi, OE ka sjellë mostrat si më poshtë:
Kompjuter FE E/720/Corei3 G4/HDD 500 Gb ï 10 copë;
Laptop L i kompletuar ï 10 copë.
Fletë-hyrja në magazinën e institucionit nr.15, datë 06.11.2020.
Subjekti likujduar më datë me Urdhër shpenzimin nr.226, datë 03.12.2020.

Titulli i Gjetjes	**Shpenzimet për "Pajisje kompjuterike"-viti 2020**
Situata	-Garancia e lëshuar nga OE është fotokopje, e pa noterizuar, si dhe e pa nënshkruar nga Komisioni i marrjes në dorëzim. Gjithashtu ajo nuk specifikon afatin e mbulimit, siç është kërkuar në specifikimet teknike, pra 3 vjet; -Nga Titullari i ISHMT-së nuk është nxjerrë urdhëri për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim të mallrave. Për këtë mbanë përgjegjësi z.L.S. -Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël; -Është i njëjti grup i cili administrimit të procedurës së prokurimit, ka marrë në dorëzim mallrat, me përbërje M.M, A.M, A.M, si dhe në komisionin e marrjes në dorëzim nuk është personi me

	përgjegjësi materiale në ISHMT. Për ktë mbanë përgjegjësi Titullari i ISHMT, z.L.S. -Mallrat janë sjellë më datë 06.11.2020 (sipas fletë-hyrjes në magazinë dhe faturës tatimore të lëshuar nga subjekti), pra jo sipas afatit të përcaktuar (ku duhej brenda datës 02.11.2020), ndërkohë nga komisioni i marrjes në dorëzim është plotësuar fiktivisht procesverbali nr.2572/3 prot., datë 02.11.2020, pasi në këtë datë nuk është bërë hyrje në magazinën e institucionit asnjë produkt. Në këto kushte nuk duhet të ishin pranuar mallrat e furnizuara, por komisioni duhet të kishte përzgjedhur ofertuesin e renditur të dytin; -Vlera pa TVSH për njësi e laptopit në formularin e ofertës së shpallur fituese nuk është e njëjtë me vlerën pa TVSH të pasqyruar në faturën tatimore, konkretisht sipas formularit të ofertës ajo është 18,245 lekë pa TVSH/21,894 lekë me TVSH ndërkohë në faturën tatimore është 35,000 lekë pa TVSH/42,000 lekë me TVSH, pra 20,106 lekë me TVSH më tepër * 10 cop = 201,060 lekë, paguar më tepër nga oferta e shpallur fituese. Në këto kushte duhet të ishte refuzuar pranimi i faturës tatimore, e cila në prcedurat me vlerë të vogël, në mungesë të lidhjes së kontratës, ka fuqinë e kësaj të fundit; -Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit të të dhënave për desktop dhe laptop, në prani të specialistit të IT së ISHMT z.M.M (njëkohësisht Kryetar i grupit të marrjes në dorëzim të produkteve) rezultoi se, Kompjuterat dhe Laptop sjellë nga OE nuk janë sipas specifikimeve teknike, konkretisht kompjuterat e kërkuar me të dhënat teknike që duhet të plotësojnë janë vlerësuar me 7900 pikë, ndërkohë nga verifikimi që bëri grupi i auditimit në internet[33] të dhënave të kompjuterit të marrë në dorëzim, rezultoi se me ato parametra ai plotëson 3611 pikë, pra jo 7900 pikë, si dhe për laptopët duhet të kenë 4900 pikë, ndërkohë rezultojnë me 2067 pikë[34]. **Në këto kushte mallrat e mësipërm nuk duhet të ishin marrë në dorëzim.** -Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. M.M, zj. A.M, z. A.M;
Kriteri	Shkronja b, pika 3 në nenin 22 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; Neni 32 të Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò, i ndryshuar Pika 6 në nenin 14 dhe pika 3 në nenin 57të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për prokurimin publikò, i ndryshuar; Udhëzimi nr.3 datë 24.10.2016 ñMbi Deklarimin e Konfliktit të Interesit nga Zyrtarët e Prokurimitò. Pika 17 në Udhëzimin nr.3, datë 8.01.2018 ñmbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, ndryshuar. Pikat 42 dhe 43 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar. Pika 43 e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar. Specifikimet teknike për mallrat e prokuruar, miratuar me shkresën me nr.2278/1 prot., datë 07.10.2020. Fatura tatimore e lëshuar nga OE më datë 06.11.2020 për mallrat e furnizuara; Fletë-hyrja në magazinën e institucionit nr.15, datë 06.11.2020.
Ndikimi/Efekti	Janë marrë në dorëzim mallrat, kompjutera dhe laptop 20 cop gjithësej, në vlerën 712,450 lekë pa TVSH, jo sipas specifikimeve teknike, shpenzimet e të cilave përbëjnë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit.
Shkaku	Marrja në dorëzim e mallrave jo sipas specifikimeve teknike; Mosrespektim i detyrimeve kontraktore (fatura tatimore) nga OE shpallur fitues,; Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore të bëra në kuadrin rregullator në fushën e prokurimit

[33] https://www.cpubenchmark.net/cpu.php?cpu=Intel+Pentium+4405U+%40+2.10GHz&id=2666
[34] https://www.cpubenchmark.net/cpu.php?cpu=Intel+Core+i3-4170+%40+3.70GHz&id=2522

Rëndësia	E Lartë
Rekomandime	ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 712,450 lekë, nga OE ñI.N Alò shpk, si pasojë e mosdorëzimit nga ky i fundit të mallrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara, ose në të kundërt të kërkojë dorëzimin e tyre sipas specifikimeve teknike. **Menjëherë**

Tenderi "Blerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim", viti 2021

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Blerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim		
Urdhër prokurimi nr.51, datë 26.02.2021 Lloji i procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozim	-Hartuesit e dokumenteve të tenderit: Urdhër nr.51, datë 26.02.2021, zj.F.C me detyrë Përgjegjës Sektori; z.A.H, me detyrë Inspektor; z.E.L, me detyrë Inspektor -Hartuesit e specifikimeve teknike: Urdhër nr.45, datë 23.02.2021 z.R.B; z.L.L; z.G.N	Komisioni i vlerësimit të ofertave: Urdhër nr.55 datë 04.03.2021 z.J.Ll, Kryetar z.E.S, Anëtar z.G.N, Anëtar
Fondi limit (pa TVSH) 4,320,001 lekë	Oferta fituese pa TVSH: 4,199,575 lekë	Diferenca me fondin limit (pa TVSH):
Data e hapjes së tenderit: 16.03.2021	Burimi i financimit: Buxheti i shtetit	Operatorët Ekonomike: Sõkualifikuar: K.R ï nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike; I - nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike; P.I ï 4,308,300 lekë (nuk plotëson kapacitetet teknike certifikatë ISO 17025, autorizime prodhuesi) I ï (nuk plotëson kapacitetet teknike certifikatë ISO 17025, autorizime prodhuesi) L.B ï 4,086,000 lekë (nënkontraktim) AM - 3,932,000 lekë (nuk plotëson kapacitetet teknike, shitje të ngjashme gjatë tri viteve të fundit, certifikatë ISO 17025) Kualifikuar: L.G shpk - 4,199,575 lekë F.D shpk - 4,200,000 lekë Shpallur fitues: L.G shpk me ofertën me çmim më të ulët.
Ankimime	Përgjigje e ankesës	Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP

Nga subjekti L.B shpk datë 25.03.2021.	Shkresa nr.611/2, datë 29.03.2021, është refuzuar kërkesa e OE.	
Zbatimi i kontratës së mallrave		
Lidhja e kontratës Nr.633/4, prot., datë 22.06.2021	Vlera e kontratës me TVSH: -5,039,490 lekë	Likujduar deri në dt: -Urdhër Shpenzimi nr.210, datë 03.08.2021 në vlerën 5,039,490 lekë.
Fatura: Nr.14/2021, datë 11.09.2020 4,199,575 lekë pa TVSH 5,039,490 lekë me TVSH	Afati i kontratës në ditë: 60 ditë	
Akti i marrjes në dorëzim: Pa nr., datë 22.06.2021	Fletë hyrja nr.8, datë 22.06.2021	

Titulli i Gjetjes	**Tenderi "Pajisje dhe instrumenta për inspektim", viti 2021**
Situata	-Personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit me Urdhër të Titullarit të AK, nuk është pjesë e njësisë së prokurimit, për të cilën mban përgjegjësi z. L.S, Kryeinspektori i AK; -Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk administrohen fizikisht ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, theksojmë se ato janë në sistemin elektronik të prokurimit. Për këtëmbanë përgjegjësi njësia e prokurimit, zj. F.C, z.A.H, z.E.L. -Nuk administrohet argumentimi i AK për përzgjedhjen e operatorëve ekonomik, të cilëve u ka drejtuar ftesën për ofertë, për të cilën mbanë përgjegjësi njësia e prokurimit zj. F.C, z.A.H, z.E.L; **<u>Hartimi i specifikimeve teknike:</u>** -Në një rast, në specifikimet teknike të përcaktuara për produktin Aparat për Togëzimin, konkretisht: (Rryma e zhurmës (IEXT) Maks. IEXT = 10 A (AC) (RA <20 q) Maks. IEXT = 2 A (AC) (RA> 20 q)[35] kërkesat e përdorura për produktin, i përkasin markës Fluke dhe asnjë marke tjetër që mund të jetë ekuivalente e saj[36], si dhe nuk janë përfshirë fjalët ñekuivalentò në përcaktimin e specifikimeve të mësipërme. -Për sa më sipër mbanë përgjegjësi Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike z.R.B, z.L.L, z.G.N. **<u>Hapja dhe vlerësimi i ofertës së shpallur fituese L.G shpk:</u>** -Nga KVO nuk është mbajtur procesverbali, në datën e hapjes së ofertave, por vetëm procesverbali i vlerësimit të ofertave, për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z. J.Ll, Kryetar, z. E.S, Anëtar, z. G.N, Anëtar; -Nuk administrohet deklarata e konfliktit të interesave e anëtarëve të KVO-së, në ditën e hapjes së ofertave, por deklarata e konfliktit të interesave është nënshkruar nga anëtarët e KVO-së, më datë 04.03.2021, për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z. J.Ll, Kryetar, z. E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar; -Vërtetimi elektronik i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë më datë 11.03.2021, për xhiron e 3 viteve të fundit (2018, 2019, 2020) për subjektin L.G, pasqyron si aktivitet të subjektit: Ndërtimi i veprave të tjera të inxhinierisë civile p.t.k, pra që nuk lidhet aspak me llojin e aktivitetit që ka të deklaruar subjekti L.G në ekstraktin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Theksojmë se vërtetimi i lëshuar për xhiron e 3 viteve të fundit (2016, 2017, 2018), nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë më datë 28.01.2019, përmban të dhënat e sakta mbi

[35] https://www.fluke-direct.com/pdfs/cache/ëëë.fluke-direct.com/1625-2-kit/datasheet/1625-2-kit-datasheet.pdf
[36] https://www.fluke.com/

	llojin e aktivitetit që ushtron subjekti L.G shpk, për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar. Pra është kërkuar vërtetim për 3 vitet e fundit 2017, 2018, 2019. Subjekti ka sjellë 2 vërtetime, një që lidhet me objektin e aktivitetit të tij të regjistruar në QKB (vërtetimi lëshuar për xhiron e viteve 2016, 2017, 2018-qëështë i saktë dhe arrihet të plotësohet kriteri për dy vitet 2017 dhe 2018) dhe një tjetër që nuk lidhet me objektin e aktivitetit të regjistruar në QKB (2018, 2019, 2020-që do të thotë se për vitin 2019, subjekti nuk e ka plotësuar kriterin e përcaktuar në DST). -Në pasqyrat financiare të vitit 2017, konkretisht shënimet shpjeguese në përmbajtjen e tyre, japin informacion për një shoqëri tjetër, konkretisht për shoqërinëñE.Kò shpk**(pasqyruar në foton nr.1, Kapitulli Anekse-Aneksi nr.4)**, pra nuk i përkasin shoqërisëñL.Gò. Në këto kushte arrihet në përfundimin se pasqyrat financiare për vitin 2017 të dorëzuara nga subjekti L.G, me qëllim plotësimin e kriterit të përcaktuar në DST, kanë mangësi në përmbajtjen e tyre. Sa më sipër nga KVO duhet të ishin kryer verifikimet e nevojshme, por që nuk ka ndodhur. KVO nuk duhet të kishte pranuar dhe vlerësuar për kualifikim ofertën e OE L.G, e cila ka patur mangësi në dokumentacionin e saj. Për këtë mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar; -Në pasqyrat financiare të vitit 2018, konkretisht shënimet shpjeguese në përmbajtjen e tyre, japin informacion për një shoqëri tjetër, konkretisht për shoqërinëñE.Kò shpk, **(pasqyruar në foton nr.2, Kapitulli Anekse-Aneksi nr.4)** pra nuk i përkasin shoqërisëñL.Gò. Në këto kushte arrihet në përfundimin se pasqyrat financiare për vitin 2018 të dorëzuara nga subjekti L.G, me qëllim plotësimin e kriterit të përcaktuar në DST, kanë mangësi në përmbajtjen e tyre. Sa më sipër nga KVO duhet të ishin kryer verifikimet e nevojshme, por që nuk ka ndodhur. KVO nuk duhet të kishte pranuar dhe vlerësuar për kualifikim ofertën e OE L.G, e cila ka patur mangësi në dokumentacionin e saj. Për këtë mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar; -Raporti i auditimit për certifikimin e pasqyrave financiare të vitit 2018, nuk është nënshkruar në çdo fletë të tij, nga audituesi ligjor, dhe në këto kushte nuk duhet të ishte pranuar nga KVO, për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar; -Nuk është kryer auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2019, për certifikimin e tyre, në kundërshtim me kërkesat e DST, për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar; -Lidhur me kapacitetin teknik në DST, ku është kërkuar që OE të sjellë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se procedures pra për vitet 2020, 2019 dhe 2018 ï rezulton se OE i shpallur fitues ka sjellë dëshmi për kontrata në vitin 2018 dhe 2019 (L.G-UK Durrës datë 30.05.2018; L.G-RTSH 07.11.2018; L.G-OSHEE datë 27.06.2018; L.G ï AG datë 13.11.2019), pra jo edhe dëshmi për kontrata të ngjashme të kryera gjatëvitit 2020. Në këto kushte nuk duhet të ishte kualifikuar, dhe për këtë mbanë përgjegjësi KVO z. J.Ll, Kryetar, z. E.S, Anëtar, z. G.N, Anëtar; -Vërtetimi noterial më datë 11.03.2021, NR.REP.1168 (pasqyruar në foton nr.3, **Aneksi nr.4**), për vërtetim përkthimi nga përkthyesi zj.J.T, që administrohet në dosjen e tenderit, është fotokopje, si dhe gjykojmë dhe vlerësojmë se është i pavlefshëm, për arsye nuk përmban vulën e thatë (që vendoset mbi aktin noterial) si dhe pullën e taksës, për të cilën mbanë përgjegjësi njësia e prokurimit zj.F.C, z.A.H, z.E.L; -Në dokumentin e mësipërm (vërtetim përkthimi), nuk specifikohet se çfarë dokumentesh janë përkthyer; -Vërtetimi noterial më datë 11.03.2021, NR.REP.1169 (**tjetër vërtetim, pasqyruar në foton nr.4, Kapitulli Anekse-Aneksi nr.4)**, për vërtetim përkthimi nga përkthyesi zj.J.T, që administrohet në dosjen e tenderit, është fotokopje, si dhe gjykojmë dhe vlerësojmë se është i pavlefshëm, për arsye nuk përmban vulën e thatë (që vendoset mbi aktin noterial) si dhe pullën e taksës, për të cilën mbanë përgjegjësi njësia e prokurimit zj.F.C, z.A.H, z.E.L;

	-Në dokumentin e mësipërm (vërtetim përkthimi), nuk specifikohet se çfarë dokumentesh janë përkthyer; -Në dokumentet e përkthyera në gjuhën shqipe, nuk është nënshkrimi i përkthyesit zj. J.T**(pasqyruar në foton nr.5, Kapitulli Anekse-Aneksi nr.4)**. Pra që përkthimi të jetë i rregullt, duhet që veç dokumentit noterial (që duhet origjinal dhe i qartë në përmbajtje), edhe përkthimi i dokumenteve të jetë kryer nga një përkthyes i autorizuar dhe çdo dokument i përkthyer të jetë i firmosur nga përkthyesi. Sa më sipër nuk vërtetohet kryerja e përkthimit në gjuhën shqipe nga një përkthyes i autorizuar; Mangësitë e konstatuara më sipër janë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DST, pika 4.6 dhe Shtojca 8, Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar. -Deklarata e garancisë për produktet e sjella nga OE, nuk është në përputhje me përcaktimet ligjore, pasi nuk specifikohet se çfarë mbulon garancia në produktet e sjella/zonën mbi të cilën vepron ajo, dhe në këto kushte nuk duhet të ishte pranuar, për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar; -Në katalogun e sjellë për produktin veshje mbrojtëse nga rrezatimi X, nuk jepet informacion për specifikimin ñMbi të gjithë tensionin e tubit me rreze X, shkon nga 50 - 150 kVò, si dhe standardi i kërkuar nga AK që të plotësohet nga produkti IEC 61331-1 / EN 61331-1[37], nuk përputhet me standardin DIN 61331-3[38] që pasqyrohet në katalogun e produktit, në kundërshtim me kërkesat e DST (specifikime teknike), për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar; -Sipas specifikimeve teknike për produktin peshore me precision të lartë, i përket modelit Peshore ABP 300-4M, ndërkohë katalogu i sjellë nga OE L.Gme të dhënat teknike të produktit, i përket një modeli tjetër peshoreje ABP 100-5DM, pra jo sipas kërkesave të DST, dhe në këto kushte nuk duhet të ishte pranuar, për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar; -Theksojmë se deklarata e konformitetit për produktin peshore, që administrohet në dosjen e tenderit si dhe në sistemin e APP, nuk është në përputhje me elementët që duhet të përmbajë ky dokument, konkretisht ajo nuk ka numrin e identifikimit unik të produktit, emrin dhe adresën e prodhuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar, që në këtë rast duhet të ishte L.G shpk, dhe në këto kushte nuk duhet të ishte pranuar, për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar; -Deklarata e konformitetit për produktin ñAparat për Togëzimò nuk i përket llojit F 1625-2, atij të kërkuar nga AK, por llojit F 1625 (pra jo të produktit të kërkuar), dhe në këto kushte nuk duhet të ishte pranuar nga KVO, për të cilat mbanë përgjegjësi KVO z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar, z.G.N, Anëtar. Për llojin F 1625-2, ka deklaratë tjetër konformiteti[39]; -Deklarata e konformitetit për produktin Aparat për Togëzim, duke marrë në konsideratë përcaktimet e bëra në nenin 8 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.20111 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar, si dhe autorizimin e prodhuesit (F, B.V. Eindhoven, Netherlands) për produktin e mësipërm (ku është autorizuar si distributor ME Slloveni, e më pas nga ky i fundit është autorizuar L.G shpk), duhet të ishte lëshuar nga prodhuesi i produktit që në këtë rast është F, B.V. Eindhoven, Netherlands, i cili ka lëshuar edhe autorizimin e prodhuesit. Nga shqyrtimi i kësaj deklarate rezulton se ajo është lëshuar nga prodhuesi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku minimalisht duhet të ishte lëshuar për prodhuesin e autorizuar në Europë, për të provuar lidhjen ndërmjet kompanisë mëmë në Shtetet

[37] https://webstore.iec.ch/publication/5289
[38] https://global.ihs.com/doc_detail.cfm?document_name=DIN%20EN%2061331%2D3&item_s_key=00622800?document_name=DIN\x20EN\x2061331\x2D3&item_s_key=00622800&FORCEAPPLICATIONREFRESH=0
[39] https://asset.conrad.com/media10/add/160267/c1/-/en/001171304CC00/verklaring-van-overeenstemming-1171304-fluke-1623-2-aardingsmeter.pdf

	e Bashkuara të Amerikës ï Filialit të saj në Europ (Holland) ï Distributorit të Autorizuar në Slloveni ñMEò ï L.G shpk. -Për më tepër theksojmë se nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit në prani të magazinieres së ISHMT, rezultoi se produkti Aparat për Togëzim, në pjesën e pasme të tij ka mbishkrimin **"Made in Romania"**/ñProdhuar në Rumaniò**(pasqyruar në foton nr.6, Kapitulli Anekse-Aneksi nr.4)**, pra që nuk lidhet aspak me prodhuesin F, B.V. Eindhoven, Netherlands, që ka lëshuar autorizimin për ME. -Për sa është trajtuar më sipër për produktin Aparat për Togëzim, deklarata e konformitetit e dorëzuar nga subjekti për këtë produkt nuk duhet të ishte pranuar, dhe për këtë mbanë përgjegjësi KVO, z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, dhe z.G.N, Anëtar. **<u>Lidhja e kontratës:</u>** -Në DST, specifikimet teknike, është përcaktuar që në rast nevoje OE, duhet të marrë përsipër trajnimin e stafit për pajisjet e ofruara, kërkesë e cila nuk është parashikuar edhe në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, për të cilën mbanë përgjegjësi njësia e prokurimit zj.F.C, z.A.H, z.E.L, si hartuese e DST, pjesë e të cilës janë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës;Ky konstatim është mbështetur në pikën 9 të nenit 2, pikën 13.3 të nenit 13, nenin 8 në kushtet e veçanta, dhe aneksi 2, pjesë përbërëse e kontratës nr.633/4, datë 26.04.2021. **<u>Marrja në dorëzim:</u>** -Të gjithë mallrat e kërkuar janë sjellë nga subjekti L.G shpk, brenda afatit 60 ditor, të përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet palëve; -Referuar **katalogut të produktit peshore me precision të lartë dorëzuar nga OE shpallur fitues**, si dhe produktit të publikuar në faqen zyrtare të prodhuesit[40], produkti duhet të ketë edhe aksesorët që e shoqërojnë atë (konkretisht tavolina në të cilën vendoset peshorja[41], si dhe pajisjen për skanimin e barkodeve[42]), ku sipas verifikimit të kryer të pajisjeve nga grupi i auditimit në prani të Magazinieres të ISHMT zj.L.K, rezultoi se aksesorët shoqërues nuk ishin sjellë (vlera e të cilëve nuk mund të matet), dhe në këto kushte peshoret nuk duhet të ishin marrë në dorëzim. Komisioni i marrjes në dorëzim të produktit L.L (Kryetar), A.K, Sh.H, S.B, E.Sh, I.B, L.K (Anëtar); -Gjithashtu deklarata e konformitetit e lëshuar më datë 24.10.2019**(pasqyruar në foton nr.7, Kapitulli Anekse-Aneksi nr.4)**, që ndodhej në paketimin e produktit (pra jo ajo e sjellë nga OE, gjatë dorëzimit të ofertës së tij), nuk i plotësonte të gjitha direktivat 2014/35/EU, 2011/65/EU, 2014/31/EU, 2014/30/EU, konkretisht nuk plotësonte direktivën 2014/31/EU, dhe në këto kushte nuk duhet të ishte marrë në dorëzim, nga Komisioni i marrjes në dorëzim të produktit L.L (Kryetar), A.K, Sh.H, S.B, E.Sh, I.B, L.K (Anëtar); -OE i shpallur fitues, për peshoren me precision të lartë (1 që mund të verifikohej, pasi mbishkrimi në paketimin tjetër ishte i dëmtuar), ka sjellë autorizimin e prodhuesit datë 05.03.2021, në të cilën pasqyrohet informacioni se prodhuesi ñK&S gmbhò autorizon L.G shpk, për negocimin dhe lidhjen e kontratës me ISHMT dhe ofrimin e mallrave, mirëpo nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit në prani të Magazinieres të ISHMT zj.L.K, rezultoi se në paketimin e produktit të mësipërm **(pasqyruar në foton nr.8, Kapitulli Anekse-Aneksi nr.4)**, ishte i pasqyruar informacioni, që produkti është dërguar nga prodhuesi i tij për subjektin tjetër S&C shpk, **pra që nuk ka aspak lidhje me subjektin e shpallur fitues**, për më tepër nuk përmendet fare në autorizimin e lëshuar nga prodhuesi, si një distributor i produktit për Shqipërinë, ndryshe

[40] https://www.kern-sohn.com/cgi-bin/cosmoshop/lshop.cgi
[41] https://www.kern-sohn.com/cgi-bin/cosmoshop/lshop.cgi?action=showdetail&ls=de&artnum=TYPS-03A B&&gesamt_zeilen=0Tshowdetail----ABP|-|-|299
[42] https://www.kern-sohn.com/cgi-bin/cosmoshop/lshop.cgi?action=showdetail&ls=de&artnum=PET A09&&gesamt_zeilen=0Tshowdetail----ABP|-|-|299

	në rastin e produkteve Matës densiteti portabël, Pajisje Portabël për testimin e kavove të ashensorëve, për të cilat administrohet autorizimi i prodhuesit për distributorin në Shqipëri, si dhe autorizimi i distributorit në Shqipëri për L.G shpk. Konstatimi i mësipërm mbështetet në: **1.**Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur të OE L.G shpk, pika 5, shkronja ñbò: ñPër qëllime të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, un kuptoj që fjala ñkonkurrentëò nënkupton cdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh, që është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje të njoftimit të kontratës dhe/ose ftesës për ofertë. -Për të vijuar me pikën 8 të kësaj deklarate: Përvec kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet **apo dërgesa të vecanta të produkteve** apo shërbimeve që lidhen me me prokurimin në fjalë, përvec se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërmò. **2.**Autorizimin e prodhuesit të produktit ñPeshore me precizion të lartëò, i cili ka deklaruar shprehimisht: ñK&S GmbH me adresë, Sitz: B, AG S HRB 40086S, prodhues i peshoreve laboratorike. Autorizojmë: L.G Sh.p.k, me adresë Tiranë Kashar, Rruga Mark Bazati, Pallati Jora Shpk, Kati përdheā Dygani/Magazina me nr.1, **të prezantojnë një ofertë**, negociojnë dhe nënshkruajnë një kontratë me "Inspektoriatin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut" për tenderin me objekt "Blerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim në terren", në datë 16.03.2021 për mallrat e prodhuara nga ne. **Asnjë kompani tjetër përvec L.G Sh.p.k**. me adresë Tiranë Kashar, Rruga Mark Bazati, Pallati Jora Shpk, Kati përdhe, Dyqani/Magazina me nr.1 **është i autorizuar të ofrojë**, negociojë dhe nënshkruajë një kontratë për **mallrat tona**, për tenderin me REF-88918-03-03-2021 për mallrat e prodhuara nga neò. **3.**Kontrata nr.633/4 prot., datë 26.04.2021: ñNeni 2, pika 1. ñKontratëò do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga **Dokumentat e Tenderit** duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha **shtojcat dhe formularët e plotësuar** dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti. -Neni 2, pika 4. ñLëvrimiò do të thotë **të gjitha aktivitetet dhe veprimet** që mundësojnë **marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes** siç specifikohet në kontratë si **paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi**, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrolli i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie. -Neni 2, pika 9. ñShërbimet e lidhura me toò do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, **si transportimi**, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave. -Neni 2, pika 10.ñObjekt i kontratësò do të thotë të gjitha **Mallrat** dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi **do të sigurojë sipas kushteve të kontratës**. -Neni 13, pika 13.1 Kontraktuesi **është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit** përvec se kur kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. -Neni 14, pika 14.1 Kontraktuesi **është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin** e Mallrave sic kërkohet, me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuara në kontratë. -Neni 18, pika 18.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, **çmimi i**

kontratës përfshin kostot dhe tarifat, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhurame dorëzimin e Mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, instalimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualet dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar dhe të nevojshme për përdorim të regullt, mirëmbajtje dhe riparime të Mallrave. Vlera e taksave dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas legjislacionit përkatës, në fuqi 28 ditë para hapjes së ofertaveò.

4.Përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore:
ñPika 7 neni 3. ñPërfaqësues i autorizuarò është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Shqipëri, i cili ka një akt përfaqësimi nga prodhuesi për të vepruar në emër të tij për detyra specifike, për detyrimet e prodhuesit që parashikohen në këtë ligj ose aktet nënligjore në zbatim të tij.
-Pika 3 neni 4. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për të siguruar që i gjithë informacioni që ata japin për produktet e tyre të jetë i plotë, i saktë dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të zbatueshëm ndaj tyre.
-Pika 6 neni 10. Prodhuesi vendos në produkt emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohet. Kur këto elemente nuk mund të vendosen në produkt, prodhuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentin shoqërues të produktit-Këtu në paketimin e produktit kemi emrin e prodhuesit dhe të një subjekti, i cili nuk është përfaqësuesi i tij i autorizuar, OE i shpallur fitues, si dhe as i nënkontraktuar.
-Pika 3 neni 12. Importuesi vendos në produkt emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohet. Kur këto elemente nuk mund të vendosen në produkt, importuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentin shoqërues të produktit ï Në këtë rast në paketim është vendosur emri i subjektit tjetër S&Cò.
-Sa më sipër (mungesa e aksesorëve shoqërues të produktit, mosplotësimi i direktivës së kërkuar, sipas deklaratës së konformitetit në paketimin e produktit), pajisjet ñpeshore me precizion të lartëò, në vlerën 450,000 lekë pa TVSH, nuk duhet të ishin marrë në dorëzim nga Komisioni i marrjes në dorëzim të produktit L.L (Kryetar), A.K, Sh.H, S.B, E.Sh, I.B, L.K (Anëtar).
-Gjithashtu në procesverbalin e marrjes në dorëzim veç mangësive të mësipërme, duhet të ishte pasqyruar edhe fakti që produkti në paketimin e tij kishte mbishkrimin, në të cilin pasqyrohej informacioni, se produkti është dërguar nga prodhuesi i peshoreve tek subjekti S&C, duke verifikuar në këtë mënyrë respektimin e detyrimit kontraktor ndërmjet palëve, si dhe përmbushjen e deklaratës së dhënë prej tij, për paraqitje oferte në mënyrë të pavarur.

<u>Likujdimi i faturës tatimore nr.14/2021, datë 22.06.2021</u>
-Konstatohet se nga AK nuk është kryer likujdimi i faturës tatimore brenda afatit 30-ditor.
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Nëpunësi Autorizues i Institucionit z.L.S dhe Nëpunësi Zbatues zj.E.Xh.

<u>Mbi shqyrtimin e ankesës të subjektit L.B shpk:</u>
-Nga titullari i AK, në momentin e administrimit të ankesës nga subjekti i mësipërm më datë 26.03.2021, është nxjerrë Urdhri nr.64, për pezullimin e procedurës së tenderit, ngritjen e grupit për shqyrtimin e ankesës;
-Arsyetimi i bërë nga ISHMT për ankesën e subjektit të mësipërm, në gjykimin e grupit të auditimit, qendron, pasi vetë subjekti ka plotësuar gabim deklaratën për paraqitje oferte të pavarur (shtojca 2/1), ku bazuar në këtë deklaratë është bërë sõkualifikimi nga procedura i subjektit, pasi në DST është përcaktuar që nuk lejohet nënkontraktimi, ndërkohë subjekti i ka plotësuar të dyja rubrikat:

	a.Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; **PO** JO b.Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). **PO** JO - Më datë 29.03.2021 (brenda 7 ditëve) nga Titullari i AK, është nxjerrë vendimi për shqyrtimin e ankesës dhe i është përcjellë subjektit me shkresën nr.611/2. - Ankesa e mësipërme është pasqyruar në raportin përmbledhës të procedurës së tenderit, nga KVO. - Grupi i auditimit e vlerëson të rregullt praktikën e ndjekur nga ISHMT, për shqyrtimin e ankesës së mësipërme, në përputhje me përcaktimet e bëra në Kreun X, neni 78, në VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
Kriteri	Pikën 5 të nenit 23,pikën 1 të nenit 60, në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar; Neni 14, pika 2 në nenin 15, nenin 39, pikën 2 dhe 3 të nenit 57, pikën 2 tënenit 64të VKM nr.914, datë 29.12.2014ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuarme VKM nr.823, datë 21.10.2020; Shkronjën ñdò të nenit 12 në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar, në fuqi për periudhën e raportimit të PF, viti 2017. Pika 1 në nenin 13, pikën 1 dhe pikën 4 të nenit 16 në Ligjin nr.25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò; Neni 41, pika 1 në nenin 43, pika 2 në nenin 48 në Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 ñPër auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor, dhe të kontabilistit të miratuarò, i ndryshuar. Shkronja ñdhò, neni 63 dhe pika 1 e nenit 69 shkronjën ñgò të pikës 2 të nenit 105Neni 135 të Ligjit nr.110/2018 ñPër noterinëò; Pikën 6 të nenit 3, si dhe pikën 2, dhe shkronjat ña, c dhe çò të pikës 3 të nenit 29 të Kreut II, nenin 32 të Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò, i ndryshuar; shkronjën ñbò pika 2 neni 8 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.20111 ñpër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar; Pikën 61 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar; Pikën 184 të Udhëzimit nr.9, datë 20.07.2018 ñPër procedurat standard të zbatimit të buxhetit të shtetitò, i ndryshuar Pika 2 e Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.23, datë 07.12.2020 ñpër evidentimin, administrimin, ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale dhe për organizimin, funksionimin dhe ruajtjen e arkivave noterialë, përfshirë formatin e tyre, si dhe formën, përmbajtjen, verifikimin e rregullueshmërisë dhe administrimin e regjistrave të veprimtarisë noterialeò. Kontrata nr.633/4, datë 26.04.2021 lidhur ndërmjet palëve; Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave pa nr., datë 22.06.2021; Dokumentet Standard të Tenderit hartuar me procesverbalinpa *nr.,*i mbajtur më datë 03.03.2021; Procesverbali pa nr., i mbajtur më datë 19.03.2021, për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.
Ndikimi/Efekti	Pajisjet ñPeshoret me precizion të lartë, 2 copò, në vlerën 450,000 lekë pa TVSH, janë marrë në dorëzim jo në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara, pasi mungojnë aksesorët e produktit (vlera e të cilëve nuk mund të matet);
Shkaku	Marrja në dorëzim e mallit, në kushtet kur ai nuk është në përputhje me specifikimet teknike;

	Mosrespektim i detyrimeve kontraktore nga OE Shpallur fitues; Veprime dhe mosveprimeve në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në kontratën midis palëve, si dhe kuadrin rregullator cituar në kriteret audituese.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandime	ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, duke i kërkuar OE L.G shpk, të dorëzojë mallratñpeshore me precizion të lartëò në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara, ose në të kundërt arkëtimin e vlerën 450,000 lekë pa TVSH, të produktit. **Menjëherë**

Observacion: Me shkresën nr.614/10, datë 15.10.2021 nga ISHMT është bërë observacion për konstatimet e grupit të auditimit për procedurën e prokurimit më sipër, ku në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë vijon:

1.Ofertat që janë administruar nga ISHMT drejtuar 3 operatorëve ekonomik, L.G shpk, SC shpk, PI shpk, janë administruar në fazën e studimit të tregut ngritur me Urdhërin ñNr 71, datë 21.05.2020 ñPër prcaktimin e nevojave sasiore, hartimin e specifikimeve teknike dhe testimit e tregut për procedurën e prokurimit me objekt. Në sistemin elektronik janë ftuar 5 operatorë ekonomikë për të marrë pjesë në procedurë siç i referohet edhe GA.

2.Grupi i Punës më ISHMT në specifikimet teknike ka kërkuar që aparati për togëzim të ketë rrymë maksimale eksitimi 10 Amper për rezistencë më të vogël se 20 Ý dhe rrymë maksimale eksitimi 2 amper për rezistencë më të madhe se 20 Ý. Kjo kërkesë e GP nuk bien ndesh me asnjë dispozitë të pikës pikës 5 të nenit 23 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

3.Për sa i përket konstatimit të GA ku thuhet se ñspecifikimet teknike për produktin peshore me precision të lartë, i referohen modelit të produktit Peshore e llojit ABP 300-4M^{3ò,} nuk është i saktë pasi mjafton rasti i produktit AB MS304TS/00 të markës T shiko webin https://www.mt.com/int/en/home/products/Laboratory_weighing_Solutions/Analytical/Advanced/MS-TS_Analytical/MS304TS.html#overviewpm, ku specifikimet teknike siç jepen në materialin bashkëlidhur këttij observacioni, specifikimet teknike përputhen.

4.Deklaratat e konfliktit të interesit nga anëtarët e KVO-së janë mbajtur më datën 04.03.2021, në atë datë në të cilën është ngritur Grupi i vlerësimit të ofertave me Urdhërin Nr 55, datë 04.03.2021 ñPër ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave me object blerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim në terrenò. Për sa i përket konstatimit të GA se anëtarët e KVO duhet të nënshkruanin një deklaratë konflikti interesi në datën 19.03.2021, në këtë procesverbal të vlerësimit është cilësuar sërish se ñanëtarët e KVO-së, firmosëm deklaratate konfliktit të interesit me ofertuesit në këtë prokurim dhe rezulton se asnjë prej anëtarëve të KVO-së nuk është në kushtet e konfliktit të interesitò.

5.Deklarata mbi konfliktin e interesave, plotësuar nga OE është në përputhje sipas pikën 1 të nenit 16 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", dhe është e plotë sipas shtojës Nr 7 të DST. (Bashkëlidhur shtojca nr 7 e dst për konfiktin e interesit nga OE dhe foto në vijim).

6.Vërtetimi elektronik i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë më datë 11.03.2021, për xhiron e 3 viteve të fundit (2018, 2019, 2020) për subjektin L.G, pasqyron si aktivitet të subjektit: Ndërtimi i veprave të tjera të inxhinierisë civile p.t.k, pra që nuk lidhet aspak me llojin e aktivitetit që ka të deklaruar subjekti L.G në ekstraktin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesitò. Është vetë GA që në vijim të paragrafit sa më sipër e pranon që ñpër xhiron e 3 viteve të fundit (2016, 2017, 2018). nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë më datë 28.01.2019, dokumentacioni i sjellë nga OE përmban të dhënat e sakta mbi llojin e aktivitetit që ushtron subjekti L.G shpkò. Është e qartë që jemi para faktit që subjekti L.G Shpk ka në veprimtarinë e tij për sa i përket kërkesave në DST objektin e veprimtarisë që kërkohet për këtë procedurë prokurimi duke e

plotësuar tërësisht këtë kërkesë. Dokumenti Vërtetimi elektronik i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë më datë 11.03.2021, për xhiron e 3 viteve të fundit (2018, 2019, 2020) për subjektin L.G, që pasqyron si aktivitet të subjektit vetëm ndërtimi i veprave të tjera të inxhinierisë civile p.t.k, vjen për faktin se është një extract i kufizuar me qëllim informacioni vetëm xhiron e tre viteve të fundit. *(Bashkëlidhur foto të ekstraktit)*

7.Në DST tek kriteret e vecanta të kualifikimit përkatësisht pika 2.2.2 ñkapaciteti ekonomik dhe financiarò përcaktohet se: operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuar të bilanceve të viteve 2017, 2018, 2019 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. pasqyra financiare e vitit 2017 e paraqitur nga subjekti L.G shpk dhe e administruar nga ishmt i përket po këtij subjekti dhe është e vulosur në çdo faqe të saj nga drejtoria rajonale e tatimeve tiranë. pra, jemi para faktit që bilancet finaciare janë paraqitur dhe miratuar nga ana e autoriteteve përkatëse tatimore.

8.Për konstatimin e dhënë nga ana e ga për sa më sipër deklarojmë se operatori ekonomik referuar pika 4, neni 27 VKM 914/2014 ñpër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, ka paraqitur kontratat të ngjashme me entet publike si edhe faturat tatimore të cilat janë në përputhje me kërkesat në dst të tenderit, pra plotësohet kushti që brenda 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së procedurës, subjekti ka paraqitur dëshmi për furnizime të ngjashme.

9.GA referohet nenit 16, pika 6, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar, dispozitë e cila nuk ekziston në këtë VKM, ndërsa neni 16 VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar është mbi deklarimin e konfliktit të interesit dhe të informacionit konfidencialò. Pavarësisht këtij fakti ku GA ka një referencë të gabuar ligjore, në asnjë pikë të legjislacionit të prokurimit publik përsa i përket procedurës ñKërkesë për propozimò, një OE i cili ka paraqitur një ofertë gjatë procesit të specifikimeve teknike dhe studimit të tregut, nuk mundet të ndryshojë ofertën e tij gjatë garës në procedurën e tenderimit që zhvillohet nëpërmjet www.app.gov.al. Ofertat ekonomike të OE të paraqitura gjatë procedurës së tenderimit ñKërkesë për propozimò në asnjë rast nuk mund të kufizohen nga ofertat që mund të jenë paraqitur nga ana e oparatorit ekonomik në fazën e studimit të tregut. Për më tepër, nëse marrim në konsideratë diferencën midis ofertës së paraqitur nga subjekti më datë 24.02.2021 me shkresën nr.497/2 prot., në kohën e përgatitjes nga AK të specifikimeve teknike dhe përllgaritjen e fondit limit, diferenca me ofertën e paraqitur në garën e zhvilluaer të procedurës së tenderimit ñKërkesë për proppozimò, është vetëm 2,800 mijë lekë.

10.Vërtetimi noterial më datë 11.03.2021, NR.REP. 1168, për vërtetim përkthimi nga përkthyesi Zj.JT, që administrohet në dosjen e tenderit, është origjinal dhe administrohet nga ISHMT.

11.Përkthimi i dokumentave është bërë nga përkthyes i licensuar nga Ministria e Drejtësisë ndërsa njehsimi i dokumentit të përkthyer me origjinalin është kryer nga Noter i licensuar. Kompetenca dhe përgjegjësia e vërtetësisë dhe saktësisë së dokumentacionit është përgjegjësi e përkthyesit i cili ka deklaruar para zyrës noteriale se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentat bashkëlidhur.

12.OE pa kufizime dhe kushte ofron garanci 24 mujore nga data e dorëzimit të mallrave. Për më tepër, referuar kontratës me nr reference Ref ï 88918-03-03-2021 ndërmjet AK dhe L.G Shpk, nga ky i fundit ofrohen garanci në lidhje me produktet e ofruara.

13.Standardi DIN 61331-3 plotëson kriterin për mbrojtjen nga tensioni 50 - 150 kV, dhe përfshin të gjitha kriteret e kërkuara në DST, duke qenë ekuivalent për sa i përket mbrojtjes nga rrezatimi krahasuar me IEC 61331-1.

14.Deklarata për produktin peshore përmban, tipin e produktit, emrin dhe adresën e prodhuesit, modelin e peshores, ka të listuar të gjitha direktivat dhe standardet që plotëson dhe është është e firmosur nga përfaqësuesi i prodhuesit, numrin e organit të miratuar që ka bërë miratimin e tipit të peshores. kjo deklaratë i përmban të gjithë elementët që duhet të ketë një deklaratë konformiteti në bazë të legjislacionit në fuqi. Në asnjë rast përfaqësuesi i autorizuar nuk nënshkruan deklaratën e konformitetit, por ajo lëshohet në përgjegjësinë e vetme të prodhuesit.

15.Deklarata e konformitetit e paraqitur nga ana e OE është e të njëjtës klasë të aparateve të togëzimit të cilët janë f 1625-2, dhe f 1625. edhe ga ka konstatuar se për modelin f 1625-2, deklarata e konformitetit është e disponueshme në webin e prodhuesit dhe përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga ligji.
16.Në DST, specifikime teknike në rast nevoje operatori ekonomik duhet të marrë përsipër trajnimin e stafit për pajisjet e ofruara. Për këtë, nuk është kërkuar si kriter në kriteret e përgjithshme të pranimit apo kualifikimit, të përmendura në Shtojcën 8 që duhet të paraqesë në SPE, operatori ekonomik. Bazuar në kontratën nr 633/4 datë 26.04.2021 neni 2 pika 1, parashikon që një kontratë do të thotë marrëveshje e shkruar me disa autoritete kontraktore dhe kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK. Të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe dokumentat e tjera që përfshihen në referim të çdo dokumenti. Në kuptim të kësaj pike, kontrata e lidhur midis ISHMT si autoritet kontraktues dhe L.G Shpk përmban dhe nënkupton përveç kritereve të përgjithshme të kualifikimit edhe çdo kriter të drejtë apo detyrim të përmendur në dokumentat e tjera të tenderit. Në rastin e detyrimit të OE për trajnimin e stafit, në rast nevoje si kriter i përmendur në specifikime teknike rrjedhimisht përfshihet edhe në kushtet e kontratës, pasi operatori ka nënshkruar duke pranuar të gjitha parashikimet e saj. Gjithashtu, sipas pikës 9 të nenit 2 të kontratës shërbime të lidhura me to (nga shërbimet e lidhura me to) do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të mallrave si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e mallrave.
17.Për sa i përket aksesorëve shoqërues që GA konstaton se janë në katalogun e produktit peshore me precision të lartë në faqen zyrtare të prodhuesit, konkretisht tavolinë në të cilën vendoset peshorja dhe pajisja për skanimin e barcodeve, këto aksesorë nuk janë kërkuar në specifikimet teknike të shojcës 9 të DST *(foto më poshtë e specifikimeve teknike sipas DST).* Tavolinë dhe pajisja për skanuesin e barcodit nuk janë pjesë përbërëse e pandashme nga produkti peshore me presion të lartë, si dhe nuk cënon përdorimin dhe funksionalitetin e instrumentit matës.
18.Siç edhe konstatohet nga GA: OE i shpallur fitues, për peshoren me precision të lartë, ka sjellë autorizimin e prodhuesit datë 05.03.2021, në të cilën pasqyrohet infomacioni se prodhuesi K&S gmbh autorizon L.G shpk, për negocimin dhe lidhjen e kontratës me ISHMT. Subjekti L.G Shpk është paraqitur dhe ka dorëzuar peshoren me precision të lartë pranë ambjenteve të ISHMT. Është i gabuar konkluzioni i GA ku thuhet se produkti peshore është sjellë nga një subjekt tjetër S&C Sh.p.k. Në momentin e dorëzimit të mallit pranë ISHMT është paraqitur përfaqësuesi i shoqërisëL.G Sh.p.k i cili ka nënshkruar në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit. Grupi i marrjes në dorëzim verifikon dorëzimin e mallit sipas specifikimeve teknike dhe merret e mirëqënë fakti se mallin e dorëzon shoqëria L.G Shpk.

Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH:

-Për observacionin nr.1 janë bërë ndryshimet përkatëse;
-Për observacionet nr.2 dhe 3, argumenti juaj merret në konsideratë pjesërisht, vetëm për specifikimet e produktit peshore me precision të lartë.
-Për observacionin nr.4, i jemi referuar përcaktimit ligjor të bërë në pikën 2 të nenit 64:
Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës. Në vijim të këtij përcaktimi, ofertat janë hapur më datë 19.03.2021, ndërkohë deklarata e nënshkruar nga ju është e datës 04.03.2021.
Argumenti juaj nuk merret në konsideratë.
-Për observacionin nr.5 argumenti juaj është marrë në konsideratë.
-Për observacionin nr.6 e kemi shpjeguar edhe në observacionin e mëparshëm, ku OE, për vitin 2019, nuk ka sjellë vërtetimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore. Arsyen përse kemi dalë në këtë konstatim e kemi pasqyruar edhe në çështjen përkatëse, si dhe në qëndrimin tonë të mbajtur për

observacionin tuaj në përfundim të auditimit në terren. Këtë konstatim e kemi mbështetur nga verifikimi i aktivitetit të OE L.G, në ekstraktin e regjistrimit të subjektit në QKB.

-Për observacionin nr.7, argumenti juaj nuk merret në konsideratë. Qëndrimi jonë dhe konstatimi jonëështë i mbështetur në përcaktimet ligjore përkatëse, të referuara gjatë trajtimit të konstatimit përkatës, përcaktimet të cilat qartësojnë përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe kush bën certifikimin e tyre. Drejtoria e Tatimeve nuk kryen certifikim të pasqyrave financiare.

-Për observacionin nr.8, ashtu siç e kemi shpjeguar edhe në rastin e prokurimit të vitit 2020, për OE N.V, të njëjtin qëndrim kemi edhe këtu. Konstatimi jonëështë mbështetur në përcaktimet e bëra nga ju në DST, dëshmi të furnizimeve të ngjashme për 3 vitet e fundit nga data e shpalljes së procedurës, ndërkohë subjekti ka sjellë dëshmi të ngjashme për vitin 2018 dhe 2019. Jo më kot është përcaktuar ky kriter, me qëllim vërtetimin e kapacitetit teknik të OE, i cili këtë kriter e ka vërtetuar/plotësuar me dokumentacion për vitin 2018 dhe 2019.

-Për observacionin nr.9, merret në konsideratë argumenti.

-Për observacionin nr.10 nuk merret në konsideratë argumenti. Verifikimi i dokumentit është kryer dheështë pasqyruar me foto, si dhe elementët që duhet të përmbajë ai për të qenë i vlefshëm.

-Për observacionin nr.11, nuk merret në konsideratë argumenti. Ju risjellim në vëmendje përcaktimin ligjor përkatës:

Neni 135 Vërtetimi i përkthimeve Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga Ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi 55 bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. **Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi.**

-Për observacionin nr.12, nuk merret në konsideratë argumenti. Grupi i auditimit e ka bërë konstatimin për fazën e vlerësimit të ofertave, ndërkohë ju shpreheni për përcaktimet e bëra në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, pra pas shqyrtimit të ofertave dhe shpalljes së fituesit.

-Për observacionin nr.13, nuk merret në konsideratë argumenti. Konstatimi i bërë nga grupi i auditimit, është bazuar në përcaktimet e bëra në DST, për specifikimet teknike të produktit. Pra ju keni kërkuar plotësimin e standardit IEC 61331-1/EN 61331-1, ndërkohë produkti i sjellë plotëson standardin DIN 61331-3. Se çfarë përfshin apo se cfarë dallimesh ka, referojuni përshkrimeve për dy standardet.

-Për observacionin nr.14, nuk merret në konsideratë argumenti. Elementët që duhet të përmbajë deklarata i kemi cituar. Nuk jemi shprehur se përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit duhet të nënshkruajë deklaratën e konformitetit, por kemi thënë që nuk përmban emrin e prodhuesit ose përfaqësuesit të autorizuar të prodhuesit, në përputhje me përcaktimin e bërë në shkronjën ñbò, pika 2, neni 8 në Ligjin nr.10489, datë 15.12.20111 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar.

-Për observacionin nr.15, nuk merret në konsideratë argumenti. Keni kërkuar në DST deklaratë konformiteti për produktin F 1625-2, subjekti ka sjellë për llojin F 1625, pra jo sipas kërkesës tuaj. Se çfarë gjendet nëweb nuk ka aspak lidhje me procedurën e prokurimit dhe kërkesat që duhet të plotësojë subjekti. Deklaratën që ju kemi referuar, është për të ilustruar, që për produktin e kërkuar nga ju duhet kjo deklaratë, pra për modelin F 1625-2, e cila pa dyshim në brendësinë e saj (përjashtuar modelin F 1625-2) do ketë të dhëna të tjera lidhur me numrin serial të produktit, pasi një deklaratë konformiteti e lëshuar për një produkt të prodhuar (i njëjti model) në vitin 2018, nuk mund të ketë të njëjta të dhëna me një produkt (i njëjti model) të prodhuar në vitin 2020.

-Për observacionin nr.16, nuk merret në konsideratë argumenti. Arsyetimi jonë bazohet në pikën 9 të nenit 2, pikën 13.3 të nenit 13, nenin 8 në kushtet e veçanta, dhe aneksi 2, pjesë përbërëse e kontratës nr.633/4, datë 26.04.2021. Konkretisht në pikën 9 të nenit 2 jepet përkufizimi i termit ñshërbime të lidhura me toò, pra për mallrat e prokuruara, në pikën 13.3 përcaktohet se koha e dorëzimit dhe shërbimet e lidhura me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë, për të vijuar në kushtet e vecanta të kontratës, nenin 8 ñshërbimet në lidhje me toò sipas aneks 2, në të cilin jepen vetëm specifikimet teknike të mallrave, dokumentacioni, afati i lëvrimit dhe garancia. Pra në asnjë përcaktim nuk është parashikuar trajnimi.
-Për observacionin nr.17, argumenti juaj nuk merret në konsideratë. Në vijim argumentojmë se, në DST, për produktin në fjalë keni kërkuar katalogun që përfshin specifikimet e tij. Sipas këtij katalogu (dokumentacion që lidhet me produktin, të dhënat, përdorimin, përfitimet), rezulton se ky produkt tregëtohet së bashku me aksesorët e tij. Ju nuk keni si ta kërkoni që të ketë edhe aksesorët pasi, ai produkt ashtu tregëtohet së bashku me aksesorët. Sa për argumentin tuaj se tavolina apo pajijsja e skanimit të barkodeve, nuk cenon përdorimin apo funksionalitetin, ju sjellim në vëmendje informacionin e pasqyruar në katalogun teknik të produktit, si dhe atë të publikuar në faqen e prodhuesit të tij (i cili e ñrrëzonò argumentin tuaj), për rolin e tavolinës, konkretisht: tavolina e peshores e cila shërben për thithjen e vibrimeve dhe luhatjeve, të cilat ndikojnë në rezultatin e matjes. Gjitashtu në vijim të argumentit të dhënë më sipër, sjellim në vëmendjen tuaj përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 3, si dhe pikën 2, dhe shkronjat ña, c dhe çò të pikës 3 të nenit 29 të Kreut II, në Ligjin nr.9902, datë 17.04.2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò, i ndryshuar:
Kreu II
Përputhshmëria Kontraktuale
Neni 29 Detyrimi i përputhshmërisë
2. Shitësi i dorëzon konsumatorit mallra, të cilat janë në përputhje me kontratën.
3. Mallrat prezumohen në përputhje me kontratën kur:
a) përputhen me përshkrimin e dhënë nga shitësi dhe zotërojnë cilësitë e mallit, që shitësi ia ka paraqitur konsumatorit si mostër ose si model;
c) përputhen me qëllimet, për të cilat mallrat e të njëjtit tip përdoren normalisht;
ç) paraqesin cilësitë dhe performancën, të cilat janë normale për mallra të të njëjtit tip dhe që konsumatori, në mënyrë të arsyeshme, i pret, sipas natyrës së mallit dhe duke marrë parasysh karakteristikat e mallit, të bëra nga shitësi, prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij, në deklaratat publike, veçanërisht në publicitetet ose etiketimet.
-Për observacionin nr.18, nuk merret në konsideratë argumenti. Konstatimi jonë për çështjen përkatëse mbështetet në:
1.Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur të OE L.G shpk, pika 5, shkronja ñbò:
-Për qëllime të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, un kuptoj që fjala ñkonkurrentëò nënkupton cdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh, qëështë një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje të njoftimit të kontratës dhe/ose ftesës për ofertë.
-Për të vijuar me pikën 8 të kësaj deklarate:
Përvec kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet **apo dërgesa të vecanta të produkteve** apo shërbimeve që lidhen me me prokurimin në fjalë, përvec se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm.

2.Autorizimin e prodhuesit të produktit ñPeshore me precizion të lartëò, i cili ka deklaruar shprehimisht:
K&S GmbH me adresë, Sitz: B, AG S HRB 40086S, prodhues i peshoreve laboratorike.
Autorizojmë:

L.G Sh.p.k, me adresë Tiranë Kashar, Rruga Mark Bazati, Pallati Jora Shpk, Kati përdheā Dygani/Magazina me nr.1, **të prezantojnë një ofertë**, negociojnë dhe nënshkruajnë një kontratë me "Inspektoriatin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut" për tenderin me objekt "Blerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim në terren", në datë 16.03.2021 për mallrat e prodhuara nga ne.

Asnjë kompani tjetër përvec L.G Sh.p.k. me adresë Tiranë Kashar, Rruga Mark Bazati, Pallati Jora Shpk, Kati përdhe, Dyqani/Magazina me nr.1 **është i autorizuar të ofrojë**, negociojë dhe nënshkruajë një kontratë për **mallrat tona**, për tenderin me REF-88918-03-03-2021 për mallrat e prodhuara nga ne.

3.Kontrata nr.633/4 prot., datë 26.04.2021:

-Neni 2, pika 1. ñKontratëò do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga **Dokumentat e Tenderit** duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha **shtojcat dhe formularët e plotësuar** dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

-Neni 2, pika 4. ñLëvrimiò do të thotë **të gjitha aktivitetet dhe veprimet** që mundësojnë **marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes** siç specifikohet në kontratë si **paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi**, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrolli i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

-Neni 2, pika 9. ñShërbimet e lidhura me toò do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, **si transportimi**, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.

-Neni 2, pika 10.ñObjekt i kontratësò do të thotë të gjitha **Mallrat** dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi **do të sigurojë sipas kushteve të kontratës**.

-Neni 13, pika 13.1 Kontraktuesi **është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit** përvec se kur kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës.

-Neni 14, pika 14.1 Kontraktuesi **është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin** e Mallrave sic kërkohet, me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuara në kontratë.

-Neni 18, pika 18.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, **çmimi i kontratës përfshin kostot dhe tarifat, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhura** me dorëzimin e Mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, instalimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualet dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar dhe të nevojshme për përdorim të regullt, mirëmbajtje dhe riparime të Mallrave. Vlera e taksave dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas legjislacionit përkatës, në fuqi 28 ditë para hapjes së ofertave.

4.Përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore:

-Pika 7 neni 3. ñPërfaqësues i autorizuarò është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Shqipëri, i cili ka një akt përfaqësimi nga prodhuesi për të vepruar në emër të tij për detyra specifike, për detyrimet e prodhuesit që parashikohen në këtë ligj ose aktet nënligjore në zbatim të tij.

-Pika 3 neni 4. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për të siguruar që i gjithë informacioni që ata japin për produktet e tyre të jetë i plotë, i saktë dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të zbatueshëm ndaj tyre.

-Pika 6 neni 10. Prodhuesi vendos në produkt emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohet. Kur këto elemente nuk mund të vendosen në produkt, prodhuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentin shoqërues të produktit-Këtu në paketimin e produktit kemi emrin e prodhuesit dhe të një subjekti, i cili nuk është përfaqësuesi i tij i autorizuar, OE i shpallur fitues, si dhe as i nënkontraktuar.

-Pika 3 neni 12. Importuesi vendos në produkt emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohet. Kur këto elemente nuk mund të vendosen në produkt, importuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentin shoqërues të produktit ï Në këtë rast në paketim është vendosur emri i subjektit tjetër Start&Co.

5. Gjithashtu për të mbështetur argumentin tuaj në observacionin përkatës, ju duhet ta kishit shoqëruar me dokumentacion vërtetues (praktika e importit të produktit), dhe nga verifikimi i observacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur, nuk kishte një të tillë.

Shpenzimet për "Pajisje kompjuterike" – viti 2021.

Me shkresën nr.467 prot., datë 18.02.2021 ISHMT i është drejtuar AKSHI-t për miratimin e specifikimeve teknike për kompjuter desktop, printer standard, printer me ngjyra, laptop, skaner;
Me shkresën nr.467/1 prot., datë 01.03.2021 AKSHI i është drejtuar ISHMT, për dërgimin e termave të referencës, sipas formularit Aneksi 3;
Me shkresën nr.467/2 prot., datë 03.03.2021 ISHMT i është drejtuar AKSHI-t, për plotësimin e termave të referencës sipas formularit Aneksi 3 (3 kompjutera desktop, 4 printera, 3 laptop, 1 printer me ngjyra, 1 skaner);
Me shkresën nr.467/3 prot., datë 11.03.2021 ISHMT i është drejtuar përsëri AKSHI-t, për plotësimin e termave të referencës sipas formularit Aneksi 3 (3 kompjutera desktop, 4 printera, 3 laptop, 1 printer me ngjyra, 1 skaner), duke plotësuar saktë kërkesat e formularit;
Me shkresën nr.467/prot., datë 19.03.2021 AKSHI i është drejtuar ISHMT, për miratimin e specifikimeve teknike;
Me shkresën nr.597 prot., datë 18.03.2021 nga Drejtoria Teknike, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve, Drejtoria e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale, Sektori i Financës dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, drejtuar Komisionit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël, është bërë kërkesë për blerjen e mallrave: Kompjutera, Printer, Skaner, Laptop, Kamera për kompjuter dhe Kufje me mikrofon, por pa përcaktuar sasinë e nevojshme për këto mallra;
Me urdhërin nr.60, datë 18.3.2021 është ngritur grupi i punës për marrjen e ofertave dhe testimin e tregut për pajisjet e mësipërme, me përbërje si vijon:
-M.M
-G.U
-G.N
Me procesverbalin nr.598/1 prot., datë 19.03.2021 nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël A.M, M.K dhe H.Zh, ngritur në fillim të vitit me Urdhërin nr.6, datë 08.01.2021, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operator ekonomik (I.N.al, ZN dhe ES) është përcaktuar fondi limit i procedurës në vlerën 740,000 lekë pa TVSH, si dhe miratimi i relacionit nga titullari i institucionit;
Në dosje administrohet oferta e I.N.al pa datë dhe nr.prot., (gjatë fazës së studimit të tregut), i cili ka sjellë ofertë për laptop ï 4 cop, printer me të gjitha funksionet ï 1 cop, desktop ï 8 cop, monitor ï 8 cop) ï 785,136 lekë pa TVSH;
ZN më datë 22.02.2021 (printer ï 4 cop, desktop - 8 cop, monitor ï 8 cop, laptop ï 8 cop) ï 796,156 lekë pa TVSH;
ES pa datë dhe nr.prot., (Desktop-8 cop, laptop-8 cop, printer-4 cop) ï 810,000 lekë pa TVSH;
Urdhëri i prokurimit nr.62, datë 23.03.2021 për blerjen e pajisjeve kompjuterike:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Kompjuter Desktop	Cop	3
2	Printer mobile all in one	Cop	4
3	Skaner	Cop	1
4	Printer advanced	Cop	3
5	Laptop	Cop	3

6	Printer color standard	Cop	1
7	Kufje dhe kamera për PC	Cop	8

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr.603/1 prot., datë 23.03.2021, pa specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet afati i lëvrimit të mallrave brenda 2 ditëve pune nga momenti i pranimit të ofertës dhe dorëzimi i dokumentacionit nga fituesi pranë AK, drejtuar 5 OE;
Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje A.M, M.K dhe H.Zh, ku është shpallur fitues OE I.N.al me ofertën më të ulët të rradhës, në vlerën 681,200 lekë pa TVSH;
Dokumentet e sjella nga I.N.al (Vërtetim debie nga OSHEE, Certefikatë regjistrimi, Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike pa datë, nr.llogarie bankare, preventivi, vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, elektronik, por që nuk arrihet të skanohet bar-kodi për të verifikuar saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentit të lëshuar, vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, elektronik, por që nuk arrihet të skanohet bar-kodi për të verifikuar saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentit të lëshuar, Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, ekstrakt)
Procesverbali i marrjes në dorëzim të mostrave nr.603/3 prot., datë 09.04.2021, dhe Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave nr.603/3 prot., datë 12.04.2021.
Kontrata e lidhur ndërmjet palëve nr.603/4, datë 07.04.2021, për dorëzimin e mallrave më datë 12.04.2021;
Fatura tatimore nr.31/2021 e lëshuar nga OE më datë 07.04.2021 për mallrat e furnizuara;
Fletë-hyrja në magazinën e institucionit nr.2, datë 12.04.2021.
Subjekti likujduar më datë me Urdhër shpenzimin nr.113, datë 20.04.2021.

Titulli i Gjetjes	**Shpenzimet për "Pajisje kompjuterike"-viti 2021**
Situata	-Subjekti ñJ.Bò me ofertën ekonomike në vlerën 290,000 lekë pa TVSH, është sðkualifikuar nga gara për arsyet se oferta është shumë e ulët nga fondi limit/ofertë anomalisht e ulët dhe objekti i aktivitetit nuk përputhet me objektin e prokurimit, **ndërkohë** që kriteri për ofertën anomalisht të ulët nuk zbatohet për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si dhe sipas ekstraktit të regjistrimit në QKB[43] të subjektit, ai tregëton pajisje elekronike dhe ato informatike dhe në këto kushte nuk duhet të ishte sðkualifikuar. -Subjekti ñAKò 740,000 lekë oferta ekonomike, sipas QKB ka aktivitet ñTregëti paisje elektronike dhe kompjuterike, të programeve dhe softeve të ndryshmeò, ndërkohë është sðkualifikuar me arsyetimin se nuk përputhet objekti i veprimtarisë me atë të prokurimit; -E njëjta situatë edhe për subjektin ñAò me ofertë në vlerën 730,000 lekë dhe për subjektin ñBBò me ofertë në vlerën 718,900 lekë; -OE ñPCSò është sðkualifikuar nga gara për arsye të mos dorëzimit të mostrave të kërkuara nga AK, ku theksojmë se në asnjë rast nuk është vendosur si kriter dorëzimi i mostrave, si dhe për më tepër, referuar pikës 8 të Udhëzimit nr.3 datë 8.01.2018 ñmbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, ndryshuar, në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël autoriteti kontraktor **nuk duhet të kërkojë paraqitjen e mostrave të mallit objekt prokurimi**, pasi verifikimi i cilësisë së mallit bëhet në momentin e marrjes në dorëzim të mallit, objekt prokurimi. Theksojmë se në dosjen e prokurimit administrohet dokumentacioni i sjellë nga OE PCS, me nr.603/2 prot., datë 29.03.2021; -Kriteret e pjesëmarrjes publikuar në sistemin e APP, nuk janë sipas përcaktimeve ligjore; -Dokumentet e tenderit nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve të bëra në manualin teknik të prokurimit me vlerë të vogël, ku dokumentat që duhet të bashkëlidhen në këtë rast, përveç ftesës për ofertë, mund të jenë të dhënat e objektit që do të prokurohet si psh, sasia, specifikimet

[43] file:///C:/Users/User/Downloads/EkstraktHistorik-7_28_2021%20(5).pdf

	teknike, preventivi, termat e referencës, kushtet e kualifikimit etj., nëse këto janë përgatitur në dokumenta të veçantë nga ftesa për ofertë, që në këtë rast janë përgatitur më vete. -Ftesa për ofertë nuk ka bashkëlidhur specifikimet e kërkuara për pajisjet TI; -Hapat e ndjekur për shpalljen e njoftimit të fituesit nuk janë sipas përcaktimeve të bëra në manualin teknik ñPër zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronikò, konkretisht edhe pas gjenerimit të procesverbalit të mbajtur nga komisioni për kalimin tek operatori i rradhës, përsëri në krye të listës së OE, del subjekti ZO 2020, i cili sipas procesverbalit të mbajtur nga Komisioni, është sôkualifikuar për arsye të tërheqjes nga gara, dhe në këto kushte në hapin e rradhës i renditur i pari do të ishte PCS (OE i renditur i dyti), e kështu me rradhë për të vazhduar deri tek OE i shpallur fitues I.N.al. -Theksojmë se edhe tek raporti i klasifikimit përfundimtar, përsëri del i pari në listë subjekti ñZO 2020ò; -ISHMT i është drejtuar AKSHI-t për miratimin e specifikimeve teknike **vetëm për pajisjet** kompjuter desktop, printer standard, printer me ngjyra, laptop, skaner, **ndërkohë** veç pajisjeve të mësipërme ka prokuruar edhe produktin ñPrinter mobile all in oneò, ñkamera për PCò, për të cilat nuk ka përcaktuar specifikime teknike, si dhe nuk i është drejtuar AKSHI-t për miratimin e tyre. Për këtë mbanë përgjegjësi Titullari i ISHMT z.L.S. -Nuk administrohen deklaratat e garancisë për mallrat e furnizuara sipas specifikimeve teknike të miratuara; -Nga Titullari i ISHMT-së nuk është nxjerrë urdhëri për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim të mallrave. Për këtë mbanë përgjegjësi z.L.S; -Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël; -Është i njëjti grup i cili administrimit të procedurës së prokurimit, ka marrë në dorëzim mallrat, me përbërje A.M, H.Zh, M.K dhe L.K, për më tepër në mungesë të Urdhërit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave në ISHMT. Për këtë mbanë përgjegjësi z.L.S; -Mallrat janë sjellë më datë 12.04.2021 (sipas fletë-hyrjes në magazinë), pra jo sipas afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë (ku duhej brenda datës 09.04.2021). Në këto kushte nuk duhet të ishin pranuar mallrat e furnizuara, por komisioni duhet të kishte përzgjedhur ofertuesin e rradhës; -Dokumentet e OE shpallur fitues që administrohen në dosjen e prokurimit janë pa numër protokolli; -Afati i përcaktuar në kontratën nr.603/4, datë 07.04.2021 lidhur ndërmjet ISHMT dhe OE shpallur fitues, për dorëzimin e mallrave, pra në datën 12.04.2021 është në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 5 të VKM nr.914, datë nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për prokurimin publikò, i ndryshuar:
	ñKryerja e procedurës me mjete elektronike të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së. -Pikën 20 të Udhëzimit nr.3 datë 8.01.2018 ñmbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, ndryshuar: Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, me mjete elektronike, zhvillohet sipas formateve standard dhe manualit teknik bashkëlidhur këtij udhëzimi, Formulari nr.3 ñFtesa për ofertëò.
	Për këtë mbanë përgjegjësi z.L.S; -Gjithashtu nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit të të dhënave për Kompjuterat desktop (modeli HP), rezultoi se, kompjuterat e sjellë nga OE nuk janë sipas specifikimeve teknike, konkretisht kompjuterat e kërkuar me të dhënat teknike që duhet të plotësojnë janë vlerësuar me 7900 pikë, ndërkohë nga verifikimi që bëri grupi i auditimit të të dhënave të kompjuterit[44] të marrë në dorëzim, rezultoi se me ato parametra ai plotëson 4170 pikë, pra jo 7900 pikë.

[44]https://www.cpubenchmark.net/cpu.php?cpu=Intel+Core+i3-6100+%40+3.70GHz&id=2617

	Në këto kushte mallrat e mësipërm nuk duhet të ishin marrë në dorëzim. -Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi A.M, H.Zh, M.K dhe L.K;
Kriteri	Pikën 5 të nenit 2dhe nenin 40, pika 5 të VKM nr.914, datë nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për prokurimin publikò, i ndryshuar; Shkronja ñjò pika 6 në VKM nr.673, datë 22.11.2017 ñPër riorganizimin e AKSHI-tò, të ndryshuar; Neni 32 të Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 ñPër mbrojtjen e konsumatorëveò, i ndryshuar; Pikën 8 të Udhëzimit nr.3 datë 8.01.2018 ñmbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, ndryshuar Shkronja ñbò, pika 7, pikat 8, 16, 17 dhe 20, manuali teknik kapitulli 2, në Udhëzimin nr.3 datë 8.01.2018 ñmbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, ndryshuar Shkronja b, pika 3 në nenin 22 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; Udhëzimi nr.3 datë 24.10.2016 ñMbi Deklarimin e Konfliktit të Interesit nga Zyrtarët e Prokurimitò. Pikat 42 dhe 43 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar. Specifikimet teknike miratuar me shkresën nr.467/prot., datë 19.03.2021; Procesverbali i marrjes në dorëzim të mostrave nr.603/3 prot., datë 09.04.2021, dhe Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave nr.603/3 prot., datë 12.04.2021; Fatura tatimore nr.31/2021, më datë 07.04.2021 për mallrat e furnizuara; Fletë-hyrja në magazinën e institucionit nr.2, datë 12.04.2021.
Ndikimi/Efekti	-Sa më sipër, si pasojë e veprimeve nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, sõkualifikimi i padrejtë i OE ñJ.Bò renditur i pari, është krijuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 391,200 lekë (Diferenca e vlerës së I.al ï vlerën e subjektit J.B). -Janë marrë në dorëzim mallrat, kompjutera 3 cop gjithësej, në vlerën 156,576 lekë pa TVSH, jo sipas specifikimeve teknike, shpenzimet e të cilave përbëjnë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit.
Shkaku	Sõkualifikimi i padrejtë i OE renditur i pari; Marrja në dorëzim e mallrave jo sipas specifikimeve teknike; Mosrespektim i detyrimeve kontraktore (fatura tatimore) nga OE shpallur fitues,; Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore të bëra në kuadrin rregullator në fushën e prokurimit
Rëndësia	E Lartë
Rekomandime	ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 391,200 lekë, nga personat përgjegjëszj.A.M, z.H.Zh dhe zj.M.K, në mënyrë përpjestimore, si pasojë e sõkualifikimit të padrejtë të OE renditur i pari. ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 156,576 lekë, nga OE ñI.N Alò shpk, si pasojë e mosdorëzimit nga ky i fundit të mallrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara, ose në të kundërt të kërkojë dorëzimin e tyre sipas specifikimeve teknike. **Menjëherë**

Observacion: Me shkresën nr.614/10, datë 15.10.2021 nga ISHMT është bërë observacion për konstatimet e grupit të auditimit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël (**Shpenzimet për**

“Pajisje për videokonferencë dhe panel akses kontrolli”, Shpenzimet për “Pajisje kompjuterike”, 2 procedura), ku në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë vijon:
Në lidhje me këtë konstatim sqarojmë se ofertat gjenerohen nga sistemi dhe ruajtja në rubrikën ñDorëzimi i ofertaveò nuk bëhet nga grupi i prokurimit. renditja e operatorëve si dhe ofertat që ka paraqitur secili prej tyre ndodhen në klasifikimin përfundimtar si dhe të ruajtura në sistem dhe të pasqyruara në rubrikën call reference në sistem.
Sipas udhezimit nr.30 datë 27.12.2011 pikat 42, 43, 44 ñTitullari i njësisë miraton urdhërin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësine e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues.Për sa më sipër legjislacioni për prokurimet me vlerë të vogël nuk parashikon asnjë dispozitë ndaluese që njësia e prokurimit e cila ka zhvilluar procedurën, të jetë edhe në grupin e marrjes në dorëzim të mallit.
Anëtarët e komisionit të Prokurimit të caktuar me anë të urdhërit të vitit 2020 mbajnë pozicionet dhe kanë detyrat funksionale si më poshtë:A.M, Inspektore në Drejtorinë Teknike, me Arsim në fushën Inxhinierike; me detyrë funksionale verikimin e procedurave të inspektimit, mbikëqyrjen e sistemit e-inspection, etj.M.M, Inspektor në Sektorin e Pronësisë Industriale, Drejtoria e Pronësisë Intelektuale, ku detyrat funksionale përfshijnë inspektimet në fushën e pronësisë intelektuale.A.M, Inspektor, në Sektorin e Drejtave të Autorit, me detyrë funksionale kryerjen e inspektimieve në fushën e Drejtave të Autorit në terren.Për sa më sipër anëtarët e komisioni të prokurimit të caktuar nga titullari nuk janë ekspertë në fushën e prokurimeve si dhe nuk janë trajnuar nga strukturat përgjegjëse.
Përsa i përket konstatimit për mungesën e urdhërit për marrjen në dorëzim të mallrave, përgjatë vitit 2020 për shkak të situatës së Pandemisë Covid-19, punonjësit e ISHMT kanë patur infektime në masë.
Në ftësën për ofertë nga ana e AK nuk është kërkuar deklaratë garancie malli.
Në lidhje me këtë pretendim për skualifikimin e Operatorit ekonomik ñJ.Bò me vlerë 290.000 lekë pa TVSH, dhe krijimin për këtë shkak të dëmit ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 391,200 lekë (Diferenca e vlerës së I.al ð vlerën e subjektit J.B), të ngritur nga grupi i auditimit të KLSH, sqarojmë se Operatori Ekonomik ñJ.Bò me ofertën ekonomike 290.000 lekë pa TVSH, ka paraqitur një ofertë e cila në referim të cmimeve të referencës sipas AKSHI-t, i cili përcakton se cmimet për njësi për kompjuterat është minimalisht 85.428 lekë pa TVSH, cmimi për njësi i një laptopi është minimalisht 103.723 lekë pa TVSH, si dhe për printerat cmimet për njësi është 15,931 lekë pa TVSH, është shumë e ulët si dhe në mospërputhje të plotë me cmimet e referencës. Nëse ky subjekt do të shpallej fitues nga ana e ISHMT-së, përvec zvarritjes së procedurës, për shkak të numrit të lartë të pjesëmarrësve, rrezikohej që subjekti të mos përmbushte në afat, pajisjet objekt prokurimi me parametrat dhe cilësinë e kërkuar.Për këtë arsyje Operatori ekonomik ñJ.Bò efektivisht ka qënë në pamundësi të ekzekutimit apo të realizimit të këtij objekti prokurimi duke parë edhe listën me pajisjet dhe mjetet kompjuterike që ISHMT ka kërkuar.
Pas gjenerimit të procesverbalit dhe në bazë të procesverbalit të klasifikimit përfundimtar, operatori ZO është klasifikuar i pari, dhe me kalimin sipas rradhës të operatorëve fitues është vazhduar me operatoret e tjerë të ndodhur më poshtë në rënditje. (bashkëlidhur klasifikimi përfundimtar i OE të klasifikuar). Kalimi i fituesit nga Operatori i parë në Operatorët e renditur më poshtë nuk ndryshon klasifikimin e operatorëve në rënditje, por bëhet pasqyrimi në bazë të procesverbaleve të tërheqjes apo të njoftimeve drejtuar Operatorëve Ekonomike.
Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së: Për argumentet e bëra më sipër kemi të njëjtin qëndrim me atë të pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit. Konstatimet e grupit të auditimit janë mbështetur në përcaktimet ligjore të referuara si dhe në verifikimin fizik të mallrave të marrë në dorëzim.

III.2.4.Auditim mbi administrimin e ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.

Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave dhe rivlerësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve.

Mbas shqyrtimit të dokumentacionit të sipër cituar konstatohet se:

Për auditimin e kësaj pike sipas drejtimeve të përcaktuara në programin ***nr. 614/1, datë 15.06.2021, pika 2,*** u mbështetëm në kriteret ligjore si më poshtë:

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 ñParaqitja e Pasqyrave Financiareò), të përcaktuara në Ligjin nr. 25/2018 ñPër Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò. Ligjinr. 10296, datë 8.7 2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, ndryshuar. Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, ndryshuar.

4/a.Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe valutë në përputhje me disiplinën financiare, si dhe magazinën për vitet 2019, 2020 deri në datë 30.06.2021.

Mbasi u shqyrtua dokumentacioni në lidhje me kryerjen e veprimeve me arkë e bankë, bazuar në Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 ñPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeveò, i ndryshuar; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", UMF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"i ndryshuar, u konstatua se:

Për periudhat ushtrimore 2019 dhe 2020, nuk rezulton të ketë kryerje të veprimeve me arkë në asnjërën prej monedhave në lekë apo në valutë, për pasojë nuk është mbajtur ditar arke, si dhe nuk ka veprime të kryera arkëtime apo pagesa me subjekte dhe operatorë. Të gjitha veprimet janë kryer nëpërmjet bankës.

Urdhër shpenzimet në përgjithësi kanë bashkëlidhur dokumenta autorizuese, vërtetues, kontabël, sipas natyrës së shpenzimit, përfshirë; (autorizim, urdhër prokurimi, procesverbal, oferta ekonomike, kontrata, fatura tatimore etj, etj), ndërsa për blerjet e materialeve është bashkëlidhur fletëhyrja e artikullit të blerë. Vlerat e shënuara në urdhër shpenzim përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës në përgjithësi është bërë sipas destinacionit e natyrës së shpenzimit llog.(602), ndërsa totali shpenzimit mujor e progresiv kuadron me konfermat bankare mujore. Regjistrimi i urdhër shpenzimeve evidentohet në ditarin e bankes në formatin përkatës në mënyre kronologjike dhe veprimet janë pasqyruar në llogaritë përkatëse rakorduar në vlerën totale vjetore në zbatim të Kreu I neni 3 pika 8 germa ñcò, Kreu II, neni 6, pika 2 të ligjit nr. 25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò.

4/c.Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave, si dhe rivlerësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve.

Inventarizimet i Pronës shtetërore për vitin 2019.

Është nxjerrë urdhri nr. 162, datë 16.12.2019 , i Kryeinspektorit për ngritjen e komisionit dhe kryerjen e inventarizimi fizik të aktiveve, i përbërë nga: Mariola Meta Kryetare, Enxhi Bostanxhi dhe Armid Tauzi anëtare, referuar udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar, janë paraqitur inventarët kontabël më datë 31.12.2020, për të kryer krahasimin e aktiveve kontabël me gjendjen e tyre fizike (të inventarit kontabël të magazinës).

Nga auditimi rezultoi se,nuk administrohen raportet lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, në mospërputhje me pikën 85/c, të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar.
Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me inventarizimin e pasurisë nga ISHMT për vitin 2019 rezulton se, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër MFKò, i ndryshuar, dhe Kreu IV-të UMF nr.30 datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuarrezulton se, janë ngritur komisionet e përbëra nga 3 antarë për inventarizimin e aktiveve sipas listës hartuar nga nëpunësi zbatues në bazë të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë, por rezulton të jenë të përshkruar specifikimet teknike(treguesit teknik) për të konkluduar në lidhje me gjëndjen e tyre.
Në inventaret fizikë nuk kanë rezultuar diferenca në plus apo minus.
Llogaria 214-Instalime teknike, makineri e pajisje, evidentohet në vlerën kontabël 6,839,271 lekë dhe fizik në vlerën 6,839,271 lekë pa diferenca.
Llogaria 215-Mjete transporti evidentohet në kontabilitet e përfshirë në llogarinë 218.
Llogaria 312-Materiale evidentohet në vlerën 2,252,462 lekë,sikurse evidentohet në bilanc.
Konstatohet se inventarizimi fizik është përshkruar vetem në sasi pa çmime dhe vlera.
Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi komisionet e inventarizimit.
Gjithashtu nuk rezulton të jetë kryer ndonjë procedurë për vlerësimin e aktiveve sipas UMF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 95 ku është përcaktuar se:

Vleresimi është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.

-Lidhur me problematikat e konstatuara më sipër mbajnëpërgjegjësi: znj E.Xh Përgjegjëse Sektorit Financës dhe Shëbimeve, znj F.B, specialiste e financës, komisioni inventarizmit.

Inventarizimi i pronës shtetërore për vitin 2020.
Është nxjerrë urdhri nr.216, datë 26.11.2020 i Kryeinspektorit për kryerjen e inventarizimi fizik të magazinës i përbërë nga:E.S, Kryetar komisioni,F.B, M.K anëtar,për kryerjen e inventarizimit të vlersimit të materialevetë zyrave dhe ambjenteve të institucionit komisioni i përbërë nga: A.C Kryetare, M.M dhe A.Sh anëtare, datë 20.01.2020, ku referuar nenit 4 pika 26 të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publikò janë paraqitur inventarët kontabël më datë 31.12.2019, për të kryer krahasimin e aktiveve kontabël me gjëndjen e tyre fizike (me përjashtim të inventarit kontabël të magazinës).
Sipas urdhrit janë ngritur komisionet e inventarizimit dhe janë paraqitur inventarët fizikë,por nuk administrohen raportet lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, në mospërputhje me pikën 85/c, të udhëzimit të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar.
Në inventaret fizikë nuk kanë rezultuar diferenca në plus apo minus.
Llogaria 214-Instalime teknike, makineri e pajisje evidentohet në vlerën kontabël 17,798,253 lekë dhe fizik në vlerën 11,798,253, lekë pa diferenca.
Llogaria 215-Mjete transporti evidentohet në vlerën 4,801,463 lekë kontabël e fizik po aq në bilanc pa diferenca .
Llogaria 218-Inventar ekonomik evidentohet në kontabilitet i njejtë me fizikun në vlera 8,672,678 lekë.
Llogaria 312-Materiale evidentohet në vlerën 3,136,358 lekë, sikurse evidentohet në bilanc.
Konstatohet se nuk është kryer inventarizimi fizik i magazinës.
Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi komisionet e inventarizimit.

Gjithashtu nuk rezulton të jetë kryer procedurë për vlerësimin e aktiveve sipas UMF nr.30, datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 95.
Nga auditimi rezultoi se regjistri i aktiveve, ishte përgatitur në mënyrë të shpërndarë, ku një pjesë ishin evidentuar në një tabelë, i cili na u paraqit në formë elektronike dhe pjesa tjetër gjendej bashkëlidhur me bilancet në përmbledhëset e inventarëve kontabël e fizikë. Pra regjistrimi i aktiveve paraqitet me parregullsi të theksuara në këtë drejtim.
Megjithatë edhe të përmbledhura,regjistri i aktiveve ka mangësi lidhur me plotësimin e kërkesave minimale siç janë:data e daljes në përdorim, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes.
Sa sipër është vepruar në mospërputhje me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III, pikat 26-33, veçanërisht pika 30.

4.d.Auditim mbi evidentimin, administrimin dhe dokumentimin e vlerave materiale e monetare, inventarët përkatës. Inventarizimi dhe administrimi i inventarëve të mjeteve kryesor, makineri e pajisje dhe të objekteve sipas inventarizimit të vitit të fundit të aktivitetit të këtyre njësive publike.
Nga auditimi i veprimeve të magazinës për vitet 2019,2020 në lidhje me evidentimin, administrimin dhe dokumentimin e vlerave materiale e monetare, u konstatua se:
-Blerjet e ndryshme nga njësia nga subjektet e ndryshme, dokumentoheshin me fletë hyrje dhe regjistroheshim sipas radhës kronologjike në ditar sipas dokumentacionit origjinal.
Nga auditimi rezultoi se, regjistri kontabël i aktiveve nuk ishte krijuar për llogarinë:
-215 Mjete Transporti (ku përfshihet edhe inventari ekonomik) me vlerë në bilancin e vitit 2020 prej 12,488,051 lekë.
Sa sipër është vepruar në mospërputhje me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III, pikat 26-33, veçanërisht pika 30.
-Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit, të bankës dhe magazinës ishte i bazuar në dokumentat origjinale.
Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, por konstatohet se bashkëlidhur fletëhyrje nuk ndodhen proces-verbalet e marrjes ne dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë, bashkëlidhur daljeve të aktiveve nga magazina ndodhen dokumentat shoqërues si urdhërdorëzime, fletëkërkesëa, plani i shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohen me fletëdaljen të cilat ishin të nënshkruara nga marrësit në dorëzim.

Konkluzion:
Lidhur me inventarët për vitin 2019: Konstatohet se nuk është kryer inventarizimi fizik në cdo llogari ekonomike për janë mjaftuar me inventarin kontabël.
Nuk rezulton që komisioni të ketë bërë relacion permbledhes për drejtuesit e Institucionit mbi gjendjen e akiveve materiale e jo materiale dhe sistemimin e tyre.
Lidhur me inventarët për vitin 2020:
Për vitin 2020 janë kryer inventarizimet, përveç inventarit të mjetevetë transportit,i cili është vetem në kontabilitet, si dhe nuk rezulton që komisioni të ketë bërë relacion permbledhes për drejtuesit e institucionit për gjëndjen e akiveve materiale e jo materiale.
Lidhur me evidentimin, administrimin dhe dokumentimin e vlerave materiale e monetare:
Nga kontrolli rezultoi se nuk ishte krijuar regjistri i kontabël i aktiveve..
Megjithatë, u konstatua se regjistri kontabël i aktiveve nuk ishte krijuar për llogaritë:
për vitin 2019;

214-Instalime teknike, llogari në vlerë 6,839,271lekë
215-Mjete transporti. llogari nëvlerë 5,648,780 lekë,
Viti 2020:
214-Instalime teknike, llogari në bilancin e vitit 2020 me vlerë: 11,798,253 lekë.
215-Mjete transporti, llogari në bilancin e vitit 2020 me vlerë: 4,801,463 lekë lekë.
Sa sipër, nga vlera e përgjithshme e AAGJM për vitin 2020 me vlerë:25,272,394, nuk ishin krijuar regjistrat kontabël të AAGJM për një vlerë prej 16,599,716 lekë.
Sa sipër është vepruar në mospërputhje me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III, pikat 26-33, veçanërisht pika 30.
Gjithashtu nuk rezulton të jetë kryer ndonjë procedurë për vlerësimin e aktiveve sipas UMF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 95.

Lidhur me problematikat e konstatuara më sipër mbajnë përgjegjësi: znj E.Xh Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shëbimeve të Brendshme, si dhe komisioni i inventarizimit.

Lidhur me observacionin e ISHMT nr. 975/1/21, datë 12.08.2021 dhe administruar në KLSH me nr. 614/4, datë 12.08.2021, mbi ProjektRaportin e auditimit të KLSH-së.
Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pasqyrat financiare se nuk qëndrojnë parregullësite e konstatuara.
Qëndrimi i Grupit Auditues të KLSH: Për sa më lart u morrë në konsideratë pjesërisht dhe u trajtua nëRaportin Përfundimtar të Auditimit.

Mbi auditimin e rregullshmërisë së pasqyrave financiare.
Lidhur me këtë çështje të programit të auditimit, u ushtrua auditim mbi ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe vlerësimin e aktivitetit financiar, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, nxjerrjen e llogarisë vjetore, kuadri ligjor i përdorur mbi sistemin dhe procesin kontabël, kompjuterizimin, raportimin e pasqyrave financiare, për periudhën 01.01.2019, deri më datë 30.06.2021ò.U shqyrtua dhe u verifikua dokumentacioni i vënë në dispozicion, i Pasqyrave Financiare, ditarët e magazinës, të arkës e të bankës, ditarët e shpenzimeve korrentë progresive vjetore, **2019, 2020deri me datë 30.06.2021** të plotësuara nga **Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut,**në zbatim të ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareòdhe Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò.

Mbas shqyrtimit të dokumentacionit të sipër cituar konstatohet se :
Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut e ka kryer veprimtarinë e saj për vitet 2019, 2020 deri më datë 30.06.2021 dhe Pasqyrat Financiare rezultojnë të përgatitura nga Përgjegjëse e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme znj. E.Xhdhe specialistja e financës znj. F.B dhe është miratuar nga Kryeinspektori L.S, të vulosura e nënshkruar me shkrese përcjellëse me nr.566 datë 11.03.2021 nga Dega e Thesarit Tiranë.

Pika 3, a-Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit sipas planit unik kontabël për institucionet publike.
Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitet **2019, 2020** japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, u analizuan pasqyrat financare të vitit **2019, 2020** dhe pasqyra e shpenzimeve deri më datë **30.06.2021** nga ku rezultoi se:
Nuk ishin krijuar ditarët e pagesave, ditari i veprimeve të ndryshme, centralizatori, por mbahej vetëm ditari i bankës dhe magazinës.

Ditari i bankës, megjithëse mbahej, në këtë ditar reflektoheshin vetëm llogaritë financiare dhe të shpenzimeve dhe jo të gjithë llogaritë, sipas planit kontabël bazuar në UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", këto edhe për shkak të mos mbajtjes së ditërëve të tjerë, siç u përmend edhe më sipër.

Lidhur me ditarin e llogarive të magazinës, për aktivet qarkulluese, konstatohet se veprimet dhe ngjarjet e ndodhura, janë marrë në ditar dhe janë kontabilizuar si llogaria 603 ñNdryshimi i gjendjeveò e cila prekej vetëm në ñDebiò për fletë-daljet, ndërsa për fletë-hyrjet prekej në ñKrediò llogaria 401 ñFurnitorëò, në një kohë që kjo llogari ka lidhje dhe kreditohet në debi të llogarisë së klasës 6 të shpenzimeve të shfrytëzimit.

Kontabilizimi i llogarisë 603 në debi, nuk bëhej për çdo fletë dalje, por kryhej vetëm një herë në muaj, në mënyrë të përmbledhur.

Sa sipër është në mospërputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

Pasqyrat financiare të vitit 2020, ishin hartuar vetëm bazuar në ditarin e bankës dhe të magazinës dhe shumë veprime si dhe nxjerrja e pasqyrave financiare bëhej nga jashtë (extra kontabël).

Përveç artikujve të magazinës, për të gjithë postet e tjera të pasqyrave financiare, nuk ishin përgatitur inventarët dhe analizat sipas këtyre posteve, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, neni 15, si dhe në mospërputhje **me** UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28, ku përcaktohet se:

> ñÇdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet më vete), para evidentimit të dhënave në pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimoreò.

Pjesë e pasqyrës financiare të vitit 2020 janë edhe aktrakordimet me degën e thesarit, inventarët etj, pasqyrat F1, F2, F4, F5, F7,etj.

Mbasi u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion bazuar në kriteret e vlerësimit, rezultoi se:

ISHMT Tiranë, ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2020, mbështetur në Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

Pjesë përbërëse të PF/2020 janë: Pasqyra e pozicionit financiar (F1); Pasqyra e Performancës financiare (F2); Pasqyra e flukseve monetare (F3); Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4); Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore: Investimet dhe burimi i financimit (F6); Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a); Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b); Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8); Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, ku është dhënë informacion mbi: Emrin e njësisë ekonomike raportuese.

Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2020-31.12.2020.

Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë.

hartimi dhe dorëzimi i pasqyrave financiare në degën e thesarit është është protokolluar në degën e thesarit, më datë 31 mars 2021 brenda afatit ligjor.

Përgatitur nga znj. E.Xh përgjegjëse e sektorit Financës dhe znj. Fatbardha Ballaspecialiste.

Pasqyrat Financiare janë dorëzuar në Degën e Thesarit me shkresën e ISHMT Tiranë nr. 566 prot., datë 11.03.2021 dhe me vulën e ISHMT , të nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm z. L.S

Nga auditimi i Pasqyrave financiare rezultoi:

Pasqyrat Financiare të vitit 2020 rezultojnë në përgjithësi të jenë të plotësuara sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, planit kontabël dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit tëMinistrisë

së Financave nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò.
Pasqyrat financiare vjetore 2020 janë dorëzuar në Degën e Thesarit më datë 31 Mars 2020, me të dhënat e mëposhtme:

AKTIVI **Në lekë**

Nr.			VITI	VITI
Reshti	**Referenca**	**E M E R T I M I**	**USHTRIMOR**	**I MËPARSHËM**
	Llogarive		**2020**	**2019**
1	**A.**	**Aktivet**	**42,401,666**	**23,563,673**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**17,129,272**	**6,777,997**
3		**1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre**	**0**	**0**
4	520	Disponibilitete në thesar	0	0
5		**2. Gjendje Inventari Qarkullues**	**3,136,358**	**2,252,462**
6	31	Materiale	3,136,358	2,252,462
7		**3. Llogari të Arkëtueshme**	**13,992,914**	**4,525,535**
8	468	Debitorë të ndryshëm	7,522,936	-
9	4342	Operacione me shtetin(Të drejta)	6,469,978	4,525,535
10		**II. Aktivet Afat gjata**	**25,272,394**	**16,785,676**
11	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**
12	**21**	**2. Aktive Afatgjata materiale**	**25,272,394**	**16,785,676**
13	211	Pyje, Plantacione	0	0
14	212	Ndërtesa e Konstruksione	0	0
15	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	0	0
16	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	11,798,253	6,839,271
17	215	Mjete Transporti	4,801,463	5,648,780
18	218	Inventar Ekonomik	8,672,678	4,297,625
19	**B.**	**PASIVET (DETYRIMET)**	**13,992,914**	**4,525,535**
20		**I. Pasivet Afat shkurtra**	**13,992,914**	**4,525,535**
21		**1.Llogari të Pagueshme**	**13,992,914**	**4,525,535**
22	401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	0	0
23	42	Detyrime ndaj personelit	4,502,003	3,144,064
24	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	429,747	308,061
25	435	Sigurime Shoqërore	1,349,543	941,379
26	436	Sigurime Shëndetësore	188,685	132,031
27	4341	Operacione me shtetin(detyrime)	7,522,936	0
28	**C.**	**AKTIVET NETO/FONDET (A-B)**	**28,408,752**	**19,038,138**
29	**D.**	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**28,408,752**	**19,038,138**
30	101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	28,408,752	19,038,138
34	**E.**	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**42,401,666**	**23,563,673**
KONTROLLE		**Shifra 0(zero)- Tregon Kuadrat urën**	**Kuadratura**	**Kuadratura**
Kontroll 1.		Aktivet Neto a janë të barabarta me Fondin e Konsoliduar	**0**	**0**
Kontroll 2.		Totali i Aktiveve a është i barabartë me=Totalin e Pasiveve	**0**	**0**

Më poshtë evidentohen testet thelbësore në lidhje me llogaritë të cilat janë vlerësuar si materiale, bazuar në materialitetin e përcaktuar dhe që përbëjnë një evidencë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të auditimit mbi pasqyrat financiare të mbyllura për periudhën 01.01.2020-31.12.2020.
Nga të dhënat e evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2020 sipas aktivit **Grupi I-Aktivet Afat shkurtra** evidentohen në vlerën**17,129,272 lekë, nga 6,777,997 lekë** në vitin 2019, ndërsa në **Grupin II-Aktivet Afat gjata** evidentohen me një vlerë prej **25,272,394 lekë**, **nga 16,785,676 lekë** në vitin 2019. Totali aktivit evidentohet në vlerën **42,401,666 lekë nga 23,563,673** lekë në vitin 2019 dhe është i barabartë me totalin e Pasivit.
Më hollësisht plotësimi i pasqyrave financiare analizohet si mëposhtë:

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje Inventari qarkullues"

Llogaritë	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca

kontabël				2020-2019
2	**Gjendje Inventari Qarkullues**	**3,136,358**	**2,252,462**	**+883,896**
31	Materiale	3,136,358	2,252,462	+883,896
	Totali	**3,136,358**	**2,252,462**	**+883,896**

Llogaritë e Klasës 3, sikurse evidentohen në pasqyrat financiare me datë 31.12.2020 paraqiten në vlerën **3,136,358 lekë** që përbëhet nga llogaria kontabël 31 ñMaterialeò në vlerën **3,136,358 lekë**.

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të Arkëtueshme"

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
3	**Llogari të arkëtueshme**	**13,992,914**	**4,525,535**	**+9,467,379**
468	Debitorë te ndryshem	7,522,936	-	+7,522,936
4342	Operacione me shtetin(të drejta)	6,469,978	4,525,535	+1,944,443

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" në vlerën 7,522,936 lekë përfaqëson detyrimet e debitorëve nga vitet e kaluara, vlera e debitorëve të cilët nuk kanë likuiduar detyrimin për asgjesimin e lodrave si dhe detyrime me një vlerë prej 7,400,000lekë, gjoba të pa arkëtuara nga subjektet private.

Llogaria 4342 ñOperacione me shtetin (Debitor) në vlerën**6,469,978lekë** pasqyron detyrimin e shtetit ndaj Institucioneve publike për shpenzimet e konstatuara të vitit 2020 por që do të përballohen nga buxheti i vitit 2021, si dhe detyrime ndaj punonjesve për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, e rakorduar kjo me llogaritë në pasiv 401, 421,431,435,436 dhe llogarinë kreditore 467 ñKreditorë të ndryshëmò në Postin B-të Bilancit.

Llogaria 4342 ñTe tjera operacione me shtetin (debitor)ò, në fund të vitit 2020 kuadron me Llogarinë 7206 ñFinancim i pritshëm nga buxhetiò sipas Pasqyrës së Performancës Financiare, duke qenë në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 32.

Llogaritë e klasës së 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës së 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës së 5.

Grupi A- AKTIVE Afatgjata

II-Aktivet Afatgjata evidentohen në vlerën **25,272,394 lekë**.

1.Llogaritë e Klasës 20 **"Aktive Afatgjata jo materiale"** përfaqësojnë vlerën **25,272,394lekë,** ndërsa sipas të dhënave të pasqyruara në vitin paraardhës 2019, AAGJ jo Materiale evidentohen me një vlerë prej**8,486,718lekë me nje rritje të vlerës së** AAGJ jo Materiale**.**

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
20	**1-Aktive Afatgjata jo Materiale**	**25,272,39**	**16,785,67**	**8,486,718**

Llogaritë e Klasës 21 ñ**Aktivet Afatgjata materiale** " përfaqësojnë vlerën **25,272,394lekë** sipas tëdhënave pasqyruar për vitin ushtrimor 2020, ndërsa sipas të dhënave të pasqyruara në vitin paraardhës 2019, AAM evidentohen me një vlere prej**25,272,394lekë me një shtim të vlerës së AAGJM prej 8,486,718lekë.**

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
21	**2-Aktive Afatgjata materiale**	**25,272,394**	**16,785,676**	**8,486,718**
211	Pyje, Plantacione	0	0	0
212	Ndertesa e Konstruksione	0	0	0
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0	0	0
214	Instalime teknike, makineri e paisje	11,798,253	6,839,271	+4,958,982
215	Mjete Transporti	4,801,463	5,648,780	-847,317
218	Inventar Ekonomik	8,672,678	4,297,625	+4,375,053

Në aktivin e pasqyrave vjetore nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 209 dhe 219, respektivisht për Aktivet afatgjata jo materiale dhe Aktivet afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky në moszbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 31, ku citohet se:

ñAktivet afatgjata paraqiten ny pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyreò

Të dhënat për amortizimin janë nxjerrë nga pasqyra nr. 7.b, pasi në pasqyrat financiare nuk evidentohet shuma e akumuluar e amortizimit në llogaritë 209 dhe 219, nuk evidentohet llogaria 1013 por vetëm në pasqyrën nr. 4 si dhe në pasqyrën e performancës financiare Rubrika 7, Llogaria 681 ñKuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimitò. Llogaria 681, paraqitet pa vlerë në rubriken e amortizimit në pasqyrat e performancës .

Llogaria 212 ñNdërtesa e konstruksioneò evidenton në fillim të vitit ushtrimor dhe në mbyllje të vitit ushtrimor me vlerë 0.institucioni nuk ka ndertesë në inventare apo pronësi.

Llogaria 214 "Instalime elektrike, makineri e paisje", për vitin 2020 paraqitet në vlerën 11,798,253 lekë**,** ndërsa për vitin 2019 evidentohet në vlerën prej **6,893,271 lekë** me nje shtesë në vlerën 4,958,982 **lekë** vlerë cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në fillim të vitit ushtrimor dhe në mbyllje të vitit ushtrimor.

Llogaria 215 "Mjete transporti" evidentohet në një vlerë prej 4,801,463 lekë që paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të ISHMT më datë 31.12.2020, nga **5,648,780 lekë** që ishte në vitin paraardhës, me një rritje **në vlerën 12,806,158 lekë,** vlerë cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në fillim të vitit ushtrimor dhe në mbyllje të vitit ushtrimor.

Llogaria kontabël 218 ñInventar ekonomikò evidentohet në një vlerë prej 8,672,678lekë, që paraqet vlerën e inventarit ekonomik më datë 31.12.2020, nga **4,279,625 lekë** që ishte në vitin paraardhës, me një rritje **në vlerën 4,375,053 lekë,** vlerë cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në fillim të vitit ushtrimor dhe në mbyllje të vitit ushtrimor.

Llogaria inventariale **31** ñMaterialeò **në vlerën 3,136,358lekë,** pasqyrojnë gjendjen e materialeve sipas inventareve fizik e kontabël **më datë datë 31.12.2020, nga 2.252,462 lekë** me rritje në vlerë **883,896lekë** që pasqyrohet në llogarinë **73 "Ndryshime të gjendjes së inventarit të produkteve".**

Pasqyra e amortizimit viti 2020, AAGJM, (Nxjerrë nga formati 7/b)

Nr. Llog.	Emërtimi	Gjendja e amortizimit viti 2019	Shtesa amortizimit viti 2020	Pakësim amortizimit viti 2020	Gjendja në fund të vitit 2020
	AAGJ/MATERIALE	**2,359,760**	**2,554,804**	**-**	**4,914,564**
214	**Instalime,makineri,pajisje**	268,840	943,819	-	1,212,659
215	**Mjete transporti**	904,329	847,317	-	1,751,646
218	**Inventar Ekonomik**	1,186,591	763,668	-	1,950,259
	T O T A L I	**2,359,760**	**2,554,804**	**-**	**4,914,564**

Pasqyra e Aseteve llog. 214 dhe 215

Nr. Llog.	Emërtimi	Gjendja datë 31.12.2019	Blerje e Krijuar Me pagesë	Shtesë transf.kap. viti 2020	Gjendja në fund me datë 31.12. 2020
214	**Instalime, Makineri, pajisje**	7,108,111	5,902,800	-	13,010,911
215	**Mjete transporti**	6,553,109	-	-	6,553,109
218	**Inventar Ekonomik**	5,484,216	1,811,30	3,327,384	10,622,940
	T O T A L I	**19,145,436**	**7,714,140**	**3,327,384**	**30,186,960**

Pasqyra e ndryshimeve klasa 3-Materiale dhe objekte inventari

Nr.	Emërtimi	Gjendjameda	Shtesa Mat.	Pakësim mat.	Gjendja në fund

Llog.		të 31.12.2019	konsumi viti 2020	Konsumi viti 2020	të vitit 2020
31	Materiale	1,252,462			3,136,358
	T O T A L I	1,252,462			3,136,358

Llogaritë e Arkëtueshme (Kërkesa arkëtimi mbi debitoret) për vitin 2020 paraqitet në vlerën 7,522,936lekë nga 0lekë evidentuar në vitin 2019 dhe përbëhet nga llogaria 4342-Operacione me shtetin(Të drejta) në vlerën 7,522,936 lekë,që përfaqëson detyrimet e shtetit ndaj institucioneve publike për shpenzimet e konstatuara të vitit 2020 që përballohen me fondet buxhetore të vitit 2021 si dhe shpenzimet për paga, kontributet e sigurimeve shoqerore e tatimi mbi të ardhurat e punonjësve të muajit Dhjetor që likuidohen në Janar 2021. Llogaria 468 ñDebitorë të ndryshëmò evidentohet në vlerën 7,522,936 lekë përfaqëson gjoba të pa arkëtuara si dhe dëmtime të lodrave të disa subjekteve detyrim arkëtimi pranë ISHMT.

B.PASIVET (DETYRIMET) e Pasqyrave Financiare vjetore evidentohen në **vlerën 13,992,914 lekë** e kuadruar me aktivin e Pasqyrave Financiare vjetore në të njëjtën vlerë dhe përfaqëson:

I. Pasivet Afat shkurtra për vitin 2020 të cilat evidentohen në vlerën **0 lekë**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrave Financiare, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e ISHMT më 31.12.2020, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020,

Llogaritë	PËRSHKRIMI I OPERACIONEVE	Viti 2020	Viti 2019	Dif /ndryshimi
B	PASIVET(DETYRIMET)	13,992,914	4,525,535	9,467,379
	I.Pasivet Afat shkurtra	13,992,914	4,525,535	9,467,379
	1.Llogari të Pagueshme	13,992,914	4,525,535	9,467,379
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	-	-	-
42	Detyrime ndaj personelit	4,502,003	3,144,064	+1,357,939
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	429,747	308,061	+121,686
435	Sigurime Shoqërore	1,349,543	941,379	+408,164
436	Sigurime Shëndetësore	188,685	132,031	+56,654
4341	Operacione me shtetin(detyrime)	7,522,936	-	+7,522,936

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" evidentohet në fund të vitit 2020 me një vlerë **0** lekë.

Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit" evidentohet në një **vlerë** 4,502,003 **lekë** që përfaqëson vlerën e pagave të muajit Dhjetor për tâu paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa" evidentohet në një **vlerë prej** 429,747 **lekë** që përfaqëson detyrime për tu paguar nga subjektit ndaj shtetit tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" evidentohet në **vlerën** 1,349,543**lekë**dhe paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të cilat paguhen në vitin **e ardhshëm në Janar.**

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" në fund të vitit 2020 evidentohet në vlerën 0lekë

Llogaria 467 "Kreditore të ndryshëm" në fund të vitit 2020 evidentohet në vlerën 0lekë

C. AKTIVET NETO/FONDET (A-B) në fund të **vitit 2020** evidentohet në **vlerën 28,408,752 lekë,** me një **vlerë të barabartë me klasën D "FONDI I KONSOLIDUAR".**

D. "FONDI I KONSOLIDUAR", në fund të **vitit 2020** evidentohet në **vlerën 28,408,752 lekë** dhe paraqitet si më poshtë:

Llog.	PËRSHKRIMI I OPERACIONEVE	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca/ndryshimi
D	Fondi i Konsoliduar	28,408,752	19,038,138	+9,370,614
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar	28,408,752	19,038,138	+9,370,138
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	42,401,666	23,563,673	+18,837,993

Pasqyra e Performancës financiare (F2)

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të ISHMT më datë 31.12.2020 janë të rakorduar me Degën e Thesarit, konkretisht:

Llog.	PËRSHKRIMI I OPERACIONEVE	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca/ndryshimi
A	**TË ARDHURAT**	**77,614,258**	**63,335,433**	**+14,278,825**
71	**III.TË ARDHURA JO TATIMORE**	**3,697,998**	**10,444,220**	**-6,746,222**
711	**2.Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare**	**3,697,998**	**10,444,220**	**-6,746,220**
7115	Gjoba, kamatëvonesa,sekuestrime e zhdëmtime	3,697,998	10,444,220	-6,746,220
72	**V- Grante Korente**	**73,916,260**	**52,891,213**	**+ 21,025,047**
720	**1.Grant korent I Brendshëm**	73,916,260	52,891,213	+ 21,025,047
7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	67,446,282	48,365,678	+19,080,604
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	6,469,978	4,525,535	+ 1,944,443

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" evidentohet me deficit në **vlerën0 lekë,.**

në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Llogaritë Financiare(Disponilitete në Thesar)" e cila paraqitet në vlerën **0lekë.** Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në zbatim me kërkesat e përcaktuara në **UMF nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.6 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare".**

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO/FONDET NETO

Numër llogarie	Emërtimi	Fond. bazë grant. Kap.	Rezultatet e Ushtrimit Tepricë/Deficit	GJITHSEJ Aktive/Neto Fonde/Neto
		1	2	
101	**I.AKTIVET NETO/FONDET NETO**	19,038,138		**19,038,138**
	II.NDRYSHIMET NË AKTIVET/FONDET NETO			
	1.NGA BURIME TË BRENDSHME			
105	Nga grantet e brendshme kapitale(+)		7,714,140	**7,714,140**
85	Nga rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)		883,894	**883,894**
115	Nga Fondet e veta të investimeve (+,-)			
1013	Nga konsumi i AAGJ(-) Amortizimi		-2,554,804	**-2,554,804**
	2. NGA BURIME TË JASHTME			**3,327,384**
106	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)			
1016	Nga transferuat e brendshme të AAGJ, Dhurata (+,-)		3,327,384	**3,327,384**
	TOTALI I FONDEVE TË VETA (I+II)	**19,038,138**		**28,408,752**

V.O. Në tabelë nuk janë përfshirë rubrikat boshe

Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/Fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar" **në vlerën 28,408,752lekë.**

Pasqyra e Aktiveve neto/Fonde neto është plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në UMF për ñRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet netoò.

Edhe shënimet shpjeguese (Pasqyra F5) në përgjithësi janë plotësuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 03.09.2018, pika 3.7 ñRregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individualeò.

Megjithatë u konstatua se nuk ishin plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat si më poshtë:

Rubrika 1:Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, lidhur me vendin e paraqitjes, numri dhe data e protokollit të ISHMT Tiranë.

Rubrika 2: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, si dhe nr. e protokollit të institucionit marrës së pasqyrave financiare.

PASQYRAT STATISTIKORE

Pasqyra statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit", pasqyron shpenzimet për investime për AAGjM në vlerën 7,714,140 lekë grande nga buxheti dhe 7,714,140 lekë grande kapitale nga nivele tjera me vleren3,327,384 lekëve vendosur në Formatin 1, të pasqyrës së Pozicionit Financiar (AAGJM).

Pasqyra statistikore nr. 7/a, 7/b, paraqet gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata dhe evidentohen me koston historike të tyre si dhe me vlerën neto, që gjendjen në çelje dhe mbyllje, si më poshtë;

Nr	Aktivet Afatgjata	AAGJ vlere Bruto	AAGJ me vlerë Neto
I	**Gjendja në fillim**	**19,145,436**	**16,785,676**
II	Shtesa gjatë vitit	11,041,524	8,486,720
III	Pakësime gjatë vitit	-	
IV	Gjendja në fund	**30,186,564**	**25,272,394**

Për plotësimin e Pasqyrës Statistikore për ñGjendje dhe ndryshimet e AAGJ me kosto historikeò janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në UMF nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.2 ñRregullat për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën bruto)ò.

Megjithatë, siç u përmend edhe më sipër, në aktivin e pasqyrave vjetore paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky moszbatim të me Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 31. Vlera neto e AAGJM të pasqyrave financiare, formati 1, rakordon me tabelën mbi gjendjen dhe ndryshimet e AAGJM sipas formateve 7/a dhe 7/b, vetëm për vlerën neto.

Pasqyra e Flukseve Monetare (CASH FLOW), Formati nr. 3

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi akordimin e fondeve buxhetore për shpenzime korente, për detyrime e shpenzime korentë, rritja/rënia neto e mjeteve monetare, si dhe tepricat e likuiditeteve në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor, përmbledhtazi si më poshtë:

Nr.	PËRMBAJTJA	Periudha Raportuese 2020	Periudha Paraardhëse 2019
I	**VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT**	**48,601,736**	**64,108,787**
1	**Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente(+)**	**115,000,000**	**117,000,000**
2	**Arkëtime e të hyra(Cash), gjatë vitit ushtrimor**	**3,697,998**	**-**
	Të tjera arkëtuar(+)	3,797,998	10,444,220
3.	**Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente**	**73,794,260**	**-63,335,433**
	Për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor(-)	73,794,260	-63,335,433
II	**VEPRIMTARITË E INVESTIMEVE**	**0**	**8,529,350**
	Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale(+)	7,714,140	14,000,000
	Për detyrime e Investime te viti ishtrimor(-)	-7,714,140	-5,470,650
III	**TRANSFERTA E TË TJERA**	**-30,703,738**	**-72,638,137**
	Derdhje e Transferime të të Ardhurave në Buxhet(-)	-3,697,998	-
	Transferime në buxhet të Fondeve të pa përdorura(-)	-27,005,740	-72,638,137
IV	**Rritja/Rënia neto e Mjeteve monetare**	**17,897,998**	**0**
V	**Teprica në fillim të vitit ushtrimor**	**0**	**0**
VI	**Teprica e Likujditeteve në fund të vitit ushtrimor**	**0**	**0**

Pasqyra statistikore nr. 8 "Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave".

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore ñNumri i punonjësve dhe fondi i pagaveò është bërë në zbatim të kërkesave të përcaktuara në UMF nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.4 ñRregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagaveò, sipas pasqyrës së mëposhtme:

Nr.	Kategoritë	Numri mesatar vjetor i punonjësve	NUMRI I PUNONJËSVE ndryshuar gjatë vitit			FONDI I PAGAVE DHE KONTRIBUTET					
			Pranuar të	Larguar	Gjendje në fund të vitit	Fondi i pagave gjithsej	Shpërblime suple	Ndihma shoq	Kontributi sig.shoq. dhe	Shpërblime të	Tatimi mbi të ardhurat

		gjithsej	rinj		ushtrimor		mentare	ërore e të menjëhershme	shëndetësore	tjera	
1	Nr.i punonjës gjithsej (1+2+3+4+5)					**50,159,893**			**13,874,308**		**3,913,308**
1	Drejtues	4	-		4	10,241,394			2,737,446		928,464
2	Specialist me arsim të lartë	50	18	4	64	37,208,824			10,380,864		2,923,832
3	Teknikë		0		0	0			0		0
4	Nëpunës të thjeshtë	2	1		3	1,661,476			463,352		36,727
5	Punëtorë		0		0	0			0		0
6	Punëtorë të përkohshëm		4		4	1,048,199			292,446		24,285

I.Pagat dhe përfitimet e punonjësve me një vlerë **50,159,893 lekë**
II. Kontribute të Sigurimeve në vlerën **13,874,308 lekë**
III Blerje Mallra e Shërbime në vlerën**17,276,978 lekë**e cila përbëhet nga: llogaria 6020 ñMateriale zyre e të pergjithshmeò në vlerën **4,303,424 lekë, llog.6021** ñMateriale dhe shërbime specialeò në vlerën 0 lekë, llog 6022 ñSherbime nga te treteò vlerën **1,397,1701, lekë,** llog 6023 ñShërbime transportiò në vlerën**1,130,537**lekë, llog.6024 ñShpenzime udhëtimiònë vlerën **3,371,495 lekë,**llog.6025 ñShpenzime për mirëmbajtje të zakonshmeò në vlerën **0 lekë**, llogaria 6027 ñShpenzime për detyrime për kompensime legaleò në vlerën **6,989,952 leke** dhe llog 6029 ñShpenzime te tjera operativeò në vlerën **84,400 lekë.**
V. Transferime Korente, në vlerën **122,000 lekë**
VII. Kuota Amortizimi dhe shuma të parashikuara, me një vlerë 3,697,998 lekë.
VIII. Ndryshim i gjendjeve te invenarit (+-) në vlerën 1,420,418 lekë
IX Shpenzime të tjera
VII Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produktevenë vlerën**-883,896 lekë.**
Sikurse evidentohet më siper rezulton se totali i aktivit është i barabartë me totalin e pasivit të bilancit kontabël për vitin ushtrimor dhe për ushtrimin e mëparshëm perkatësisht në vlerat **42,401,666 lekë dhe 42,401,666 lekë.**

Konkluzion:
Llogaria 63 në Pasqyrën F2 (në vlerën **13,992,914 lekë)** është e barabartë me Ndryshimin e Gjendjeve të Klasës 3, në Pasqyrën F1 (në vlerën **13,992,914 lekë).**
Vlerat e llogarive të paraqitura në postet e bilancit kontabël korespondojnë me informacionin që jepet në pasqyra, anekse, **formati 4 për shpenzimet dhe burimet për investime, formati 5, për lëvizjen Cash** kuadron me **situacionet e shpenzimeve për vitin 2020,** për fondet nga buxheti dhe shpenzimet e thesarit; për të ardhurat tatimore dhe jo tatimore dhe transferuar; dhe formatin 8,për lëvizjen e fondeve. Totali i shpenzimeve për paga personeli të përhershëm e të përkohshëm (pasqyra 3/1 ne postet përkatëse) është i barabarte me totalin e fondit te pagave në pasqyrën e nr. të punonjësve dhe të fondit të pagave (kolona5, formati 9).
Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të trupëzuara është llogaritur sipas normave të amortizimit të përcaktuara udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, pika 36. Në kontabilitet, ai është pasqyruar në pasiv të bilancit si fond dhe në aktiv si pakësim të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e rakorduar kjo shumë, **me formatin 7 të pasqyrës së bilancit**.
Por megjithatë, u konstatua se nuk ishin hapur ditarët e Shpenzimeve të Pagave, Ditari i Veprimeve të ndryshme, Libri i madh. Mbahej vetëm ditari i Bankës dhe Magazinës.

Ditari i Bankës, megjithëse mbahej, në këtë ditar reflektoheshin vetëm llogaritë financiare dhe të shpenzimeve dhe jo të gjithë llogaritë, sipas planit kontabël bazuar në UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", këto edhe për shkak të mos mbajtjes së ditarëve të tjerë, siç u përmend edhe më sipër.
Lidhur me ditarin e llogarive të magazinës, për Aktivet Qarkulluese, konstatohet se veprimet dhe ngjarjet e ndodhura, janë marrë në ditar dhe janë kontabilizuar si llogaria 603 ñNdryshimi i gjendjeveò e cila prekej vetëm në ñDebiò për fletë-daljet,
Kontabilizime i llogarisë 603 në debi, nuk bëhej për çdo fletë dalje, por kryhej vetëm një herë në muaj, në mënyrë të përmbledhur.
Sa sipër është në mospërputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".
Pasqyrat financiare të vitit 2020, ishin hartuar vetëm bazuar në Ditarin e Bankës dhe të Magazinës dhe shumë veprime si dhe nxjerrja e pasqyrave financiare bëhej nga jashtë (extra kontabël).
Përveç artikujve të magazinës, për të gjithë postet e tjera të pasqyrave financiare, nuk ishin përgatitur inventarët dhe analizat sipas këtyre posteve, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, neni 15, si dhe në mospërputhje meUMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28.

Të dhënat për amortizimin janë nxjerrë nga pasqyra nr.7.b, pasi në pasqyrat financiare nuk evidentohet shuma e akumuluar e amortizimit në llogaritë 209 dhe 219, nuk evidentohet llogaria 1013 por vetëm në pasqyrën nr. 4 si dhe në pasqyrën e Performancës financiare Rubrika 7, Llogaria 681 ñKuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimitò.
Në aktivin e pasqyrave vjetore nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 209 dhe 219, respektivisht për Aktivet afatgjata jo materiale dhe Aktivet afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky moszbatim me Udhëzimin të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 31.

Përse trajtuar në këtë Akt-Konstatimi mbajnë përgjegjësi Përgjegjëse e sektorit të Financës dhe shërbimeve znj. E.Xh dhe specialistja e financës znj. F.B.

Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave dhe rivlerësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve.
Mbas shqyrtimit të dokumentacionit të sipër cituar konstatohet se:
Për auditimin e kësaj pike sipas drejtimeve të përcaktuara në programin **nr.614/1, datë 15.06.2021, pika 2,** u mbështetëm në kriteret ligjore si më poshtë:

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 ñParaqitja e Pasqyrave Financiareò), të përcaktuara në Ligjin nr. 25/, datë 03.2018 ñPër Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò
Ligji nr.10296, datë 8.7 2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò.
Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

Titulli i Gjetjes	**Pasqyrat financiare vitet 2019-2020**
Situata	ISHMT (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitet 2019-2020, nuk kishin hapur ditarët me veprime të ndryshme si dhe libri i madhë. Nuk është paraqitur inventari kontabël dhe nuk është kryer inventarizimi fizik i këtyre llogarive;

	-llogaria ñ214, Instalime teknikeò, llogari në bilancin e vitit 2020 me vlerë: 11,798,253 lekë. -llogaria ñ215 Mjete transportiò,llogari në bilancin e vitit 2020 me vlerë: 4,801,463 lekë. Për vitin2019-2020, nuk rezulton të jetë bërë relacion permbledhes për drejtuesin e Institucionit për gjendjen e aktiveve materiale dhe jo material; Për vitet 2019-2020, lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit, në pasqyrat financiare nuk evidentohet shuma e akumuluar e amortizimit në llogaritë 209 dhe 219, nuk evidentohet llogaria 1013, por vetëm në pasqyrën nr.4, si dhe në pasqyrën e performancës financiare Rubrika 7, Llogaria 681 ñKuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimitò. Në aktivin e pasqyrave vjetore nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 209 dhe 219, respektivisht për Aktivet afatgjata jo materiale dhe Aktivet afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar).
Kriteri	Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar; Neni 6, gërma (e) në Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, Pika 28 në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" pikat 28,31,32,34, Aneksi 2; Udhëzimin e MFE nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Kreu III, pikat 26-33 dhe pika 30dhe pikat 104/c dhe 106.
Ndikimi/Efekti	Mungesa informacionit financiar, mos ndjekje e saktë veprimeve dhe ngjarjeve të ndodhura dhe veprimeve të kryera.
Shkaku	Moszbatim i kuadrit rregullator.
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	ISHMT të hapë dhe të mbajë librat analitikë të të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, si dhe të gjithë ditarët e tjerë dhe analizat/libri i madh. Në ditarin e Bankës, regjistrimet kontabël të kryhen në llogaritë financiare dhe të llogarive të tjera, sipas veprimeve dhe ngjarjeve konkrete dhe të mos kalohen në çdo rast direkt në shpenzime. Për pasqyrat financiare, të përgatiten inventarët dhe analizat sipas posteve të bilancit. ISHMT të marrë masa për të ardhmen lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit dhe në pasqyrat financiare të evidentojë shumat e akumuluara të amortizimit, në llogaritë 209 dhe 219, dhe të evidentohet llogaria 1013. Llogaria 681, të evidentojë saktësisht shumat vjetore të amortizimit të AAGJ.

Titulli i Gjetjes	**Inventarizimi 2019-2020**
Situata	Nga auditimi rezultoi se rregjistri i aktiveve, ishte përgatitur në mënyrë të shpërndarë, ku një pjesë ishin evidentuar në tabele jo regjistër, i cili na u paraqit në formë elektronike dhe pjesa tjetër gjendej bashkëlidhur me bilancet në përmbledhëset e inventarëve kontabël e fizikë të paraqitura. Pra regjistrimi i aktiveve paraqitet me parregullsi të theksuara në këtë drejtim.
Kriteri	Udhëzimin e MFE nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
Ndikimi/Efekti	Mungesa informacionit financiar, mos ndjekje e saktë veprimeve dhe ngjarjeve të

	ndodhura dhe veprimeve të kryera.
Shkaku	Moszbatim i kuadrit rregullator.
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	Sektori i Financës dhe shërbimevetë marrë masa për të ardhmen, dhe të hapë regjistrate aktiveve për cdo llogari ekonomike.

III.2.5.Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit, të cilat mund të kërkojnë auditim edhe jashtë periudhës së auditimit.

-Gjatë auditimit nuk ka pasur probleme të tjera, veç çështjeve të programit të trajtuaramë sipër.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, *rekomandojmë*:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga ISHMT nuk është respektuar përcaktimi ligjor në pikën 2, të nenit 10 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, për hartimin dhe miratimin e metodikës për përcaktimin e vlerës së gjobës gjatë konstatimit të shkeljeve ligjore nga subjektet, si dhe nuk është hartuar manuali i posaçëm për përllogaritjen e riskut, planifikimin e inspektimit dhe kryerjen e tij mbi bazë risku, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 1.3 kapitulli 1 në Urdhërin nr.13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSHò; Neni 3 në Urdhërin nr.6, datë 19.02.2015 ñPër miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskutò.*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat për hartimin dhe miratimin e rregullores, ku gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës për llojin e shkeljes, të merret në konsideratë historiku dhe frekuenca e shkeljeve të subjektit në vitin paraardhës, me qëllim shmangien e qëndrimit subjektiv të inspektorit në përcaktimin e masës së gjobës përballë shkeljeve të subjektit.

1.2.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat për hartimin dhe miratimin e munualit posaçëm të inspektimit, referuar edhe përcaktimeve të bëra në manualin e përgjithshëm të inspektimit në RSH.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

2.Gjetje nga auditimi: Programi vjetor i inspektimit, për periudhën 2019-Qershor 2021, nuk është hartuar sipas përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjat ña, c, ç dhe dò të pikës 2 të Urdhërit nr.5, datë 19.02.2015 ñPër miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeveò;

-Programet mujore të inspektimit për periudhën 2019-Qershor 2021, nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 ñPër përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik ñe-inspektimiò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: ISHMT për subjektet e inspektuara në 3 vitet e fundit, të bëjë një vlerësim të sjelljes së tyre ndaj respektimit të kërkesave ligjore, si dhe në bazë të këtij vlerësimi, të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët), e për rrjedhojë edhe frekuenca e inspektimit të tyre, gjatë planifikimit të inspektimit.

2.2.Rekomandimi: Gjithashtu planet mujore tôi përcillen për mendim Inspektoratit Qendror dhe më pas të miratohen nga titullari i institucionit.

Brenda vitit 2021 dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, është konstatuar se në **9 raste,** në kryerjen e procedurës së shkatërrimit të produkteve të ndaluara për tregëtim, nuk administrohet dokumentacioni *(rekomandimi i Komisionit të Menaxhimit të Riskut, plani i shkatërrimit, procesverbali i asgjesimit/shkatërrimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedure, ISHMT, Inspektori mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i transferimit të mbetjeve, kontrata e shërbimit ndërmjet gjeneruesit të mbetjeve dhe subjektit i cili ka kryer procedurën e shkatërrimit dhe transportimit të produkteve në landfill, fletë-dalja e produkteve nga subjekti, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në mjetet e shkatërrimit dhe dërgimit të tyre në landfill, etj)*, në përputhje me kërkesat ligjore të bëra në VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñPër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò; Pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 ñPër miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshmeò; Kreun VIII të VKM nr.452, datë 11.7.2012 ñPër lendfillet e mbetjeveò, i ndryshuar, me qëllim identifikimin e kushteve të nevojshme për ruajtjen, trajtimin, transportimin dhe shkatërrimin e tyre dhe vërtetimin e këtij procesi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, që çdo proçedurë asgjesimi/shkatërrimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe procesverbali i asgjesimit i mbajtur nga Inspektorët e mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i transferimit të mbetjeve, fletë-dalja e produkteve nga magazina e subjektit privat, kontrata e shërbimit të shkatërrimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill.

Në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në të cilat sipas informacionit të pasqyruar në procesverbalet dhe vendimet e inspektimit, është bërë bllokimi i produkteve të rrezikshme/jo konforme për përdorim nga konsumatori, është konstatuar se **në 14 raste** (për produktet si instrumenta karburanti, lodra, etj), në këtë procedurë, nuk dokumentohet me foto vendosja shenjave dalluese të bllokimit/vendosja e masës ñbllokimò, si dhe administrimi i produkteve të bllokuara në magazina të dedikuara për këtë qëllim, mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën a të nenit 41, shkronjën ç të pikës 2 të nenit 43 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 ñPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò dhe pikën 18 të Kreut III të VKM nr.742, datë 20.11.2019 ñPër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteveò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast.

4.2.Rekomandimi: Gjithashtu të analizohet dhe vlerësohet mundësia e investimit në blerjen/ndërtimin/marrjes me qira (alternativa ekonomikisht e favorshme) të një magazine/ambienti të posaçëm, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen/shkatërrohen, të ruhen në këto ambjente, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në këto ambjente, tâu tarifohet subjekteve në të cilat është bërë bllokimi, deri në momentin e asgjesimit/shkatërrimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet, nuk do tâ lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit të futet përsëri në treg.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në **18 raste** është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i

inspektuar, si dhe në **12 raste** është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga ISHMT nuk është autorizuar ri-inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre, veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 4 dhe 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 ñPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò, dhe pikën 16 të Kreut IV të Urdhrit nr.25, datë 10.08.2018 për miratimin e rregullores ñPër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.1 dhe 2.2) faqe (17-115 dhe 116-126) të Raportit të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, për autorizimin e inspektimeve me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohen shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohen afate konkrete për korrigjimin e tyre duke këshilluar subjektet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në të cilat është marrë mostër për analizë laboratorike/testim për parapaketime, lodra, nga vetë ISHMT/operator të kontraktuar prej saj, në **45 raste** janë konstatuar mangësi të ndryshme:

- Në **26 raste** nuk dokumentohet marrja e mostrës (*mos pasqyrimi në procesverbal, mungesë të vërtetimit të marrjes së mostrës, protokoll-matjeve*), si dhe nuk pasqyrohet metoda e përdorur për analizimin e tyre, kryesisht në produktet e parapaketuara dhe lodrat;

- Në **6 raste** sasia e mostrës së marrë për analizë laboratorike nuk është e plotë;

-Në **13 raste** marrja e mostrës është bërë në mungesë të kompetencës ligjore për marrjen dhe testimin e tyre. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 4 të nenit 38 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011ñPër inspektimin në RSHò; Pikën 4 të nenit 30 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet jo ushqimoreò, ndryshuar; Kreun I dhe tabelën nr.1 dhe nr.1/a në VKM nr.1352, datë 3.10.2008 ñPër miratimin e rregullores për parapaketimetò, e ndryshuar; Kreun XIX të Urdhrit nr.305, datë 30.5.2014 ñPër procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregutò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të inspektimit me dokumentacionin e munguar, si dhe për kryerjen e matjeve/testimeve të saktësisë së instrumentit matës së karburantit, në çdo rast që e gjykon të nevojshme tôi drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose personit juridik privat të autorizuar prej DPM.

6.2.Rekomandimi: Gjithashtu nga ISHMT të merren masat që çdo procedurë e marrjes së mostrës, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjes fizike dhe asaj online, të jenë: Autorizimi i inspektimit, listë-verifikimi, procesverbali standard i inspektimit (*ku të pasqyrohet marrja e mostrës*), vërtetimi i marrjes së mostrës në rastin e lodrave, si dhe të eliminohet nga përdorimi dokumenti ñprotokoll-matjeò, përdorur për produktet e parapaketuara, si një dokument jo zyrtar.

Në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Ngaauditimi i praktikave të inspektimit janë konstatuar mangësi të ndryshme lidhur me dokumentimin e veprimeve të kryera përgjatë inspektimit, plotësimin e dokumenteve standard të miratuara, të cilat cenojnë transparencën, efektivitetin/qëllimin e inspektimit si dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Konkretisht mangësitë janë:

-54 raste listë-verifikimi i inspektimit (dokumenti standard në të cilin pasqyrohen shkeljet dhe respektimi i kuadrit ligjor nga subjekti) nuk është plotësuar në çdo rubrikë të tij, si dhe në 6 raste nga 54 gjithësej, ky dokument nuk administrohet në dosje ose nuk është plotësuar aspak;

-54 raste procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të detajuar për veprimet e inspektorëve përgjatë inspektimit, ku theksojmë se në 32 raste nga 54 gjithësej, në dosjen e inspektimit administrohet një dokument ñwordò jozyrtar dhe i pamiratuar, në të cilin pasqyrohen dhënat për produktet e inspektuara, të dhëna të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalin e inspektimit;
-60 raste nuk dokumentohen me foto produktet e inspektuara/nuk administrohet dokumentacion vërtetues i pohimeve të bëra prej inspektorëve, konkretisht të markimit CE të vendosur në produkt, deklaratave të konformitetit, paralajmërimet për detergjentët/ose produktet e rrezikshme, instruksionet e përdorimit për lodrat, etiketimin e produkteve;
-44 raste dokumentet justifikuese që administrohen në dosje, me qëllim vërtetimin e pohimeve të inspektorëve (pra kur detyrim ligjor kërkon që subjekti të ketë një dokument për të vërtetuar sigurinë e produktit), që subjekti plotëson detyrimin ligjor, janë fotokopje dhe pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar;
-16 raste në inspektimet jashtë planit (mbi bazë indicie/ankesë) autorizimi i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm, pra shkaqet, burimin e informacionit për të cilin është iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien.
Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 1 të nenit 39, si dhe shkronjat ñaò dhe ñeò në nenin 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pikën 3.2 në Urdhërin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 ñPër miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisëò, Kreun III dhe kolonën 7 në shtojcën 1 në Urdhërin nr.25, datë 10.8.2018 ñPër miratimin e rregullores ñpër përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativò.*(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.1 dhe 2.2) faqe (17-115dhe 116-126) të Raportit të Auditimit)*
7.1.Rekomandimi: Nga ISHMT të merren masat që, gjatë hartimit të procesverbalit të inspektimit sipas formatit të miratuar, të jepet informacion i detajuar për veprimet e inspektorëve përgjatë inspektimit dhe për çdo rast të inspektimeve, të plotësohet listë-verifikimi në të gjitha rubrikat e tij, si dhe rubrika ñ*komente*ò me arsyetimin përkatës.
7.2.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (*të autorizuara mbi bazë ankese, indicie*), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm, shkaqet, burimin e informacionit, ankesën/indicien etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Ngaauditimi i praktikave të inspektimit u konstatua se:
- Në **32 raste** nuk është zbatuar plotësisht objekti i inspektimit përcaktuar në autorizimin e tij (moskryerja e inspektimit të instrumentave matës, markimit CE të produkteve, etj), ku theksojmë se në 11 raste (të subjekteve që tregëtojnë detergjentë) nga 32 gjithësej, inspektimi nuk është kryer aspak, por është anulluar në mungesë të arsyetimit ligjor dhe të aktit të titullarit të institucionit për anullimin e tij, duke mos realizuar në këtë mënyrë, qëllimin e inspektimit pranë këtyre subjekteve. Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 50 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar (shfuqizuar në Dhjetor të vitit 2020) dhe nenin 48 të Ligjit nr.126, datë 15.10.2020 ñPër metrologjinëò; Nenin 29 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò; Shkronjën ñaò të pikës 2 në nenin 4 të Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Nenin 11 në Ligjin nr.10216, datë 21.01.2010 ñPër detergjentëtò; Pikën 4 në Kreun II të VKM nr.36, datë 20.01.2016 ñPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMTò, ndryshuar;
- Në **11 raste** inspektimi është i pavlefshëm, nga të cilat në **5 raste** ai është kryer **jashtë afatit** të përcaktuar në autorizimin e inspektimit, **5 rastebaza ligjore** e përdorur për verifikimin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga subjekti i inspektuar, **ka qenë e shfuqizuar**, si dhe në **1 rast** vendimi përfundimtar i inspektimit është marrë jashtë afatit 30-ditor nga data e mbajtjes së procesverbalit

të inspektimit. Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën ñaò të pikës 2 të nenit 4, pikën 4 të nenit 29 dhe pikën 3 të nenit 45 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Pikën 2 të nenit 99 të Ligjit nr.44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò; Pikën 6 të VKM nr.349, datë 29.4.2020 ñPër miratimin e rregullit teknik ñpër pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionitò dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuaraò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi:ISHMT të marrë masat e nevojshme që, në çdo inspektim të garantohet zbatimi i plotë i objektit të inspektimit, si dhe kryerja e tij brenda afatit të përcaktuar në autorizimin e inspektimit, në rastet kur kjo është objektivisht e pamundur, anulimi i tij të bëhet me akt të titullarit të institucionit, i cili duhet të jetë i arsyetuar.

8.2.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat për ndryshimin e bazës ligjore (në dokumentet standarde të inspektimit) të përdorur në inspektimin e produkteve elektrike, bazë ligjore e cila është shfuqizuar me VKM nr.349, datë 29.4.2020 ñPër miratimin e rregullit teknik ñpër pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionitò dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuaraò.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.3.Rekomandimi: Mbështetur në nenin 5, 8 dhe 9 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, si dhe në nenin 9 të Urdhërit të Inspektorit të Përgjithshëm nr.7, datë 19.02.2015[45], me qëllim rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarisë së inspektimit, Titullari i ISHMT të ngrejë një grup pune (me punonjës që nuk janë të përfshirë në inspektim), i cili çdo 6-mujor, të kryejë vlerësim të praktikave të inspektimit (duke përzgjedhur një kampion sa më gjithëpërfshirës të tyre), mbi zbatimin e kuadrit ligjor përkatës nga inspektorët.

Në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Ngaauditimi i praktikave të inspektimit u konstatua se:

- Në **60 raste** ndaj subjekteve që kanë qenë në shkelje të ligjit nuk është marrë masë administrative gjobë, si dhe në **22 raste** në 60 gjithësej veç masës administrative gjobë nuk është vendosur ndalimi i përdorimit të instrumentit matës të karburantit, matësave të ujit, tregëtimit të produkteve të ndryshme elektrike, korrigjimit të shkeljeve, njoftimit të konsumatorit, etj;
- Në **7 raste** masa administrative e marrë me vendim të ndërmjetëm, është hequr në vendimin përfundimtar të inspektimit në mungesë të arsyetimit ligjor. Kjo për produkte të ndryshme si Rezistenca, Bolier, Panel Diellor, Dekoder dixhital, Kamera inteligjente, Bateri për kompjuter PC, Ngrohës të ndryshëm, Hekur rrobash etj;
- Në **12 raste** trajtim me dy standarde në marrjen e vendimeve/kryerjen e veprimeve inspektuese në subjekt;
- Në **1 rast**, ku nuk është kryer kallëzim penal ndaj subjektit tregëtues të karburanteve, i cili nuk ka lejuar kryerjen e inspektimit, si dhe ka dëmtuar vulat e bllokimit të instrumenteve, duke kaluar në regjim manual të përdorimit të tyre dhe ndërprerje të lidhjes së instrumentit me kasën fiskale.

Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 50 dhe nenin 64 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 ñPër metrologjinëò, i ndryshuar; Nenin 43, 48 dhe 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 ñPër inspektimin në RSHò; Nenin 27, 30 dhe 35 të Ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 ñPër tregëtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimoreò, ndryshuar; Nenin 182 dhe 235 të Ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 ñKodi Penal i Republikës së Shqipërisëò, ndryshuar; Nenin 13 dhe pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr.44/2015 ñKodi i Procedurave

[45] ñPër miratimin e rregullave të përgjithshme bazë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë inspektuese dhe kriteret e vlerësimit dhe raportimit të tyreò.

Administrative i Republikës së Shqipërisëò. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.1 dhe 2.2) faqe (17-115dhe 116-126) të Raportit të Auditimit)*

9.1.Rekomandimi:ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative ñgjobëò, urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit.

9.2.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmangë trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës.

Në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi:NëISHMT, për të dy vitet 2019-2020, u konstatua se:

-Nuk janë mbajtur të dhëna analitike për të ardhurat dhe shpenzimet (ditarët e të ardhurave dhe shpenzimeve, ditari i veprimeve të ndryshme dhe libri i madh);

-Në ditarin e Bankës, regjistrimet kontabël prekin vetëm llogaritë financiare dhe të shpenzimeve dhe jo të gjithë llogaritë e tjera;

-Rregjistri i aktiveve ka mangësi lidhur me plotësimin e kërkesave minimale siç janë: data e daljes në përdorim, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes. Këto mosveprime janë në kundërshtim meLigjin nr.25/2018, datë 10.05.2018ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar, pikën 28 në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Udhëzimin e MFE nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Kreu III, pikat 26-33 dhe pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (219-233) të Raportit të Auditimit)*

10.1.Rekomandimi: ISHMT të hapë dhe të mbajë librat analitikë të të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, si dhe të gjithë ditarët e tjerë dhe analizat/libri i madh. Në ditarin e Bankës, regjistrimet kontabël të kryhen në llogaritë financiare dhe të llogarive të tjera, sipas veprimeve dhe ngjarjeve konkrete dhe të mos kalohen në çdo rast direkt në shpenzime. Për pasqyrat financiare, të përgatiten inventarët dhe analizat sipas posteve të bilancit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019-2020, lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit, në pasqyrat financiare nuk evidentohet shuma e akumuluar e amortizimit në llogaritë 209 dhe 219, nuk evidentohet llogaria 1013 por vetëm në pasqyrën nr.4, si dhe në pasqyrën e Performancës financiare Rubrika 7, Llogaria 681 ñKuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimitò. Në aktivin e pasqyrave vjetore nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 209 dhe 219, respektivisht për Aktivet afatgjata jomateriale dhe Aktivet afatgjata materiale, si dhe paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre (kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 31. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (219-233) të Raportit të Auditimit)*

11.1. Rekomandimi: ISHMT të marrë masa për të ardhmen lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit dhe në pasqyrat financiare të evidentojë shumat e akumuluara të amortizimit, në llogaritë 209 dhe 219, dhe të evidentohet llogaria 1013. Llogaria 681, të evidentojë saktësisht shumat vjetore të amortizimit të AAGJ.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në Ligjin nr.44/2015 ñ*Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë*ò, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, i ndryshuar, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues), të merren masa e të kërkohet në rrugë administrative dhe ligjore, shpërblimin e dëmit të krijuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën *7,434 mijë lekë*[46], si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i proçedurës së marrjes me qera të ambjenteve për zyra, është konstatuar se:
-Janë paguar 1,545,771 lekë për pasurinë e llojit ñBanimò me nr.X + 1-2 (kati i dytë banim) ZK X, vol X, faqe X, datë 27.08.2020, sipërfaqe 191.6 m^2, me mangësi në dokumentacionin vërtetues për garantimin e gëzimit të qetë të saj, në kushtet kur kjo pasuri ka qenë e bllokuar në favor të palëve të treta. Veprime që bien në kundërshtim me nenet 674, 802, 806, 807 të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil në RSHò, i ndryshuar, si dhe shkronjat ñaò dhe ñbò të pikës 35, si dhe pikën 36 në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-Janë paguar 4,303,094 lekë paradhënie për 6 muaj, për rregullime/punime në objekt, në mungesë të miratimit paraprak të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, në mungesë të referimit ligjor specifik siç kërkohet. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikat 160 dhe 161 të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar.
1.1.Rekomandimi:ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për fillimin e procedurës për arkëtimin nga pronari i objektit, shtetasi A.N, të dëmit ekonomik në vlerën 1,545,771 lekë, shkaktuar në buxhetin e shtetit.

1.2.Rekomandimi: Ministria e Financës dhe Ekonomisë (institucioni epror i ISHMT) të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për fillimin e procedurës së ndërprerjes së kontratës ndërmjet ISHMT dhe shtetasit A.N, kthimin në buxhetin e shtetit të shumës së paradhënies përfituar nga pronari i objektit, në vlerën 4,303,094 lekë, si dhe sigurimin e ambjenteve për zyra për ISHMT.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik për vitin 2019 ñblerje instrumenta dhe pajisje për inspektim në terrenò, është konstatuar se, OE ñF.Dò shpk, i shpallur fitues, nuk ka sjellë sipas specifikimeve teknike në DST (vlerësimi i konformitetit dhe vendosja e markimit CE në produkt, element kostoje të produktit por që nuk mund të maten), mallin e kërkuar ñSky Ray Instrument-Spektometëròë vlerën 2,250,000 lekë pa TVSH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
2.1.Rekomandimi:ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, duke i kërkuar OE ñF.Dò shpk, të dorëzojë aparatin ñS*pektometër*ò në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara, ose në të kundërt arkëtimin e vlerës 2,250,000 lekë pa TVSH.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik për vitin 2020 ñblerje instrumenta dhe pajisje për inspektim në terrenò, është konstatuar se, OE ñN.Vò shpk, i shpallur fitues, nuk ka sjellë sipas specifikimeve teknike në DST (vlerësimi i konformitetit, vendosja e markimit CE në produkt, kalibrimi i instrumentave, element kostoje të produktit por që nuk mund të maten), mallrat e kërkuara në vlerën 2,454,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

[46]Përfshirë vetëm vlera e matshme.

3.1.Rekomandimi:ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, duke i kërkuar OE N.V shpk, të dorëzojë mallrat ñMatës i shkallës së ndriçimit, Seri gramarësh 1g-500g, Seri gramarësh 1mg-500mg, Aparat për matjen e volumit të gazit, Kronometër, si dheTestues izolacioni multimetërò në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara, ose në të kundërt arkëtimin e vlerës 2,454,000 lekë pa TVSH, të produkteve të mësipërme.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me vlerë të ulët, për vitin 2020 ñPajisje për videokonferencë dhe panel akses kontrolliò, si dhe referuar fletë-hyrjes nr.19, datë 16.12.2020 të hyrjes së mallrave në magazinë e ISHMT, është konstatuar se, nga OE ñA.Oò, person fizik, janë shtuar mallra/shërbime në vlerën 426,000 lekë, të cilat nuk kanë qenë objekt prokurimi sipas Urdhërit të Prokurimit nr.230, datë 07.12.2020, të Titullarit të ISHMT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi:ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 426,000 lekë, nga OE ñA.Oò person fizik.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me vlerë të ulët për vitin 2020 ñblerje pajisje kompjuterikeò, është konstatuar se, OE ñI.N Alò shpk, i shpallur fitues, nuk ka sjellë sipas specifikimeve teknike, mallrat e kërkuara (kompjutera dhe laptop 20 cop gjithësej) në vlerën 712,450 lekë pa TVSH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi:ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 712,450 lekë, nga OE ñI.N Alò shpk, si pasojë e mosdorëzimit nga ky i fundit të mallrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara, ose në të kundërt të kërkojë dorëzimin e tyre sipas specifikimeve teknike.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me vlerë të ulët për vitin 2021 ñblerje pajisje kompjuterikeò, u konstatua se:

-Nga Komisioni i Prokurimit me përbërje A.M, M.K dhe H.Zh, është sõkualifikuar padrejtësisht nga gara OE ñJ.Bò renditur i pari me ofertën ekonomike në vlerën 290,000 lekë pa TVSH dhe është shpallur fitues oferta me vlerën 681,200 lekë pa TVSH duke shkaktuar një dëm ekonomik për diferencën në vlerën 391,200 lekë pa TVSH.

- Janë marrë në dorëzim, 3 (tre) kompjutera, në vlerën 156,576 lekë pa TVSH, jo në përputhje me specifikimet teknike, shpenzimet e të cilave përbëjnë dëm ekonomik i shkaktuar buxhetit të shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi:ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 391,200 lekë, nga personat përgjegjës zj.A.M, z.H.Zh dhe zj.M.K, në mënyrë përpjestimore, si pasojë e sõkualifikimit të padrejtë të OE renditur i pari.

6.2.Rekomandimi:ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 156,576 lekë, nga OE ñI.N Alò shpk, si pasojë e mosdorëzimit nga ky i fundit të mallrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara, ose në të kundërt të kërkojë dorëzimin e tyre sipas specifikimeve teknike.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik për vitin 2021 ñblerje instrumenta dhe pajisje për inspektim në terrenò, është konstatuar se, OE ñL.G shpkò, i shpallur fitues, nuk ka sjellë sipas specifikimeve teknike në DST, aksesorët e produktit (vlera e të cilëve nuk mund të matet), mallin e kërkuar ñPeshore me precision të lartëò, në vlerën, 450,000 lekë pa TVSH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
7.1.Rekomandimi:ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, duke i kërkuar OE L.G shpk, të dorëzojë mallrat ñpeshore me precizion të lartëò në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara, ose në të kundërt arkëtimin e vlerës 450,000 lekë pa TVSH, të produktit.

Menjëherë

B.1.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, është konstatuar se në 4 raste për gjobat e vendosura në vlerën 700,000 lekë ndaj subjekteve (L, A.E, A-2000, M.M), të cilat janë kthyer në vendim të formës së prerë, nga ISHMT nuk janë marrë masa për ekzekutimin dhe arkëtimin e tyre (kërkesë për lëshimin e urdhërit për ekzekutim/përcjelljen pranë përmbaruesit të vendimit të gjykatës), me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit, mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 9, shkronjën b të pikës 4 të nenit 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò dhe nenet 511 dhe 515 të Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 ñKodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.1 dhe 2.2) faqe (17-115 dhe 116-126) të Raportit të Auditimit)*
1.1.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme për të bërë kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në Gjykatën e Shkallës së Parë/përcjelljen pranë përmbaruesit të vendimit të gjykatës, me qëllim vënien në ekzekutim të gjobave të vendosura, si dhe eleminimin e efekteve negative financiare në buxhetin e shtetit.

Menjëherë

C.MASA ADMINISTRATIVE.

C.I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2018 deri më 30.01.2021, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 23, të ligjit nr. 162/2020 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, me qëllim marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, ndaj 7 punonjësve, sipas rolit të tyre në procedurë,për procedurat e prokurimit si vijon:

I.Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave në dy procedura prokurimi.

Procedura e prokurimit "Pajisje dhe instrumenta për inspektim", viti 2020.
Vlerësimi i ofertës së shpallur fituese, nga operatori ekonomik ñN.Vò shpk:
-Komisioni i Vlerësimit të Ofertës z. J.Ll, Kryetar, z.L.L, Anëtar dhe z.G.N, Anëtar, ngritur me Urdhërin nr.100, datë 09.07.2020 të Titullarit të ISHMT.

-Procesverbal i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa nr., prot., datë 29.07.2020.

Nga verifikimi i kryer në sistemin e Agjencisë Prokurimit Publik (APP), të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik, i shpallur fitues[47] konstatohet se ky i fundit nuk ka përmbushur kërkesat e kapacitetit teknik dhe specifikimet teknike për mallrat, të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht:
-Dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së procedurës ï nuk e plotëson;
-Dorëzimin e referencave të kalibrimit nga laborator të akredituar me certifikatën ISO 17025 të pajisjeve të kryera gjatë 3 viteve të fundit ï nuk e plotëson;
-Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, në rast se paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit ï nuk e plotëson;
-Certifikatë kalibrimi për produktet 14 dhe 15 ñSeri Gramarëshò (1g - 500g) dhe 1 mg ï 500 mg-nuk e plotëson;
-Certifikata e kalibrimit për produktin 16 ñAparat për matjen e volumit të gazitò-nuk e plotëson;
-Certifikata e kalibrimitpër produktin 4 ñKalibër, digjitalò-nuk e plotëson**.**
-Certifikata e kalibrimit për produktet 12 dhe 13 ñInstrument matës temperature me një sensor N, me bateriò-nuk e plotëson;
-Certifikata e kalibrimit për produktinpër produktin 17 ñKronometërò- nuk e plotëson.
▪ Sa më sipër, si pasojë e mospërmbushjes së kritereve të vendosura në DST, nga KVO nuk duhet të ishte shpallur fitues subjekti ñN.Vò shpk.
(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)

Procedura e prokurimit "Pajisje dhe instrumenta për inspektim", viti 2021.
Vlerësimi i ofertës së shpallur fituese, nga operatori ekonomik ñL.Gò shpk:
-Komisioni i Vlerësimit të Ofertës z.J.Ll, Kryetar, z.E.S, Anëtar dhe z.G.N, Anëtar, ngritur me Urdhërin nr.55, datë 04.03.2021 të Titullarit të ISHMT.
-Procesverbal i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa nr., prot., datë 19.03.2021.

-Nga KVO nuk është mbajtur procesverbali, në datën e hapjes së ofertave, por vetëm procesverbali i vlerësimit të ofertave;
-Nuk administrohet deklarata e konfliktit të interesave e anëtarëve të KVO-së, në ditën e hapjes së ofertave, por deklarata e konfliktit të interesave është nënshkruar nga anëtarët e KVO-së, më datë 04.03.2021;
-Vërtetimi elektronik i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për xhiron e 3 viteve të fundit (2018, 2019, 2020) ï nuk e plotëson;
-Dorëzimin e pasqyrave financiare të certifikuara për vitet 2018, 2019 dhe 2020;
-Dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se procedures pra për vitet 2020, 2019 dhe 2018 ï nuk e ka plotësuar;
-Deklarata e garancisë për produktet e sjella nga OE, nuk është në përputhje me përcaktimet ligjore, pasi nuk specifikohet se çfarë mbulon garancia në produktet e sjella/zonën mbi të cilën vepron ajo;
-Në katalogun e sjellë për produktin veshje mbrojtëse nga rrezatimi X, nuk jepet informacion për specifikimin ñMbi të gjithë tensionin e tubit me rreze X, shkon nga 50 - 150 kVò, si dhe standardi

[47] https://www.app.gov.al:446/

i kërkuar nga AK që të plotësohet nga produkti IEC 61331-1 / EN 61331-1[48], nuk përputhet me standardin DIN 61331-3[49] që pasqyrohet në katalogun e produktit;
-Sipas specifikimeve teknike për produktin peshore me precision të lartë, i përket modelit Peshore ABP 300-4M, ndërkohë katalogu i sjellë nga OE L.Gme të dhënat teknike të produktit, i përket një modeli tjetër peshoreje ABP 100-5DM;
-Deklarata e konformitetit për produktin peshore, që administrohet në dosjen e tenderit si dhe në sistemin e APP, nuk është në përputhje me elementët që duhet të përmbajë ky dokument, konkretisht ajo nuk ka numrin e identifikimit unik të produktit, emrin dhe adresën e prodhuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar, që në këtë rast duhet të ishte L.G shpk;
-Deklarata e konformitetit për produktin ñAparat për Togëzimò nuk i përket llojit F 1625-2, atij të kërkuar nga AK, por llojit F 1625 (pra jo të produktit të kërkuar);
-Deklarata e konformitetit për produktin Aparat për Togëzim, duke marrë në konsideratë përcaktimet e bëra në nenin 8 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 ñPër tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar, si dhe autorizimin e prodhuesit (F Europe, B.V. Eindhoven, Netherlands) për produktin e mësipërm (ku është autorizuar si distributor ME Slloveni, e më pas nga ky i fundit është autorizuar L.G shpk), duhet të ishte lëshuar nga prodhuesi i produktit që në këtë rast është F Europe, B.V. Eindhoven, Netherlands, i cili ka lëshuar edhe autorizimin e prodhuesit. Nga shqyrtimi i kësaj deklarate rezulton se ajo është lëshuar nga prodhuesi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku minimalisht duhet të ishte lëshuar për prodhuesin e autorizuar në Europë, për të provuar lidhjen ndërmjet Kompanisë Mëmë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ï Filialit të saj në Europ (Holland) ï Distributorit të Autorizuar në Slloveni ñMEò ï L.G shpk.
-Për më tepër theksojmë se nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit në prani të magazinieres së ISHMT, rezultoi se produkti Aparat për Togëzim, në pjesën e pasme të tij ka mbishkrimin **"Made in Romania"**/ñProdhuar në Rumaniò (pasqyruar në foton nr.6, **Aneksi nr.4**), pra që nuk lidhet aspak me prodhuesin F Europe, B.V. Eindhoven, Netherlands, që ka lëshuar autorizimin për ME.
▪ Sa më sipër, si pasojë e mospërmbushjes së kritereve të vendosura në DST, nga KVO nuk duhet të ishte shpallur fitues subjekti ñL.Gò shpk.
(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)

II.Për Njësinë e Prokurimit në një procedurë prokurimi.
Procedura e prokurimit "Pajisje dhe instrumenta për inspektim", viti 2021.
-Hartuesit e dokumenteve të tenderit, grupi zj.F.C, Kryetar, z.A.H, Anëtar dhe z.E.L, Anëtar, ngritur me Urdhrin nr.51, datë 26.02.2021, të Titullarit të ISHMT.
Kontrata nr.633/4, prot., datë 22.06.2021, ISHMT-L.G shpk:
-Në DST, specifikimet teknike, është përcaktuar që në rast nevoje OE, duhet të marrë përsipër trajnimin e stafit për pajisjet e ofruara, kërkesë e cila nuk është parashikuar edhe në kontratën e lidhur ndërmjet palëve;
-Vërtetimi noterial më datë 11.03.2021, NR.REP.1168 (pasqyruar në foton nr.3, **Aneksi nr.4,Raporti i Auditimit**), për vërtetim përkthimi nga përkthyesi zj.JT, që administrohet në dosjen e tenderit, është fotokopje, si dhe gjykojmë dhe vlerësojmë se është i pavlefshëm, për arsye nuk përmban vulën e thatë (që vendoset mbi aktin noterial) si dhe pullën e taksës;
-Vërtetimi noterial më datë 11.03.2021, NR.REP.1169 (**tjetër vërtetim,** pasqyruar në foton nr.4, **Aneksi nr.4, Raporti i Auditimit**), për vërtetim përkthimi nga përkthyesi zj.JT, që administrohet në dosjen e tenderit, është fotokopje, si dhe gjykojmë dhe vlerësojmë se është i pavlefshëm, për arsye nuk përmban vulën e thatë (që vendoset mbi aktin noterial) si dhe pullën e taksës;

[48] https://webstore.iec.ch/publication/5289
[49] https://global.ihs.com/doc_detail.cfm?document_name=DIN%20EN%2061331%2D3&item_s_key=00622800?document_name=DIN\x20EN\x2061331\x2D3&item_s_key=00622800&FORCEAPPLICATIONREFRESH=0

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)

D. MASA DISIPLINORE

D.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

D.1.1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Mbështetur në nenin 57 ñPërgjegjësia për masat disiplinoreò, nenin 58 ñLlojet e masave disiplinoreò, germa ñaò dhe nenin 59 ñKompetenca dhe procedura për masat disiplinoreò të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civilò, i rekomandojmë Ministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, fillimin e proçedurës, për marrjen e masës disiplinore **"Vërejtje"**ndaj:

- **Z. L.S**, me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes së Tregut, për shkelje të kryera prej tij, gjatë ushtrimit të detyrës si Titullar i institucionit. Konkretisht për veprime dhe mosveprime në përputhje me kuadrin rregullator përkatës:

-12 raste për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektimin e subjektit, me qëllim verifikimin e respektimit të detyrimeve të lëna në inspektimin e mëparshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*

-5 raste në inspektimet jashtë planit të miratuar, për mosnxjerrjen e autorizimit me elementët që kërkohen nga kuadri ligjor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*

-4 raste mosbërjen e kërkesës në Gjykatë, për nxjerrjen e urdhërit për ekzekutimin e gjobave të vendosura nga ISHMT. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.1 dhe 2.2) faqe (17-115 dhe 116-126) të Raportit të Auditimit)*

-8 raste në procedurat e prokurimit, për mosnxjerrjen e urdhërit për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallrave të furnizuara, si dhe shmangien e konfliktit të interesit, ku i njëjti grup pune është lënë të hartojë specifikimet teknike, vlerësimin e ofertave dhe marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

-2 raste për mosngritjen e njësisë së prokurimit sipas përcaktimeve ligjore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

-2 raste për përdorimin pa efektivitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore në vlerën 11,062,800 lekë, ku janë prokuruar instrumenta për inspektim dhe që nuk janë përdorur për një periudhë prej 1-1.5 vite. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

-1 rast për lidhjen e kontratës për marrjen me qera të ambienteve për zyra, në kundërshtim me detyrimet ligjore që përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

-1 rast në procedurën e marrjes me qera të ambienteve për zyra, për kryerjen e parapagimit prej 6 muajsh ndaj pronarit të objektit në vlerën 4,303,094 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

D.1.2. Mbështetur në nenin 57 ñPërgjegjësia për masat disiplinoreò, nenin 58 ñLlojet e masave disiplinoreò, germa ñaò dhe nenin 59 ñKompetenca dhe procedura për masat disiplinoreò të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civilò, i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, fillimin e proçedurës, për marrjen e masës disiplinore **"Largim nga shërbimi civil"**ndaj:

➢ **Z. J.Ll**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve, për shkelje shumë të rënda të kryera prej tij, shoqëruar me efekte financiare, gjatë ushtrimit të detyrës si drejtues drejtorie. Konkretisht për veprime dhe mosveprime në përputhje me kuadrin rregullator përkatës:
-2 raste në vitin 2019 dhe 2020, si kryetar i grupit të marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar, për marrjen në dorëzim të mallit, i cili nuk ka qenë në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-1 rast në vitin 2020, si kryetar i grupit të marrjes në dorëzim, për marrjen në dorëzim të ambjenteve me qera, jo sipas kërkesave të përcaktuara në kontratë dhe udhëzimit pëkatës për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-1 rast për parregullsitë e konstatuara në hartimin e specifikimeve teknike dhe ndryshimin e tyre, në procedurën e marrjes me qera të ambjenteve për zyra. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-2 raste në vitin 2020 dhe 2021, si kryetar i KVO-së, për shpalljen fitues të OE N.V shpk, dhe OE L.G shpk, në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në DST. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-2 raste për përdorimin pa efektivitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore në vlerën 11,062,800 lekë, ku z.J.Ll, ka bërë kërkesë për blerjen e instrumentave për kryerjen e inspektimeve, ndërkohë nuk ka marrë masa për përdorimin e tyre, për një periudhë prej 1-1.5 vite. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

<u>"Vërejtje me paralajmërim", ndaj:</u>
➢ **z. L.L**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Produkteve Elektrike,
-Për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë konstatuar në 14 raste inspektimesh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
-Për 1 rast në procedurën e marrjes me qera të ambjenteve për zyra, si anëtar i KVO-së, për shpalljen fitues të subjektit, i cili nuk ka plotësuar kriteret e vendosura. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (128-219) të Raportit të Auditimit)*
-Për 1 rast në vitin 2020, si anëtar i KVO-së, për shpalljen fitues të OE N.V shpk, në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në DST. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-Për 1 rast në vitin 2021, si anëtar i grupit të marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar, për marrjen në dorëzim të mallit, i cili nuk ka qenë në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
➢ **Zj. F.C**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Inspektimit të Produkteve Kimike, -Për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë konstatuar në 7 raste inspektimesh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
-Për 1 rast në vitin 2019, si anëtare e grupit të marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar, për marrjen në dorëzim të mallit, i cili nuk ka qenë në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-Për 1 rast në procedurën e marrjes me qera të ambjenteve për zyra, si kryetare e KVO-së, për shpalljen fitues të subjektit, i cili nuk ka plotësuar kriteret e vendosura. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-Për 1 rast në vitin 2020, si anëtare e grupit të marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar, për marrjen në dorëzim të mallit, i cili nuk ka qenë në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-Për 5 raste në vitin 2021, si kryetare e njësisë së prokurimit, në procedurën e blerjes së instrumentave për inspektim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
➢ **Zj. S.B**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Inspektimit të Produkteve Mekanike,

-Për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë konstatuar në 4 raste inspektimesh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
-Për 1 rast për parregullsitë e konstatuara në hartimin e specifikimeve teknike dhe ndryshimin e tyre, në procedurën e marrjes me qera të ambjenteve për zyra. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-Për 1 rast në vitin 2020, si anëtare e grupit të marrjes në dorëzim, për marrjen në dorëzim të ambjenteve me qera, jo sipas kërkesave të përcaktuara në kontratë dhe udhëzimit pëkatës për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-Për 1 rast në vitin 2020, si anëtare e grupit të marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar, për marrjen në dorëzim të mallit, i cili nuk ka qenë në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*
-Për 1 rast në vitin 2021, si anëtar i grupit të marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar, për marrjen në dorëzim të mallit, i cili nuk ka qenë në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

- **Z. R.G** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të të Drejtave të Autorit,

-Për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë konstatuar në 7 raste inspektimesh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (116-126) të Raportit të Auditimit)*
- Për 1 rast në vitin 2020, si anëtar i grupit të marrjes në dorëzim, për marrjen në dorëzim të ambjenteve me qera, jo sipas kërkesave të përcaktuara në kontratë dhe udhëzimit pëkatës për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

<u>"Vërejtje", ndaj punonjësve:</u>

- **Z. R.H**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 10 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. A.H**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 10 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. G.N**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 10 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. E.S**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë 10 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Zj. I.Xh**, me detyrë Inspektore, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 10 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. I.B**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 10 raste të inspektimeve *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. A.H**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 10 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z.Sh.S**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë konstatuar në 7 raste inspektimesh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z.B.G**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë konstatuar në 6 raste inspektimesh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. E.D**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 6 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Zj. J.O**, me detyrë Inspektore, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në në 6 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. O.B**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 6 raste të inspektimeve *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Zj. A.M**, me detyrë Inspektore, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 5 raste të inspektimeve *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*

- **Z. E.L**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndëisë së lartë në 4 raste të inspektimeve dhe mangësi në 2 raste në procedurat e prokurimit, si anëtar i grupit të marrjes në dorëzim të mallrave të furnizuar dhe hartues i dokumenteve të tenderit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. N.Z**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 4 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. A.R**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 4 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. E.Sh**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 3 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. E.Sh**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë konstatuar në 3 raste inspektimesh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (116-126) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. E.M**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 2 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Z. J.M**, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi të rëndësisë së lartë në 2 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit).*
- **Z. R.B**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Metrologjik, për të meta dhe mangësi në 2 raste të inspektimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-115) të Raportit të Auditimit)*
- **Zj. E.Xh**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, për të meta dhe mangësi në 2 raste, konkretisht në hartimin e specifikimeve teknike në procedurën e marrjes me qera të ambjenteve për zyra, si dhe në hartimin dhe plotësimin e dokumentacionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (126-218) të Raportit të Auditimit)*

V.ANEKSE

Aneksi nr.1 ñPër kategorizimin e riskut, llogaritjen e materialitetit dhe përzgjedhjen e kampionit të auditimitò.

Tabela nr.1 Kategorizimi i riskut dhe përzgjedhja e numrit të kampionit për tû audituar

Nr.	Aktiviteti	Niveli i Riskut	Kampioni i përzgjedhur
1	Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve	I Lartë	250
2	Drejtoria e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale	I Mesëm - I Lartë	100
5	Shpenzimet financiare	I Mesëm - I Lartë	Sipas materialitetit
6	Raportimi	I Ulët - I Mesëm	Sipas materialitetit

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vlerësimi i materialitetit mbi shpenzimet e institucionit, llogaritur për vitin 2019 (e njëjta mënyrëështë përdorur edhe për periudhat e mëpasshme)[50].

Tabela nr.2 Shpenzimet e ISHMT 2019

Pershkrimi	Plani vjetor	Realizimi me banke/thesar	%
SHPENZIME BUXHETORE TOTAL	131,000,000	68,806,000	53
PAGA, SHPERBLIME DHE TE TJERA SHPENZIME PERSONELI	90,000,000	46,011,000	51
KONTRIBUTE PER SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE	13,000,000	7,648,000	59
MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA	14,000,000	9,676,000	69
INVESTIME	14,000,000	5,471,000	39
TRANSFERIME NE BUXHETET FMILJARE	0	0	0

Burimi: ISHMT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- **Niveli i materialitetit:** 2% * 57,592,102 lekë = 1,376,120 lekë
- **Gabimi i lejuar:** 1,376,120 lekë * 10% = 137,612 lekë
- **Saktësia:** 1,376,120 lekë ï 137,612 lekë = 1,238,508 lekë
- **Preçizioni i materialitetit** ose gabimet e mundshme për gjithë popullatën (vlerën totale të shpenzimeve të institucionit) 1,238,508 lekë * 90% = 1,114,657 lekë
- Numri i çështjeve për tu shqyrtuar për totalin e popullatës: (68,806,000 lekë * 0.7 faktorin e riskut) : 1,238,508 lekë = **38 çështje**

Numri i çështjeve për tu shqyrtuar për një nga llogaritë ekonomike që ka risk më të lartë se të tjerat, në gjykimin e grupit të auditimit, mallra dhe shërbime, (9,676,000 lekë * 0.7)/ 1,238,508 lekë = **5 ose 6 çështje**

Aneksi nr.2 ñPër auditimin e funksionit të inspektimit të produkteve joushqimore (metrologji, kimike, lodra, elektrike, mekanike)ò.

Aktiviteti i inspektimit

Tabela nr.5 Realizimi i inspektimeve dhe gjobat e vendosura për vitin 2019 dhe 2020 nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve

DMP	Numri i inspektimeve	Numri i inspektimeve brenda planit	Numri i inspektimeve jashte planit planit	Gjoba	Në lekë
VITI 2019	1151	997	154	17	5,850,000
VITI 2020	1250	840	410	24	6,300,000

ISHMT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.6 Realizimi i inspektimeve dhe gjobat e vendosura për vitin 2019 dhe 2020 nga Drejtoria e Pronësisë Industriale dhe Intelektuale (të drejtat e autoriti, licenca, autorizime, kontrata)

DPII	Numri i inspektimeve	Numri i inspektimeve brenda planit	Numri i inspektimeve jashte planit planit	Gjoba	Në lekë
VITI 2019	390	311	79	29	3,350,000

[50]Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, Kapitulli 3.4 ñMaterialitetiò

VITI 2020	396	375	21	21	3,400,000

ISHMT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT